



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada–Government

PROGRAMI PËR REFORMA NË EKONOMI (PRE)

2022-2024

Prishtinë, Janar 2022

Tabela e përmbajtjes

1.	KORNIZA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT	6
2.	ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË POLITIKAVE	6
3.	KORNIZA MAKROEKONOMIKE.....	14
3.1.	Mjedisi i jashtëm ekonomik.....	14
3.2.	Zhvillimet e fundit ekonomike në Kosovë dhe perspektiva për vitin 2021	17
3.2.1.	Sektori real	17
3.2.2.	Treguesit kryesorë të tregut të punës	21
3.3.	Skenari makroekonomik afatmesëm.....	23
3.3.1.	Parashikimet e sektorit real	23
3.3.2.	Politika monetare dhe e kursit të këmbimit dhe inflacioni.....	24
3.3.3.	Sektori i jashtëm dhe qëndrueshmëria e tij afatmesme	25
3.3.3.1.	Llogaria rrjedhëse	25
3.3.3.2.	Llogaria financiare	28
3.4.	Sektori financiar	29
3.5.	Skenarët alternative dhe reziqet	32
4.	KORNIZA FISKALE	36
4.1.	Zbatimi i buxhetit në vitin 2021 (Të dhëna preliminare)	36
4.2.	Përmbledhje e implikimeve fiskale të krizës Covid-19	38
4.3.	Planet e buxhetit për vitin 2022 dhe periudhën afatmesme	39
4.4.	Parashikimi i shpenzimeve për vitin 2022 dhe periudhën afatmesme	40
4.5.	Bilanci strukturor fiskal	41
4.6.	Nivelet dhe zhvillimet e borxhit, analiza e operacioneve të mëposhtme dhe rregullimet e flukseve të stoqeve	44
4.7.	Analiza e ndjeshmërisë dhe krahasimi me programin e mëparshëm	45
4.7.1.	Krahasimi me programin e kaluar	45
4.8.	Qeverisja fiskale dhe kornizat buxhetore	46
4.9.	Qëndrueshmëria e financave publike	46
4.9.1.	Qëndrueshmëria e Borxhit	47
5.	REFORMAT STRUKTUREORE 2022-2024.....	57
5.1.	Përditësim mbi tri pengesat kryesore për konkurrencën dhe rritjen gjithëpërfshirëse dhe masa përkatëse të reformës	57
5.2.	Analiza e pengesave në fushat tjera dhe masat lidhur me reformat strukturore.....	73
5.2.1.	Menaxhimi i Financave Publike.....	73
5.2.2.	Tranzicioni i gjelbër	75
5.2.3.	Transformimi digjital	78
5.2.4.	Mjedisi i biznesit dhe zvogëlimi i ekonomisë joformale	82
5.2.5.	Hulumtim, Zhvillimi dhe Inovacion	87

5.2.6.	Reformat për integrim ekonomik	90
5.2.7.	Reforma e Tregut të Energjisë	95
5.2.8.	Reformat në tregjet e transportit	97
5.2.9.	Bujqësia, Industria dhe Shërbimet	100
5.2.10.	Edukimi dhe aftësitë.....	111
5.2.11.	Punësimi dhe tregu i punës	115
5.2.12.	Mbrojtja dhe përfshirja sociale	116
5.2.13.	Sistemet Shëndetësore.....	120
5.3.	Përmbledhje e masave të reformës.....	121
6.	KOSTOT DHE FINANCIMI I REFORMAVE STRUKTURE.....	123
7.	ÇËSHTJET INSTITUCIONALE DHE PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESIT....	124
SHTOJCA 1: TABELAT E PROGRAMIT PËR REFORMA NË EKONOMI 2022-24.....		125
SHTOJCA 2: LIDHJET MES FUSHAVE TË REFORMËS DHE DOKUMENTEVE TË POLITIKËS PËRKATËSE.....		169
SHTOJCA 3: KONTRIBUTI I JASHTËM NË PRE 2022-2024		180

Figure 1. Numri i dozave të administruara për 100 banorë sipas vendeve fqinje dhe të ardhurave	15
Figure 2. Perspektiva e rritjes së BPV-së – Komisioni Evropian	16
Figure 3. BPV me çmime i vitit paraprak – i përshtatur sipas sezonave.....	17
Figure 4. Kontributi i inflacionit të tregtueshëm dhe të patregtueshëm	20
Figure 5. Inflacioni total kundrejt inflacionit bazë	20
Figure 6. Paga mesatare bruto në ATK, në euro	22
Figure 7. BPV-ja reale dhe kontribuuesit kryesorë.....	23
Figure 8. Indeksi Herfindahl Hierchman	25
Figure 9. Indeksi i hapjes së tregtisë.....	26
Figure 10. Përbërësit e llogarisë financiare, mln Eur.....	28
Figure 11. Pozicioni neto i investimeve ndërkombëtare, mln Eur.....	29
Figure 12. Rritja e kreditimit në sektorin privat.....	30
Figure 13. Detyrimet e korporatave publike jo financiare (NP-ve) si përqindje e BPV-së (2019) (Eurostat, 2021).....	33
Figure 14. Pjesëmarrja e detyrimeve gjithsej sipas NP-ve (përqindje e BPV-së).....	35
Figure 15. Struktura e të hyrave në gjithsej të hyrat	40
Figure 16. Struktura e shpenzimeve buxhetore.....	41
Figure 17. Bilanci primar i parregulluar, bilanci strukturor primar dhe hendeku i prodhimit (2007-2024).....	43
Figure 18. Bilanci strukturor primar, pozicioni fiskal dhe impulsi fiskal (2007-2024).....	43
Figure 19. Borxhi si % e BPV-së- Skenari Bazë	Figure 20. Nevoja për Financim% e BPV-së- Skenari Bazë
Figure 21. Struktura e Bilancit të Përgjithshëm- Skenari Bazë (mil Eur).....	49
Figure 22. Niveli i Borxhit sipas Skenarit Bazë dhe Skenarëve Alternativë	50

Table 1. Çmimet në tregjet ndërkombëtare.....	17
Table 2. Treguesit paraprak dhe të rastësisë për përbërësit e kërkesës agregate.....	18
Table 3. Treguesit kryesorë të tregut të punës	21
Table 4. Eksporti dhe importi i mallrave dhe shërbimeve	27
Table 5. Pasqyrat financiare të përmbledhura për sektorin e NP-ve (mijëra euro).....	34
Table 6. Operacionet e Qeverisë së Përgjithshme, në miliona Euro	38
Table 7. Vlerësimi i ndikimit fiskal të krizës së Covid-19 në vitin 2021	39
Table 8. Borxhi i përgjithshëm i qeverisë, në milion euro (përveç nëse tregohet ndryshe).....	45
Table 9. Garancitë shtetërore	45

LISTA E SHKURTESAVE

ZAK	Zgjidhja alternative e kontesteve	MBPZhr	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
TAP	Tregu aktiv i punës	MCC	Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit
PBZHR	Programi i bujqësisë dhe zhvillimit rural	MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
TKB	Treguesi i klimës së biznesit	MZhd	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
BEEPS	Anketa e mjedisit biznesor dhe performancës së ndërmarrjeve	MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës	MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore	MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
CMIS	Sistemi informativ për menaxhimin e lëndëve	MF	Ministria e Financave
IÇK	Indeksi i çmimeve të konsumit	MD	Ministria e Drejtësisë
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës	NMVM	Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme
KE	Komisioni Europian	KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
EE	Eficienca e energjisë	MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
DEE	Direktiva e efikasitetit të energjisë	SKZH	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit
EFTA	Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë	NEET	Jo në arsim, punësim ose trajnim
SIMAS	Sistemi informativ për menaxhimin e arsimit	OJQ	Organizatat joqeveritare
IPN	Inxhinieria, Prokurimi dhe Ndërtimi	PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
ARE	Agjenda e Reformave Evropiane	OBESH	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PRE	Programi i Reformave Ekonomike	OPEC	Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës
BE	Bashkimi Europian	ZKM	Zyra e Kryeministrit
IHD	Investime të huaja direkte	MFP	Menaxhimi i Financave Publike
BPV	Bruto prodhimi vendor	PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
QK	Qeveria e Kosovës	KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
HBS	Anketa e buxhetit të ekonomive familjare	KREK	Kursi real efektiv i këmbimit
AL	Arsimi i lartë	BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
IAL	Institucionet e arsimit të lartë	KZHI	Kërkimi, Zhvillimi dhe Inovacioni
SIMAL	Sistemi informativ për menaxhimin e arsimit të lartë	SEED	Kualifikimet e harmonizuara të shoferëve profesionistë të Evropës Juglindore
HHI	Indeksi Herfindahl- Hirschman	SEETO	Observatori i Transportit të Evropës Juglindore
IFN	Institucionet financiare ndërkombëtare	SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
IMF	Fondi Monetar Ndërkombëtar	BVM	Bizneset e Vogla dhe të Mesme
IPA	Instrumenti për Ndhimën e Paraanëtarësimit	ZPS	Zyra e Planifikimit Strategjik
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim	STIKK	Shoqata e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës
BK	Buxheti i Kosovës	ZhPT	Zhvillimi i Produkteve Turistike
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës	TC	Termocentrali
KEDS	Shpërndarja dhe furnizimi me energji elektrike në Kosovë	KPNj	Kosto e punës për njësi
KESP	Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës	UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore	USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë	AAP	Aftësimi dhe arsimi profesional
ShPFP	Shkalla e Pjesëmarrjes në Fuqinë Punëtore	BB	Banka Boterore
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore	OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
SIMP	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Punës		

1. KORNIZA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT

Procesi i hartimit të PRE 2022-2024 u udhëhoq nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve si Koordinator Kombëtar në koordinim me Zyrën e Planifikimit Strategjik (ZPS) në Zyrën e Kryeministrit dhe koordinatorët e fushave të politikave nga ministritë e linjës. Koordinatorët janë takuar rregullisht për të diskutuar përmbajtjen e masave, si dhe përputhshmërinë e tyre me dokumentet përkatëse të planifikimit strategjik dhe me udhëzimet e politikave të marra përmes Dialogut Ekonomik dhe Fiskal me Komisionin Evropian.

Grupet punuese ndërministrore u takuan për të siguruar që aktivitetet afatshkurtra nga projekt PRE-ja të përfshiheshin në Planin Vjetor të Punës të Qeverisë për vitin 2022 dhe të jenë në përputhje me aktivitetet e planifikuara në projekt Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) dhe Agjendën Evropiane të Reformave (ARE), si dhe me projektbuxhetin e vitit 2022. ZPS-ja, në bashkëpunim me koordinatorët e fushave, siguroi që shumica e masave lidhen drejtpërdrejt me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe me udhërrëfyesit për zbatimin e saj.

Duke marrë parasysh strukturën aktuale ekonomike të Kosovës dhe pengesat e shumta ndaj rritjes ekonomike, është e nevojshme që reformat strukturore të synojnë ekonominë funksionale të tregut dhe fuqizimin e konkurrueshmërisë, të cilat paraqiten si bazat kryesore in Programin e Qeverisë 2021-2025.

Në këtë linjë, Qeveria mbetet e përkushtuar për të mbështetur rimëkëmbjen ekonomike dhe për të përmirësuar perspektivat e punësimit. Korniza e përgjithshme e politikave e PRE-së është një kombinim i: (1) programit të rimëkëmbjes ekonomike i cili synon të mbështesë rimëkëmbjen ekonomike pas pandemisë; (2) një politike fiskale të bazuar në rregulla e të orientuar drejt stabilitetit të financave publike dhe, brenda hapësirës fiskale në dispozicion, drejt mbështetjes së rritjes ekonomike përmes investimeve kapitale dhe shtimit të fondeve për zonat prioritare të zhvillimit; dhe (3) një sërë reformash prioritare strukturore që adresojnë pengesat kryesore ndaj rritjes ekonomike, mbështesin zhvillimin e sektorëve ekonomikë konkurrues dhe sigurojnë që rritja ekonomike është gjithëpërfshirëse dhe e rrit mirëqenien.

2. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË POLITIKAVE

[1.A] Të ofrohet mbështetje fiskale e shënjestruar mirë dhe e përkohshme lidhur me pandeminë për ekonomitë familjare dhe bizneset e cënueshme; [1.B] Me kusht që rimëkëmbja ekonomike të jetë e fuqishme, të parashihet në buxhetin e vitit 2022 dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve kthimi gradual në tavanin e deficitit prej 2%, sipas përkufizimit të rregullit fiskal, deri në vitin 2023. [1.C] Me qëllim të sigurimit të shpenzimeve publike efikase, të drejta dhe të qëndrueshme, të rishikohet ligji për pagat e sektorit publik dhe të përgatitet rishikimi i sistemit të sigurimit shoqëror, duke përfshirë pensionet e veteranëve të luftës. [1.D] Të bëhet rishikimi i shpenzimeve tatimore duke përcaktuar nivelin e të hyrave të humbura nga përjashtimet dhe normat e reduktuara.

[1.A] Me qëllimin që të krijojmë një shoqëri të barabartë dhe të rrisim mirëqenien e qytetarëve, do t'i ndajmë 50 milionë euro për grupet e cënueshme të shoqërisë. Kjo mbështetje synon lehtësimin e barrës që u është shkaktuar këtyre shtresave si pasojë e pandemisë. Disa prej masave të ndërmarra deri më tani – shumica e të cilave janë në zbatim e sipër – në kuadër të mbështetjes së ekonomive familjare janë si vijon:

- Vendimi i QK-së në prill 2021 për rritjen e pagesave të ndihmës sociale me 30% dhe rritjen e pensioneve mujore nën 100 eurove në 100 euro;
- Mbështetje në vlerë 1,500 euro për familjet të cilat e kanë humbur anëtarin;

- 170 euro për lehonat e papunësuarra (6 muaj) dhe lehonat e punësuarra (3 muaj);
- Si shtesë ndaj pensionit të rregullt, 100 euro për një muaj për të gjithë pensionistët;
- Familjet në skemën e ndihmës sociale morën pagesa të dyfishta për dy muajt e fundit të 2021-ës;
- Mbështetja për likuiditetin e ekonomive familjare me anë të subvencionit prej 10% të kredive konsumuese, deri në maksimum 300 euro;
- Mbështetja financiare në shumën prej 1 milionë Euro për Organizatat Jo-Qeveritare/ kushzinat popullore që shpërndajnë ushqim për njerëzit e varfër dhe grupet e marginalizuara.

Rritja e shpenzimeve sociale së fundi ka targetuar kategoritë më në nevojë, për të cilat nga fillim-viti 2022, është bërë rritja e përhershme e pensioneve bazike, atyre të personave me aftësisë të kufizuara, pensionet familjare dhe invalide të punës në 100 Euro (më parë ishin në mes të 75 dhe 90 Euro) duke siguruar se nuk do të ketë pensione mujore nën 100 euro për këto grupe të ndieshme të shoqërisë.

Meqë prioriteti i parë i qeverisë është punësimi, janë ndërmarrë disa masa që synojnë t'i mbështesin drejtpërdrejt punëkërkuessit, si më poshtë:

- **Mbështetja për ata që e kanë humbur punën:** ka për qëllim t'i mbështesë bizneset që i kanë rikthyer në punë personat të cilët e kishin humbur vendin e punës gjatë pandemisë. Mbështetja në kuadër të kësaj mase përfshin subvencionimin e pagave deri në 50% të pagës bruto mujore për tre muaj, ku subvencionimi nuk mund të tejkalojë shumën prej 170 eurosh;
- **Formalizimi i punësimit:** ka për qëllim t'i mbështesë bizneset që i kanë punëtorët të formalizuar, me anë të subvencionimit të kontributeve pensionale të punëtorëve në shumë prej 10% të pagës bruto mujore, deri në 12 muaj, ku subvencionimi nuk mund të tejkalojë shumën prej 100 eurosh;
- **Mbështetja e punësimit të grave:** ka për qëllim t'i mbështesë bizneset që punësojnë gra, me anë të subvencionimit deri në 50% të pagës bruto mujore për tre muaj, ku subvencionimi nuk mund të tejkalojë shumën prej 170 eurosh. Pas përfundimit të periudhës 3 mujore, mbështetja në kuadër të kësaj mase do të vazhdojë për 9 muaj të tjerë në formë të subvencionimit të kontributeve pensionale të punëtorëve në shumë prej 10% të pagës bruto mujore, ku subvencionimi nuk mund të tejkalojë shumën prej 100 eurosh.

Mbështetja për bizneset që janë goditur më së rëndi nga pandemia, duke iu siguruar subvencionim në vlerë prej 50% të qirasë mujore për një muaj, për të mbuluar shpenzimet për muajin (prill 2021) gjatë të cilit ishin vendosur masat kufizuese të qeverisë dhe bizneset nuk mund të operonin

Masa tjera të zbatuara gjatë tremujorit të fundit të 2021, ishin subvencionimi prej 20% të kredive investuese për prodhuesit dhe përpunuesit(deri në 400,000 Euro), subvencionim prej 20% të kredive investive për bizneset në pronësi të grave (deri në 400,000 Euro), subvencionim prej 10% të kredive për likuiditet (deri në 30,000 Euro), dhe subvencionim direkt për eksportuesit për ngritjen e kapaciteteve, certifikimet profesionale dhe marketing.

[1.B] Në Ligjin e Buxhetit për vitin 2022, parashihet një kthim gradual në rregullin fiskal në periudhën afatmesme. Përkatësisht, deficitit buxhetor pritet të arrijë në 3% të BPV-së në vitin 2022, dhe të mbetet brenda rregullit fiskal prej 2% në dy vitet pasuese.

[1.C] Projektligji për pagat është duke u hartuar aktualisht nga grupi punues i emëruar nga Qeveria. Grupi punues udhëhiqet nga zyrtarët ligjorë të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Sipas programit legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës, afati për miratimin e këtij projektligji nga Qeveria deri në Mars 2022.

Në fillim të vitit 2021, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve pranoi asistencë teknike nga Departamenti për Çështje Fiskale i FMN-së lidhur me vlerësimin e performancës së sistemit pensional. Kjo asistencë u përqendrua në politikat pensionale afatgjata dhe në përputhshmërinë e skemave ekzistuese dhe të planifikuara me kufizimet makroekonomike, demografike, të tregut të punës dhe administrative të Kosovës. Objektivi parësor i asistencës ishte të ofronte informata për krijimin e kornizës gjithëpërfshirëse të politikave sociale të vendit, si dhe për përpjekjen të modelimit të pensioneve të Bankës Botërore që është në zbatim e sipër. Një përjashtim domethënës nga vlerësimi është sistemi i përfitimeve që burojnë nga lufta të cilat përbëjnë përfitime që zakonisht janë mbi përfitimet sociale standarde që paguhen në raste të ndodhive me rrezik të ngjashëm dhe bazohen në kriterë më të lehta të pranueshmërisë.

[1.D] Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka bërë vlerësimin fillestar të të hyrave të humbura nga lirimi i vitit 2019 prej tatimit në të ardhurat e korporatave prej deri në 30%, përkatësisht 20% për sponsorimin e asociacioneve sportive dhe artistike. Ligji hyri në fuqi në pjesën e dytë të 2019-ës, ndërsa kufizimet e Qeverisë ndaj ngjarjeve sportive dhe artistike hynë në fuqi në vitin 2020, kështu që pati nivel të ulët të shfrytëzimit (1% më 2019 dhe 3% e gjithëj të hyrave nga TAK më 2020). Për shkak të aktivitetit të papritur ekonomik dhe performancës së përgjithshme të të hyrave, rezultatet e vlerësimit nuk u përfshinë në kornizën makroekonomike 2022-2024, mirëpo ajo mund të përditësohet lehtë pasi të përfundojë periudha e deklarimit tatimor 2021 dhe të zbuten pasojat pas-COVID-19, dhe ato do të përfshihen në raundin tjetër të parashikimeve. Pasi të zbuten pasojat e pandemisë dhe MFPT-ja të jetë në gjendje ta kthejë vëmendjen nga menaxhimi i rimëkëmbjes ekonomike, ajo do të bëjë vazhdimisht vlerësime të shpenzimeve të tjera ekzistuese tatimore.

[2.A] Të përmirësohet realizimi i shpenzimeve kapitale përmes zbatimit të udhëzimeve administrative për planifikimin, përzgjedhjen, realizimin dhe monitorimin e projekteve kapitale dhe avancimin e planifikimit shumëvjeçar të projekteve. [2.B] Për të zvogëluar rrezikun e detyrimeve kontigjente, të përmirësohet mbikëqyrja dhe llogaridhënia financiare e ndërmarrjeve publike, duke përfshirë raportimin e tyre të rregullt tremujor. [2.C] Të merren hapat e radhës për krijimin e një organi pavarur të mbikëqyrjes fiskale bazuar në rekomandimet e dokumentit të opsioneve.

[2.A] Udhëzimi Administrativ për Kriteret Përzgjedhëse të Projekteve Kapitale është në fuqi dhe është duke u zbatuar që dy vite. Shumica e projekteve kapitale të përfshira në buxhet janë projekte shumëvjeçare. Për më tepër, në fillim të vitit të ardhshëm, moduli i menaxhimit të parasë së gatshme do të jetë efektiv si rezultat i reformës së ndërmarrë me mbështetjen e Bankës Botërore. Gjithashtu, është nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Thesarit/MFPT dhe Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës (KRPP) lidhur me ndërveprimin ndërmjet dy sistemeve (SIMFK dhe e-prokurimi) në mënyrë që të bëhet rezervimi (zotimi) i fondeve me qëllim të sigurimit të alokimit të buxhetit për zbatimin e kontratave.

[2.B] Ministria e Ekonomisë tashmë ka propozuar që projektligji për NP-të të përfshihet në Planin Legjislativ për vitin 2022. Nevoja për ndryshimin e këtij ligji të ri ka ardhur për shkak të disa rrethanave të cilat e kanë penguar zbatimin e plotë të ligjit aktual edhe pas ndryshimeve të tij. Njëri prej argumenteve kryesore në favor të projektligjit është se ligji i vjetër përmban

paqartësi sa u përket procedurave për rregullimin e NP-ve. Projektligji synon të trajtojë qartë çështjen e raportimit financiar sipas parimeve ndërkombëtare.

Njësia për Politika dhe Monitorim të NP-ve që nga viti 2020 raporton në baza tremujore në Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me të dhënat mbi borxhin e NP-ve. Përveç kësaj, raportet financiare tremujore, sipas modelit të miratuar paraprakisht, ndahen me Divizionin për Politika Makroekonomike të MFPT-së, gjë që mundëson kryerjen e analizave të rrezikut fiskal që ndërlidhet me NP-të. Këto raporte financiare tremujore janë duke u publikuar në ëebfaqen e MFPT-së¹, siç parashihet nga Asistenca Makrofinanciare e BE-së.

[2.C] Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2020 dhe tremujorit të parë të vitit 2021, MFPT-ja pranoi asistencë teknike nga Departamenti për Çështje Fiskale i FMN-së në lidhje me vlerësimin e opsioneve për krijimin e kështjës së pavarur mbikëqyrës fiskal në kornizën ligjore dhe institucionale të Kosovës si dhe kapaciteteve në dispozicion. Ky dokumenti i opsioneve është hapi fillestar për vendimin dhe zbatimin e një institucioni të pavarur fiskal. Dokumenti rendit veprimet që duhen ndërmarrë nën opsionet e identifikuar.

[3.A] Të sigurohet një kornizë e fuqishme rregulative e sektorit financiar në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe të BE-së, të sigurohet menaxhimi i shëndoshë i rrezikut kreditor, publikimi transparent i cilësisë së aktiveve dhe provizionimi adekuat, si dhe të zhvillohet një kornizë më e integruar për matjen e borxhit të ekonomive familjare. [3.B] Të reduktohen më tej pengesat e mbetura institucionale dhe ligjore për zgjidhjen e shpejtë dhe efektive të kredive joperformuese. [3.C] Të sigurohet funksionimi efektiv i bankës qendrore duke kryer një analizë të thellë të kërkesave për personel në fushat kryesore të politikave të saj, me theks në stabilitetin financiar dhe mbikëqyrjen e sektorit financiar, si dhe të plotësohet pozitat e zbrazëta në bord në mënyrë që të sigurohet kuorumi i saj.

[3.A] Në ndryshimin e rregulloreve ekzistuese dhe në miratimin e rregulloreve të reja, BQK-ja përdor si pikë referimi direktivat e BE-së dhe Kornizën e Bazelit.

- i. Rregullore për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave bazohet në Kornizën e Bazelit, si vijon:
 - Përkufizimi i kapitalit sipas Kornizës së Bazelit III
 - Peshat e rrezikut kreditor – Qasja e standardizuar sipas Kornizës së Bazelit II
 - Rreziku i tregut sipas qasjes së standardizuar të Kornizës së Bazelit II
 - Rreziku operacional sipas qasjes së standardizuar të Kornizës së Bazelit II
- ii. Rregullorja për treguesin e leverazhit bazohet në dokumentin e Kornizës së Bazelit III
- iii. Nga janari 2020 BQK-ja është në harmoni me Standardin SNRF 9
- iv. Aktualisht, BQK-ja i ka finalizuar projekt-rregulloret për Raportin e Mbulueshmërisë së Leverazhit (LCR) dhe Raportin e Financimit Stabil (NSFR) sipas direktivave të BE-së
- v. BQK-ja është në proces të ndryshimit të Rregullores për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit sipas Kornizës së Bazelit. Gjithashtu, është përfunduar Projektligji i ri për Bankat dhe u është përcjellë organeve vendimmarrëse të BQK-së për miratim.

¹ <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,187>

Projektligji i ri për Bankat përfshin Kornizën e Rimëkëmbjes dhe Zgjidhjes që është e harmonizuar me Direktivën 2014/59/BE.

BQK-ja është në proces të hartimit të raportit përfundimtar lidhur me mbingarkesën me borxh të kredimarrësve të ekonomive familjare. Studimi përdor të dhënat nga Regjistri i Kredive si dhe ato nga institucionet financiare. Nëntë banka dhe nëntë institucione mikrofinanciare kanë ofruar të dhënat sipas kërkesës, dhe raporti pritet të publikohet së shpejti.

[3.B] Sektori bankar në Kosovë vazhdon të jetë stabil edhe gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. Bankat kanë krijuar një sistem të mirë të menaxhimit të rrezikut kreditor, duke krijuar mekanizma adekuatë të mbikëqyrjes së rrezikut kreditor, me vëmendje të shtuar gjatë situatës së pandemisë Covid-19. Në mënyrë të vazhdueshme, bankat kanë monitoruar nga afër performancën e huamarrësve dhe bazuar në Udhëzuesin e BQK-së për ristrukturimin e kredive për shkak të Covid-19, kanë aplikuar ristrukturimin e kredive për huamarrësit që janë përballë me probleme në bizneset e tyre për shkak të situatës së pandemisë Covid-19.

Sa i përket transparencës në prezantimin e cilësisë së aktiveve, bankat në baza të rregullta raportojnë pasqyrat financiare në BQK, në kuadër të të cilave paraqesin edhe cilësinë e aktiveve. Cilësia e aktiveve vlerësohet edhe gjatë ekzaminimeve të bankave, të cilat kanë vërtetuar atë që kanë raportuar bankat në raportet e tyre financiare të dorëzuara në BQK. Cilësia e aktiveve raportohet në përputhje me SNRF 9 dhe ndahet në tre shtylla sipas modelit për Humbjet e Parashikuara Kreditore (HPK). Sa i përket përshtatshmërisë së provizioneve, bankat gjithashtu raportojnë në baza të rregullta në BQK pasqyrat financiare që përfshijnë edhe provizionimin e kredive. Provizionimi po zbatohet në përputhje me kërkesat e SNRF 9, ku bankat, bazuar në modelet e parashikuara të humbjeve kreditore, aplikojnë provizione dhe klasifikime në kuadër të njëjës prej tre fazave të SNRF 9. Gjatë ekzaminimeve, vlerësohet se bankat kanë rezerva të mjaftueshme sipas modeleve të SNRF 9.

[3.C] Roli dhe funksioni i Departamentit të Stabilitetit Financiar është zgjeruar me miratimin e kornizës së politikave makroprudenciale në vitin 2016 nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, pasi që përgjegjësia kryesore e këtij departamenti është monitorimi i rrezikut sistematik. Kjo ka diktuar thellimin e aftësive të punonjësve aktualë dhe zgjerimin e ekipit për të mbuluar fushëveprimin.

Stafi i Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare (DMB) është i kategorizuar në tre nivele, përkatësisht, ekzaminerët e vjetër, ekzaminerët dhe ekzaminerët e rinj – të gjithë me sfond ekonomik. Megjithatë, duke parashikuar zhvillimet në industrinë bankare, më konkretisht ato që kanë të bëjnë me modelet SNRF 9 dhe bazuar në analizën e brendshme të kërkesave për staf, BQK-ja është në fazën përfundimtare të shpalljes së vendeve të lira të punës për staf të ri të BSD-së me kualifikime fushash të ndryshme si matematika, matematika financiare dhe inxhinieria e të dhënave.

Më 22 nëntor 2021, Kuvendi i Kosovës zgjodhi dy anëtarë jo-ekzekutivë të Bordit të BQK-së. Këta dy anëtarë jo-ekzekutivë të zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës janë në pritje të dekretimit nga Presidentja e Republikës së Kosovës, siç kërkohet me Ligjin për BQK-në. Në seancat e ardhshme të Kuvendit pritet të votohet edhe për një anëtar tjetër jo-ekzekutiv të BQK-së.

[4.A] Të miratohet një strategji koherente afatgjate e energjisë dhe klimës për uljen e emetimeve të karbonit, duke përfshirë planet për heqjen graduale të subvencioneve të qymyrit dhe lëndëve djegëse fosile, siç është zotuar në kuadër të Deklaratës së Sofjes.
[4.B] Në përputhje me zotimet e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, të rriten stimujt e efijencës së energjisë për sektorin privat dhe ekonominë familjare; dhe [4.C] Të përmirësohen skemat mbështetëse për projektet e energjisë së ripërtëritshme përmes zbatimit të tenderimit konkurrues/ankandeve; [4.D] Të miratohet plani i veprimit për

rregullimin gradual të tarifave të energjisë që i reflektojnë kostot aktuale dhe ofrojnë masa zbutëse për konsumatorët e cenueshëm.

[4.A] Grupi punues përgjegjës për hartimin e *Strategjisë* afatgjatë të *Energjisë* përqendrohet në identifikimin e kërkesave për zbatimin e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor. Është mbajtur një seminar gjithëpërfshirës si dhe konsultime me sektorin privat dhe OSHC-të.

Grupi ndërinstitucional punues, i ngarkuar për hartimin e *Strategjisë së Energjisë 2022-2031* është themeluar më 18 tetor 2021 dhe janë krijuar nëngrupet punuese si më poshtë:

- Nën-grupi punues për gjenerim dhe fleksibilitet;
- Nën-grupi punues për BER dhe EE;
- Nën-grupi punues për bashkëpunim rregullativ dhe ndërkombëtar.

Nëngrupi punues për Gjenerim dhe Fleksibilitet është duke punuar në hartimin e skenarëve të bazuar në kriteret e dekarbonizimit, sigurisë së furnizimit, përballueshmërisë dhe diversifikimit.

Gjithashtu, Plani i Energjisë dhe Klimës është duke u hartuar me mbështetje të GIZ-it. Rezultatet e analizës së procesit të hartimit të *Strategjisë së Energjisë* do të shërbejnë për përcaktimin e politikave dhe masave të dimensioneve për Planin e Energjisë dhe Klimës.

[4.B] Udhëzimi Administrativ për Shërbimet e Energjisë (ESCO) për sektorin privat dhe atë të ekonomive familjare janë miratuar në Dhjetor 2021. Për më tepër, në lidhje me stimujt e efikasitetit të energjisë për sektorin privat dhe ekonominë familjare, zhvillimi i këtyre stimujve për të dy sektorët është në fazën fillestare me mbështetjen e projektit MCC. Përveç kësaj, Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë mbështetet përmes Projektit REEPLUS në hartimin e Termave të Referencës për projektin e ngritjes së kapaciteteve në nivel lokal dhe qendror për raportimit e të dhënave lidhur me efikasitetin e energjisë. GIZ po mbështet gjithashtu palët e interesuara në zhvillimin e opsioneve për mekanizmat financiarë që rrisin normat e zbatimit të masave të EE dhe BER në sektorin rezidencial / sektorin privat

[4.C] Për të adresuar skemën e re të mbështetjes për energjinë e ripërtëritshme, Ministria e Ekonomisë ka krijuar një grup punues për hartimin e skemës së re të mbështetjes për BRE-të bazuar në procesin konkurrues - tenderimi/ankandet. Koncepti dokumenti fillestar është zhvilluar me mbështetjen e BERZH-it. Në këtë drejtim, BB-ja gjithashtu ka shfaqur interes për të ofruar mbështetje të mëtejshme. Si rezultat, skema do të zhvillohet paralelisht me projektligjin për BRE-të gjatë vitit të ardhshëm.

[4.D] Zyra e Rregullatorit për Energji konform kompetencave ligjore të saj në vazhdimësi trajton çështjen e reflektimit të kostos në mënyrë të drejtë për të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Për këtë qëllim, ka zhvilluar studime të cilat kanë dhënë pikëpamje rreth trendit të çmimeve me pakicë, duke përfshirë edhe ndikimin nga de-rregullimi gradual i konsumatorëve. Zyra e Rregullatorit për Energji është në procesin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm të tarifave për aktivitetet në sektorin e energjisë elektrike, për shkak të rritjes të paprecedentë të çmimeve në tregjet evropiane të energjisë elektrike, që u ndikuan nga kërkesa për gaz në Azi dhe për shkak të rimëkëmbjes ekonomike pas kufizimeve fillestare të COVID-19. Për të mbuluar kostot shtesë të rritura të sistemit dhe për të reflektuar drejtë kostot të kategoritë e konsumatorëve, ZRRE-ja ka dalë me propozim të ndryshohet struktura tarifore dhe tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal nga muaji shkurt 2022. Është propozuar që kostot shtesë të sistemit të mbulohen përmes tarifës së bllokut progresiv mbi 600 KWh tek konsumatorët shtëpiakë dhe tarifat për konsumatorët biznesorë dhe për konsumatorët shtëpiak me konsum nën 600KWh mbetet me 0%. Pra me këtë propozim të ZRRE-së, do të do të eliminohet subvencionimi i

kategorive të konsumatorëve të rregulluar tarifor, ku secila kategori e konsumatorëve do të paguajë kostot reflektive të shërbimeve që i shkakton sistemit. Edhe pse, procesi i rishikimit të tarifave është iniciuar nga ZRRE-ja duke përfshirë propozimet e lartpërmendura, duhet theksuar se çdo ndryshim i mundshëm në tarifat aktuale do të vendoset nga ZRRE-ja vetëm pas procesit të konsultimit publik, i cili mund të rezultojë në një rezultat të ndryshëm.

Lidhur me Reformat Tarifore që ka të bëjë me konsumatorët me nevojë të energjisë elektrike, ZRRE-ja ka iniciuar diskutimet e grupit punues për konsumatorët në nevojë të energjisë elektrike, i cili është themeluar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Ky grup me mbështetjen e Bankës Botërore dhe Asociacionit Nacional të Komisionarëve të Ndërmarrjeve Rregullative (NARUC) ka zhvilluar një raport/studim, i cili trajton aspekte të politikave për konsumatorët në nevojë të energjisë elektrike. Raporti i është dërguar ministrive relevante ku janë rekomanduar politika për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë të energjisë elektrike. Sipas nenit 49 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe në konsultim me palët tjera të interesit në sektorin e energjisë elektrike është përgjegjëse për hartimin e një programi të detajuar për përcaktimin e statusit të konsumatorëve në nevojë dhe masave që kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë në mbulimin e kërkesës së tyre për energji elektrike. Konsumatorët e cenuar aktualisht mbështeten nga një skemë e pagesës direkte nga Qeveria e Republikës së Kosovës në vlerë 4.5 milionë Euro për mbulimin e një pjesë të kostos së energjisë

[5.A] Të përditësohet plani i veprimit i Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019–2023 dhe të sigurohet zbatimi i saj. [5.B] Të zbatohen masa stimuluese me synimin për të formalizuar punësimin dhe bizneset joformale; dhe [5.C] të adresohet evazoni fiskal në sektorët e identifikuar me rrezik të lartë në përputhje me strategjinë dhe planin e veprimit. [5.D] Me synimin për të parandaluar evazionin tatimor të të ardhurave nga prona, të përmirësohet transparenca duke publikuar të gjitha çmimet e shitjes së pronave të patundshme.

[5.A] Plani i ri i Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Informale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimin Financiar (2019-2023) po hartohet nga Sekretariati i kësaj Strategjie me ndihmën e një eksperti të jashtëm të kontraktuar nga projekti i LuxDev. Ky plan veprimi parashikon aktivitete të shumta të cilat adresojnë objektivat kryesore të Strategjisë.

[5.B] Për të reduktuar kostot dhe barrën administrative për kompanitë e vogla me akses të kufizuar në ekspertizë ligjore, MFPT ka hartuar dhe publikuar 3 lloje të kontratave të punës (afatshkurtra, afatgjata dhe detyra specifike), të cilat mund të përdoren apo të përshtaten nga një gamë gjerë e punëdhënësve, me qëllim të rritjes së numrit të punëtorëve të regjistruar². Administrata Tatimore aktualisht ka ndërmarr një fushatë të gjerë që synon rritjen e regjistrimit të punëtorëve, duke mundësuar një formular online ku punonjësit mund të kontrollojnë nëse janë në listën e pagave të punëdhënësit të tyre³. Plani i Veprimit parashikon disa aktivitete thelbësore që synojnë të trajtojnë këtë çështje, siç janë.

- Realizimi i fushatave informuese për publikun e gjerë në lidhje me përfitimet dhe pasojat e punësimit joformal dhe informimi i punëdhënësve për pasojat e punësimit joformal. Në këto fushata do të paraqiten edhe statistika mbi rrezikun e identifikimit të punëdhënësve që kanë punëtorë joformalë;

² <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1%2C190>

³ <https://apps.atk-ks.org/regemployer>

- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me partnerët socialë, me qëllim të adresimit të punësimit joformal; dhe
- Hartimi i doracakut/procedurave operative për inspektimin e punës.

[5.C] Aktivitetet në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit që trajtojnë evazionin fiskal në sektorët e identifikuar me rrezik të lartë në përputhje me strategjinë dhe planin e veprimit janë:

- Krijimi i grupeve të përbashkëta të Doganës së Kosovës dhe ATK-së me qëllim të kontrollit të mallrave të kategorizuara me rrezik të lartë të evazionit fiskal.
- Rritja e numrit të vizitave dhe auditimeve të kryera nga ATK-ja, bazuar në vlerësimin e rrezikut në luftimin e ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal.

[5.D] Me qëllim të parandalimit të evazionit tatimor mbi të ardhurat nga prona dhe përmirësimit të transparencës duke publikuar të gjitha çmimet e shitjes së pronave të patundshme, do të lidhet një memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe ATK-së ose MFLT-së për të siguruar shkëmbimin e të dhënave nga noterët për transaksionet në pronat e patundshme, gjë që do të kontribuonte në parandalimin e evazionit tatimor mbi të ardhurat në pronë.

[6.A] Të zbatohen tërësisht mekanizmat ekzistues të sigurimit të cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit nëpërmjet rritjes së inspektimeve të shkollave dhe efektivitetit të koordinatorëve të cilësisë, si dhe monitorimit të programeve të studimit nga Agjencia e Akreditimit. [6.B] Të zhvillohet një sistem për monitorimin dhe parashikimin e nevojave për aftësi në tregun e punës për të lehtësuar përafrimin e sistemeve të arsimit dhe trajnimit dhe ofrimin e rikualifikimit dhe ngritjes së aftësive me nevojat e tregut të punës. [6.C] Të krijohet një Task Forcë ndërministrorë që përfshin ministritë përkatëse, agjencitë e tyre dhe palët e interesuara për të zhvilluar planin e zbatimit të Garancisë së të Rinjve.

[6.A] Inspektorati i Arsimit ka nisur procesin e përmirësimit të performancës së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave. Në mars 2021 janë trajnuar 49 drejtorë dhe 3 zëvendës drejtorë shkollash. Për shkak të Covid-19, janë shtyrë disa procese si procesi i performancës në shkollë dhe vlerësimi i performancës së mësimdhënësve, i kufizuar si rezultat i mospranisë fizike në shkolla;

Inspektori i Arsimit është i përgatitur që të vazhdojë me këto procese, sapo të lejojë situata me pandeminë. Më tej, aktualisht jemi në proces të punësimit të kuadrove të reja, të cilët do të punojnë si inspektorë arsimorë.

Të gjitha shkollat në Kosovë kanë koordinatorë të kontrollit të cilësisë. Rreth 300 koordinatorë shkollash janë trajnuar gjatë viteve të fundit, si dhe një koordinator i cilësisë në nivel të drejtorive komunale. Pas hartimit të udhëzimit të ri administrativ për këtë çështje, do të mbahen trajnime për koordinatorët e sapoemëruar të kontrollit të cilësisë.

Agjencia Kosovare e Akreditimit tashmë ka finalizuar Udhëzimin Administrativ (UA) për monitorimin e cilësisë. Ky UA është aktualisht në fazën e diskutimit publik, ku do të merren komente nga të gjitha palët e interesit të arsimit të lartë. Pas marrjes së komenteve, pyetësorët do të finalizohen dhe miratohen nga Komisioni i Nëpunësve Civilë. Me miratimin e këtij udhëzimi o të mundësohet nisja e procedurave të monitorimit të të gjitha institucioneve të arsimit të lartë. Me dinamikën aktuale, presim që udhëzimet të miratohen në TM1 ose TM2 të vitit 2022. Monitorimi i institucioneve të arsimit të lartë pritet të fillojë në shtator 2022.

[6.B] Projektet e LuxDev-it në Kosovë po promovojnë arsimin në përgjithësi dhe zhvillimin e shkathtësive të të rriturve. Përfitues i drejtpërdrejtë i këtyre projekteve është Ministria e Arsimit, e cila i realizon projektet përmes Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional. Instituti për Studime të Arsimit EdGuard është përgjegjës për zbatimin e projektit për aftësimin dhe arsimin e të rriturve, ndërsa Global CT do të jetë përgjegjëse për zbatimin teknik. Aktualisht, kjo kompani është duke hartuar pyetësorë të cilët synojnë mbledhjen e informatave në lidhje me nevojat e tregut të punës. Gjetjet e pyetësorit do të përfshihen në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Punësimit (SIMP).

[6.C] Në tetor të 2020-ës, Komisioni Evropian (KE) publikoi Planin gjithëpërfshirës ekonomik dhe të investimit për Ballkanin Perëndimor (PEI), me fokus në rimëkëmbjen ekonomike afatgjatë, tranzicionin e gjelbër dhe digjital, integrimin rajonal dhe konvergjencën me Bashkimin Evropian. Ky plan prezantoi nismën kryesore #10, duke sugjeruar që qeveritë e BP-6 duhet të krijojnë garancinë e të rinjve në përputhje me Garancinë e të Rinjve në BE.

Më 8 korrik 2021, në takimin e dytë ministror BE-Ballkani Perëndimor për Punësimin dhe Çështjet Sociale, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve miratoi një Deklaratë për sigurimin e integritit të qëndrueshëm të të rinjve në tregun e punës. Deklarata njeh ndikimin shpërpjesëtimor të krizës së vazhdueshme të të rinjtë dhe shpreh angazhimin për të zbatuar dhe përmirësuar gradualisht skemat e garancisë për të rinjtë në rajon, duke marrë frymëzim nga Rekomandimi i Këshillit të BE-së i datës 30 tetor 2020 lidhur me pakon “Ura drejt vendeve të punës – fuqizimi i Garancisë së të Rinjve” [*A Bridge to Jobs – reinforcing the Youth Guarantee*]. Në korrik 2021, u lansua Instrumenti i Asistencës Teknike të KE-së/ILO-s (IAT) për garancinë e të rinjve në BP-6, i cili u ofron ekonomive pjesëmarrëse, duke përfshirë Kosovën, asistencë teknike në përgatitjen e Planit të Zbatimit të Garancisë së të Rinjve. Fondacioni Evropian i Trajnimeve (ETF) gjithashtu iu bashkua IAT-it.

Në linjë me udhëzimet për GR të përgatitura nga KE/ILO, më 13 tetor 2021 Qeveria nxori vendimin për krijimin e grupit ndërministror (në nivel politik) për garancinë e të rinjve. Më 29 tetor 2021, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve nxori edhe vendimin për formimin e ekipit teknik ndërministror të GR-së (në tekstin e mëtejshëm TTGR) të udhëhequr nga Koordinatori për GR. Më 14 tetor, Koordinatorin për GR mori pjesë në takimin lansues për Fazën 1 – hartimi i Planeve të Zbatimit të Garancisë së të Rinjve në Ballkanin Perëndimor.

Grupi Punues për Garancinë e të Rinjve (TTGR) është duke hartuar Planin e Zbatimit të Garancisë së të Rinjve (PZGR), dhe shpërndarja e sistemit është në proces. Procesi po mbështetet nga ILO dhe ETF-ja. Deri në mars/prill 2022, projekt PZGR-ja do të ndahet me KE-në/ILO-n/ETF-në për informata kthyese teknike. Deri në gusht të 2022-ës, PZGR-ja do të finalizohet dhe dorëzohet. Si pjesë e këtij procesi, tashmë ka filluar përgatitja e profilit statistikor të të rinjve në punë ose në proces studimi ose trajnimi (NEET) në Kosovë bazuar në të dhënat në dispozicion të prodhuara nga Agjencia e Statistikave. Gjithashtu, rishikimi i politikave të punësimit të të rinjve është në proces e sipër.


3. KORNIZA MAKROEKONOMIKE

3.1. Mjedisi i jashtëm ekonomik

Rimëkëmbja e ekonomisë globale është në vazhdim e sipër, megjithëse me dallime të mëdha midis vendeve dhe rajoneve. Këto divergjenca shpjegohen me qëndrueshmërinë fiskale, nivelin e shpenzimeve të qeverisë në mbështetje të sektorit privat dhe grupeve të marginalizuara, si dhe numrin e rasteve të reja të infektuara me Covid-19. Pothuajse në të gjitha vendet, borxhi publik është rritur ndjeshëm përtej nivelit të krizës financiare 2007-2009. Megjithatë, ekonomia botërore në gjysmën e parë të vitit 2021 performoi më mirë sesa pritej.

Vaksinat kundër virusit COVID-19 janë dëshmuar të jenë të suksesshme në luftimin e pandemisë, por shpërndarja e tyre nëpër vendet e botës është thellësisht e pabarabartë. Vendet e zhvilluara, kryesisht, ishin të parat që vaksinuan një pjesë të konsiderueshme të popullsisë. Që nga fillimi i janarit 2022, në mbarë botën janë administruar mesatarisht rreth 122 vakcina për 100 persona⁴. Vendet kryesore në numrin e personave të vaksinuar ishin Emiratet e Bashkuara Arabe me rreth 228 doza për 100 banorë, pastaj Uruguai dhe Izraeli, përkatësisht me rreth 200 dhe 185 doza.

Figure 1. Numri i dozave të administruara për 100 banorë sipas vendeve fqinje dhe të ardhurave



Burimi: Our World in Data [Bota Jonë në të Dhëna]

Të dhënat e fundit tregojnë se Kosova është shumë afër vendet me të ardhura të mesme të ulëta. Edhe pse Kosova ka filluar vaksinimin relativisht më vonë se vendet e tjera ballkanike, shpejtë ka rritur ritmin. Sipas të dhënave për Covid-19 në 'OurWorldInData.org', që nga 25 janari 2022, Kosova renditet më së larti në rajon me 53% të njerëzve të vaksinuar (plotësisht dhe pjesërisht), e ndjekur nga afër nga Serbia (48%) dhe Mali i Zi (46%).⁵

Përkundër rritjes së shkallës së vaksinimit, versioni Delta ka shkaktuar sërish pasiguri në treg, duke detyruar vende të ndryshme të rimarrin masat e bllokimit të pjesshëm. Këto masa ngadalësuan trendin e rimëkëmbjes. Shanset për shfaqjen e versioneve të reja të virusit në muajt e ardhshëm e bëjnë të vështirë parashikimin e fundit të pandemisë dhe si do të ndikojë në rimëkëmbje në krahasim me nivelet e para krizës. Ndhimja në vaksinimin e popullsisë për vendet e varfra besohet të jetë e nevojshme për t'i dhënë fund pandemisë. Deri më tani, këto vende janë larg mesatares botërore dhe nevojitet një ndërhyrje e shpejtë për të rritur intensitetin e vaksinimit. Kështu, rimëkëmbja e ekonomisë botërore drejt nivelit para pandemisë është e vështirë të parashikohet në rrethana rreziqesh që rrjedhin nga shfaqja e varianteve të reja të virusit dhe të pasigurive të larta në treg.

Në dy tremujorët e parë të 2021, ekonomia u paraqit më mirë se parashikimet e institucioneve financiare ndërkombëtare. Pothuajse të gjitha vendet pësuan rritje të aktivitetit ekonomik, e nxitur nga rritja e kërkesës për shkak të rihapjes së bizneseve dhe paketave stimuluese fiskale – veçanërisht në vendet e zhvilluara. FMN-ja publikoi parashikimin e saj të rritjes së BPV-së për muajin prill dhe e rishikoi atë përsëri në korrik dhe tetor. Parashikimet e fundit sugjerojnë rritje të ekonomisë botërore prej 5.9% në 2021 dhe 4.9% në 2022⁶. Parashikimi i përditësuar, i


⁴ Numri i të vaksinuarve në 100 banorë mund ta gjeni në: <https://ourworldindata.org/grapher/covid-vaccinationdosespercapita>

⁵ <https://ourworldindata.org/covid-vaccinations>

⁶ World Economic Outlook publication: <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2021/10/12/world-economic-outlook-october-2021>

cili uli normën e rritjes së BPV-së me 0.1 pp, erdhi si rezultat i ndërprerjeve nga ana e ofertës - kryesisht në vendet e zhvilluara - shpërndarjes së vaksinave dhe mbështetjes së qeverisë për sektorët e prekur nga kriza shëndetësore. Vendet e zhvilluara pritet të rriten me 5.2% në vitin 2021 dhe 4.5% vitin e ardhshëm. Rritje relativisht e ngjashme pritet edhe në vendet e Eurozonës, ku jetojnë një numër i konsiderueshëm i emigrantëve kosovarë. Nga ana tjetër, vendet evropiane në zhvillim pritet të rriten me 6% këtë vit dhe 3.6% në 2022. Këto parashikime ishin më të larta se vlerësimet e korrikut dhe prillit, përkatësisht me 1.1 dhe 1.6 pp.

Figure 2. Perspektiva e rritjes së BPV-së – Komisioni Evropian⁷



Parashikimi i vjeshtës i Komisionit Evropian, i paraqitur në Figurën 2, sugjeron projeksione të ngjashme me ato të FMN-së. Bashkimi Evropian dhe Eurozona pritet të rriten afërsisht me një normë të ngjashme gjatë dy viteve të ardhshme. Më tej, rritja e parashikuar ekonomike e ekonomisë botërore është vendosur në 5.7% për vitin 2021 dhe 4.5% dhe 3.5% për dy vitet e ardhshme, që është pak më e ulët se parashikimet e FMN-së.

Kriza energjetike me të cilën përballlet pjesa më e madhe e Evropës mbetet një kërcënim serioz për trendin pozitiv të rritjes ekonomike. Zbutja e efekteve të kësaj krize mbetet një sfidë kryesore për qeveritë e vendeve të prekura. Ka disa arsye për këtë kërcënim⁸. Së pari, fusha më e madhe e nxjerrjes së gazit në Evropë, Groningeni në Holandë, ka filluar të shterohet ngadalë. Ky varfërim ka shkaktuar tërmete të vogla në zonën përreth, duke dëmtuar banesa dhe biznese. Si rezultat, furnizuesi më i madh evropian ka reduktuar prodhimin. Së dyti, Kina dhe vendet e tjera aziatike po largohen nga qymyri, duke përdorur kështu gazin natyror si një burim zëvendësues ose kalimtar energjie. Vlerësohet se çdo vit rreth 15 milionë shtëpi në Kinë lidhen me rrjetin e gazit. Kjo barazohet me kërkesën për gaz të Holandës dhe Belgjikës së bashku. Përveç Kinës, strategji të tilla po ndjekin edhe vende të tjera aziatike. Së fundi, kompania ruse monopole Gazprom po ndjek politika shtetërore, duke rritur ndikimin e shtetit në kontinentin evropian. Rritja eksponenciale e çmimit të gazit ka rritur kostot e prodhimit. Edhe pse kriza energjetike nuk ndikon drejtpërdrejt në tregun kosovar, ndikimet e tërthorta përmes çmimeve të importit mund të ndihen në vendin tonë.

Inflacioni mbetet një nga kërcënimet kryesore për një rimëkëmbje të shpejtë. Së fundmi, FMN-ja e ka rishikuar parashikimin e inflacionit për vitin 2021, duke e rritur në 2.9% për vendet e zhvilluara dhe 4.9% për vendet në zhvillim. FMN-ja ka paralajmëruar gjithashtu bankat qendrore në mbarë botën që të jenë shumë të kujdesshme me politikat e tyre dhe të monitorojnë nga afër rritjen e çmimeve. Sipas tyre, stabilizimi i inflacionit pritet të ndodhë rreth mesit të vitit 2022. Ekonomistët, nga ana tjetër, menduan se edhe nëse rritjet e çmimeve duken të jenë kalimtare, ato rrezikojnë të bëhen të përhershme.⁹ Ata argumentojnë se bankat kryesore qendrore janë ende të mbyllura nga masat e vendosura në mars 2020, kur paniku dhe pasiguritë

⁷ Parashikimi i vjeshtës i Komisionit Evropian mund të gjendet në: https://ec.europa.eu/info/sites/default/files/economy-finance/ip160_en_0.pdf

⁸ Analiza e krizës energjetike mund të gjeni në: <https://www.ft.com/content/72d0ec90-29e3-4e95-9280-6a4ad6b481a3>

⁹ Analiza e inflacionit mund të gjendet në: <https://www.ft.com/content/dc3bedc7-5694-4868-8b86-f9a215966f52>

ishin në kulm. Tregu po përjeton një goditje të ofertës dhe jo të kërkesës. Nëse e shohim më nga afër, mund të vërehet se mallrat e qëndrueshme janë kategoria me inflacionin më të lartë. Kjo shpjegohet, ndoshta, me rritjen e kërkesës për mallra të tillë pas bllokimit.

Table 1. Çmimet në tregjet ndërkombëtare

	2019 Mes.	2020				2021		
		TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3
Indeksi i çmimeve për të gjitha mallrat (çmimet e mallrave bazë - FMN) ¹⁰	117.6	108.1	91.7	106.7	117.1	139.7	154.1	167.5
Indeksi i çmimeve të ushqimeve dhe pijeve (çmimet e mallrave-FMN)	98.2	100.2	95.5	97.9	106.1	117.2	130.1	129.7
Çmimi i naftës bruto e tipit Brent (Fleta Rozë e BB-së) ¹¹	64	50.5	31.4	42.7	44.5	60.6	68.6	73.0
Nikeli, \$ për ton metrikë (Fleta Rozë e BB-së)	13,914	12,690	12,237	14,266	15,957	17,618	17,359	19,112

Tabela 1 pasqyron trendin në rritje të çmimeve për të gjitha produktet, i cili reflektohet në secilën kategori. Çmimet e naftës në tremujorin e fundit të 2021-ës, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, parashikohen të rriten me mbi 50%, ndërsa çmimet e produkteve të tjera pritet të rriten mesatarisht me 16%. Gjatë këtij viti pritet të rriten edhe çmimet e mallrave të tjera.

3.2. Zhvillimet e fundit ekonomike në Kosovë dhe perspektiva për vitin 2021


3.2.1. Sektori real

Në fund të vitit 2020, pasuritë e NP-ve arritën në 18.7 përqind të BPV-së, një ngritje prej 2.1 pikë të përqindjes nga 2019 (16.6 përqind e BPV-së në 2019), ndërsa detyrimet e tyre ishin 7.9

përqind të BPV-së (nga 7.6 përqind në 2019). Të ardhurat e tyre totale janë ekuivalente me 4.9 përqind të BPV-së (nga 4.6 përqind në 2019) ose 16.1 përqind e të hyrave buxhetore totale.

Në tërësi, sektori i NP-ve gjeneroi një fitim prej 13.2 milionë euro në vitin 2020, një përmirësim nga humbja e përgjithshme prej 8.4 milionë euro në vitin 2019. Më shumë se gjysma e NP-ve gjeneruan një fitim. Përkundër faktit ky sektor ishte profitabil gjatë 2020, kthimi i përgjithshëm nga sektori është i ulët – një kthim në ekuitet prej 1.8 përqind në vitin 2020. Likuiditeti i këtij sektorit është duke u dobësuar, por NP-të kanë akoma asete të mjaftueshme afatshkurtra për të përmbushur detyrimet afatshkurtra. Mesatarisht rreth 42 përqind e financimit të NP-ve vjen nga borxhi. Sidoqoftë, performance e dobët financiare (humbje në pothuajse gjysmën e NP-ve), do të thotë se ky nivel i borxhit është i lartë në krahasim me të ardhurat që gjenerohen nga sektori.

Table 5. Pasqyrat financiare të përmbledhura për sektorin e NP-ve (mijëra euro)

	2016	2017	2018	2019	2020
Total të hyra	307,029.1	286,537.9	298,658.3	326,597.4	329,535.3
<i>përqindje e BPV-së</i>	5.06	4.47	4.48	4.63	4.87
EBITDA	73,484.3	76,663.2	98,356.8	99,562.7	102,148.8
<i>përqindje e BPV-së</i>	1.21	1.20	1.47	1.41	1.51
Neto Profiti apo Humbja	29,324.2	(33,435.1)	7,292.5	(8,370.8)	13,222.2
<i>përqindje e BPV-së</i>	0.48	-0.52	0.11	-0.12	0.20
Gjithsej Asetet	1,005,846.8	996,931.6	978,517.0	1,169,390.1	1,267,340.8
<i>përqindje e BPV-së</i>	16.57	15.54	14.67	16.6	18.7
Asetet afatshkurtra	271,389.5	256,818.9	226,132.7	238,911.1	264,902.7
<i>përqindje e BPV-së</i>	4.47	4.00	3.39	3.39	3.91
Detyrimet gjithsej	527,894.9	517,011.8	513,086.6	538,757.9	534,153.2
<i>përqindje e BPV-së</i>	8.70	8.06	7.63	7.56	7.77
Detyrimet afatshkurtra	115,697.5	116,831.9	123,462.7	173,216.8	200,869.6
<i>përqindje e BPV-së</i>	1.91	1.82	1.85	2.45	2.97
Ekuiteti	478,836.8	480,786.8	464,047.2	630,632.6	733,187.7
<i>përqindje e BPV-së</i>	7.89	7.50	6.96	8.94	10.83

Vlerësimi i rrezikut fiskal të NP-ve

NP-të mund të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në treguesit fiskalë, për shembull kur sigurohen subvencione më të larta se sa pritej, kredi ose injeksione të kapitalit (ekuitetit); ka një kristalizim të detyrimeve kontingjente (të mundshme); ose të ardhurat nga taksat dhe dividendët janë më të ulëta se sa pritej. NP-të gjithashtu mund të kenë një ndikim indirekt në treguesit fiskal përmes ndikimit të aktiviteteve të tyre në rritjen ekonomike. Materializimi i rreziqeve në nivelin e kompanisë ka më shumë mundësi të shkaktojë rreziqe fiskale kur NP-të nuk janë mjaftueshëm të kapitalizuara, janë me humbje dhe kanë nivele të ulëta likuiditeti.


Përveç mbështetjes emergjente fiskale që iu ofrua NP-ve gjatë periudhës pandemisë (rreth 11.7 mln Eur për NP- të të marrë në konsideratë në këtë studim), rreziqet e tjera fiskale të lidhura me NP janë materializuar. Borxhet e papaguara të taksave të NP-ve janë grumbulluar. Infrastruktura dhe pajisjet e NP-ve janë duke u vjetruar dhe zhvlerësuar tej mase, dhe tani duhet të zëvendësohen, por NP-të nuk janë në gjendje ta përballojnë kostot që ndërlidhen me këto investime. Për NP-të si kompanitë hekurudhore dhe Posta e Kosovës, ndër të tjera, tarifrat që ata ngarkojnë, të cilat janë të rregulluara, janë të pamjaftueshme për të mbuluar kostot e tyre. Disa NP, veçanërisht Telekom i Kosovës, po përjetojnë vështirësi aq të rënda financiare sa që mbështetja e qeverisë mund të jetë e nevojshme për të siguruar mbijetesën e tyre.

Një vlerësim i rrezikut fiskal të 17 NP-ve është përpiluar. Vlerësimi i rrezikut fiskal u bazua në rezultatet vjetore të audituara (pasqyrat financiare të audituara) për vitin 2020. Për secilën

kompani, u llogaritën gjashtë tregues kryesorë financiarë: *i*) raporti i mbulimit të kostos; *ii*) kthimi në kapital; *iii*) raporti i përmbushjes së obligimeve afatshkurta me asete afatshkurta; ('current ratio'), *iv*) ditët për përmbushjen e llogarive të arkëtueshme; *v*) raporti i borxhit ndaj aseteve; *si* dhe *vi*) raporti i borxhit ndaj EBITDA (të hyrat para interesit, taksave, zhvlerësimit dhe amortizimit). Këta tregues janë zgjedhur pasi ofrojnë një tregues të mirë të përgjithshëm të përfitimit, likuiditetit dhe aftësisë paguese të NP-ve individuale. Çdo raporti iu caktua një vlerësim rreziku, bazuar në normat ndërkombëtare. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut u llogarit si mesatarja aritmetike e vlerësimeve të rrezikut për raportet individuale. Metodologjia për kryerjen e vlerësimit të rrezikut do të vazhdojë të përmirësohet çdo herë e më shumë.

Nga 17 NP, gjashtë u klasifikuan si "me rrezik të lartë" ose "me rrezik shumë të lartë" (gjatë 2019 ishin gjithsej dhjetë). Së bashku, detyrimet e papaguara të këtyre kompanive arrijnë në 2.5 përqind të BPV-së. Vlerësimi i rrezikut tregon se, në tërësi, shumica e NP-ve kanë një pozicion likuiditeti të shëndoshë, por disa prej kompanive po përjetojnë vështirësi në mbledhjen e borxheve nga debitorët e tyre. Shumë nga NP-të kanë nivele të larta detyimesh karshi aftësisë së tyre (të pamjaftueshme) për të gjeneruar të hyra, përmes të cilave t'i mbulojnë më pas ato detyrime.

Figure 14. Pjesëmarrja e detyrimeve gjithsej sipas NP-ve (përqindje e BPV-së)



Për të adresuar disa prej problemeve të lartpërmendura, Qeveria është në procesin e ndryshimit të Ligjit për NP-të, i cili krijon kornizën mbi funksionimin e sektorit të NP-ve, me qëllim të përafrimit të qeverisjes korporative të NP-ve me standardet e njohura ndërkombëtare, përmirësimin e performancës së NP-ve, rritjen e vlerës së aseteve të tyre dhe sigurimin e shërbimeve cilësore për publikun. Janë edhe një sërë masash që duhen diskutuar në të ardhmen e afërt për të adresuar problemet ekzistuese të NP-ve, sikurse stabilizimi i bordeve dhe menaxhmentit të NP-ve përmes një procesi transparent dhe merititor, ristrukturimi, privatizimi, apo edhe likuidimi ndër të tjera.

Rreziku nga detyrimet kontingjente që rrjedhin nga kreditë e nënhuazuara dhe garancitë shtetërore

Në portofolin e borxhit shtetëror të Kosovës, burim potencial i këtij rreziku janë kreditë e garantuara të sektorit publik dhe kreditë ndërkombëtare të nën-huazuara tek kompanitë që ofrojnë shërbime esenciale publike. Kreditë e garantuara në fund të tremujorit të katërt të vitit 2021 janë në shumën 30.63 milionë euro dhe përbëjnë 1.8% të borxhit të përgjithshëm. Pjesa e portofolit që mund të kërkojë monitorim më të afërt janë garancia shtetërore ndaj Trafikut Urban dhe kreditë e nën-huazuara ndaj kompanive që ofrojnë shërbime publike. Analizat e rreziqeve financiare dhe ekonomike kanë ngritur shqetësimet lidhur me performancën e dobët të kompanive publike. Një devijim më i thellë i rezultateve financiare të këtyre kompanive mund shkaktojë barrë për Qeverinë në afat të mesëm si për subvencionimin e shërbimeve që

ato ofrojnë ashtu edhe për marrjen përsipër të obligimeve financiare ndaj kreditorëve të jashtëm. Për të kufizuar ndikimin e rrezikut nga detyrimet kontigjente do të vazhdojnë të zbatohen një numër masash si: (a) monitorimi i pozitës financiare të përfituesve (b) vlerësimi fillestar i mundësisë së materializimit të detyrimeve kontigjente ekzistuese. Varësisht nga vlerësimet për humbjet e supozuara, do të përcaktohen edhe tarifat e garancisë të aplikueshme sipas Ligjit për Borxhin Publik. Si masë për menaxhimin e këtyre rreziqeve shërben edhe përfshirja e garancive në shumën e borxhit të përgjithshëm, në kalkulimin e kufirit të borxhit ndaj BPV-së. Në plan afatmesëm si masë shtesë që duhet të ndërmerret në funksion të menaxhimit të këtyre rreziqeve është përfshirja e një pozicioni në Ligjin e Buxhetit si ndarje buxhetore për humbjet nga garancitë dhe kreditë e nën-huazuara në rast të dështimit në shlyerjen e tyre nga huamarrësi kryesor.

Rreziqet e jashtme

Ngritja e çmimeve të rrymës në Evropë

Aktualisht, ky është rreziku kyç që vjen nga ekonomia e jashtme. Për shkak të një rimëkëmbje të shpejtë globale, edhe kërkesa për gazin, si një nga burimet e energjisë elektrike është rritur. Këtë vit çmimi i gazit në Evropë është ngritur deri në 600 përqind. Ky zhvillim mund të ketë pasoja negative për ekonominë tonë. Siç edhe u cek më herët, ndërlihdhet e ekonomisë tonë me atë të jashtme janë të shumta, posaçërisht përmes dy kanaleve: tregtisë dhe remitencave. Andaj, përmes këtyre dy kanaleve mund të përcillet edhe efekti negativ nga ky zhvillim. Efektet negative potencialisht mund të jenë: aktivitet më i ulët ekonomik, të hyra të disponueshme më të ulëta si dhe inflacion më i lartë.

Veç kësaj, një zhvillim negativ së fundi si rezultat i ngritjes së çmimit të gazit është ndërprerja e prodhimit të njërës ndër eksportuesve kyç në Kosovë – Ferronikelit, që njëkohësisht është edhe punëdhënës i rreth 1,000 punëtorë.

Masat për të adresuar inflacionin e lartë në Eurozonë

Përveç rimëkëmbjes së shpejtë në vendin tonë, gjatë këtij viti është diskutuar shumë edhe tema e rritjes së çmimeve, pra inflacionit. Kjo temë ka qenë prezentë në pothuajse të gjitha vendet e botës, ku kishte zhvillime të ngjashme.

Është e mundshme që gjatë vitit 2022, vendet e Eurozonës (ku gjenden një pjesë e madhe e partnerëve tanë tregtarë) të ndërmarrin masa shtrënguese të kushteve monetare (rritje e normës së interesit) për të adresuar rritjen e vazhdueshme të çmimeve. Këto masa do të ndikojnë negativisht në aktivitetin ekonomik të këtyre vendeve, gjë e cila potencialisht mund të përçohet edhe tek ekonomia jonë.

4. KORNIZA FISKALE

4.1. Zbatimi i buxhetit në vitin 2021 (Të dhëna preliminare)

Rritja e të ardhurave, e reflektuar në të gjitha kategoritë, është mbështetur nga rikuperimi i shpejtë i aktivitetit ekonomik mbështetur nga një rikthim i fortë në konsum, nga masat e ndërmarra në kuadër të rritjes së përputhshmërisë vullnetare, kthimi i besimit tek institucionet dhe nga inflacioni i lartë i nxitur kryesisht nga çmimet e larta të importeve.

Të dhënat për periudhën janar-dhjetor 2021 tregojnë një realizim më të lartë të të ardhurave si dhe shpenzime më të ulëta se ato të planifikuara në Buxhetin e Rishikuar për vitin 2021²¹.

Të hyrat nga taksat indirekte kanë shënuar rritje të ndjeshme pasi reflektojnë drejtpërsëdrejti rritjen e importeve të mallrave, jo vetëm për shkak të volumit më të lartë të importeve, por edhe çmimeve të larta të importit. Të hyrat indirekte gjatë kësaj periudhe shënuan rritje vjetore me 30.8% krahasuar me vitin 2020 dhe 17.6% krahasuar me vitin 2019. Të hyrat nga doganat në këtë periudhë shënuan rritje vjetore prej 22.6% në vitin 2021. Të hyrat nga TVSH-ja kufitare shënuan rritje vjetore prej 34.8% për 2021. Gjithashtu, të hyrat nga akciza si një nga kontribuuesit më të lartë në gjithsej të hyrat buxhetore, shënuan rritje prej 25.9% në fund të muajit dhjetor. Kjo rritje i atribuohet kryesisht rritjes ekonomike në vend që ndikon drejtpërdrejt në rritjen e kërkesës agregate, e cila u reflektua në rritjen e vazhdueshme të importeve të rregullta të naftës dhe benzinës gjatë këtij dhjetëmujori. Gjithashtu, importi i cigareve dhe pijeve alkoolike është rritur gjatë kësaj periudhe, në linjë me hapjen e ekonomisë dhe veçanërisht sektorit të hotelerisë.

Nga ana tjetër, **të hyrat nga taksat direkte** janë rritur me 28.0% në terma vjetorë për periudhën janar-dhjetor, si pasojë e rritjes së aktivitetit ekonomik dhe 17.1% krahasuar me vitin 2019. Rritja më e theksuar gjatë kësaj periudhe është te të hyrat nga tatimi mbi të ardhurat personale me 19.9% krahasuar me vitin e kaluar; tatimi mbi të ardhurat e korporatave u rrit me 33.6%; dhe tatimi në pronë është rritur me 59.7%.

Të hyrat jo-tatimore gjatë kësaj periudhe arritën vlerën prej 233.8 milionë eurosh, të cilat janë rritur me 30.2% në terma vjetorë, dhe 9.8% krahasuar me vitin 2019. Gjatë kësaj periudhe, të hyrat nga dividendët arritën në 10 milionë euro të paguara nga KEK-u.

Nga ana tjetër, **gjithsej shpenzimet buxhetore** në periudhën janar-dhjetor 2021 shënuan një rritje prej 2.5% krahasuar me vitin paraprak (2020). Shpenzimet në kategorinë **“paga dhe mëditje”** shënuan rritje vjetore prej 1.0% krahasuar me vitin e kaluar, e cila erdhi kryesisht nga masat e lidhura me pandeminë. Shpenzimet për **“mallra dhe shërbime”** shënuan rritje prej 9.6%, pjesërisht si rezultat i përshpejtimt të aktivitetit të administratës publike, por edhe si pasojë e blerjes së vaksinave. Përveç kësaj, MFPT ka paguar edhe disa borxhe të trashëguara prej disa vitesh për mallra dhe shërbime. Shpenzimet për **“subvencione dhe transfere”** ishin rreth 2.9% më të ulëta në terma vjetorë, kryesisht për shkak të efektit bazë në vitin e kaluar (2020), me targetim më të mirë të shpenzimeve sociale.

Gjithsej shpenzimet kapitale gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 shënuan rritje prej 10.8%. Struktura e shpenzimeve kapitale sipas burimeve të financimit dominohet nga buxheti i rregullt me rreth 82.8%, pasuar nga fondet e të hyrave vetanake (11.0%), huamarrja e jashtme e financiar nga klauzola e investimeve (4.8%); dhe nga huamarrja e jashtme e rregullt (1.4%).

Shpenzimet e interesit gjatë kësaj periudhe arritën në 32.2 milionë euro, të cilat janë rritur për 17.0% krahasuar me vitin e kaluar.

Deri në fund të vitit 2021, **shpenzimet për përbalimin e pandemisë Covid-19 në kuadër të “Programit të Ringjalljes Ekonomike”** arrijnë në 234.2 milionë euro (3.2% e BPV-së), nga të cilat 22.8 milionë euro për paga dhe mëditje, 20.8 milionë për mallra dhe shërbime dhe 190.1 milionë euro për subvencione dhe transfere. Shpenzimet për Covid-19 për vitin 2021 mbeten nën nivelin e regjistruar krahasuar me atë një vit më parë, i cili vlerësohet në rreth 4.2% të BPV-së.

²¹ Kjo pjesë bazohet në të dhënat preliminare për vitin 2021, të cilat mund të kenë diferenca të vogla pasi të finalizohen dhe publikohen pasqyrat financiare për vitin 2021

Table 6. Operacionet e Qeverisë së Përgjithshme, në miliona Euro

Përshkrimi	2020	Buxheti i rishikuar i vitit 2021	Aktualet janar-tetor 2021
1. Të hyrat totale	1,722.2	2,043.2	2,183.71
1.1 Të hyrat nga tatimi	1,507.0	1,791.3	1,947.96
Tatimet Direkte	267.2	326.4	342.17
Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatave	85.3	110.2	113.95
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	158.0	176.3	189.52
Tatimi mbi pronën e patundshme	22.7	35.0	36.26
Tjetër	1.3	4.9	2.44
Tatimet indirekte	1,272.7	1,512.9	1,664.70
Tatimi mbi vlerën e shtuar:	770.1	929.1	1,038.22
Të brendshme:	222.4	264.5	291.67
Kufitare	547.8	664.5	746.55
Detyrimi doganor	101.6	126.3	124.61
Akciza	398.1	454.1	501.30
Të tjera indirekte	2.9	3.5	0.57
Rimbursimet e tatimeve	-33.0	-48.0	-58.91
1.2 Të ardhurat jo-tatimore	181.2	241.4	235.75
Tarifa, ngarkesa dhe të tjera - Nivelit Qendror	103.5	119.7	129.2
Tarifa, ngarkesa dhe të tjera - Nivelit Lokal	42.7	49.0	57.27
Tarifa koncesionare	2.7	19.0	16.97
Renta Minerare	29.4	20.0	19.24
Të ardhurat nga dividendët	0.0	30.0	10.0
Të ardhurat nga interesi (hua e KEK)	2.7	3.7	3.07
1.3 Mbështetja buxhetore dhe grantet	34.0	10.5	0.0
1.4 DDG- Grantet e donatorëve	9.0	12.0	16.80
2. Shpenzimet totale	2,234.9	2,516.6	2,290.86
2.1 Shpenzimet e përsëritura	1,827.7	1,927.4	1,837.87
Pagat dhe mëditje	660.8	646.2	667.33
Mallrat dhe shërbimet	299.2	384.3	327.86
Subvencionet dhe transfere	867.8	864.3	842.68
	228.7	n/a	190.1
2.2 Shpenzimet kapitale	380.0	554.5	420.79
Financimi nga Buxheti i rregullt	283.0	443.6	402.3
Financimi nga Klauzola e Investimit	43.0	111.0	18.49
Të hyrat nga likuidimi (AKP)	54.0	0.0	0.0
2.3 Interesi i borxhit publik	27.5	34.7	32.2
DDG- Grantet e donatorëve	9.00	12.00	9.71
Deficiti buxhetor (sipas rregullës fiskale) si % e BPV-së	-5.40%	-4.60%	-0.84%
Bilanci i shfrytëzueshëm bankar si % e BPV-s	3.50%	3.90%	3.97%
Shpenzime totale Covid-19, mln Eur	287.3		234.2
Shpenzime totale Covid-19, % BPV	4.2%		3.2%

4.2. Përmbledhje e implikimeve fiskale të krizës Covid-19

Ngjashëm me vitin paraprak, Qeveria e Kosovës në vitin 2021 ka vazhduar si të miratojë masa kufizuese për të parandaluar përhapjen e varianteve të reja të virusit Covid-19, ashtu edhe të ofrojë mbështetje fiskale për grupet dhe bizneset më të cënueshme, duke stimuluar rimëkëmbjen ekonomike. Masat mbështetëse të Covid-19, janë prezentuar gjatë Buxhetit të Rishikuar 2021, dhe Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, me buxhet rreth 440 milionë euro. Megjithatë, bazuar në informatat më të fundit në dispozicion mbi zbatimin e kësaj pakoje, shpenzimet që ndërliken me pandeminë Covid-19 pritet të jenë rreth 234 milionë euro deri në fund të vitit 2021, ose rreth 3.2% e BPV-së.

Krahas masave të ndihmës direkte, qeveria u ka mundësuar bizneseve edhe shtyrje të pagesës së taksave, por shumica e tyre duhej të paguheshin brenda vitit 2021. Përveç kësaj, Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike i miratuar në Kuvend në fund të vitit 2020 parashikonte dy masa që

preknin të hyrat buxhetore gjatë vitit aktual (2021). Një nga masat përfshinte lirim të subjekteve nga pagesa e rentës minerare nga 1 janari 2021 deri më 31 maj 2021, me një humbje të vlerësuar të të hyrave buxhetore prej rreth 14.5 milionë eurosh. Masa e dytë përfshinte uljen e TVSH-së nga 18% në 8% për furnizimet e hoteleve, shërbimet e restoranteve dhe të hotelierisë, me një kosto fiskale prej rreth 5-7 milionë eurosh. Të gjitha këto masa kontribuuan në humbje të të hyrave buxhetore prej rreth 19.5-21.5 milionë eurosh, ose rreth 0.2% të BPV-së.

Megjithatë, të hyrat janë ndikuar nga rimëkëmbja e fuqishme e aktivitetit ekonomik, pavarësisht se pandemia vazhdon ende gjatë vitit 2021. Me heqjen e komponentit ciklik nga të ardhurat buxhetore, ndikimi i kësaj rimëkëmbjeje në të hyrat buxhetore vlerësohet të jetë rreth 1.2% e BPV-së.

Pandemia e Covid-19 ka sjellë nevojën për financime shtesë. Qeveria ka marrë financim shtesë në vlerën 78 milionë euro në vitin 2021, nga të cilat 50 milionë euro nga Asistenca Makro Financiare e BE-së (kësti i dytë); 17 milionë euro nga Financimi i Sektorit Publik për Reagimin Emergjent Covid-19 (CEB); 3.51 milionë euro nga Projekti IDA për Shëndetësi dhe 7.54 milionë euro nga Projekti IDA Emergjencia në Kosovë Covid-19:-të gjitha këto janë të disbursuara.

Table 7. Vlerësimi i ndikimit fiskal të krizës së Covid-19 në vitin 2021

	Për shkak të masave diskrete të njëhershme (në % të BPV-së)	Për shkak të rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik (në % të BPV-së)
Në shpenzimet buxhetore	+ 3.2%	
Në të hyrat buxhetore	- 0.2%	+1.2%
Ndikimi i përgjithshëm në buxhet	+ 1.8%	+1.2%
Në borxhin publik	+ 1.0%	
Në detyrimet e kushtëzuara		

4.3. Planet e buxhetit për vitin 2022 dhe periudhën afatmesme

Të ardhurat buxhetore për periudhën afatmesme pritet të rriten më lartë se trendi i tyre historik të periudhës para pandemisë. Sipas parashikimeve të fundit, gjithsej të hyrat buxhetore pritet të rriten mesatarisht me 10.5% në periudhën afatmesme. Rritja e parashikuar është më e theksuar në vitin 2022 me 15.0%, kryesisht si rezultat i vazhdimit të rimëkëmbjes së ekonomisë pas pandemisë.


Të hyrat nga taksat indirekte do të vazhdojnë të kenë përqindjen më të lartë në gjithsej të hyrat, me rreth 74.6% në vitin 2022 dhe pritet të rriten me rreth 16.5% krahasuar me Buxhetin e Rishikuar të vitit 2021. TVSH-ja pritet të rritet me 18.7%, e nxitur nga rritja e importeve të mallrave dhe konsumi i përgjithshëm, por edhe nga presionet e vazhdueshme të larta inflacioniste deri në mesin e vitit 2022. Gjithashtu vlen të theksohet se eksportet e shërbimeve të udhëtimit, kanë një efekt pozitiv në rritjen e të hyrave vendore nga TVSH-ja. Të hyrat nga akciza parashikohen të rriten me 17.1% gjatë vitit 2022, ndërsa të hyrat nga dogana pritet të zvogëlohen me 0.6% krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2021.

Të hyrat nga tatimet direkte gjatë vitit 2022 pritet të rriten me rreth 22.2% krahasuar me Buxhetin e Rishikuar të vitit 2021, duke arritur në 16.9% të gjithsej të hyrave.

Të hyrat jo-tatimore gjatë vitit 2022 parashikohet të zvogëlohen krahasuar me Ligjin e Rishikuar të Buxhetit për vitin 2021 dhe pritet të jenë 239.1 milionë euro. Kjo rënie vjen si pasojë e efektit bazë në vitin 2021, gjatë të cilit janë pritur të pranohen të ardhura nga dividendët në vlerë prej 10 milionë eurosh nga KEK-u.

Në dy vitet e ardhshme(2023-2024), të hyrat totale buxhetore pritet të rriten mesatarisht rreth 8.3%. **Tatimet direkte** në periudhën 2023-2024 pritet të kenë një rritje mesatare prej 8.0%. Të hyrat nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave pritet të rriten mesatarisht për 8.1%. Në mënyrë të ngjashme, tatimi mbi të ardhurat personale pritet të rritet me 8.1%, ndërsa tatimi në pronë pritet të shënojë një rritje mesatare më të theksuar me 7.4%. **Tatimet indirekte** pritet të rriten me 8.7% në 2023-2024. TVSH-ja parashikohet të rritet me 9.4%; taksa doganore me 8.9% dhe akciza me 7.0%. Rritja mbështetet kryesisht nga rritja e bazave tatimore për secilin lloj tatimi, por edhe duke marrë parasysh efektin negativ të marrëveshjes së tregtisë së lirë me Turqinë dhe MSA-në. Të hyrat jo-tatimore pritet të ndjekin trendin e tyre historik dhe të kenë një rritje prej 6.9% në periudhën 2023-2024.

Figure 15. Struktura e të hyrave në gjithsej të hyrat



4.4. Parashikimi i shpenzimeve për vitin 2022 dhe periudhën afatmesme


Gjithsej shpenzimet buxhetore në vitin 2022 pritet të rriten me 9.2% në terma vjetorë, krahasuar me Buxhetin e Rishikuar për vitin 2021.

Gjithsej shpenzimet rrjedhëse gjatë vitit 2022 janë planifikuar të rriten me 3.3% krahasuar me Buxhetin e Rishikuar për vitin 2021, në vlerë prej 1,990.3 milionë eurosh. Shpenzimet për kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë planifikuar të jenë 670.9 milionë euro dhe do të shënojnë rritje prej 3.8%, duke mbetur brenda rregullës fiskale. Shpenzimet për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë planifikuar të shënojnë rritje prej 5.1% krahasuar me Buxhetin e Rishikuar për vitin 2021, kurse subvencionet dhe transferet gjatë vitit 2022 pritet të rriten me 3.3% kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve për grupet vulnerabël (pensionet bazë dhe të disa kategori tjera), ndihma sociale, pagesat e pushimit të lehonisë dhe shtesat për fëmijë si dhe shpenzimet tjera të lidhura me pandeminë. Shpenzimet kapitale - përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të gjithsej shpenzimeve dhe pritet të përfaqësojnë rreth 25.6% të tyre në vitin

2022. Gjatë kësaj periudhe, pritet realizimi i projekteve kapitale bazuar në listën e prioriteteve e cila përfshin projekte me ndikim në përmirësimin e rrjetit të transportit, përmirësimin e rrjetit elektrik dhe përmirësimin e kushteve në arsim, si dhe në sistemin social dhe atë shëndetësor. Shumica e investimeve kapitale pritet të financohen nga buxheti i rregullt, por një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshëm janë planifikuar të financohen me huamarrje të jashtme përmes klauzolës së investimit. Ndërsa për kategorinë e rezervës rrjedhës janë ndarë 21.02 milionë euro.

Gjatë viteve në vijim 2023 dhe 2024, shpenzimet totale janë planifikuar të rriten me një normë mesatare prej 5.7%. Shpenzimet rrjedhëse gjatë vitit 2023 dhe 2024 planifikohen të rriten mesatarisht rreth 1.6%, ndërsa shpenzimet kapitale planifikohen të rriten me 16%.

Figure 16. Struktura e shpenzimeve buxhetore



4.5. Bilanci strukturor fiskal

Bilanci strukturor përfaqëson bilancin fiskal të qeverisë, të korigjuar nga efektet ose luhatjet e ciklit të biznesit, të cilat nuk janë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të qeverisë. Shpesh argumentohet se bilanci i përgjithshëm fiskal nuk ofron një panoramë gjithëpërfshirëse të pozicionit fiskal sepse ky pozicion ndikohet në një masë të konsiderueshme edhe nga ciklet e biznesit nëpër të cilat kalon një ekonomi. Gjatë periudhave, kur një ekonomi përjeton përshejtim të rritjes ekonomike, të hyrat tatimore kanë tendencën të rriten; ndërsa në kushte të ngadalësimit ekonomik, të hyrat tatimore, veçanërisht të hyrat nga të ardhurat dhe konsumi, zvogëlohen, ndërsa në të njëjtë kohë shpenzimi qeveritar rritet, kryesisht si rezultat i shpenzimeve më të larta në përfitime të papunësisë²². Këto zhvillime në treguesit fiskalë, të cilat ndodhin pa asnjë lloj ndërhyrje diskrecionale nga qeveria, ndihmojnë në zbutjen e luhatjeve ekonomike, dhe për këtë arsye njihen si “stabilizatorë automatikë”. Bilanci fiskal strukturor (i zhveshur nga cikli biznesor) synon të masë pozicionin fiskal “të pastruar” nga këta stabilizatorë, me qëllimin për të kuptuar më mirë shkallën dhe intensitetin e politikës diskrecionale fiskale.

Për të përftuar bilancin strukturor është e rëndësishme që të izolohet komponenti ciklik i bilancit fiskal, i cili vjen si rezultat i hendekut të prodhimit dhe elasticitetit të prodhimit të buxhetit. Në rastin kur një ekonomi është në nivelin e saj potencial (hendeku i prodhimit është zero), ky komponent ciklik i bilancit fiskal do të jetë zero dhe rrjedhimisht bilanci aktual fiskal

²² Literatura sugjeron se përfitimet e të papunëve janë i vetmi komponent ciklik i shpenzimeve që duhet të merret parasysh kur llogaritet bilanci strukturor fiskal.

përfaqëson në të njëjtën kohë edhe bilancin strukturor. Vlerësimi i bilancit strukturor i paraqitur në këtë pjesë duhet të interpretohet me një shkallë të lartë të kujdesit, duke marrë parasysh disponueshmërinë e kufizuar të të dhënave të BPV-së dhe pasiguritë lidhur me përlogaritjen e prodhimit potencial. Në këtë version të përditësuar të PRE-së, bilanci strukturor është vlerësuar duke përdorur të dhënat vjetore që mbulojnë periudhën 2007 - 2024 (gjithsej 18 observime, 4 prej të cilave projeksione).

Variablat e përdorura në këtë kalkulim janë: BPV-ja reale, BPV-ja potenciale (e kalkuluar duke përdorur filtrin HP), hendeku i prodhimit, të hyrat buxhetore në terma realë (përkatësisht të hyrat tatimore, jo-tatimore dhe grantet), shpenzimet në terma realë dhe elasticiteti i prodhimit të të hyrave tatimore.²³

Me qëllim të heqjes së komponentit ciklik ose të ‘zhveshjes’ së variablave të nevojshme për këtë kalkulim është përdorur specifikimi në vijim:

Variabla e rregulluar fiskale

$$= \text{Variabla e parregulluar fiskale} * \left(\frac{\text{BPV potencial}}{\text{BPV aktual}} \right)^{\text{Elasticiteti}}$$


Të hyrat tatimore u përshtatën duke përdorur elasticitetin e ndryshimit vjetor të të hyrave tatimore, i vlerësuar në rreth 1.12. Ky elasticitet tregon se të hyrat tatimore në mënyrë shpërpjesëtimore rriten më shumë se sa që rritet BPV-ja, gjë që mund të shpjegohet nga disa faktorë. Një faktor mund të jetë se seritë kohore të të hyrave tatimore nuk janë të korigjuara ose të përshtatura për ndryshimet e politikave diskrecionale. Një arsye tjetër mund t’u atribuohet shtrembërimeve të shkaktuara nga sektori jo-formal, të cilat mund të ndikojnë në rritjen dhe elasticitetin e taksave. Ndërsa sa i përket elasticitetit të përdorur për të ‘rregulluar’ të hyrat jo-tatimore është përdorur vlera 1.00. Shpjegimi për përdorimin e kësaj vlere bazohet në faktin se të hyrat jo-tatimore zakonisht lëvizin njëtrajtshëm me BPV-në. Gjithashtu, duke marrë parasysh faktin se Kosova nuk ka stabilizues automatikë (të tilla si përfitimet e të papunëve), pra shpenzimet nuk varen nga gjendja ciklike e ekonomisë, është zgjedhur të mos aplikohet asnjë lloj përshtatjeje në asnjërën prej kategorive të shpenzimeve. E njëjta vlen për grantet.

Pasi u rregulluan variablat e mësipërme, bilanci strukturor primar është llogaritur si më poshtë:

Bilanci Primar Strukturor = Të hyrat tatimore + Të hyrat jotatimore + Grantet – Shpenzimet

²³ Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit përdoret për t’i shndërruar Variablat nominale në terma realë, përkatësisht të hyrat tatimore dhe jo-tatimore, grantet dhe shpenzimet.

Figure 17. Bilanci primar i parregulluar, bilanci strukturor primar dhe hendeku i prodhimit (2007-2024)




Grafiku 17 tregon ecurinë e ndërlidhjes ndërmjet bilancit primar të parregulluar, bilancit strukturor dhe hendekut të prodhimit. Bilanci strukturor primar tregon se sa do të ishte bilanci primar sikur BPV-ja aktuale të ishte e barabartë me atë potenciale (ose shkurtimisht, sikur bilanci primar të zhishej nga cikli biznesor). Për më tepër, grafiku tregon se si gjatë periudhave kur ekonomia operon nën potencial (ose kur hendeku i prodhimit ka vlerë negative), edhe bilanci strukturor primar është më i lartë se bilanci primar i parregulluar, dhe anasjelltas. Bazuar në këto rezultate, periudhat gjatë të cilave ekonomia ka operuar nën potencialin e vet janë viti 2014 dhe 2020 e tutje. Gjatë periudhave të tjera, ekonomia mesatarisht ka qenë lehtësisht mbi potencialin e vet.

Variabla e pozitës fiskale (*'fiscal stance'*), e matur me bilancin strukturor fiskal primar, tregon nëse pozita fiskale e qeverisë ka qenë ekspansioniste a shtrënguese (tkurrëse) gjatë kohës. Në bazë të shifrave të dhëna në figurën 17, shihet se Kosova prej vitit 2010 e tutje (edhe në vitet e parashikuara 2022-2024) ka ndjekur dhe pritet të ndjekë një politikë fiskale ekspansioniste.

Së fundi, variabla 'Impulsi Fiskal', llogaritur si ndryshimi vjetor i pozitës fiskale (bilanci strukturor primar), mat drejtimin dhe shkallën e ndryshimeve në politikat fiskale, ku vlerat negative tregojnë një shtim të impulsit fiskal, ndërsa ato pozitive një tërheqje të impulsit fiskal në kërkesën agregate. Nga llogaritjet e paraqitura në figurën 18 vërehet se masat e ndërmarra nga Qeveria në vitin 2020 si reagim ndaj pandemisë kanë kontribuar në impulsin fiskal ekspansionist. Në vitin 2021, impulsi fiskal ka vazhduar të jetë zgjeruese, falë masave të parashikuara në Pakon e Ringjalljes Ekonomike për vitin 2021. Në horizontin e parashikuar (2022-2024), pozita fiskale parashihet të mbetet mbështetëse, ku në vitin 2022 do të shënohet impuls fiskal ekspansionit për shkak të realizimit më të lartë të shpenzimeve kapitale dhe masave të vazhdueshme të qeverisë për adresimin e rimëkëmbjes ekonomike pas pandemisë.

Figure 18. Bilanci strukturor primar, pozicioni fiskal dhe impulsi fiskal (2007-2024)



4.6. Nivelet dhe zhvillimet e borxhit, analiza e operacioneve të mëposhtme dhe rregullimet e flukseve të stoqeve

Kosova ka adaptuar një kornizë mjaft të matur ligjore me qëllim të parandalimit të praktikave të paqëndrueshme të borxhit. Ligji nr. 03/L-175 për Borxhet Publike i jep Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve të drejtën ekskluzive për të hyrë në hua dhe për të negociuar kushtet e borxhit ndërkombëtar në emër të Republikës së Kosovës. Sipas Kushtetutës, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare financiare duhet të ratifikohen në Kuvend me shumicë të dy të tretave të votës.

Deri më tani, Ligji për Borxhin Publik përfshin disa dispozita që sigurojnë stabilitet fiskal, duke përfshirë tavanin e borxhit publik prej 40% të BPV-së si dhe kufizime të caktuara të huamarrjes komunale. Detyrimet kontigjente llogariten si borxh publik sipas këtij treguesi. Ligji për Borxhin Publik obligon raportim të rregullt në Kuvend (neni 15) përmes përgatitjes së Programit të Borxhit Shtetëror, i cili përfshin strategjinë afatmesme të borxhit që duhet të dorëzohet për miratim në Qeveri dhe për informim në Kuvend.

Sa u përket kufizimeve të tjera për borxhin publik, në këtë drejtim është bërë një amendament dhe është shtuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), i cili kufizon deficitin vjetor të buxhetit në jo më shumë se 2% të BPV-së së parashikuar. Një tjetër ndryshim i LMFPP-së është shtuar në vitin 2015, i cili i lejon qeverisë të kontraktojë borxhin që tejkalon rregullin fiskal prej 2%, vetëm nëse financimi ofrohet nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe dedikohet për projekte kapitale (klauzola e investimeve). Ministria e Financave ka nxjerrë rregullore për borxhin ndërkombëtar dhe borxhin e brendshëm që i kontribuojnë menaxhimit më efikas të borxhit publik. Bazuar në Rregulloren për Emetimin dhe Administrimin e Borxheve Shtetërore, Garancive Shtetërore dhe Borxheve Komunale, huatë ndërkombëtare negocohen nga një ekip zyrtar që përbëhet nga anëtarë të departamenteve të ndryshme: Divizioni për Menaxhimin e Borxhit (DMB), Departamenti Ligjor, Departamenti i Politikave Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, Departamenti i Buxhetit dhe organizatat përkatëse buxhetore. Emetimi i letrave të brendshme me vlerë të qeverisë autorizohet me Ligjin për Borxhet Publike, dhe është i rregulluar me Rregulloren nr. 02-2021 për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë.

Praktikat e deritanishme të menaxhimit të borxhit shtetëror janë në përputhje të plotë me kërkesat që dalin nga legjislacioni parësor dhe dytësor. Projektligji për Borxhin ka kaluar fazën e konsultimit publik dhe është caktuar për shqyrtimin e parë në Kuvend në janar 2022.

Me qëllim të avancimit dhe përshtatjes së infrastrukturës ligjore me standardet e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, legjislacioni parësor dhe dytësor i është nënshtruar procesit të rishikimit dhe deri në fund të 2021-së pritet të miratohet legjislacioni parësor, ndërsa ai dytësor pritet të përfundohet dhe miratohet gjatë vitit 2022.

Tabela më poshtë tregon nivelet e borxhit gjatë viteve.

Table 8. Borxhi i përgjithshëm i qeverisë, në milion euro (përveç nëse tregohet ndryshe)

Përshkrimi	2018	2019	2020	P.2021	P.2022	P.2023	P.2024
Borxhi ndërkombëtar	416.43	409.10	525.80	569.66	878.83	1,111.08	1,345.07
Borxhi i Brendshëm	676.62	791.94	961.90	1,106.14	1,226.14	1,356.14	1,486.14
Borxhi i Përgjithshëm i Qeverisë	1,093.05	1,201.05	1,487.69	1,675.8	2,104.14	2,467.22	2,831.21
Garancitë Shtetërore	44.00	42.68	31.65	30.63	29.61	28.59	27.57
Borxhi/BPV	17.04%	17.63%	22.44%	22.45%	25.4%	27.16%	28.58%

Detyrimet kontigjente

Në fund të vitit 2021 portfolioja e garancive shtetërore përbëhet nga tri garanci shtetërore:

1. Garancia e dytë shtetërore ndërkombëtare i është lëshuar në vitin 2016 ndërmarrjes publike lokale Trafiku Urban për kredinë e dhënë nga BERZH-i në vlerë prej 10 milionë eurosh. Kredia ishte disbursuar plotësisht dhe ripagimi i saj filloi në vitin 2018.
2. Garancia e tretë është lëshuar në vitin 2016 në shumë prej 24 milion eurosh për të garantuar linjën e dytë kreditore të FSDK-së. Linja kreditore nuk është tërhequr akoma dhe data e fundit e disponueshmërisë është dhjetor 2023.

Siç tregohet në tabelën më poshtë, shumën e garancive shtetërore është në rënie. Gjatë vitit 2021, Qeveria nuk ka hyrë në marrëveshje të reja të garancisë shtetërore.

Table 9. Garancitë shtetërore

	2018	2019	2020	2021	P.2022	P.2023	P.2024
Garancitë shtetërore	44.00	42.68	31.65	30.63	29.61	28.59	27.57
Garancia për Linjën Kreditore të FSDK	10.00	10.00	-	-	-	-	-
Garancia për Trafikun Urban në Prishtinë	9.70	8.68	7.65	6.63	5.61	4.59	3.57
Garancia për linjën e dytë kreditore të FSDK-së	24.00	24.00	24.00	24.00	24.00	24.00	24.00
Garancitë shtetërore (% e BPV)	0.66	0.60	0.47	0.43	0.39	0.36	0.35

4.7. Analiza e ndjeshmërisë dhe krahasimi me programin e mëparshëm

4.7.1. Krahasimi me programin e kaluar

Për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19, prioritetet e qeverisë orientohen drejt tejkalimit të krizës dhe rimëkëmbjes ekonomike. Prandaj, objektivat kryesore të vendosura në PRE 2021-2023 janë: i) beteja për të mposhtur pandeminë, dhe ii) rimëkëmbja ekonomike pas pandemisë. Ndikimi i pandemisë në ekonominë dhe masat e ndërmarra nga qeveria kanë ndryshuar parashikimet makro-fiskale për këtë vit krahasuar me parashikimet e PRE-së së vitit 2020, gjë që shpjegon pjesën kryesore të devijimeve nga programi paraparak.

Krahasuar me PRE-në e kaluar, në PRE 2022, të hyrat për 2021 parashikohet të jenë më të larta për 8.3% (6.8% të hyrat tatimore dhe 20.8% të hyrat jo-tatimore), ndërsa për vitin 2022 të hyrat janë më të ulëta për 18.1% (19.0% të hyrat tatimore dhe 6.3% të hyrat jo-tatimore) dhe për vitin 2023 të hyrat janë më të ulëta për 22.3% (23.66% të hyrat tatimore dhe 7.5% të hyrat jo-tatimore).

Nga ana tjetër, për të akomoduar iniciativa të reja për adresimin e pasojave socio-ekonomike të pandemisë, shpenzimet e përgjithshme janë rritur me 2.5% në vitin 2021 (7.7% shpenzime rrjedhëse dhe -11.4% shpenzime kapitale), ndërsa për dy vitet e ardhshme shpenzimet janë rritur për 15.7% dhe 19.4%, përkatësisht.

Deficiti fiskal, sipas rregullit fiskal, në vitin 2021 pritet të arrijë nivelin prej – 4.6% BPV-së (-338.4 milionë euro), ndërsa bilanci i pashpërndarë bankar do të jetë rreth 3.9% BPV-së (284.8 milionë euro). Në vitet në vijim (2022, 2023 dhe 2024), deficiti buxhetor pritet të ulet gradualisht në përkatësisht -2.9%, -1.8% dhe -0.8%. Këto të dhëna tregojnë që duke filluar nga viti 2023 deficiti ynë fiskal do të jetë brenda rregullit tonë fiskal, pas një tejkalimi të përkohshëm si rrjedhojë e pandemisë COVID-19. Nga ana tjetër, bilanci i përdorshëm bankar pritet të jetë 4.9% e BPV-së në vitin 2022, 4.4% e BPV-së më 2023 dhe 4.6% e BPV-së më 2024.

4.8. Qeverisja fiskale dhe kornizat buxhetore

Në vitin 2020 për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19, ka pasur disa ndryshime sa i përket qeverisjes fiskale dhe kornizave buxhetore. Për të krijuar hapësirën e nevojshme fiskale për të adresuar problemet e shkaktuara nga kriza COVID-19 (rënie të të hyrave tatimore dhe rritjes së shpenzimeve), më 16 qershor 2020, rregullat fiskale të mëposhtme u ndryshuan përkohësisht:

- Deficiti fiskal është lejuar që përkohësisht të arrijë deri në 6.5 për qind të BPV-së, nga ajo që ishte 2 për qind e BPV-së më parë; dhe
- Bilanci bankar është lejuar që përkohësisht të arrijë në 3 për qind të BPV-së, nga 4.5 për qind e BPV-së më parë.

Edhe pse parashikimet e fundit buxhetore parashikojnë një rivendosje të rregullave fiskale drejt niveleve të tyre para pandemisë në vitin 2023, të dhënat preliminare për ekzekutimin e buxhetit për vitin 2021 tregojnë se rregullat fiskale tashmë janë rivendosur dhe pritet të ruhen në vitin 2022 (bazuar në normat historike të ekzekutimit të shpenzimet kapitale).

Sipas aktivitetit 1.1.1 të Planit Strategjik dhe Operacional të Qeverisë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) planifikon të hartojë një Strategji për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike 2022-2026, e cila ka nxitur një sërë punëtorish të organizuara nga MFPT mbështetur nga BE. Këto punëtori synojnë të diskutojnë çështjet që kanë të bëjnë me MFP në përgjithësi dhe me zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) në Kosovë. Lidhur me këtë, është duke u hartuar një koncept dokument i cili do të drejtonte strategjinë dhe do të publikohet për konsultim me partnerët e jashtëm.

4.9. Qëndrueshmëria e financave publike

Pas tkurrjes ekonomike prej 5.3% në vitin 2020, rimëkëmbja e përjetuar në 2021 ishte më e shpejtë se sa pritej. Kjo ecuri, e kombinuar me formalizimin e shkaktuar nga pandemia, kthimi I besimit në institucione dhe çmimet e larta të importit, çoi në një mbledhje më të lartë të të hyrave nga sa pritej, gjë që mundësoi mbushjen e hapësirave fiskale në 2021. Si rrjedhojë, deficiti fiskal sipas rregullës fiskale prej rreth – 5.4% në 2020, arrit në -0.8% në 2021, ndërkohë që niveli i bilancit bankar u rrit nga 3.5% në 4.0% të BPV-së.

Pas tejkalimit të përkohshëm të rregullave fiskale të kufirit të deficitit dhe bilancit bankar në vitin 2020 (rritja e deficitit fiskal nga 2% në 6.5% të BPV-së dhe zvogëlimi i nivelit të bilancit bankar nga 4.5% në 3% të BPV-së), të dhënat aktuale të fundit mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2021 tregojnë tashmë një rikthim të këtyre rregullave më herët se sa ishte planifikuar.

4.9.1. Qëndrueshmëria e Borxhit

Raporti i borxhit publik ndaj BPV-së është brenda niveleve të qëndrueshme, por me një prirje rritëse, e nxitur kryesisht nga projektet e financuara nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare. Megjithatë, në vitin 2020, një tjetër faktor që ka filluar të ndikojë në rritjen e borxhit publik ka qenë financimi shtesë për të adresuar krizën ekonomike të shkaktuar nga COVID-19. Megjithatë, rregullat fiskale në fuqi që kufizojnë nivelet e borxhit publik dhe nivelin e deficitit janë një mjet i rëndësishëm për të ruajtur stabilitetin fiskal në afat të gjatë.

Ligji për Borxhin Publik u miratua në vitin 2010, duke kufizuar borxhin në 40% të BPV-së, ku çdo huamarrje e jashtme i nënshtrohet ratifikimit nga parlamenti. Rregulli tjetër fiskal u prezantua në vitin 2013; dhe kufizon deficitin e përgjithshëm buxhetor në 2% të PBB-së. Në vitin 2015, rregulli fiskal u ndryshua duke futur klauzolën e investimeve, e cila përfshin financimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës dhe plotësimin e nevojave zhvillimore. Gjithashtu, në vitin 2018 u vendos edhe rregulli i rritjes së pagave, duke kufizuar rritjen e faturës së pagave me rritjen e fundit vjetore të BPV-së nominale.

Në fund të vitit 2021, borxhi publik arriti në 22.5% të BPV-së, ku borxhi i brendshëm përbënte 14.6% të BPV-së dhe borxhi i jashtëm 7.5%.

Republika e Kosovës ka filluar emetimin e letrave me vlerë në janar 2012. Zhvillimi i tregut ka qenë shumë i suksesshëm sa i përket interesit të investitorëve dhe kostove të huamarrjes. Kosova ka filluar punën për zgjatjen e maturimit të borxhit të brendshëm në mënyrë që të zvogëlojë rrezikun e rifinancimit. Në këtë linjë, nga viti 2018, Kosova filloi emetimin e bonove 10-vjeçare. Në vitin 2021, Kosova filloi të emitoi ‘obligacionet e diasporës’, të cilat synojnë të tërheqin kapital nga jashtë, por edhe banorët rezidentë kanë të drejtë investimi. Shuma totale e emetuar në vitin 2021 është 20 milionë euro dhe pjesa më e madhe e tyre janë obligacione 5-vjeçare, ndërsa pjesa tjetër janë obligacione 3-vjeçare. Norma vjetore e interesit për obligacionet e diasporës është e fiksuar nga Qeveria, ku ato 5-vjeçare kanë normë të kthimit prej 2.2%, ndërsa për ato 3-vjeçare 1.2%.

Nga ana tjetër, borxhi ndërkombëtar, i cili përbën rreth 7.5% të BPV-së në fund të vitit 2021, përbëhet kryesisht nga kredi me koncesion nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare, si BERZH dhe FMN.

Supozimet kryesore të analizës së qëndrueshmërisë së borxhit

- Analiza e Qëndrueshmërisë së Borxhit (AQB) merr parasysh parashikimet makroekonomike për rritjen në afat të mesëm. Rritja nominale parashikohet të jetë mesatarisht 9.6% për periudhën 2022-2024, dhe më pas të luhatet rreth 4.5% në 2025-2035. Deficiti, duke përjashtuar projektet e financuara nga IFN-të dhe projektet e financuara nga të ardhurat e privatizimit, parashikohet të mbetet brenda kufirit të deficitit sipas rregullit fiskal pas vitit 2022, gjatë gjithë periudhës së mbuluar nga kjo analizë.
- Borxhi publik në analizë nuk përfshin borxhin e NP-ve, por vetëm borxhin dhe garancitë e qeverisë.
- Në periudhën e analizës, borxhi afatshkurtër supozohet të ulet pasi qeveria rrit amortizimin mesatar të letrave me vlerë. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve pas vitit 2017 është fokusuar në zgjatjen e afatit mesatar të maturimit dhe emetimin e

instrumenteve me afat maturimi 5, 7 dhe 10 vjet. Borxhi ndërkombëtar nga IFN-të pasqyron kushtet e marrëveshjeve të borxhit për periudhën e parashikuar. Disbursimet nga klauzola e investimit parashikohet të vazhdojnë deri në vitin 2025, ndërsa fondet e likuidimit pritet të finalizohen në vitin 2022, me një kontribut afërsisht 21 milionë euro.

- Mbajtja e një bilanc bankar prej 4.5% të PBB-së konsiderohet edhe në periudhën pas vitit 2024, megjithëse ky nivel nuk është i detyrueshëm në vitet kur fondet e likuidimit nuk financojnë shpenzime kapitale.
- Struktura e borxhit është e ndarë midis borxhit tregtar, borxhit koncesionar dhe letrave me vlerë të Qeverisë. Aksionet e secilit lloj borxhi janë dhënë në bazë të disa supozimeve të Departamentit të Borxhit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për katër periudha kohore 2022-2032; 2033-2043; 2044-2054; dhe 2055-2065, me rritjen e përqindjes së borxhit tregtar me kalimin e viteve duke qenë se projektet e infrastrukturës dhe nevojat e zhvillimit do të plotësohen gradualisht nga projektet e financuara nga IFI-të. Kjo analizë do të fokusohet në periudhën deri në vitin 2035 pasi për këtë periudhë ka të dhëna më të detajuara në lidhje me amortizimin e kredive të projektit dhe ecurinë e letrave me vlerë.

Skenari bazë tregon se stoku i borxhit publik do të jetë i qëndrueshëm. Raporti i borxhit ndaj BPV-së tregon një prirje rritëse gjatë periudhës dhe tejkalon nivelin prej 30% të PBB-së në vitin 2034. Krahasuar me analizën e borxhit në PRE 2021-2023, nivelet e borxhit afatgjatë pritet të rriten në nivele më të ulëta. Në AQB-në e vitit të kaluar, rritja e borxhit publik ishte parashikuar të rritet më shpejt për shkak të nënvlerësimit të mbledhjes së të ardhurave për vitet 2021-2024. Kështu, në AQB-në e vitit aktual borxhi publik që tejkalon 30% të BPV-së është shtyrë për disa vite.

Pjesa e shpenzimeve për interesa në strukturën e përgjithshme të bilancit (deficitit) mbetet e ulët në vitet e para – ngjashëm me parashikimet e vitit të kaluar –; Gjithashtu, kërkesa për financim (përfshirë financimin mbi deficitin 2% nëpërmjet klauzolës së investimeve deri në vitin 2025), pritet të jetë e njëjtë.

Megjithatë, projeksionet aktuale tregojnë se kontributi i bilancit primar (duke përjashtuar shpenzimet e interesit) nevoja totale për financim është më i ulët se kostot e shërbimit të borxhit, vetëm pas vitit 2028.

Nevoja për financim mbetet nën nivelin 10% të BPV-së, që është nën pragun prej 10% të BPV-së për ekonominë në zhvillim brenda analizës së AQB-ës. Nevoja për financim në 2022-2024 është 3.8% e BPV-së. Mungesa e investimeve të financuara nga fondet e likuidimit dhe ulja graduale e klauzolës së investimit kanë ulur gradualisht nevojën për financim për të reflektuar deficitin e përgjithshëm fiskal. Vetëm në vitin 2022, nevoja për financim parashikohet të jetë 5 e BPV-së, e cila gradualisht stabilizohet pas goditjes së pandemisë.

Figure 19. Borxhi si % e BPV-së- Skenari Bazë




Figure 20. Nevoja për Financim% e BPV-së- Skenari Bazë





Figure 21. Struktura e Bilancit të Përgjithshëm- Skenari Bazë (mil Eur)



Skenari Alternativ

Goditjet nga skenarët e ndryshëm ndikojnë në nivelin e borxhit në përqindje të BPV-së, por nevoja për financim pritet të jetë në nivele të qëndrueshme. Kjo është kryesisht për shkak të respektimit të rregullit fiskal për një deficit prej 2%, në dy skenarët alternativë të mëposhtëm që i respektojnë këto rregulla.

Skenari 1- Goditje ndaj rritjes së BPV-së

Një goditje negative ndaj rritjes së BPV-së prej 2 p.p. në periudhën 2025-2035 e çon raportin e borxhit ndaj BPV-së në 30.8% në fund të periudhës, ose 1.6 pikë përqindje më shumë krahasuar me skenarin bazë. Goditjet negative në aktivitetin ekonomik pritet të ndikojnë negativisht në të hyrat buxhetore. Megjithatë, në këtë skenar rregulli fiskal supozohet se respektohet dhe kjo shërben si një tampon për nivelin e borxhit. Si rezultat, shpenzimet e rregullta reduktohen për të përballuar rënien e të ardhurave dhe për t'iu përshtatur rregullit fiskal prej 2% të PBB-së.

Skenari 2- Goditje ndaj Shpenzimeve Buxhetore

Një goditje ndaj bilancit primar duke rritur shpenzimet me 2% të BPV-së gjatë periudhës 2025-2035 do të rriste raportin e borxhit ndaj BPV-së në 53% në fund të kësaj periudhe. Ky skenar është ndërtuar mbi supozimin se rregullat fiskale nuk janë respektuar. Si rrjedhojë, niveli i borxhit shënon një rritje të ndjeshme prej rreth 23.8 pikë përqindjeje krahasuar me nivelin e

borxhit të parashikuar në skenarin bazë. Ky skenar thekson rëndësinë e respektimit të rregullave fiskale.


Skenari 3- Goditje në normat e interesit

Skenari i tretë paraqet një rritje me 1 p.p. në normat e interesit të kredive(komerciale dhe koncesionare). Megjithatë, rreziqet ndaj niveleve të borxhit që rrjedhin nga interesi i borxhit publik janë brenda “kufijve të tolerueshëm”, sepse ato rregullohen në strategjinë e borxhit dhe rregullin e deficitit fiskal. Më shumë se gjashtëdhjetë përqind e borxhit total është me normë fikse të interesit, dhe pjesa e borxhit me interes të ndryshueshëm është relativisht e vogël. Në të njëjtën kohë, nëse respektohet rregulli fiskal, ndikimi i një rritje prej 1 p.p. në normat e interesit, në stokun e përgjithshëm të borxhit si raport ndaj BPV-së është i papërfillshëm. Stoku i përgjithshëm i borxhit nuk ndryshon ndjeshëm si rezultat i rritjes së normave të interesit. Megjithatë, duke supozuar një goditje interesi prej 1 p.p. në një skenar të mosrespektimit të rregullit të deficitit buxhetor, stoku i borxhit do të rritej ndjeshëm. Stoku i borxhit në fund të vitit 2035 parashikohet në 33.4% të PBB-së, ose 4.3 p.p më i lartë se niveli në skenarin bazë.

Në fund, borxhi publik i Kosovës pritet të rritet, por do të mbetet në nivele stabile ashtu siç sugjeron skenari bazë. Rregullat fiskale në fuqi, veçanërisht ajo që kufizon deficitin në 2% të BPV-së, shërbejnë si stabilizues të nivelit të borxhit. Gjithashtu, duke konsideruar që mos të pritet financim nga fondet e likuidimit, është e nevojshme që të ketë më shumë kontroll mbi shpenzimet rrjedhese për të kursyer hapësirë fiskale për shpenzimet kapitale.

Figura në vijim përmbledh diskutimin mbi bazën dhe tre skenarët alternativë lidhur me dinamikën afatgjatë të borxhit publik në Kosovë.

Figure 22. Niveli i Borxhit sipas Skenarit Bazë dhe Skenarëve Alternativë



KLAUZOLA E INVESTIMEVE

Në vitin 2012, si pjesë e programit të atëhershëm me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Kuvendi i Kosovës pati aprovuar amandamentet e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, përfshirë edhe rregullën fiskale. Ndër të tjera, kjo nënkupton një kufizim vjetor të huamarrjes shtetërore në maksimum 2% të Bruto Produktit Vendor (BPV), pa marrë parasysh kapacitetin e Qeverisë për të siguruar më shumë financim të jashtëm për projekte kapitale me rëndësi publike.

Në të njëjtën kohë, Qeveria e Kosovës identifikoi nevojën për hapësirë shtesë për financim të projekteve të mëdha kapitale dhe në 2015 filloi negociatat për një program të tretë të FMN-së, i cili mes të tjerash, do të lejonte relaksim të rregullës fiskale. Me fjalë të tjera, për projekte të mëdha kapitale me rëndësi strategjike, Qeveria do të ishte në gjendje të hynte në borxh përtej rregullës fiskale prej 2% për një periudhë 10 vjeçare, me kushtin kryesor që të mos tejkalohet 30% i BPV-së së parashikuar.

Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar që në mënyrë të balancuar të përfshijë në procesin e buxhetit projekte kapitale të implementuara përmes “klauzolës për investime”, ashtu që analizimi i financimit të projekteve të tilla të bazohet në analizat për qëndrueshmërinë afatgjatë të borxhit publik.

Një kusht tjetër i paraparë me dispozitat e klauzolës për investime është që Ministria e Financave të përgatisë dy herë në vit një raport narrativ për implementimin e projekteve nën këtë dispozitë.

Është më e rëndësishme të theksohet se pandemia Covid-19 ka pasur një ndikim të ndjeshëm në ngadalësimin e realizimit të projekteve të planifikuara përgjatë 2020. Masat e marra për të menaxhuar efektin e pandemisë në shëndetin publik, kanë shkaktuar një ngadalësim të aktivitetit ekonomik që është përcjellë me probleme të shumta për bizneset në vend dhe shtresat më të ndjeshme të shoqërisë. Për të sajuar dëmet e shkaktuara nga pandemia, Qeveria e Kosovës ka hartuar Planin për Rimëkëmbje Ekonomike, pjesë të së cilit do të financohen përmes Klauzolës së Investimeve.

Situata e krijuar nga pandemia ka krijuar poashtu nevojën që të sigurohet financim shtesë për të menaxhuar situatën ekonomike dhe shëndetësore.

Projektet që janë të përfshira në klauzolën investive janë të përmbledhura shkurtimisht në vijim:

1. Financim për ri-kapitalizimin e Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive - Në mënyrë që të lehtësohet qasja në financim për bizneset vendore, në kuadër të programit për rimëkëmbjen ekonomike nga kriza e shkaktuar nga pandemia COVID-19, është rritja e kapitalit të Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive (FKGK). me 40 milion euro dhe është planifikuar të financohet përmes marrëveshjes së financimit mes Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime (BEI), e cila është nënshkruar dhe ratifikuar.

2. Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19 - Ky projekt është në kuadër të programit për rimëkëmbjen ekonomike sa i përket sektorit shëndetësor me Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës. Vlera totale e kredisë është 35 milionë euro, ndërsa norma e interesit është e subvencionuar nga Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës (CEB) deri në 1 milion euro. Marrëveshja financiare është ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës dhe ka hyrë në fuqi. Kjo marrëveshje gjatë vitit 2021 është amadamentuar me financim shtesë prej 25 milion euro, ky amadamentim është në fuqi dhe një pjesë e shumës është përdorur për financimin e blerjes së vaksinave për mbrojtje nga COVID-19, si dhe shpenzimeve tjera të ndërlidhura me COVID-19.

3. Projekti Emergjent për COVID-19 për Kosovën (dhe amadamentimi i financimit shtesë) - Ky projekt është negociuar dhe ratifikuar më 2020. Qëllimi kryesor i projektit është të mbështesë Qeverinë e Kosovës në luftën kundër pandemisë së COVID-19. Komponentët kryesorë të projektit kanë të bëjnë me rimbursimin e shpenzimeve të transfereve sociale që janë bërë në vitin 2020, si dhe komponenta për blerjen e pajisjeve mjekësore. Vlera totale e projektit bazë është 46 milionë euro, si dhe 2 milionë euro grant të dhëna nga BB. Amadamentimi i financimit shtesë ka rritur shumën e projektit edhe për 15 milion euro. Një pjesë e prokurimi të pajisjeve mjekësore është duke u kryer nga UNOPS.

4. Kredia e likuiditetit të urgjencës së infrastrukturës vitale - Për shkak të pandemisë COVID-19, ofruesit e shërbimeve vitale infrastrukturore në Republikën e Kosovës janë përballur në vazhdimësi me humbje të të hyrave. Në mungesë të likuiditetit apo ndonjë përkrahje shtesë qeveritare, këto ndërmarrje janë nën vështirësi të theksuara financiare. Me qëllim të shmangies së këtij rreziku, Qeveria e Kosovës ka negociuar këtë marrëveshje për kredi emergjente për infrastrukturë vitale me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Vlera e kredisë është 30,000,000 EUR me kohëzgjatje prej 3 vjet. Marrëveshja financiare është nënshkruar dhe ratifikuar në fund të vitit 2020. Disbursimi i parë prej 10 milionë euro është bërë në tremujorin e dytë të vitit 2021, ndërsa pjesa tjetër pritet të bëhet në deri në fund të 2021 apo në fillim të 2022 në formë të nën-huazimit.

5. Projekti i Fuqizimit të Sektorit Financiar - Ky projekt ka Fondin Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) si institucion implementues, dhe qëllimi i projektit është përmirësimi i qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla, dhe të mesme, duke forcuar kapacitetin financiar dhe teknik të FKGK-së. Marrëveshja financiare është lidhur me AZhN/Bankën Botërore dhe është disbursuar në tërësi. Me aprovimin e Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike është mundësuar që FKGK të mbulojë më shumë se 50% të garancionit të kredive për investime të caktuara dhe të mbulojë tarifatat përkatëse për biznese. Asistenca teknike e paraparë në projekt është duke punuar në vazhdimësi me FKGK për të arritur synimet e përcaktuara në projekt.

6. Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10 - Institucioni zbatues i këtij projekti është Ndërmarrja Publike “Infrakos” Prishtinë. Fillimisht, kostoja totale e projektit vlerësohet të jetë rreth 194.5 milionë euro, ku gjysmën e financojnë BERZH dhe BEI, ndërsa gjysmën tjetër të këtij projekti e financojnë Bashkimi Evropian. Marrëveshjet financiare me BERZH dhe BEI janë nënshkruar dhe ratifikuar. Për sa i përket kontributit të BE-së, tashmë janë nënshkruar dhe ratifikuar marrëveshja e parë dhe e dytë e grantit. Megjithatë zhvillimet e fundit, vlera totale e projektit pritet të rishikohet. Si një projekt me prioritet të lartë për BE-në, barazia me institucionet financiare ndërkombëtare (BERZH dhe EIB) do të ruhet për të kërkuar fonde shtesë për këtë projekt. Paralelisht një aplikim për grant do të dorëzohet në WBIF. Punimet civile për fazën 1 kanë filluar në fillim të vitit 2019, ndërsa për fazën 2 kanë filluar në vitin 2021. Projektimi i detajuar për fazën 3 pritet të fillojë në vitin 2021. Disbursimi i parë nga kreditë dhe marrëveshja e donacionit është realizuar gjatë vitit 2019, dhe për shkak të vonësive në zbatim, në nëntor të vitit 2020 është nënshkruar ndryshimi i marrëveshjes së kredisë me BEI, ku data e disponueshmërisë së kredisë është shtyrë deri në vitin 2022. Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10 – institucioni implementues për këtë projekt është Ndërmarrja Publike “Infrakos” Prishtina. Fillimisht, totali i kostos së projektit është vlerësuar të jete rreth 194.5 milionë euro, ku BERZH dhe BEI financojnë gjysmën ndërsa Bashkimi Evropian gjysmën tjetër të këtij projekti. Marrëveshjet financiare me BERZH dhe BEI janë nënshkruar dhe ratifikuar. Për sa i përket kontributit të BE-së, marrëveshja e parë dhe e dytë e grantit tanimë është nënshkruar dhe ratifikuar. Por, si pasoje e ndryshimeve të çmimit të tregut ndërkohë dhe nevojës për ekspertë shtesë, vlera totale e projektit pritet të jetë rreth 255 milion EUR. Si projekt me prioritet të lartë për BE-në, do të mirëmbahet pariteti me institucionet financiare ndërkombëtare (BERZH dhe BEI) për të kërkuar financim

shtesë për këtë projekt. Paralelisht do të dorëzohet aplikacion për grant në WBIF. Punët civile për Fazën 1 kanë filluar në fillim të vitit 2019, ndërsa për Fazën 2 pritet të fillojnë në 2021. Për fazën 3 janë duke u përgatitur termat e referencës për dizajnin preliminar detal, ndërsa punët pritet të fillojnë në 2021. Disbursimi i parë nga kreditë dhe marrëveshja e donacionit është realizuar gjatë vitit 2019, dhe për shkak të vonesave në implementim në nëntor të këtij viti është nënshkruar marrëveshja e amandamentimit me BEI dhe është bërë zgjatja e afatit të kredisë deri në vitin 2022.

7. Rehabilitimi i Ibër-Lepencit - Shuma e financuar nga huamarrja për këtë projekt është 22 milion EUR, prej të cilave 7 milion janë kredi direkte tek ME dhe 15 milion janë të nën-huazuara tek Ibër-Lepenci që njëkohësisht është organizata implementuese e projektit. Marrëveshja financiare mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore është ratifikuar në vitin 2017 ndërsa disbursimi i parë është bërë në janar 2018. Deri në muajin nëntor 2021 është disbursuar 21% e shumës së përgjithshme të kredisë. Ministria e Ekonomisë së bashku me Bankën Botërore janë duke ristrukturuar projektin.

8. Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale - Institucioni implementues për këtë projekt është Ministria e Infrastrukturës. Marrëveshja financiare është nënshkruar dhe ratifikuar, dhe projekti ka vlerën prej 29 milion EUR, me financim nga BERZH. Punët në terren kanë filluar në Maj të 2019-ës dhe të gjitha kontratat janë të nënshkruara. Në fund të vitit 2020 është nënshkruar marrëveshja për vazhdim të grantit për mbulimin e shërbimeve shtesë të konsulentit si mbështetje për njësinë implementuese të projektit deri në vlerën 450,000 EUR.

9. Ndërtimi i Autostradës N9 Prishtinë - Pejë (SEETO Route 6 A) segmenti Kijevë -Klinë deri në Zahaq - Institucioni implementues për këtë projekt është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI). Kosto e projektit është 193 milion EUR. Marrëveshja e Kredisë me BERZH është nënshkruar në 2017 dhe BEI në pjesën e dytë të vitit 2018. Në janar 2019, marrëveshja prej 1 milion EUR është nënshkruar mes Republikës së Kosovës dhe BEI si pjesë e Iniciativës ERI për mbështetje gjatë implementimit. Pritet që gjatë këtij viti të përfitojmë një grant prej 100,000 eurosh nga BERZH për financimin e rrugës dhe studimin institucional. Procesi për përzgjedhjen e mbikëqyrësit të punimeve ka përfunduar dhe është lansuar tenderi për punë të vrazhda. Në vitin 2021, pas gjetjeve zyrtare të auditimit, një kërkesë për shpronësim lidhur me këtë segment është pezulluar dhe aktualisht është në Prokurorinë Speciale.

10. Projekti për Konkurrueshmëri dhe Gatishmëri për Eksport - Organizata implementuese për këtë projekt është Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT). Marrëveshja në shumën 14.3 milion euro është nënshkruar në vitin 2017 me Agjencinë Ndërkombëtare për Zhvillim – Bankën Botërore, dhe disbursimi i parë është bërë në vitin 2019 për zbatimin e projektit. Së shpejti pritet të nënshkruhen kontratat me grantmarrësit dhe me miratimin e Ligjit për Inspektimin në Kuvend pritet të bëhet hartimi i specifikimeve teknike për sistemin e e-inspektimit.

11. Projektin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - Organizata implementuese është MBPZhR. Marrëveshja për këtë projekt në shumën 20.8 milion euro është nënshkruar me Agjencinë Ndërkombëtare për Zhvillim – Bankën Botërore, në vitin 2017. Disbursimi i parë është bërë në mars të 2019-ës. Aktivitetet kryesore në kuadër të komponentit për bartjen e njohurive në sektorin rural kanë përfunduar, programet e granteve për zhvillim rural dhe hortikulturë janë duke vazhduar dhe punimet për rehabilitimin e skemës së ujitjes Radoniqi-Dukagjin janë duke vazhduar sipas planit. Data e mbylljes së projektit është qershor 2022.

12. Trajtimi i Ujërave të Zeza në Prishtinë (Ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza në rajonin e Prishtinës) - MMPHI është institucioni implementues i këtij projekti. Financimi i projektit është siguruar përmes marrëveshjes kornizë mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës, e cila është ratifikuar gjatë

2017. Bazuar në marrëveshjen, projekti ka vlerën 86 milion EUR. Implementimi ka filluar në pjesën e dytë të vitit 2020, ku është hapur tenderi për dizajn dhe është pezulluar.

13. Ekonomia Digjitale në Kosovë (KODE) - Organizata implementuese e këtij projekti është Ministria e Ekonomisë. Marrëveshja financiare për kredi në shumën 25 milion euro është nënshkruar në vitin 2018 me kreditorin IDA/Banka Botërore. Disbursimi i parë është bërë në Nëntor 2019 dhe deri më tani janë disbursuar 23.3% e shumës. Implementimi i projektit është duke vazduar me tempo normale pas disa vonesave në fillim të vitit 2021 për shkak të Covid-19

14. Ndërtimi i Impianteve për Trajtim të Ujërave të Zeza në Mitrovicë - Kompania rajonale e ujit të Mitrovicës është institucioni implementues për këtë projekt. Projekti është në proces të vlerësimit nga BERZH (si institucion kryesor financiar) dhe BEI, të cilët do të financojnë projektin së bashku, ndërsa do të mbështetet edhe nga një grant nga Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor (WBIF). Marrëveshjet me këto institucione janë nënshkruar në 2021, të cilat janë dërguar në Kuvend për ratifikim në 2021.

15. Projekti i Zhvillimit të Trajtimin të Ujërave të Zeza në Gjilan - Kompania rajonale e ujit të Gjilanit është institucioni implementues për këtë projekt, i cili ka një vlerë të paraparë prej 23 milion EUR, që do të financohet prej BERZH dhe BEI. Marrëveshja financiare prej 10 milion EUR me BERZH është nënshkruar në maj të 2020-ës dhe është ratifikuar në parlament me 23 korrik 2020, ndërsa marrëveshja prej 11 milion EUR me BEI është nënshkruar në maj 2020 dhe është ratifikuar në fund të 2020. Projekti pritet të fillojë implementimin gjatë vitit 2022.

16. Projekti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Podujevës - Komuna e Podujevës është institucioni implementues i këtij projekti. Marrëveshja financiare për kredi në shumën 5.35 milion euro është nënshkruar me UniCredit Bank Austria AG, në emër të Qeverisë së Austrisë, në vitin 2018. Disbursimi i parë për projektin është bërë në 2019 dhe deri në fund të vitit 2021 është disbursuar 94% e shumës dhe pritet të finalizohet nga mesi i 2022.

17. Ndërtimi i Skemës për Furnizim me Ujë në Komunën e Ferizajt - Komuna e Ferizajt është institucioni implementues i këtij projekti. Marrëveshja financiare për kredi në shumën 5,125 milion euro është nënshkruar në nëntor të vitit 2018 me Raiffeisen Bank International, e cila vepron në emër të Qeverisë të Austrisë. Disbursimi i parë për këtë projekt është bërë në 2019 dhe deri në shtator 2021 është disbursuar 95.8% e shumës.

18. Ndërtimi i Skemës për Furnizim me Ujë në Komunën e Istogut - Komuna e Istogut është institucioni implementues për këtë projekt, që financohet me kredi në shumën 5,094 milion euro. Marrëveshja financiare është nënshkruar në nëntor të vitit 2018 me UniCredit Bank Austria AG, e cila vepron në emër të Qeverisë së Austrisë. Disbursimi i parë për këtë projekt është bërë në 2019 dhe deri në shtator të vitit 2021 janë disbursuar 95% e shumës.

19. Projekti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Shtimes - Komuna e Shtimes është institucioni implementues për këtë projekt, që financohet me kredi në shumën 2,385 milion euro. Marrëveshja financiare është nënshkruar në nëntor të vitit 2018 me UniCredit Bank Austria AG, e cila vepron në emër të Qeverisë së Austrisë. Disbursimi i parë për këtë projekt është bërë në 2019 dhe deri në shtator të 2021 është disbursuar 72% e shumës së kredisë,

20. Ndërtimi i Skemës për Furnizim me Ujë në Komunën e Graçanicës - Komuna e Graçanicës është institucioni implementues për këtë projekt, që financohet me kredi në shumën 5,115 milion euro. Marrëveshja financiare është nënshkruar në nëntor të vitit 2018 me UniCredit Bank Austria AG, e cila vepron në emër të Qeverisë së Austrisë. Disbursimi i parë për këtë projekt është bërë në 2019 dhe deri në shtator të 2021 është disbursuar 95% e shumës së kredisë.

21. Projekti i Kadastrës së Patundshmërisë dhe Infrastrukturës Hapësinore (REGIP) - Institucioni zbatues i këtij projekti është Agjencia Kosovare e Kadastrës. Marrëveshja financiare në shumën 14.6 milion euro me kreditorin ANZh është nënshkruar në shkurt të vitit 2019. Ratifikimi i marrëveshjes është bërë në gusht 2020 dhe deri më tani janë disbursuar 0.9% e fondeve, dhe gjatë 2022 pritet e avansohet më shpejtë me implementim.

22. Projekti i Transportit Publik, Komuna e Prishtinës - Ndërmarrja Publike e Prishtinës ‘Trafiku Urban’ është institucioni zbatues për këtë projekt, i cili ka një kosto totale të vlerësuar prej 10 milion EUR. Projekti është financuar nga BERZH dhe implementimi i tij ka filluar në vitin 2016. Pas përfundimit të projektit, tani kredia është duke u paguar, deri në fund të vitit 2021 janë paguar me 3.37 milionë euro.

23. Nga Marrëveshja Kornizë për Aid Tied Loan me Qeverinë Hungareze

Këto projekte janë duke u rishikuar dhe pritet që gjatë 2022 të rivlerësohet se cilat projekte do të financohen përmes kësaj huaje. Projektet më poshtë janë indikative, por të cilat do të shqyrtohen:

- **Ndërrimi i gypave të asbestit – çementit në Komunën e Gjakovës** - Ndërrimi i linjave të tubave të furnizimit me ujë të asbestit - material nga çimento, të cilat janë instaluar 55 vjet më parë, në qytetin e Gjakovës. Ky investim do të plotësojë nevojën për të mbështetur furnizimin me ujë të pijshëm nga rubineti për 30 vitet e ardhshme. Agjencia e zbatimit është Komuna e Gjakovës. Projekti është miratuar nga Komiteti Kombëtar i Investimeve (NIC) që do të financohet përmes Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Themelimin e Programit Kuadër për Bashkëpunim Financiar (Ligji Nr. 05 / L-153). Negociatat e Marrëveshjes së Financimit i nënshtrohen procedurave të Ligjit Nr. 05 / L-153.
- **Impianti i trajtimit të ujërave të zeza në Komunën e Ferizajt** - Ky projekt përfshin dizajnin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të grumbullimit (Impianti i Trajtimit të Ujërave të Zeza) në Komunën e Ferizajt. Ky projekt do të zbatohet nga Komuna e Ferizajt. Projekti është miratuar nga Komiteti Kombëtar i Investimeve (NIC) që do të financohet përmes Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Themelimin e Programit Kuadër për Bashkëpunim Financiar (Ligji Nr. 05 / L-153). Negociatat e Marrëveshjes së Financimit i nënshtrohen procedurave të Ligjit Nr. 05 / L-153.
- **Sistemi i kanalizimit në Komunën e Deçanit** - Zona 1: Sistemi i kanalizimit për fshatin Strellec. Zona 2: Sistemi i kanalizimit për fshatin Dubovik dhe pjesë e fshatit Isniq. Zona 3: Kanalizimi i fshatrave Lëbushë, Isniq dhe Prapaqan. Ky projekt do të zbatohet nga Komuna e Deçanit. Projekti është miratuar nga Komiteti Kombëtar i Investimeve (NIC) që do të financohet përmes Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Themelimin e Programit Kuadër për Bashkëpunim Financiar (Ligji Nr. 05 / L-153). Negociatat e Marrëveshjes së Financimit i nënshtrohen procedurave sipas Ligjit Nr. 05 / L-153.
- **Rezervari i ujit të pijshëm në fshatin Verboc / Komuna e Drenasit** - Ndërtimi i ujëmbledhësit për ujë të pijshëm / nga rubineti në fshatin Verboc, i cili do të sigurojë furnizim me ujë të pijshëm në komunën e Drenasit. Ky projekt do të zbatohet nga Komuna e Drenasit. Projekti është miratuar nga Komiteti Kombëtar i Investimeve (NIC) që do të financohet përmes Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Themelimin e Programit Kuadër për Bashkëpunim Financiar (Ligji Nr. 05 / L-153). Negociatat e Marrëveshjes së Financimit i nënshtrohen procedurave sipas Ligjit Nr. 05 / L-153.

24. Projekti për Ndërtimin e Rrugës Besi-Merdare (Autostrada e Paqes) - Ky projekt financohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Evropiane

për Investime, shuma totale e projektit pritet të jetë mbi 200 milionë euro. Projekti është pjesë e Planit Investues të Ballkanit Perëndimor të hartuar nga BE-ja, dhe deri më tani ka përfituar nga grante investive dhe të asistencës teknike rreth 45 milion euro. Projekti kualifikohet për mbështetje deri në 40% me grant, andaj është dërguar aplikimi për shtim të grantit deri në 40% dhe vendimi nga strukturat e Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor pritet të merret në javët në vijim. Marrëveshjet financiare është planifikuar që të konkludohen në vitin 2022.

25. Projekti për Nxitjen dhe Levimin e Mundësive për Sigurinë e Ujit - Është projekt i cili ka si synim ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve vendore për menaxhimin e sigurisë së ujit dhe përmirësimin e sigurisë së ujit në bazenin e Moravës së Binçës. Projekti është në një shumë 25.1 milion euro, marrëveshja financiare është nënshkruar në 2021 dhe është ratifikuar në kuvend në 2022. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka kërkuar mbështetje nga Bashkimi Evropian dhe Qeverisë Zvicrane, për financimin e një pjese të asistencës teknike të cilën e parasheh projekti në mënyrë që mjetet e huasë të fokusohen më shumë në investime kapitale.

26. Projekti i Reformës së Sistemit të Ndhmës Social në Kosovë - Ky projekt ka për synim forcimin e sistemeve për ofrimin e mbrojtjes sociale dhe përmirësimin e performancës së Sistemit të Ndhmës Sociale. Projekti financohet nga IDA/Banka Botërore, me një shumë totale prej 47 milion euro, marrëveshja e financimit për të cilën është negociuar dhe nënshkruar në vitin 2021. Marrëveshja është nënshkruar dhe pritet të ratifikohet. Pjesa më e madhe e huasë është e dedikuar për linjën buxhetore Subvencione dhe Transfere, sidoqoftë janë paraparë investime për sistemet e realizimit të skemës së ndihmës sociale, varësisht nga zhvillimet në Kuvend.

27. Projekti i Efiqencës së Energjisë për Komunën e Prishtinës dhe Prizrenit - Projekti synon zhvillimin e një programi të besueshëm dhe të përballueshëm për rinovimin e energjisë për ndërtesat publike komunale. Shuma e projektit pritet të jetë 11 milion euro dhe do të financohet nga BERZH. Marrëveshja në mes BERZH dhe Qeverisë së Kosovës pritet të nënshkruhet në fillim të vitit 2022. Huaja do të merret si hua sovrane nga niveli qendror dhe pastaj do të transferohet si nën-huazim për komunat. Komunat do të buxhetojnë projektin si investim kapital për 2023, kur të përgatiten kushtet për fillimin e implementimit të projektit.

28. Projekti për Banim Social - Projekti synon të ofroj banim të përballueshëm për kategori të caktuara të qytetarëve. Projekti është duke u zhvilluar me përkrahjen e UN-Habitat, të cilët janë duke bërë studimin e fizibilitetit dhe koncept dokumentin për program. Projekti pritet të kushtoj në total rreth 50 milion euro dhe një pjesë e tij do të financohet nga CEB, derisa modalitetet e strukturimit të projektit si dhe implementimit të tij do të definohen nga studimi i fizibilitetit. Marrëveshja financiare me CEB pritet të negociohet dhe nënshkruhet në gjysmën e parë të vitit 2022.

29. Projekti për Ngrohjen Qendrore Solare - Synimi kryesor i këtij projekti është të kontribuoj në një furnizim eficient, të besueshëm dhe miqësor ndaj ambientit të ngrohjes për shtëpitë, institucionet publike dhe bizneset në Prishtinë. Ky projekt do të financohet nga KfW dhe BERZH. dhe pritet të jetë me vlerë rreth 64 milion euro, prej të cilave rreth 26 milionë euro janë grante.. Marrëveshjet pritet të negociohen dhe nënshkruhen gjatë vitit 2022.

5. REFORMAT STRUKTUREORE 2022-2024

5.1. Përditësim mbi tri pengesat kryesore për konkurrencën dhe rritjen gjithëpërfshirëse dhe masa përkatëse të reformës

a. Analiza e pengesave kryesore

Ky seksion raporton mbi zhvillimet kryesore në lidhje me pengesat kryesore të identifikuar të rritjes ekonomike që nga miratimi dhe dorëzimi i Programit për Reforma në Ekonomi 2021-2023, dhe si i tillë paraqet tre pengesa kryesore për konkurrencën dhe rritjen gjithëpërfshirëse, duke përfshirë masat përkatëse të identifikuar për t'i trajtuar ato.

Gjatë dekadës së fundit Kosova ka tejkaluar vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor për sa i përket BPV-së reale, duke shënuar një normë mesatare prej 4.3%. Megjithatë, përhapja e pandemisë COVID-19 në vitin 2020 çoi në një turrje të BPV-së reale me 5.3% në vitin 2020. Vendi tani po rimëkëmbet nga ky recesion i shkaktuar nga pandemia; rritja reale e BPV vlerësohet të jetë 9.7 % në 2021. Kjo për shkak të një rikthimi më të fortë se sa pritej të vizitave të diasporës, rikthimit të besimit të konsumatorëve dhe kreditimit më të lartë të konsumatorit.

Shkalla e papunësisë në Kosovë është më e larta në Evropë, me 24.6%. Megjithatë, vlen të theksohet se papunësia ka shënuar një rënie graduale gjatë viteve të fundit. Nga ana tjetër, inflacioni (i matur me Indeksin Çmimit të Konsumatorit) dhe borxhi publik (si% e BPV-së) kanë qenë nën kontroll, megjithëse së fundmi këta tregues kanë shënuar rritje të dukshme. Kjo i atribuohet kryesisht ndërhyrjeve të ndërmarra për të përballuar situatën e krijuar nga pandemia COVID-19.

Pavarësisht ecurisë pozitive për sa i përket të ardhurave, ka shqetësime për qëndrueshmërinë e modelit të rritjes. Modeli aktual i rritjes, i nxitur kryesisht nga konsumi privat, investimet në projekte infrastrukturore publike me kthim të ulët, investimet private në aktivitete të patregtueshme me produktivitet të ulët dhe ndihma e donatorëve, është i paqëndrueshëm në terma afatgjatë. Goditja e COVID 19 konfirmoi nevojën për një rikuperim elastik që trajton pengesat strukturore të gjata, por gjithashtu tregoi rolin e rëndësishëm që luajnë remitancat gjatë kësaj periudhe.

Përveç zhvillimeve të fundit ekonomike, Kosova përballet me sfida të ndryshme strukturore për konkurrencën dhe rritjen gjithëpërfshirëse. Komisioni Evropian përmes vlerësimit të rregullt Programit për Reforma në Ekonomi (PRE), përkatësisht përmes analizës së tij ka identifikuar tri sfidat më të rëndësishme. Krahas identifikimit të pengesave për rritjen ekonomike dhe konkurrencën gjithëpërfshirëse, duke u bazuar në analizat specifike të fushave të PRE dhe zhvillimeve të fundit, më poshtë janë identifikuar pengesat kryesore për konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse:

- **Sfida kryesore #1: Nxitja e punësimin të qëndrueshëm nëpërmjet përmirësimit të arsimit cilësor dhe lidhjes me nevojat e tregut të punës;**

- **Sfida kryesore #2: Riorganizimi i sektorit shëndetësor në mënyrë që të ofrohen shërbime shëndetësore adekuate dhe të qasshme për të gjithë qytetarët**
- **Sfida kryesore #3: Krijimi i kushteve për furnizim të qëndrueshëm me energji**

Sfida kryesore #1: Nxitja e punësimit të qëndrueshëm nëpërmjet përmirësimit të arsimit cilësor dhe lidhjes me nevojat e tregut të punës - Kosova përballlet me sfida të mëdha në

sektorin e arsimit për shkak të boshllëqeve domethënëse në rezultatet e të nxënimit të studenteve dhe përputhshmërinë e sistemit arsimor në mënyrë që ky sistem t'i përgjigjet më mirë tregut të punës krahasuar në vendet e tjera, rajonale dhe globale. Përpjekjet e Kosovës për të përmirësuar cilësinë e rezultateve të arsimit për t'i shërbyer më mirë transformimit ekonomik dhe shoqëror janë sfiduar nga burimet e përpjekjeve për reforma, sigurimin e efikasitetit në menaxhimin e financave të arsimit, sigurimin e mekanizmave për llogaridhënie dhe rritjen e kapaciteteve profesionale për mësimdhënie dhe menaxhim cilësor në të gjitha nivelet e sektorit të arsimit. Ndonëse shpenzimet në arsim janë rritur vitet e fundit, ka një mospërputhje të vazhdueshme të aftësive, e cila do të adresohet me masa direkte në periudhën e ardhshme afatmesme. Në TM1 2021, shkalla e papunësisë tek personat pa arsim ishte 55.4% (meshkujt 61.2%, femrat 33.0%); 35.0% të papunë në mesin e atyre me arsim fillor (meshkuj 34.7; femra 35.9%), 26.5% të papunë në arsimin e mesëm profesional (meshkuj 25%, femra 33.2%); shkollë e mesme-gjimnaz 27.5% (meshkuj 24.4%, femra 35.3%) dhe 19.2% te ata me arsim të lartë (meshkuj 15.8%, femra 23.7%).

Pjesëmarrja e fuqisë punëtore në tregun e punës në Kosovë mbetet e ulët. Ndikimi afatshkurtër dhe afatmesëm i COVID-19 ka rritur cenueshmërinë e vendeve të punës dhe rrezikon thellimin e ndarjeve socio-ekonomike. Kriza ekonomike dhe shëndetësore që rrethon COVID-19 rrit pasigurinë në lidhje me punësimin. Megjithatë, të dhënat e fundit në dispozicion të tregut të punës të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se shkalla e punësimit në tremujorin e parë të vitit 2021 shënoi një përmirësim të lehtë në terma vjetorë, duke arritur në 29.3%. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore u përmirësua me 0.7 p.p., duke arritur në 39.5%. Ndërsa shkalla e papunësisë u rrit me 0.8 p.p. në terma vjetorë duke arritur në 25.8%.

Shkalla e ***papunësisë tek të rinjtë*** e moshës 15-24 vjeç është ulur nga 49.1% në 2020 në 48.6% në TM1 2021. Rreth 45.7% e të rinjve të moshës 15-19 vjeç ishin të papunë afatgjatë (më shumë se 12 muaj). Tek meshkujt e rinj papunësia është 46.1%, ndërsa tek femrat papunësia është 53.5%. Sipas AFP-së TM1 2021, përqindja e të rinjve në kategorinë NEET shënoi 29.8% (krahasuar me 33.6% në 2020).

Mospërputhja e shkathtësive me nevojat e tregut të punës mbetet pengesë kryesore. Nga ana e punëdhënësit, midis rreth 50% e firmave raportojnë se edukimi i përgjithshëm nuk i përgatit studentët në mënyrë adekuate për vendin e punës - qoftë në drejtim të njohurive të përditësuara apo shkathtësive të buta (Banka Botërore, 2019). Sipas sondazhit STEP, 75% e kompanive kanë hasur në vështirësi në punësimin e menaxherëve, profesionistëve dhe teknikëve.

Puna e padëklaruar në Kosovë mbetet një tipar kronik i tregut të punës duke ekspozuar kështu punëtorët para një morie rreziqesh dhe ndikon negativisht në të drejtat e tyre, pengon konkurrencën e ndershme dhe minon stabilitetin makroekonomik, financat publike, mbrojtjen sociale dhe kohezionin e gjerë social. Aktualisht Kosova po punon për krijimin

e regjistrimit/databazës kombëtare të punësimit. Të dhënat e Agjencisë së Punësimit flasin për rritje të numrit të punëkërkuesve të regjistruar në Zyrat e Punësimit (ZP), e cila rritje ka ardhur për shkak të masave të pakos emergjente ku njëri prej kriterëve për të përfituar nga masat ka qenë regjistrimi si i papunë dhe punëkërkues në ZP.

Pengesat kryesore strukturore: Mospërputhja e shkathtësive me nevojat e tregut të punës është pengesa kryesore, ndjekur me punësimin joformal, humbjen e të ardhurave buxhetore dhe forcimin e përparësive të kompanive që operojnë në sektorin joformal, shërbimet publike të punësimit, buxheti i pamjaftueshme në zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të punësimit dhe aftësimin profesional në tregun e punës.

Masa e reformës #1: Përshtatja e Arsimit dhe Aftësimin Profesional me nevojat e tregut të punës

Përshkrimi i masës: Kjo masë synon plotësimin e sistemit të AAP me kualifikime formale dhe kualifikime për të mësuarit gjatë gjithë jetës, përfshirë njohjen e Mësimin Paraprak (NjMP) bazuar në kërkesat e tregut të punës, me qëllim të rritjes së punësueshmërisë për zhvillimin ekonomik të vendit. Masa synon fuqizimin e të mësuarit në vendin e punës, fuqizimin e qendrës kosovare të ndërmarrjeve praktike, krijimin e parakushteve për zbatimin e mësimin dual, ku kjo mund të realizohet, dixhitalizimin, këshillimin dhe orientimin në karrierë, autonominë e IAAP-ve me theks në komponentin financiar dhe rishikimin e legjislacionit.

Masa është në përputhje me Programin e Qeverisë 2021-2025, Planin Operacional Strategjik të Qeverisë dhe politikat e MASHTI, është pjesë e SKZH, do të në përputhje me Planin e ri Strategjik të Arsimit 2022-2026, është pjesë e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal ndërsa me SDG është e ndërlidhur me objektivin 4 indikatorin 4.3, 4.4, 4.5, 4.6, dhe 4b.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Definimi i kualifikimeve profesionale sipas nevojave të tregut të punës dhe sigurimi i cilësisë në funksion të zbatimit të mësimin dual; (MASHTI)
2. Identifikimi i nevojave për ngritjen e resurseve profesionale në AAP; (MASHTI)
3. Hartimi i legjislacionit për zbatimin e mësimin dual; (MASHTI)
4. Standardizimi i Qendrave të Karrierës në nivel të shkollave profesionale; (MASHTI)
5. Hartimi i rregullores së Qendrës kosovare të ndërmarrjeve praktike; (MASHTI)
6. Studim i fizibilitetit lidhur me Autonominë e IAAP-ve, përfshirë komponentin financiar; (MASHTI)
7. Zhvillimi dhe rishikimi i legjislacionit sekondar për Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve dhe zhvillimi i proceseve akredituese për institucionet që do ta zbatojnë Njohjen e Mësimin Paraprak. (MASHTI)

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Zhvillimi i programeve për realizimin e mësimin dual pas identifikimit të sektorëve dhe ndërmarrjeve në harmoni me tregun e punës; (MASHTI)
2. Hartimi i programeve trajnuese dhe ofrimi i trajnimeve për ngritjen e resurseve profesionale në IAAP; (MASHTI)
3. Hartimi i dokumenteve të nevojshme për zbatimin e mësimin dual, standardizimin e Qendrave të Karrierës dhe ndërmarrjeve praktike; (MASHTI)
4. Definimi i funksioneve dhe roleve të institucioneve përgjegjëse në fushën e AAP-së; (MASHTI)

5. Përcaktimi i kriterëve dhe parametrave që rregullojnë autonominë e IAAP-ve përfshirë komponentin financiarë me akte nënligjore dhe dokumente përcjellëse që rregullon këtë fushë; (MASHTI)
6. Akreditimi i institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak. (MASHTI)

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Hartimi i programeve trajnuese dhe ofrimi i trajnimeve për ngritjen e resurseve profesionale në AAP; (MASHTI)
2. Funksionimi i Qendrave të Karrierës dhe Ndërmarrjeve Praktike sipas standardeve; (MASHTI)
3. Ngritja e kapaciteteve të institucioneve të AAP për zbatimin e mësimit dual përmes trajnimit të mësimdhënësve dhe instruktorëve; (MASHTI)
4. Ngritja e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse të AAP-së. (MASHTI)

Treguesit e rezultateve:

Treguesit	Viti bazë 2021	Objektivi 2023	Objektivi 2024
Zbatimi i mësimit dual në IAAP (profile)	1	3	5
Programe të hartuara në bashkëpunim me tregun e punës për mësimin dual	1	3	6
Funksionimi i Qendrave të Karrierës	15	20	25

Arritja e treguesve në këtë masë është në përgjithësi në pajtim me Programin Qeverisës 'Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me kërkesat e tregut të punës'.

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Zbatimi i sistemit dual në fushën e AAP-së pritet të rrisë përputhshmërinë e zhvillimit të shkathtësive me nevojat e ekonomisë dhe rritjen e punësimit të aftësuarve në institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional. Po ashtu autonomia e IAAP-ve ndikon direkt në konkurrueshmëri në ofrimin e shërbimeve gjatë tërë jetës dhe sigurimin e cilësisë.

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Kosto e përgjithshme për zbatim të kësaj mase gjatë viteve 2022-2024 vlerësohet të jetë 4.2 milion €. Nga kjo vlerë 1.4 milion € vlerësohet kosto për vitin 2022, nga e cila 104,410.00 euro do të financohet nga Buxheti i Kosovës dhe pjesa tjetër prej 1.295,590.00 € nga burimet tjera (ALLED2, GIZ, LUX Development, EYE, OeAD, DVV). Për vitin 2023, kosto vlerësohet të jetë 1.4 milion €, nga të cilat 110,174.00 euro pritet të financohen nga buxheti i Kosovës dhe 1.289,826.00 € nga burimet tjera (ALLED2, GIZ, LUX Development, EYE, OeAD, DVV). Ndërsa kosto e vlerësuar për vitin 2024 është 1.4 milion euro nga e cila 125,070.00 euro do të financohet nga buxheti i Kosovës dhe pjesa tjetër prej 1.274, 930,00 € nga burimet tjera (ALLED2, GIZ, LUX Development, EYE, OeAD, DVV).

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Harmonizimi i shkathtësive me nevojat e tregut të punës, si dhe miratimi i akteve nënligjore që rregullojnë këtë fushë, do të rezultojë me punëtorë të kualifikuar bazuar në nevojat/kërkesat e bizneseve. Kësisoj, pritet rritja e punësimit, sidomos në mesin e të rinjve.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Masa nuk pritet të ketë ndikim në mjedis.

Rreziqet e mundshme:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
---------	---------------	---------------------------------

Vonesa në hartimin dhe aprovimin e legjislacionit, organikës funksionale, rregulloret e brendshme si dhe ngritja e kapaciteteve të mëtejme e institucioneve të AAP.	I mesëm	Koordinimi ndërinstitucional dhe mbështetja me staf profesional dhe ekspertizë të nevojshme
Mos lehtësimi i procedurave administrative nga institucionet qendrore dhe lokale	I mesëm	Trajnimi i stafit nga institucionet vendore dhe partnerët strategjik për ushtrimin e përgjegjësive të reja
Shpërndarja jo adekuatë e buxhetit në nivel të IAAP-ve	I lartë	Specifikimi i buxhetit si kategori e veçantë për arsimin profesional në ligjin e buxhetit.

Masa e reformës #2: Ngritja dhe sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë përmes fuqizimit të AKA dhe profilizimit të institucioneve të arsimit të lartë

Përshkrimi i masës: Masa vijon nga PRE e vitit të kaluar dhe synon ngritjen e cilësisë së arsimit të lartë përmes përmirësimit të legjislacionit dhe ngritjes së kapacitetit të mekanizmave që sigurojnë cilësinë e ofruar nga institucionet e arsimit të lartë (IAL). Dy projektligjet të cilat do të kenë ndikim në reformimin e tërë arsimit të lartë në Kosovë, Projektligji për Arsimin e Lartë si dhe atë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim janë në përgatitje e sipër. Projektligji për AKA adreson të gjitha rekomandimet e ENQA, siç janë pavarësia institucionale dhe financiare, krijimi i mekanizmave për ngritjen dhe monitorimin e cilësisë në arsimin e lartë etj. Në bazë të Projektligjit të arsimit të lartë, ndër të tjera do të harmonizohen edhe statutet e IAL, hartohen dhe miratohen aktet nënligjore. Agjencia e Kosovës për akreditim do të fuqizohet përmes hartimit të akteve ligjore të cilat e definojnë natyrën dhe përgjegjësitë e saj institucionale dhe gjithashtu garantojnë status të saj të pavarur. Pas aprovimit të ligjit për këtë agjenci, AKA do të zgjeroj aktivitetin e saj në fushën e sigurimit të cilësisë. Kjo fillimisht do të mundësohet përmes rritjes së kompetencave dhe përgjegjësive të saj, e cila do të mundësohet me futjen në fuqi të Ligjit për AKA-në. Rrjedhimisht, AKA do të fillojë procesin e monitorimit, përmes së cilit do të sigurohet se IAL-të në mënyrë të vazhdueshme plotësojnë kriteret dhe standardet e cilësisë. Gjithashtu AKA do të krijojë ekipe të monitoruesve lokal (të brendshëm) duke filluar kështu një fazë të re të delegimit të përgjegjësive tek zyrtarët e saj. Përmes projektit STAND (Erasmus+) do të mbështetet modernizimi i menaxhmenteve të universiteteve përmes zhvillimit dhe funksionalizimit të sistemit për menaxhim. Masa ndërlihet me SKZH si dhe do të përfshihet në planin Strategjik të Arsimit 2022-2026, ndërsa me SDG masa lidhet me objektivin 4, treguesit 4.3, 4.4, 4.5 dhe 4b.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Miratimi i projektligjit të arsimit të lartë; (Kuvendi)
2. Miratimi i akteve nënligjore që burojnë nga Ligji për AKA-në; (MASHTI)
3. Ristrukturimi i AKA-së në harmoni me Ligjin e ri për AKA-në; (MASHTI/AKA)
4. Draftimi i manualit për fushat e ekspertizës; (MASHTI/AKA)
5. Draftimi i rregullores për involvimin e studenteve në proceset e sigurimit të cilësisë; (MASHTI/AKA)
6. Ngritja e kapaciteteve të AKA-së përmes rekrutimit të 15 zyrtarëve të rinj; (MASHTI-AKA);
7. Rishikimi i standardeve në nivelin bachelor dhe master për të nxitur garantimin e cilësisë në arsimin e lartë. (MASHTI/AKA)

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Harmonizimi i statuteve të IAL me ligjin e ri të arsimit të lartë; (MASHTI)
2. Miratimi i akteve nënligjore në bazë të projektligjit të arsimit të lartë;(MASHTI)
3. Hartimi i Standardeve të veçanta për të gjitha IAL-të për programet e Inxhinierisë, shkencave aplikative, Arteve dhe Mjekësisë; (MASHTI/AKA)
4. Krijimi i një baze kombëtare të të dhënave të punësimit; (MFPT)
5. Ngritja e kapaciteteve të AKA-së përmes rekrutimit të 8 zyrtarëve të rinj; (AKA/MASHTI)
6. Zhvillimi dhe funksionalizimi i sistemit për menaxhimin e Universiteteve; (Projekti Erasmus + STAND)

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Harmonizimi i akteve nënligjore në bazë të projektligjit të arsimit të lartë; (MASHTI)
2. Rishikimi i standardeve në harmoni me European Standards and Guidelines; (ESG 2015). (MASHTI/AKA)

Treguesit e rezultateve:

Treguesit	Viti bazë 2021	Objektivi 2022	Objektivi 2023
Ngritja e kapaciteteve të AKA (rekrutimi i zyrtarëve për pozitat e paplotësuara aktualisht)	9	24	32

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Fuqizimi i kapaciteteve dhe i sigurimi i autonomisë së Agjencisë së Kosovës për Akreditim pritet të instalojë zbatimin e praktikave evropiane të sigurimit të cilësisë në fushën e arsimit të lartë. Ndërkaq, mbështetja nga MASHTI në procesin e rishikimit të programeve në fushën e arsimit të lartë konform kërkesave të tregut pritet do adresojë hendekun mes shkathtësive në nevojë dhe kuadrove që aktualisht prodhohen nga sistemi i arsimit të lartë. Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri pritet përmes: uljes së normës së papunësisë, përmes përmirësimit të konkurrueshmërisë së sektorit privat duke u bazuar në krijimin e shkathtësive relevante nga sektori i arsimit.

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Kostoja e përgjithshme për zbatim të kësaj mase gjatë viteve 2022-2024 nga kategoria e pagave si dhe kategoria e mallrave dhe shërbimeve vlerësohet të jetë 683,155.00 €. Vlera totale për vitin 2022 është 343,121.00 €, prej te cilave 107,121.00 € do te financohen nga buxheti i Kosovës, ndërsa 236,000.00€ nga donatorët. Për vitin 2023 vlera totale është 325,034.00 €, prej te cilave 163,034.00€ do te financohen nga buxheti i Kosovës, ndërsa 162,000.00€. do te financohen nga donatorët. Vlera totale për vitin 2024 është 15,000 € që do te financohen nga donatorët.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Masa synon përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë. Siguron thellimin e reformës në arsimin e lartë duke përmirësuar standardet e cilësisë së programeve të arsimit të lartë dhe duke rritur përputhjen me nevojat e tregut të punës dhe të ekonomisë. Nëpërmjet procesi të monitorimit dhe procedurave të më pastajme parashihet monitorimi i IAL-ve për të nxitur ndërlidhjen e sistemit të arsimit me tregun e punës dhe rritjen e cilësisë në arsim.

Kësisoj, ndikimi pritet të jetë i konsiderueshëm sidomos në aspektin e ngritjes së punësimit dhe punësueshmërisë, marrë parasysh se mospërputhja e shkathtësive me tregun e punës është identifikuar si faktor kyç në mirëmbajtjen e papunësisë strukturore. Arritshmëria arsimore

është faktor kyç në gjetjen e një vendi të punës. Tutje, marrë parasysh strukturën demografike në Kosovë, reforma pritet sidomos të ndikojë tek arsimimi i të rinjve, tek të cilët papunësia është në normë alarmante prej mbi 55% për grupmoshën 15 – 24. Kjo masë do të kontribuojë gjithashtu në barazinë gjinore, pasi mund të identifikohen më shumë programe të IAL-ve, përmes përshtatjes së tyre me nevojat e grave në tregun e punës.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Kjo masë është neutrale ndaj ndikimit në mjedis.

Rreziqet e mundshme:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Mos zbatimi i standardeve të cilësisë në fushën e arsimit të lartë	I ulët	Miratimi të Ligjit të AKA dhe plotësimi i stafit të AKA për ushtrimin e plotë dhe efektive të përgjegjëse.
Rezistenca nga IAL-të lidhur me ripërshtatjen e programeve të arsimit të lartë konform kërkesave të ekonomisë	I lartë	Plotësimi i analizave të duhura për identifikimin e profileve të arsimit të lartë të cilat janë deficitare apo të cilat duhet të ripërshtaten. Krijimi i kanaleve institucionale të dialogimit dhe bashkëpunimit me IAL-të lidhur me hapat për përmirësimin gradual të përputhshmërisë së programeve në arsimin e lartë me kërkesat e tregut të punës.

Masa e reformës #3: Rritja e punësimit, ulja e inaktivitetit, formalizimi, zhvillimi i shkathtësive profesionale, përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve publike të punësimit dhe aftësimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës me theks te veçante për grupet e cenueshme.

Përshkrimi i masës: Masa që për fokus parësor ka punësimin, synon zvogëlimin e inaktivitetit formalizimin, rritjen shkathtësive profesionale të fuqisë punëtore me theks të veçantë fuqizimin e rolit të gruas dhe të rinjve, si dhe synon të papunët afatgjatë, dhe grupet tjera të cenueshme. Masa po ashtu konsiston në përmirësimin e shërbimeve publike të punësimit dhe aftësimit profesional përmes rishikimit të politikave të punësimit me synim ngritjen e efektshmërisë së masave aktive të tregut të punës dhe pilotimin e nën kontraktimit të programeve të aftësimit profesional përmes ofruesve privatë dhe hapjen e profileve të reja duke rishikuar kurrikulat ekzistuese dhe të reja në harmoni me kërkesat e tregut të punës. Për më tej, Masa synon rishikimin e politikave të punësimit dhe të aftësimit profesional. Masa mbështetet në disa dokumente strategjike, si Programin e Qeverisë, Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, Strategjinë Sektoriale për Mirëqenie Sociale dhe Punësim, ERA II dhe PKZMSA. Masa është formuluar si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës, pasojave nga COVID, kapacitetet e kufizuara të shërbimeve publike të punësimit, aftësimit profesional dhe mospërputhjen e shkathtësive të fuqisë punëtore me kërkesat e tregut të punës.

Masa konsiston përpos si përgjigje ndaj sfidave të dala nga COVID, edhe në vazhdimin e reformës në shërbime publike të punësimit me synim zgjerimin dhe ofrimin e shërbimeve publike të punësimit dhe aftësimit profesional, përmes kësaj synon ofrimin e shërbimeve kuantitative dhe kualitative për fuqinë punëtore si: këshillim në punësim, coaching dhe orientim në karrierë, hapjen e profileve të reja, validimin dhe ri-validimin e profileve, standardeve profesionale, kurrikulave dhe paketave mësimore.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Hartimi dhe miratimi i Planit për implementimin e Skemës së Garancisë për të Rinjtë

2. Zgjerimi i Masave Aktive të Tregut të Punës për të papunët afatgjatë, të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara;
3. Hartimi dhe miratimi i konceptit dokumentar për rregullimin e fushës së ofrimit të shërbimeve dhe masave të punësimit;
4. Hartimi i Strategjisë së Punësimit;
5. Hartimi i Udhëzuesit për kategorizimin e punëkërkuarve dhe dhënien e shërbimeve sipas kategorive nga shërbimet publike të punësimit
6. Rishikimi dhe zhvillimi i 4 Kurrikulave, paketave mësimore duke u bazuar në standardet e profesionit, botimi i teksteve për 4 Kualifikime dhe validimi i 4 profileve të aftësimit profesional
7. Hapja e një profili në QAP për aftësim profesional bazuar në kërkesat e tregut të punës
8. Pilotimi përmes nën-kontraktimit të jashtëm për minimum dy profile deficitare të aftësimit profesional.
9. Avancimi i standardit të Klasifikimit të Profesioneve për Kosovë dhe integrimi i profesioneve me shkathtësi/kompetenca dhe kualifikime.
10. Fizibiliteti për Barometrin e Tregut të Punës;
11. Fizibiliteti për kualitetin e shërbimeve të punësimit dhe aftësimit profesional përmes zhvillimit të sistemit monitorues dhe vlerësues.
12. Miratimi i Projektligjit të Punës;
13. Zhvillimi i Konceptit të Regjistrimit të Punësuarave, institucion bartës ;
14. Zhvillimi i fushatës vetëdijësuese, për risit që dalin nga Projektligji i Punës në kontekst të adresimit të punës së padeklaruar.

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Zbatimi i skemës së Garancisë për të Rinjtë
2. Zgjerimi i Masave Aktive të Tregut të Punës për të papunët afatgjatë, të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara;
3. Hartimi dhe aprovimi i ligjit që rregullon ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe masave aktive të tregut të punës;
4. Hartimi dhe aprovimi i akteve nënligjore për politikën e punësimit dhe të aftësimit profesional;
5. Rishikimi dhe zhvillimi i 5 Kurrikulave, paketave mësimore duke u bazuar në standardet e profesionit, botimi i teksteve për 5 Kualifikime dhe validimi i 5 profileve të aftësimit profesional;
6. Hapja e një profili në QAP për aftësim profesional bazuar në kërkesat e tregut të punës.
7. Nën-kontraktimi i jashtëm pas pilotimit për minimum dy profile deficitare të aftësimit profesional.
8. Avancimi dhe zhvillimi i Barometrit të tregut të Punës me module të reja si shkathtësitë sektoriale, shkathtësitë profesionale/kompetenca dhe kualifikuese, hendekun e shkathtësive aktuale dhe për të ardhmen.

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Hartimi dhe aprovimi i akteve nënligjore për politikat e punësimit dhe të aftësimit profesional;
2. Rishikimi dhe zhvillimi i 6 Kurrikulave, paketave mësimore duke u bazuar në standardet e profesionit, botimi i teksteve për 6 Kualifikime dhe validimi i 6 profileve të aftësimit profesional;
3. Hapja e një profili në QAP për aftësim profesional bazuar në kërkesat e tregut të punës.
4. Nën-kontraktimi i jashtëm për minimum dy profile deficitare të aftësimit profesional.

Treguesit e rezultateve:

Treguesi	Viti bazë	Objektivi 2023	Objektivi 2024
% e të rinjve që përfitojnë pjesëmarrje në masa aktive të tregut të punës nga numri total i MATP-ve të ofruar në vit kalendarik.	34%	36%	38%
% e grave që përfitojnë pjesëmarrje në masa aktive të tregut të punës nga numri total i MATP-ve të ofruar në vit kalendarik.	34%	36%	38%
% e të rinjve NEET në popullsinë e të rinjve 15 – 24	31.7%	30.7%	29.7%

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Forcimi i kapaciteteve të shërbimeve publike të punësimit dhe aftësimit profesional pritet të ketë efekte pozitive në rritjen e konkurrueshmërisë përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të shkathëtësive të punëkërkuësve. Në periudhën afatmesme e afatgjatë, masa pritet të rrisë konkurrueshmërinë përmes përmirësimit të shërbimeve të punësimit dhe aftësimit profesional.

Vlerësimi i kostonë së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Kostoja e përgjithshme për zbatimin e kësaj mase vlerësohet të jetë 95,791,727.00 € për 3 vite. Ku në vitin 2022 do të jetë 32,081,149.00€, për vitin 2023 do të jetë 31,852,789.00€, dhe 31,857,789.00 € për vitin 2024. Nga shuma totale, 398,360.00 € do të financohen nga ALLED, GIZ, DVV, EYE dhe Lux Development kurse pjesa tjetër nga buxheti i Kosovës.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Kjo masë synon përmirësimin e efektshmërisë së shërbimeve publike të punësimit dhe aftësimit profesional duke u bazuar në ndërtimin e kapaciteteve sipas procesit të rishikimit institucional dhe të shënjestrimit më të mirë të MATP-ve tek të papunët afat gjatë, grupet, e caktuara, me fokus tek të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e cënueshme. Po ashtu, masa synon krijimin e shkathëtësive në profilet deficitare përmes fillimit të zbatimit të modelit të nën kontraktimit të programeve të aftësimit profesional të ofruar privatë. Si tërësi, masa shoqëruar me MATP për të rinjtë pritet të reduktojë përqindjen e lartë të NEET në mesin e të rinjve të moshës 15 – 24. Po ashtu, masa synon ngritjen e veprimeve afirmative në shënjestrimin e personave nga zonat rurale, duke synuar uljen e pabarazive shoqërore.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Masa do të jetë neutrale ndaj mjedisit.

Rreziqet potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
---------	---------------	---------------------------------

1. Zbatueshmëria e MATP-ve të planifikuara për vitet e ardhshme varet nga situata epidemiologjike me virusin Covid-19.	I lartë.	Masat që ndërmerren nga Qeveria për kapërcimin e pengesave që dalin nga situata epidemiologjike me virusin Covid-19.
2. Zvogëlimi i stafit të APRK-se për shkak të pensionimit.	I mesëm.	Të plotësohen me staf të ri, në cilën do zyre të punësimit që është e nevojshme dhe digjitalizimi i shërbimeve të ofruara nga APRK.

Sfida kryesore #2: Riorganizimi i sektorit shëndetësor në mënyrë që të ofrohen shërbime shëndetësore adekuate dhe të qasshme për të gjithë qytetarët - Sistemi i kujdesit shëndetësor

i Kosovës përballet me sfida serioze, si në aspektin e nevojës për investime dhe infrastrukturë, por edhe në aspektin e fokusimit në parandalimin e sëmundjeve dhe jo në trajtimin e tyre. Kosova ka stagnuar në të pasurit e një sistemi informativ gjithëpërfshirës për shëndetësinë. Kosova ka jetëgjatësinë më të ulët në rajon, me vetëm 73 vjet, krahasuar me mesataren prej 77 vitesh në rajon dhe 81 në 27 vendet e BE-së. Në përgjithësi, rezultatet e kujdesit shëndetësor për të gjithë popullatën dhe veçanërisht për fëmijët nuk janë të mira. Shpenzimet për kujdesin shëndetësor arrijnë në 2.83% të BPV-së, më e ulët se shumica e vendeve të rajonit dhe mbulojnë vetëm 40% të nevojave vjetore të kujdesit shëndetësor publik. Investimi në kapitalin njerëzor në sektorin e shëndetësisë dhe luftimi i ikjes së trurit janë thelbësore në parandalimin e një kolapsi të sistemit të kujdesit shëndetësor për shkak të mungesës së profesionistëve mjekësorë.

Përderisa sistemi i kujdesit shëndetësor është publik, qasja në kujdesin shëndetësor shfaq pabarazi në Kosovë. Pa sigurim shëndetësor të disponueshëm publikisht dhe me vetëm 6.8% të popullsisë të siguruar privatisht, qytetarët përballojnë rreth 40% të kostove totale të kujdesit shëndetësor krahasuar me një mesatare prej 13% në vendet e OECD. Qendrat e kujdesit shëndetësor parësor kanë si objektiv trajtimin e 80-90% të problemeve të paraqitura, duke luajtur në të njëjtën kohë rolin e portierëve për nivelet e tjera të kujdesit. Kujdesi dytësor ofrohet përmes referimeve, përveç rasteve emergjente, në gjashtë spitalet e gjashtë regjioneve, përveç Prishtinës. Në përgjithësi, shfrytëzimi i kapaciteteve spitalore të Kosovës është më pak se 60% duke sugjeruar se mund të ketë shumë spitale në vend duke pasur parasysh mungesën e personelit mjekësor. Kjo sugjeron se ka mungesë të profesionistëve mjekësorë, duke pasur parasysh një shkallë të lartë të migrimit të rinjve, veçanërisht mjekëve dhe profesionistëve të tjerë mjekësorë. Ky trend i vazhdueshëm ka potencialin të ketë pasoja të mëdha në të ardhmen, pas daljes në pension të profesionistëve aktualë të mjekësisë.

Për më tepër, faktorët e jashtëm, veçanërisht ndotja e ajrit kanë implikime të rënda për rezultatet shëndetësore të Kosovës. Është raportuar se nivelet e përqendrimeve të PM2.5 në Kosovë bien dukshëm mbi vlerën udhëzuese të OBSH-së, me zonat urbane që e tejkalojnë atë me një faktor prej 3–4, veçanërisht gjatë pikut të lartë të dimrit kur ngrohja joefikase kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në AAP.

Pengesat strukturore: 18% e popullatës nuk ka mundësi për marrjen e shërbimeve shëndetësore, fonde të pamjaftueshme të financimit në sektorin e shëndetësisë nuk mund të adresohet problemi i qasjes për këto kategori të popullatës, moszbatimi i ligjit për sigurim shëndetësor dhe mos alokimi i drejte i resurseve aktuale do të vazhdojnë me mos përmirësimin e mbrojtjes financiare ku do të thellohen barrierat në qasjen e grupeve vulnerable, qasje e ulët

në shërbime shëndetësore dhe pamundësi e familjeve për të përballuar kostot e këtyre shërbimeve me buxhet familjar.

Masa e reformës #4: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore

Përshkrimi i masës: Masa në përgjithësi do të përsëritet nga vitet paraprake pasi që aktivitetet që ndërlidhen me krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të financimit nuk janë realizuar në mungesë të ndryshimeve të nevojshme të kornizës ligjore dhe kapaciteteve administrative për fillimin e sigurimit shëndetësor të obligueshëm, sikurse mos shtrirja e sistemit të informimit shëndetësor që pritet ti nënshtrohet një procesi të vlerësimit me mjetet financiare nga kredia e bankës botërore. Masa e propozuar është një nga prioritetet më të rëndësishme në sistemin shëndetësor është ndryshimi i Ligjit për Sigurim Shëndetësor dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative njerëzore dhe infrastrukture në Fondin për Sigurime Shëndetësore, si kushte për fillimin e grumbullimit të kontributeve. Ky proces do të zhvillohet në të njëjtën kohë me kompletimin e Sistemit informativ shëndetësor. Po ashtu, për këtë qëllim, do të kompletohet legjislacionin dytësor për zbatimin e lirit nga pagesa e kontributeve, bashke pagesat dhe bashkëfinancimin për shërbime shëndetësore, skemën e barnave jashtë spitalore, kontraktim të barnatoreve dhe trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike. Përmes kësaj mase synohet sigurimi i qasjes së barabartë në shërbime shëndetësore për të gjithë qytetarët.

Masa është në përputhje të plotë me Strategjinë sektoriale shëndetësore 2017-2021 dhe objektivat strategjike të saj. Gjithashtu Masa është në përputhje me Programin e Qeverisë 2021-2025 dhe me obligimet që dalin nga agjenda evropiane përfshirë Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA dhe ERA.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022

1. Plotësim ndryshimi i Ligjit për sigurim shëndetësor;
2. Hartimi i Udhëzimit Administrativ për skemën e barnave jashtë spitalore
3. Studimi i fizibilitetit për SISH;
4. Hartimi i Udhëzimit Administrativ për kontraktim të barnatoreve
5. Plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023

1. Hartimi i listës dhe çminimeve të shërbimeve shëndetësore;
2. Hartimi i Udhëzimit Administrativ për zbatimin e lirit nga pagesa e kontributit, dhe bashkë pagesa për shërbime shëndetësore;
3. Fillimi i zbatimit të Testit të Varfërisë të kategorive sociale, për lirim nga pagesa e kontributeve për sigurim shëndetësor;
4. Fuqizimi i kapaciteteve administrative në Fondin e sigurimeve shëndetësore që me punësimin e rreth **48** zyrtarëve;

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024

1. Skema e kompensimit të barnave jashtë spitalore

Treguesit e rezultateve:

Treguesit	Viti bazë 2021	Synimi 2023	Synimi 2024
Kontributet e mbledhura nga të gjithë punonjësit në institucionet publike	0%	0%	100%
Kontributet të mbledhura për sigurimin e obligueshëm shëndetësor në sektorin privat	0%	0%	65%
Qytetarët që nuk kanë qasje në shërbime shëndetësore themelore për shkaqe ekonomike	18%	12%	< 5%

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Realizimi i masës do të ndikoj në uljen e pabarazive në shëndetësi ofrimin e qasjes së barabartë si dhe në rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Masa do të ndikoj në përmirësimin e indikatorëve shëndetësor dhe sigurimin e mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor.

Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe burimi i financimit: Kostoja totale e vlerësuar për zbatimin e kësaj mase (2022-2024) pritet të jetë rreth 1,389,400 €. Burimi i financimit të aktiviteteve për vitin 2022 dhe 2023 është nga buxheti i Kosovës dhe kredia e bankës botërore. Ndërsa buxheti për vitin 2024 përfshinë 300,000 € skema e kompensimit të barnave. Në vitin 2022 nga buxheti i Kosovës është 25.000 € ndërsa 500.000 € nga kredia e BB. Në vitin 2023 llogaritet të jetë 264.400 € nga buxheti i Kosovës dhe 300.000 € nga kredia e BB-së.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Në përgjithësi, masa pritet të ketë ndikim pozitiv në mirëqenien sociale si dhe përmirësimin e performancës së tregut të punës dhe konkurrueshmërisë. Kjo masë kjo do të ndikojë në qasje gjithëpërfshirëse përmes mbulimit të shërbimeve nga lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor për të gjitha kategoritë, sociale dhe gjinore, me një kosto të përballeshme. Përmirësime në shëndetësi gjithashtu ndikon në përmirësimin e rezultateve sociale posaçërisht për grupet e marginalizuara, si dhe personat me nevoja të veçanta, pakicat si dhe gratë .

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Kjo masë nuk ka ndikim mjedisor

Rreziqet Potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Vonesat e mundshme në miratimin e plotësim-ndryshimit të Ligjit për Sigurim Shëndetësor dhe akteve nënligjore.	I mesëm	Nënshkrimi me kohë i programeve dhe publikimi i thirrjeve për aplikim me kohë si dhe aprovimi i Ligjeve të cilët do të rregullojnë shumë çështje me rëndësi për sektorin;
Pamundësia në punësimin e stafit në fondin e sigurimit shëndetësor për shkak të masave kufizuese nga MFPT	I lartë	Krijimi i masave për punësimin e stafit në fondin e sigurimit shëndetësor.

Sfida kryesore #3: Krijimi i kushteve për furnizim të qëndrueshëm me energji - Konsumi i energjisë në Kosovë është shumë i varur nga lëndët djegëse fosile, kapacitetet e prodhimit të energjisë elektrike janë kryesisht nga termocentralet me bazë qymyri, të cilat përbëjnë rreth 94.5% të prodhimit vendor, ndërsa pjesa tjetër e furnizimit prej 5.5% është me bazë BRE, e përbërë nga hidrocentrale, parqe me erë dhe panele fotovoltaike. Gjenerimi vendor nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar ngarkesën maksimale në sistemin elektroenergjetik të Kosovës, andaj një pjesë e kërkesës nacionale për energji elektrike bazohet në import. Ndërsa vendet në Evropë po përballen me rritje të çmimeve të gazit dhe energjisë elektrike, është përkeqësuar në Kosovë ku për shkak të prodhimit të ulët vendor, defekteve teknike dhe motit të ftohtë, i detyroi autoritetet përgjegjëse të importojnë shumë më tepër energji se normalja. Në përgjithësi,

nevojës afatgjatë për të investuar në kapacitetet prodhuese, veçanërisht në burimet e rinovueshme të energjisë, i mungonte një vizion i duhur.

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë ka filluar liberalizimin gradual në vitin 2017 me nxjerrjen e udhëzuesit për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë nga ZRRE. Tregu i energjisë elektrike me shumicë ballafaqohet me mungesën e tregut një-ditë-para, , mungesën e implementimit të plotë të udhëzuesit për liberalizimin e tregut, si dhe me obligimet që rrjedhin nga Marrëveshja për Furnizim me Shumicë në mes të KEK dhe KESCO/KEDS.

Konsumatorët prodhues të energjisë elektrike kanë kufizime sa i përket kapacitetit vet prodhues dhe nivelit të tensionit ku mund të kyçen. Konsumatorët e cenuar aktualisht mbështeten nga një skemë e pagesës direkte për mbulimin e një pjese të kostos së energjisë. Kosova vazhdon të mos kenë qasje në disa komuna në veri të Kosovës. Tregu i energjisë, po ashtu, ballafaqohet me sfidën e derregullimit të çmimeve me pakicë, ku vazhdon të mbetet sfida ndër-subvencionimi i konsumatorëve të kategorive të ndryshme, dhe çmimet e ulëta të cilat nuk reflektojnë koston e prodhimit të energjisë. Kompanitë prodhuese të energjisë elektrike nga BRE-të të cilat kanë investuar nëpërmjet skemës FiT e kanë të garantuar shitjen e energjisë elektrike të prodhuar prej tyre për një periudhë 10-12 vjeçare me çmime fikse të rregulluara.

Humbjet teknike në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në vitin 2020 kanë qenë 12.56% të kërkesës në shpërndarje, kurse konsumi i paautorizuar i energjisë përbëjnë 12.84 % të kërkesës në shpërndarje, prej të cilës energjia e pa faturuar në katër komunat veriore të Kosovës përbënë 6.8 % (335 GWh). Në infrastrukturë, furnizimi i pamjaftueshëm dhe jo i besueshëm me energji elektrike është ende një kufizim i detyrueshëm edhe pse është bërë progres në fushën e integritetit në tregun rajonal, ku Bursa Shqiptare e Energjisë (ALPEX) do të ketë degën e saj në Kosovë. Bursa pritet të fillojë operimin në vitin 2022 dhe do t'i operojë tregjet afatshkurtra të energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë.

Në Kosovë, 60% e shpenzimit të përgjithshëm të energjisë elektrike bëhet nga ndërtesat, ku këto të fundit gjithashtu konsiderohet të kenë potencialin më të madh për zvogëlimin e konsumit të energjisë edhe pse ka disa iniciativa drejt procesit për përmirësimin e efijencës së energjisë në ndërtesa, sfidues mbetet certifikimi dhe kualifikimi, si për ndërtesat ekzistuese po ashtu edhe për ato të reja.

Pengesat strukturore: mungesa e investimeve për rritjen e fleksibilitetit të Sistemit; diversiteti i ulët i burimeve të energjisë; humbjet teknike dhe komerciale në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike; përdorimi joefiçent i energjisë, veçanërisht në sektorin rezidencial; tranzicioni nga skemat mbështetëse në skemat konkurruese për BRE-të; implementimi i plotë të udhëzuesit për liberalizimin e tregut; mosreflektimi i kostos në çmimet e energjisë elektrike; konkurrenca e kufizuar në tregun me shumicë dhe pakicë; bashkëpunimi i limituar ndër-kufitar dhe me vendet e rajonit.

Masa e reformës #5: Zhvillimi i politikave për EE dhe BRE në funksion të tranzicionit të gjelbër

Gjendja aktuale: Përmes kësaj mase synohet prioritizimi i efijencës së energjisë dhe përmirësimi i saj në të gjithë sektorët, e sidomos në atë rezidencial. Sektori rezidencial është një ndër konsumuesit më të mëdhenj të energjisë. Duke e pasur parasysh këtë sfidë, Plani Kombëtar i Veprimit për Efijencën e Energjisë (PKVEE) dhe baza ligjore për performancën energjetike në ndërtesa, shihen si metoda të mira për të reduktuar konsumin jo-efiçent të energjisë elektrike. Certifikimi energjetik i ndërtesave, jo vetëm që do të ndihmonte në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social, por do të ndihmonte edhe në ruajtjen e mjedisit. Kjo masë poashtu ka në fokus rritjen e gjenerimit të energjisë përmes burimeve të ripërtëritshme në përputhje me targetet e vendosura nga BE dhe Komuniteti i Energjisë, dhe

krijimin e kushteve të nevojshme për investime, në përputhje me Acquis dhe qëllimin e BE-së, dhe Komunitetin e Energjisë. Kjo masë do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e ndotjes së ajrit, rritjen e konkurrencës në tregun e energjisë, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, andaj do të kontribuojë drejt arritjes së Objektivës për Zhvillim të Qëndrueshëm për Energji të Pastër dhe të Përballueshme, si dhe drejt politikave të Agjendës së Gjelbër për Furnizim me Energji të Pastër, të Përballueshme, dhe të Sigurte.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Miratimi i projektligjit për BRE (ME)
2. Dizajnimi i skemës së re konkurruese për BRE (ME, ZRrE)
3. Hartimi i koncept dokumentit për rishikimin e ligjit për EE (ME)
4. Ndërtimi i skemës së trajnimit, certifikimi i vlerësuesve dhe rritja e numrit të auditorëve energjetik të certifikuar (ME, MMPHI);
5. Krijimi i platformës digjitale për performancën energjetike në ndërtesa (ME, MMPHI);
6. Hartimi i projektligjit për performancën energjetike në ndërtesa (MMPHI).

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Miratimi i projektligjit për EE (ME)
2. Miratimi i legjislacionit sekondar të ligjit për BRE (ME)
3. Miratimi i legjislacionit sekondar të ligjit për EE (ME)
4. Hartimi i udhëzuesit për Prosumers (konsumator vetë-prodhues) (ZRrE)
5. Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për certifikimin energjetik të ndërtesave duke përfshirë dhe trajnime për institucionet e nivelit qendror dhe lokal (ME, MMPHI);
6. Përcaktimi i procedurës për implementimin e Stimujve të efijencës së energjisë në sektorin privat dhe amvisëri (ME);
7. Miratimi i projektligjit për performancën energjetike në ndërtesa (MMPHI).

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Miratimi i Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (ME)
2. Hartimi dhe Miratimi i Planit të veprimit për implementimin e programit nxitës Prosumers (ME/ ZRrE)
3. Plani i veprimit për implementimin e programit nxitës/ stimujt për sektorin privat dhe të amvisërisë (ME)
4. Aplikimi i stimujve për sektorin privat dhe atë të amvisërisë (FKEE)
5. Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për certifikimin energjetik të ndërtesave (ME, MMPHI)

Treguesit e rezultateve:

Treguesi	Viti bazë 2021	Objektivi 2023	Objektivi 2024
Legjislacioni i BRE, i miratuar		✓	✓

Skema mbështetëse konkurruese për BRE e miratuar		✓	✓
Legjislacioni i EE, i miratuar		✓	✓

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Zbatimi i masave të EE, përfshirë politikën për certifikimin energjetik të ndërtesave, do të kontribuojë drejtpërdrejtë në uljen e konsumit dhe koston së energjisë elektrike. Ulja e konsumit të energjisë nga këto masa do të nxisë investimet e sektorit privat dhe do të ndihmojë bizneset. Në fund, ulja e humbjeve teknike do të ndihmojë në uljen e koston totale të energjisë. Zbatimi i kësaj mase e rrit sigurinë e furnizimit me energji elektrike si një kusht për rritjen e konkurrueshmërisë, dhe zvogëlon sasinë e energjisë së importuar, e cila është energji e pikut dhe me kosto më të lartë se gjenerimi vendor. Për më tepër, do të krijohet hapësirë për zhvillimin e sektorit të BREE dhe EE, krijimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore për investime, dhe për përgatitjen e kompanive vendore për eksport jashtë vendit. Gjithashtu, me zhvillimin e legjislacionit për BRE dhe skemat konkurruese do të krijohet hapësirë për investitorët privat në fushën e BRE për bashkëngjitje në tregun prodhues të energjisë duke përfutur konsumatorët vendor duke ulur çmimet e energjisë elektrike krahasuar me çmimet nga FiT.

Vlerësimi i koston së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Kosto totale për implementimin e masës është 380,000.00€. Kosto për vitin 2022 është 326,000.00€; për vitin 2023 arrin 32,000.00€; dhe për vitin 2024 është 22,000.00€. Nga kjo shumë, 70,000.00€ do të financohen nga Buxheti Qendror i Kosovës, ndërsa 310,000.00€ parashihen të financohen përmes granteve tjera.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Miratimi i legjislacionit në fushën e EE dhe BRE mundëson krijimin e kushteve ligjore dhe strategjike për investime në sektor nga kompanitë vendore dhe të jashtme. Rrjedhimisht do të ndikojë në ngritjen e kapaciteteve institucionale në sektorin e energjisë përmes gjenerimit të vendeve të reja të punës. Zbatimi i politikës për certifikimin energjetik të ndërtesave poashtu do të krijojë mundësi të reja punësimi dhe avancim në tregun e punës, përmes ngritjes së kapaciteteve të ndërmarrjeve prodhuese dhe ndërtimore, ku veprimet e tilla ndihmojnë në uljen e varfërisë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Për më tepër, dokumentet ligjore dhe strategjike do të trajtojnë edhe komponentë të barazisë gjinore, edukimit dhe inovacionit në sektorin e energjisë duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien e qytetarëve dhe pjesëmarrësve në tregun e energjisë.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Kosova si shtet anëtar i Traktatit të energjisë si dhe shtet me perspektivë evropiane, ka konfirmuar qëllimin e saj për përshtatjen e politikave me ato të Bashkimit Evropian, rrjedhimisht edhe politikat e Agjendës së Gjelbër. Me implementimin e legjislacionit dhe PKEK krijohen kushte ligjore, rregullative, operative, dhe infrastrukture që mundësojnë një treg konkurrues aktiv në të cilin rol të rëndësishëm do të ketë tregtimi pa pengesa të energjisë elektrike (pavarësisht nga kapaciteti prodhues apo lloji i teknologjive, në kushtet e zhvillimit të politikave të dekarbonizimit), si dhe do të ndikojë që në treg të depërtojë gjithnjë e më shumë energjia elektrike nga BRE-të, e cila për rrjedhojë ka uljen e emetimeve mjedisore. Për më tepër, investimet në fushën e EE dhe iniciativa për certifikimin energjetik të ndërtesave jo vetëm që do të ulin konsumin energjetik, por do të kontribuojnë po ashtu në arritjen e komfortit termal brenda ndërtesave, dhe do të kenë ndikim direkt në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit duke ndikuar edhe në reduktimin e përdorimit të formave tjera të energjisë për ngrohje.

Rreziqet potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
---------	---------------	---------------------------------

Vonesa në miratimin e ligjeve dhe akteve nën ligjore për EE dhe BRE	I ulët	Harmonizimi me planin legjislativ
Mungesa e koordinimit të plotë ndër-institucional	I ulët	Koordinim i plotë ndër-institucional përmes një numri aktiviteteve në nivelin qendror dhe lokal, përfshirë harmonizimin e aktiviteteve si prioritet në zbatimin e politikave të performancës energjetike në ndërtesa.
Paparashikueshmëria e kohëzgjatjes së pandemisë Covid-19	I mesëm	Masat e qeverisë kundër pandemisë Covid-19 si dhe bashkërendim i aktiviteteve nga distanca.

Masa e Reformës #6: Reformimi i tregut të energjisë

Përshkrimi i masës: Masa do të adresojë problemin e efektivitetit të ultë të konkurrencës në tregun e energjisë duke u mbështetur në rishikimin e politikave ekzistuese përfshirë Strategjinë e Energjisë, legjislacionin për sektorin e energjisë si dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale, rregullatore, dhe operacionale të akterëve të përfshirë në sektorin e energjisë. Kjo masë po ashtu parashih funksionalizimin e Bursës së energjisë elektrike, pjesë e së cilës është edhe Kosova si dhe ofrimin e një shërbimi shtesë për konsumatorët duke ua ofruar mundësinë që të krahasojnë në çdo kohë ofertat nga furnizuesit në tregun e energjisë. Kjo masë do të kontribuojë drejt përmbushjes së Objektivit për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG) ‘Energji e përbalueshme dhe e pastër’ pasi që pritet të nxisë konkurrencën në tregun e energjisë në zingjirin e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike; dhe me politikat e Marrëveshjes së Gjellbër të BE-së për furnizim me ‘Energji të pastër, të përbalueshme, dhe të sigurte’ ku i jepet rëndësi përbalueshmërisë dhe sigurisë së energjisë, trajtimit të varfërisë së energjisë, dhe nxitjes së bashkëpunimit rajonal në sektorin e energjisë, çështje këto që pritet të trajtohen dhe rregullohen përmes legjislacionit të propozuar.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Hartimi dhe Miratimi i Strategjisë së Energjisë dhe Programit për zbatimin e Strategjisë së Energjisë; (ME)
2. Miratimi i Koncept Dokumentit për rishikimin e ligjeve në sektorin e energjisë (ME)
3. Funksionalizimi i Bursës Shqiptare të Energjisë – ALPEX, (KOSTT)
4. Krijimi i platformës për krahasimin e çmimeve të furnizimit; (ZRRE)

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Hartimi dhe Miratimi i Projektligjit për Energjinë; (ME)
2. Hartimi dhe Miratimi i Projektligjit për Energjinë Elektrike; (ME)
3. Miratimi i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë; (ME)
4. Miratimi i akteve nënligjore të legjislacionit të sektorit të energjisë; (ME)

Treguesit e rezultateve:

Treguesi	Viti bazë 2021	Objektivi
Strategjia e energjisë e miratuar	2021	2022
Plotësim/ndryshimi i legjislacionit i përfunduar	2021	2023
Operimi i bursës		2022
Platforma funksionale dhe e qasshme		2022

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Nuk janë paraparë kosto sa i përket hartimit të dokumenteve të përcaktuara në aktivitete. Gjithashtu, edhe zhvillimi i

mjetit/platformës për krahasimin e çmimeve të energjisë do të kryhet falas, ndërsa kosto për operimin e bursës do të financohet me të hyrat vetanake pas funksionalizimit të bursës.

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Masa e reformimit të mëtejme të tregut të energjisë do të rezultojë në: (i) rritjen e sigurisë së furnizimit me energji; (ii) rritjen e fleksibilitetit të sistemit të energjisë, që do të shoqërohet me hapjen e bizneseve të reja në fushën e shërbimeve në sektorin e energjisë (iii) rritjen e investimeve, veçanërisht në fushën e prodhimit të energjisë nga BRE-të; (iv) rritjen e konkurrencës në tregun e energjisë. Pas fillimit të operimit të bursës së energjisë elektrike (ALPEX), do të garantohet më shumë transparencë dhe konkurrencë në tregun e energjisë elektrike si dhe do të ndikohet në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, shfrytëzim më efikas të kapaciteteve ndërkufitare si dhe pritet që çmimi i energjisë elektrike do të reflektojë çmimet e tregut konkurrues për qytetarët e të dyja vendeve.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Masa e reformimit të mëtejme të tregut të energjisë do të mundësojë krijimin e kushteve për investime të reja në sektor nga kompanitë vendore dhe të jashtme, në të gjitha hallkat e sistemit të energjisë, rrjedhimisht në krijimin e vendeve të reja të punës, përmirësimin e mirëqenies dhe kushteve mjedisore të jetesës. Politikat e reja dhe ndryshimet e nevojshme legjislative për zbatimin e tyre, do të kenë të përfshirë edhe komponentin e barazisë gjinore.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Masa e reformimit të mëtejme të sektorit të energjisë do ta ketë ndikim në dekarbonizim gradual të sektorit të energjisë. Rritja e mëtejme e mundësive për integrimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë, obligimet e reja ndaj operatorëve për shfrytëzimin eficient të energjisë, si dhe masat rigorozë për zbatimin e kushteve mjedisore të operimit, do të ndikojnë në uljen e emetimeve të dëmshme për mjedisin.

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Vonesa në miratimin e Akteve ligjore dhe nën ligjore si dhe dokumenteve Strategjike, operative	I ulët	Harmonizimi me kohë me planin legjislativ.
Paparashikueshmëria e kohëzgjatjes së pandemisë Covid- 19	Mesatar	Masat e qeverisë kundër pandemisë Covid-19 si dhe bashkërendim i aktiviteteve nga distanca.

5.2. Analiza e pengesave në fushat tjera dhe masat lidhur me reformat strukturore

5.2.1. Menaxhimi i Financave Publike

Gjendja aktuale: Kosova synon të siguroj një sistem modern të Menaxhimit të Financave Publike që është në harmoni me përvojat më të mira ndërkombëtare dhe mundëson funksionimin efikas dhe efektiv të të gjitha fazave në këtë fushë. Aktualisht është shtylla e tretë e Reformave në Administratën Publike (RAP). Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka për objektive që në pjesën e parë të vitit 2022 të hartoj Strategjinë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) të Kosovës 2022-2026 dhe Planit të Veprimit, dhe të njëjtat të aprovohen nga Qeveria. Kjo strategji do të jetë vazhdimësi e SRMFP 2016-2020 dhe Planit Kalimtar të Veprimit 2021, të aprovuar nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve në vitin 2021. Vlerësimi PEFA është në fazën e finalizimit të raportit. OECD/SIGMA ka finalizuar Vlerësimin e fushës së MFP, që është pjesë e Raportit Monitorues të Principeve të Administratës Publike²⁴. Gjetjet nga këto dy vlerësime, si dhe vlerësimet tjera relevante të institucioneve ndërkombëtare dhe vendore, përfshirë Zyrën Kombëtare të Auditorit, do të shërbejnë në hartimin e SRMFP 2022-2026. Strategjia pritet të ketë katër

²⁴ <http://www.sigmaweb.org/publications/monitoring-reports.htm>

shtylla si në vijim: a) disiplina fiskale; b) efikasiteti alokues; c) efikasiteti operacional dhe d) çështjet e ndërlidhura të MFP.

Si pjesë e dialogut të përbashkët në mes të Kosovës dhe Komisionit Evropian, në takimet e Grupit të Veçantë për RAP (GVRAP), është dakorduar vazhdimi i reformave, kurse me rekomandim të OECD/SIGMA, korniza strategjike në kuadër të RAP do të harmonizohet në aspektin e kohëzgjatjes duke mbuluar periudhën kohore 2022-2026.

Si sfidë aktuale, është identifikuar kuadri ligjor i Menaxhimit të Financave Publike. Është formuar Grupi Punues për hartimin e Koncept Dokumentit për trajtimin e MFP. Grupi do të trajtoj të gjitha mangësitë dhe pengesat e evidentuara, të cilat ka nevojë të inkorporohen në kuadrin ligjor. Strategjia dhe Koncept Dokumenti do të përfshijnë të gjitha objektivat të cilat cilësohen si prioritete dhe të cilat adresojnë pengesat kryesore për rritje ekonomike stabile. Objektivat kryesore gjatë hartimit të strategjisë së reformave në fushën e MFP do të jetë stabiliteti makroekonomik dhe fiskal si dhe transparenca buxhetore të cilat janë parakusht për funksionimin e operacioneve qeveritare dhe për krijimin e një klime më të favorshme për zhvillimin e sektorit privat. Gjithashtu strategjia do të jetë në mbështetje të zhvillimit të sektorëve ekonomik konkurrues dhe do të siguroj se rritja ekonomike është gjithëpërfshirëse dhe synon rritjen e mirëqenies. Në mënyrë që ligji i ri dhe SRMFP 2022-2026 të jenë në harmoni me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare do të merren për bazë edhe të gjeturat dhe rekomandimet nga PEFA të cilat së shpejti pritet të finalizohen dhe OECD/SIGMA që tashmë janë publikuar, si dhe organizatave tjera vendore dhe ndërkombëtare. Në anën tjetër, kujdes i shtuar do ti jepet fushave të cilat tashmë janë të rregulluara me standardet ndërkombëtare në mënyrë që të vazhdojnë të mirëmbahen dhe përditësohen sipas zhvillimeve të kohës.

Në fushën e Prokurimit Publik, Kosova ka një kornizë ligjore që është e mbështetur në parimet e BE për prokurim publik si: transparenca, trajtimi i barabartë, konkurrenca e lirë dhe mos diskriminimi. Kosova në vazhdimësi ka adaptuar një kornizë legislative në funksion të rritjes së konkurrencës në fushën e prokurimit publik.

Në funksion të rritjes së konkurrencës në fushën e prokurimit publik, janë krijuar kushtet ligjore si në vijim:

- është mundësuar ndarja e kontratave (aktiviteteve të prokurimit) në lloje (homogjene dhe heterogjene),
- nga viti 2016 edhe procedura e ftesës për kuotim (nga 1000 euro - 10,000 euro) është duke u zhvilluar si procedurë e hapur. Më parë zhvillohej si procedurë duke i kontaktuar së paku 3 operatorë ekonomik, si dhe
- zbatimi i plotë i e-prokurimit.

Zbatimi i plotë i e-prokurimit (nga janari i vitit 2019), ka rritur efikasitetin, transparencën, llogaridhënien në fushën e prokurimit publik si dhe ka lehtësuar në masë të madhe përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave nga operatorët ekonomik gjatë proceseve tenderuese, duke ndikuar edhe në rritjen e konkurrencës në prokurimin publik. Zbatimi i e-prokurimit mundëson që operatorët ekonomik, nga vendi i punës (kudo që janë) të përgatisin dhe dorëzojnë ofertat e tyre në aktivitetet e prokurimit në mënyrë elektronike. Gjatë vitit 2021, edhe kontratat me vlera minimale (0-1000 euro) zhvillohen përmes e-prokurimit si dhe janë funksionalizuar edhe dy module të reja në kuadër të e-prokurimit. Është funksionalizuar moduli për administrimin e menaxhimit të zbatimit të kontratës përmes e-prokurimit si dhe moduli i vlerësimit të performancës së kontraktuesve. Edhe zbatimi i këtyre dy moduleve përmes sistemit të e-prokurimit, do të rris në masë të madhe efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien gjatë menaxhimit të zbatimit të kontratave të nënshkruara në fushën e prokurimit publik.

Raporti i KE për vendin i vitit 2020, raporti i fundit që përmban të dhëna për 'ofertuesit për tender' vlerëson se: "Kosova ka mesatarisht 5 ofertues për tender që reflekton një nivel të mirë të konkurrencës". Sipas kategorisë së prokurimit (mallra, shërbime, punë), sidomos për tenderë të punëve, kemi një mesatare më të madhe që shkon edhe deri në 7 ofertues për tender (një aktivitet të prokurimit). Këto të dhëna janë nxjerr nga e-prokurimi si dhe raportet e kontratave të nënshkruara në fushën e prokurimit publik nga Autoritetet Kontraktuese në nivel të vendit, që dorëzohen në KRPP për çdo vit fiskal.

Sa i përket Menaxhimit të Financave Publike, pas takimeve dhe konsultimeve të brendshme të grupit koordinues për fushën e MFP, vlerësohet se aktualisht nuk ka ndonjë pengesë të identifikuar që ndikon në konkurrencën ekonomike, rrjedhimisht nuk kemi ndonjë masë specifike e cila mund të jetë pjesë e reformave strukturore në kuadër të Programit për Reforma në Ekonomi 2022-2024. Paralelisht me një rishikim të vazhdueshëm të legjislacionit të MFP-së të udhëhequr nga MFPT, Qeveria e Kosovës është duke përpunuar një ligj të ri për borxhin, si dhe një ligj të rishikuar të prokurimit publik.

5.2.2. Tranzicioni i gjelbër

Gjendja aktuale: Kosova ballafaqohet me çështje mjedisore të ndryshme siç janë ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore dhe ndotje të ndryshme. Këto çështje mjedisore parashtrajnë sfida zhvillimore të rëndësishme për institucionet e Kosovës, të cilat ende nuk kanë kapacitete të mjaftuara për t'i adresuar.

Ndotja e ajrit në zonat urbane dhe veçanërisht në zonat industriale, vlerësohet të jetë e lartë, bazuar në të dhënat nga monitorimi i vazhduar i cilësisë së ajrit përmes rrjetit nacional të monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë. 23.6% të kohës gjatë gjithë vitit, indeksi i cilësisë së ajrit është në nivelin me cilësi jo të mire, që nënkupton 16.9% të kohës me cilësi të dobët, 4.6% të kohës me cilësi shumë të dobët dhe 2.1% me cilësi jashtëzakonisht të dobët, që rezultojnë nga tejkalimi i vlerave të lejuara me grimcat e pluhurit PM2.5²⁵. Kosova tashmë ka një sistem për raportim online për rezultatet e cilësisë së ajrit, përmes së cilit mundësohet sigurimi i informatave të sakta në kohë reale për publikun në disa komuna të Kosovës. Ky sistem paraqet monitorimin e të dhënave për 5 indikatorë në 12 stacione të monitorimit të cilësisë së ajrit. Kontribuesit më të mëdhenj janë termocentralet, impiantet me djegie të madhe, sektori i transportit, impiantet me djegie të vogël, aktivitetet bujqësore, mbeturinat shtëpiake dhe vendet që përdoren për djegie të mbeturinave.

Sa i përket mbeturinave komunale, sasia që krijohen në nivel vendi është afërsisht mbi 450.000 tonë. Bazuar në përbërjen e mbeturinave komunale që krijohen në nivel vendi, mbi 90% e tyre mund të riciklohen. Aktualisht, në linjën e riciklimit shkojnë mbi 10 % (duke përfshirë edhe eksportin që i dedikohet riciklimit). Pothuajse e tërë sasia e mbeturinave komunale përfundojnë në deponitë sanitare kurse një pjesë e tyre përfundon në deponi ilegale. Në anën tjetër, legjislacioni për rregullimin e kësaj fushe është i harmonizuar me Acquis-in e BE-së. Mirëpo, sektori i mbeturinave ka nevojë për reformim dhe mbështetje. Ekonomia qarkore do të krijonte mundësi për investime dhe vende të reja të punës, përmes sigurimit të burimeve të lëndëve të para për prodhim. Zbatimi i Sistemit të Rimbursimit të Depozitave (SRD), do të rezultonte në investime nga sektori privat, duke përfshirë investimet e huaja direkte. Kjo është në përputhje me parimet e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit si dhe parimin ndotësi paguan.

Ruajtjes së biodiversitetit, përmes shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës, viteve të fundit i është kushtuar vëmendje e posaçme. Është arritur që rreth 11,53% e territorit të përgjithshëm, të shpallen Zona të Mbrojtura Natyrore duke përfshirë: 19 rezervate strikte natyrore, 2 parqe kombëtare, 182 monumente natyrore, 1 park natyror, 5 peizazhe të mbrojtura dhe 1 zonë e

²⁵ <https://airqualitykosova.rks-gov.net/en/>

veçantë e mbrojtur për zogjtë. Pra, në total numri i zonave të mbrojtura është 210. Përkundër këtij fakti pozitiv, menaxhimi efektiv i tyre është në nivel jo të kënaqshëm. Ndërtimet ilegale, prerja e pyjeve, gjuetia e veprime tjera të njeriut, po kërcënojnë seriozisht vlerat natyrore të këtyre zonave. Kjo gjendje ka rezultuar për shkak të zbatimit të pjesshëm të legjislacionit ekzistues si dhe në mungesë të institucioneve përkatëse për menaxhim, monitorim dhe inspektim.

Legjislacioni aktual i fushës së ujërave ka shumë mangësi dhe se reformat e politikave për këtë fushë janë të domosdoshme. Ato synohet të realizohen përmes disa aktiviteteve të planifikuara, në funksion të përmbushjes së objektivit të masës. Sasia e vogël e ujërave në ujë-rrjedhat vendore, e që sasia mesatare vjetore është më e vogël se 100 m³/s, implikon nevojën e ndërtimit të Impianteve për Trajtimin e Ujërave të Zeza (ITUZ) urbane dhe industriale. Aktualisht, në funksion janë ITUZ për zonën e Skenderajt, ITUZ për zonën e Prizrenit si dhe në fazën testuese është ITUZ për zonën e Pejës. ITUZ për zonën e Gjakovës është në fazën e realizimit. Disa komuna tjera, siç janë: Prishtina, Mitrovica, Ferizaj dhe Gjilani janë në fazat fillestare të procedurave administrative për kontraktimin e kompanive konsulente. Eksploatimi ilegal i aluvioneve në lumenj, pastaj rregullimet e lumenjve pa kritere ekologjike / hidromorfologjike, implikon nevojën emergjente për restaurimin e lumenjve, sipas kritereve mbrojtëse dhe ekologjike. Këto veprime ndikojnë drejtpërdrejt në ruajtjen e biodiversitetit të mjedisit ujor.

Pengesat strukturore: Përdorimi i teknologjive të vjetruara / impiantet të vjetërsuara të energjisë; Kufizimet financiare të kompanive për investime në teknologji të reja për zvogëlimin e shkarkimit të emisioneve në ajër; Mungesa e trajtimit të ujërave të zeza; Menaxhimi i dobët i mbeturinave; Humbja e biodiversitetit dhe shfrytëzimi i egër i resurseve natyrore;

Masa e reformës #7 Zvogëlimi i ndotjes së mjedisit dhe ruajtja e biodiversitetit

Përshkrimi i masës: Objektivi kryesor i kësaj mase është përmirësimi i cilësisë së jetës dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, social dhe kulturor. Në funksion të përmbushjes së këtij objektivi do të rishikohen politikat ekzistuese, duke i harmonizuar me legjislacionin e BE-së, për të siguruar bazën e cila synon zvogëlimin e ndotjes së ajrit, ngritjen e nivelit të menaxhimit të mbeturinave dhe të ujërave, shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e biodiversitetit dhe peizazheve natyrore si dhe ngritjen e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore. Masa ndërlidhet me SKZH, Strategjinë për cilësinë e ajrit 2013-2022, Planin Kombëtar të Kosovës për zvogëlimin e emisioneve 2018-2027, Strategjinë për menaxhimin e integruar të mbeturinave 2021-2030, Strategjinë shtetërore e ujërave 2017-2036, Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Hartimi i Strategjisë afatgjatë të dekarbonizimit (MMPHI, ME);
2. Hartimi i Strategjisë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm 2022-2031(MMPHI, ME);
3. Hulumtimi dhe analiza e mundësive për krijimin e Sistemit për Rimbursim të Depozitës (MMPHI);
4. Hartimi i projekt ligjit për ujërat e Kosovës (MMPHI);
5. Rishikimi dhe plotësimi i Strategjisë Shtetërore të Ujërave 2017-2036 (MMPHI);
6. Finalizimi i Planit të menaxhimit të pellgut të lumit Drini i Bardhë (MMPHI);
7. Përgatitja e Udhërrëfyesit për ekonominë Qarkore (MMPHI).

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Hartimi i Udhëzimit Administrativ për kompetencat e zotëruesit të mbeturinave, prodhuesit dhe importuesit të produktit (MMPHI);
2. Hartimi i Udhëzimit administrativ për krijimin e sistemit për rimbursim të depozitave (SRD-ve), (MMPHI);
3. Miratimi i Strategjisë afatgjatë të dekarbonizimit (MMPHI, ME);
4. Rritja e numrit të zonave të mbrojtura të natyrës (MMPHI);
5. Hartimi Koncept Dokumentit për fushën e financimit të menaxhimit të resurseve ujore (MMPHI).
6. Hartimi i pesë Udhëzimeve administrative nga Ligji për ujërat e Kosovës (MMPHI).

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Hartimi i projekt ligjit për financimin e menaxhimit të resurseve ujore (MMPHI);
2. Krijimi i sistemit për rimbursim të depozitës për shishet e qelqit, plastikës dhe kanaqeve- fillimi i operimit (MMPHI);

Treguesit e rezultateve:

Treguesi	Viti bazë 2022	Objektivi 2023	Objektivi 2024
Rritja e numrit të zonave të mbrojtura të natyrës	210	240	280
Pikat e vendosura për kthim të ambalazhit (shisheve të plastikes, aluminit qelqit) për zbatim të SRD-ne	0	0	20
Statusi i Mirë i Ujërave (fillimi i operimit të dy Impianteve të reja (Pejë dhe Gjakovë) për Trajtimin e Ujërave të Zeza)	2	3	4

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Zbatimi i kësaj mase do të kontribuojë për jetë në mjedis më të pastër, ruajtje të shëndetit si dhe mirëqenie ekonomike dhe sociale. Ndikimi i pritshëm ndërlidhet me tranzicionin në ekonomi qarkore/të gjelbër përmes: rritjes së sasisë së ambalazheve për shfrytëzim në industrinë vendore të riciklimit; Rritjes së eksportit të materialit të ambalazhit, kryesisht të pijeve (plastikë, alumin, qelq), efektet pozitive të së cilës mund të vërehen brenda 2-4 vitesh pas fillimit të aplikimit të SRD; Orientimin drejt ekonomisë me karbon të ulët duke ulur emetimet e gazrave serrë; Ruajtjen më të mirë të biodiversitetit dhe resurseve natyrore; Përmirësimin e kualitetit të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Kostoja totale e pritur për zbatimin e aktiviteteve pritet të jetë 1,727,200.00 €. Në bazë vjetore për vitin 2022: 1,379,100.00 €, për vitin 2023: 185,500.00 € dhe për vitin 2024 planifikohet të jetë 162,600.00 €. Realizimi i këtyre aktiviteteve bëhet përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe donatorëve. Vlerësimi i kostos së aktiviteteve nga Buxheti i Republikës së Kosovës planifikohet të jetë 621,000.00 € dhe nga donatorët 1,106,200.00 €. Në funksion të përmbushjes së këtyre aktiviteteve do të hartohen politika dhe do të bëhet harmonizimi i legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Miratimi i dokumenteve strategjike, legjislacionit si dhe zbatimi i projekteve të planifikuara të masës, sigurojnë bazë dhe mundësi për krijimin e vendeve të reja të punës. Grupe të marginalizuara të sektorit joformal do të tërhiqen në ekonomi formale. Rrjedhimisht, kjo masë ndikon në përmirësimin e kualitetit të jetës dhe mirëqenie ekonomike e sociale. Komponenta e barazisë ligjore trajtohet në dokumentet strategjike dhe ligjore.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Zbatimi i legjislacionit, planeve të veprimit për zbatimin e dokumenteve strategjike si dhe projekteve, mundësojnë zvogëlimin e ndotjes së ajrit, ujit, humbjes së biodiversitetit si dhe përmirësimit të menaxhimit të mbeturinave.

Rreziqet potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Vonesa në implementim nga situata e krijuar me Covid-19	Ulët	Masat e vendosura nga Qeveria, komunikimi virtual
Niveli i ulët i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe sektorit privat	Ulët	Sektori privat të konsultohet që nga fillimi sepse është pjesëmarrës kyç në proces
Buxhet i pamjaftueshëm për mjedis	Ulët	Krijimi i Ekofondit si dhe mundësia e anëtarësimit në GEF (Global Environment, Facility)

5.2.3. Transformimi digjital

Gjendja aktuale: Infrastruktura fikse brezgjere e komunikimeve elektronike është e përhapur gjerësisht si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Drejt një infrastrukture dixhitale gigabitëshe, ka fyte të ngushta në infrastrukturën backbone dhe kapacitete të pamjaftueshme në lidhjet ndërkombëtare. Penetrimi i internetit me qasje fikse vlerësohet të jetë 129% të familjeve krahasuar me 78%²⁶ në BE. Penetrimi i telefonisë mobile është rreth 110% të popullsisë dhe vlerësohet se përdorues të internetit përmes rrjetit 3G dhe 4G janë 78% të banorëve krahasuar me 100% në BE. Shpejtësia e internetit mobil në nivel jo të kënaqshëm – për shkak të shfrytëzimit jo të mjaftueshëm të resurseve frekuencore.

Kërkesa për kapacitete/shpejtësi shtesë të Internetit është shtuar ndjeshëm gjatë pandemisë COVID-19. Qeveria për të adresuar kërkesat në rritje për shërbime të Internetit brezgjere, përmes Projektit KODE është duke ndërmarrë veprime për krijimin e parakushteve për shtrirje të infrastrukturës brezgjere telekomunikuese robuste duke ndërlidhur përgjethjet e rrjetave mobile me kabllo optike për të mundësuar zhvillimin e teknologjive dhe shërbimeve të bazuara në rrjetat e gjeneratës 5G dhe 6G. Deri me tani janë mbuluar me infrastrukturë fikse brezgjere 188 fshatra, 105 shkolla dhe 43 ambulanca. Në kuadër të zhvillimit të resurseve njerëzore për ekonominë dixhitale dhe mbështetje për biznese dixhitale, nga viti 2020 ka filluar të zbatohet projekti IPA 2017 që ka për qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit të TIK në Kosovë. Gjithashtu, projekti tjetër i IPA 2019 për dixhitalizimin e bizneseve përmes TIK ka filluar procedurat e zbatimit dhe ka për qëllim rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit të sektorit privat përmes përdorimit të TIK, krijimit të ekosistemit të duhur dhe më të sigurt për e-biznesin dhe e-tregtinë duke bërë të mundur përmirësimin e shërbimeve elektronike për qytetarët dhe biznesin. Në qershor 2021 Qeveria ka miratuar Projektligjin për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme për transaksionet elektronike (që transponon eIDAS Regulation) dhe është proceduar për miratim në Kuvend.

Në përputhje me Strategjinë e Kosovës për TI, është filluar me zbatimin e projektit për krijimin e Qendrës së Ekselencës Dixhitale (QED) në Parkun për inovacion dhe trajnim në Prizren. Në kuadër të QED është ndërtuar edhe një Data Center si pjesë e Rrjetit Kombëtar për Hulimtim dhe Edukim, e cila do t’u shërbejë komunitetit akademik dhe hulumtues. QED do të shërbejë për zhvillimin e inovacionit në TIK dhe do të fokusohet fillimisht në studime, hulumtime dhe zhvillime në fushën e TIK bazuar në trendët më të reja të TIK-ut. Në Kosovë vlera e shtuar e sektorit të TIK-ut kryesisht sigurohet nga ofrimi i shërbimeve brenda e jashtë vendit.

²⁶ https://ec.europa.eu/newsroom/dae/document.cfm?doc_id=67086

Investimet në infrastrukturën e telekomunikimit kanë shënuar rënie të vazhdueshme që nga viti 2015 kur kanë qenë afër 52 mil. €, gjatë viteve 2016, 2017 e 2018 kanë qenë rreth 30 mil.€ në vit, e gjatë vitit 2019 e 2020 investimet kanë qenë rreth 20 mil.€ përkatësisht 24 mil.€ (apo afër 0.3% e BPV të Kosovës). Përdorimi i përgjithshëm i TIK-ut në industri është akoma i kufizuar dhe shumë kompani kanë mungesë të vetëdijesimit lidhur me përfitimet konkurruese. Vlerësohet se në sektorin e TIK-ut (Informim dhe Komunikim) janë të punësuar rreth 3.4%²⁷ e numrit total të të punësuarve krahasuar me 3,7% në nivel të BE.

Institucionet e Republikës së Kosovës kanë të zhvilluara: Rrjetin Kompjuterik Shtetëror, Qendrën e të Dhënave Shtetërore, Platformën e Interoperabilitetit, një numër të Sistemeve elektronike qendrore për ofrim të shërbimeve elektronike për qytetarët, bizneset dhe vetë administratën, Portalin elektronik “e-Kosova” ku janë lansuar një numër i kufizuar i shërbimeve dhe e cila do të jetë dritarja e vetme përmes të cilës institucionet shtetërore do të japin shërbim për qytetarë dhe Biznese.

Para se pandemia COVID-19 të godiste botën, Kosova përballë me sfida serioze në sistemin e edukimit duke u reflektuar në rezultatet e PISA. Mbyllja e shkollave si pasojë rrezikoi edhe më shumë nivelin e mësim-nxënies dhe kualitetit mësimor. Për të lehtësuar implementimin e kurrikulës në distancë përmes platformës dixhitale në Kosovë dixhitalizimi i edukimit primar dhe sekondar pati përpjekjet më të mëdha në periudhën 2020/21. Platforma elektronike me përmbajtje dixhitale edukative e njohur si Pasaporta e të nxënies (Learning Passport) filloi në Kosovë në prill të vitit 2020 dhe tani në shkurt të vitit 2021 është unifikuar për tërë arsimin parauniversitar²⁸. Deri më tani nuk ka të dhëna zyrtare për nivelin e përdorimit të kësaj platforme.

Pengesat strukturore: mungesa e një ekosistemi të përgjithshëm për të krijuar mundësi për idetë më inovative në të gjitha fushat që lidhen me TIK dhe me teknologjitë dixhitale; mungesa e shtrirjes së infrastrukturës së internetit brezgjere; mosgatishmëria e bizneseve për t’u dixhitalizuar; mungesa e mbështetjes dhe ambienti mundësues për rrjetet brezgjera fikse dhe rrjetet 5G për dixhitalizimin e ekonomisë; mos ekzistenca e një sistemi për identifikimin dhe autentifikimin elektronik (e-ID). Numër i kufizuar i shërbimeve elektronike në Platformën e-Kosova; mos aplikimi i modulit të pagesave elektronike; nevojën e investimeve në modernizimin e infrastrukturës shtetërore të TI-së; zgjerimi i Implementimit të Platformës së Interoperabilitetit për integrimin e sistemeve; avancimi i mëtejme i kapaciteteve harduerike dhe rritja e sigurisë në Qendrën e të Dhënave Shtetërore – QDHS; nevojën për ndërtimi i Qendrës së Rimëkëmbjes në rastet e fatkeqësive; si dhe ngritja dhe avancimi i kapaciteteve njerëzore profesionale. Pajisje të limituara të TIK-ut, në shkollat fillore . Nivelit terciar, dhe universitetet ende nuk kanë qasje në rrjetet akademike evropiane e ato ndërkombëtare edhe pse Kosova është anëtarësuar në rrjetin pan-evropian GEANT dhe Rrjeti Kombëtar për Hulumtim dhe Edukim është në proces të zhvillimit.

Masa e reformës #8: Shtrirja e infrastrukturës dhe shërbimeve të TIK-ut për zhvillim socio-ekonomik, shërbime publike të avancuara, si dhe dixhitalizim të sistemit arsimor

Përshkrimi i masës: Masa është vazhdimësi nga PRE së kaluar, e rishikuar me qëllim të zgjerimit të qasjes dhe përdorimit të TIK-ut përmes shtrirjes së infrastrukturës brezgjere, përkrahjes për shtrirjen e infrastrukturës mobile 5G, krijimit të kushteve për hulumtim dhe edukim, forcimit të kapitalit njerëzor, mbështetjes së bizneseve dixhitale, dixhitalizimit të bizneseve tjera, si dhe dixhitalizim të shërbimeve publike, dhe sistemit arsimor. Kjo masë është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, Agjendën Dixhitale të Kosovës 2013-

²⁷ <https://ask.rks-gov.net/media/4671/anketa-e-tregut-te-punes-2018.pdf>

²⁸ www.shkollat.org

2020, Strategjinë e Kosovës për TI, PKZMSA dhe KASH. Është thelbësore të përcaktohen përparësitë gjatë procesit të përpilimit të Axhendës Dixhitale 2030, Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë, të Strategjisë për specializim të mençur, rishikimit të Strategjisë Nacionale për TI, për investime në sektorin e TIK-ut nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me sektorin privat. Masa është në përputhje me OZHQ 17, pika 17.6 dhe 17.8

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Aprovimi i Axhendës Dixhitale 2030;
2. Rishikimi i Strategjisë së Kosovës për TI;
3. Hartimi i koncept dokumentit për Kodin e komunikimeve elektronike
4. Shtrirja e infrastrukturës fikse dhe mobile 5G;
5. Finalizimi i Stacionit Fiks për monitorim të frekuencave;
6. Finalizimi i Rrjetit Kombëtar për Hulumtim dhe Edukim (KREN)
7. Zhvillimi i trajnimeve për të rinj dhe Program – YOU (Youth Online and Upward Program);
8. Dixhitalizimi i bizneseve përmes përdorimit të TIK (eID Sistemi, krijimi i ekosistemit të duhur dhe më të sigurt për e-biznesin dhe e-tregtinë);
9. Zhvillimi në vazhdimësi i Qendrës së ekselencës dixhitale - Pilotimi i 5G;
10. Zhvillimi i korridorit dixhital Prishtinë – Tiranë mbështetur në teknologjinë 5G;
11. Krijimi i sistemit të monitorimit për TIK;
12. Zhvillimi i mëtutjeshëm i shërbimeve elektronike në Platformën eKosova, aplikimi i modulit të pagesave elektronike; (ASHI)
13. Zgjerimi i Implementimit të Platformës ndërvepruese/Interoperabilitetit për integrimin e sistemeve; (ASHI)

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Hartimi i Ligjit për Kodin e komunikimeve elektronike;
2. Përkrahja për shtrirjen e infrastrukturës fikse dhe mobile 5G (ndërlidhja e shkollave dhe ambulancave);
3. Zhvillimi i trajnimeve për të rinj dhe Program – YOU (Youth Online and Upward Program);
4. Dixhitalizimi i bizneseve përmes përdorimit të TIK (eID Sistemi, krijimi i ekosistemit të duhur dhe më të sigurt për e-biznesin dhe e-tregtinë);
5. Zhvillimi në vazhdimësi i Qendrës së ekselencës dixhitale - Pilotimi i 5G;
6. Zhvillimi i korridorit dixhital Prishtinë – Tiranë mbështetur në teknologjinë 5G;
7. Fshatrat e mençura në zonat e largëta;
8. Krijimi i qendrës për edukim - STEM në fushën e TIK-ut në QED;
9. Zhvillimi i mëtutjeshëm i shërbimeve elektronike në Platformën eKosova, aplikimi i modulit të pagesave elektronike; (ASHI)

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Përkrahja për shtrirjen e infrastrukturës fikse dhe mobile 5G (ndërlidhja e shkollave dhe

ambulancave);

2. Zhvillimi i trajnimeve për të rinj dhe lidhja e tyre me mundësitë e punëve online – të rinjtë online dhe programi i rritjes (Youth Online and Upward Program – YOU);
3. Dixhitalizimi i bizneseve përmes përdorimit të TIK (eID Sistemi, krijimi i ekosistemit të duhur dhe më të sigurt për e-biznesin dhe e-tregtinë);
4. Themelimi i Labororit për 5G, IoT, Cybersecurity dhe Smart Village, në ITP Prizren;
5. Fshatrat e mençura në zonat e largëta;
6. Fillimi i klasave për fëmijë nga shkollat fillore në Prizren në edukimin STEM;
7. Inicimi i një thirrje për propozime për projekte H&ZH në TIK;
8. Ndërtimi i Qendrës së Rimëkëmbjes në rastet e fatkeqësive; (ASHI)

Treguesit e rezultateve:

Treguesi	Viti bazë	Synimi	Synimi
Numri i përdoruesve të rrjetit mobil të lidhura me infrastrukturë fikse brezgjërë – 5G Ready	2020 0	2022 30	2024 40
Numri i të trajnuarve në fushën e TIK, për ekonominë dixhitale	2021 500	2022 1500	2024 3060
Piloti i 5G në QED i përfunduar	2021 JO	2022 Në zbatim -50%	2023 PO

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Studimi i BB arrin në përfundim që rritja e penetrimit të infrastrukturës fikse brezgjërë prej 10% do të përcillet me një rritje prej 1.21% të GDP-së në ekonominë e zhvilluar dhe 1.38% të GDP-së në ekonominë në zhvillim. Krijimi i kushteve të përshtatshme përmes shtrirjes së infrastrukturës përkatëse të rrjetave dhe mundësimit të shërbimeve brezgjërë do të lehtësojë qasjen në tregje ndërkombëtare, zhvillim të modeleve të reja të biznesit, duke i lejuar njerëzit dhe kompanitë të punojnë pavarësisht lokacionit dhe me orar fleksibil dhe në përgjithësi përshtetshëm të procedurave dhe proceseve duke rritur dinamizmin ekonomik dhe duke përmirësuar konkurrueshmërinë, përmirësimin e tregut të punës dhe mjedisin e biznesit. Ofrimi i një force të kualifikuar për punë do të ndihmonte rritjen e sektorit të TIK-ut, rritjen e konkurrueshmërisë dhe shtimin e të hyrave në ekonominë e vendit tonë.

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Kostoja totale për zbatimin e kësaj mase pritet të jetë rreth 23,431,894 mil. € për 2022-2024. Nga kjo shumë totale, kostoja e vlerësuar për vitin 2022 është 11,742,950 €, nga të cilat 4,081,250 € janë fonde nga Buxheti i Kosovës, 1,400,000 € janë fonde nga IPA dhe 6,261,700 € kredi nga Banka Botërore (Projekti KODE). Kostoja e vlerësuar për vitin 2023 është 8,388,944 € nga të cilat 3,801,449 € do të financohen nga Buxheti i Kosovës, 1,300,000 € nga Fondet IPA dhe 3,287,495 € Kredi nga Banka Botërore (Projekti KODE). Ndërsa, kostoja e vlerësuar për vitin 2024 është 3,300,000 € nga të cilat 2,000,000 € do të financohen nga Buxheti i Kosovës dhe 1,300,000 € nga Fondet IPA.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Kjo masë do të ketë ndikim pozitiv në punësim duke zgjeruar mundësitë për punë dixhitale, me fokus të veçantë tek të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara. Sipas disa anketimeve infrastruktura brezgjërë (broadband-i) është vlerësuar si një motivues kryesor i punës fleksibile, në më shumë se ¾ e bizneseve të anketuara duke e cekur zgjerimin e infrastrukturës brezgjërë si faktor që ndikon në këtë. Si rezultat direkt i komponentës së dytë të Programit KODE është planifikuar krijimi i 400 vendeve të reja të punës në bizneset e

softuerit të TI-së dhe janë planifikuar trajnime në TIK për 2000 persona, të cilët potencialisht mund të konsiderohen vende të reja të punës (të punësuar apo vetëpunësuar).

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Masa është neutrale ndaj mjedisit.

Rreziqet potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Vonesat eventuale në realizimin e projekteve me BB dhe IPA, si pasojë e pandemisë	I ulët	Shqyrtimi i hollësishëm, në fazën e hershme të zbatimit të aktivitetit, të fuqisë punëtore potenciale të TIK dhe bizneseve ekzistuese të TIK në lidhje me kriteret për pranim në aktivitet, duke përdorur mjetet më efikase të TIK-ut për testimin dhe vlerësimin e kandidatëve potencialë.

5.2.4. Mjedis i biznesit dhe zvogëlimi i ekonomisë joformale

Gjendja aktuale: Zhvillimi ekonomik i Kosovës mbetet peng i ekonomisë joformale e cila është shumë e përhapur, një gjyqësor i ngadaltë dhe joefikas, dhe sundim i përgjithshëm i dobët i ligjit. Studimet e fundit vlerësojnë që ekonomia jo-formale arrin deri në 30% të BPV-së. Prezenca e ekonomisë joformale në vend dëmton ekonominë e tregut, dhe konkurrencën e drejtë në mes të bizneseve. Në këtë drejtim ajo gjithashtu paraqet pengesë të madhe në matjen e treguesve makroekonomik siç janë: bruto produkti vendor (BPV), shkalla e rritjes ekonomike dhe papunësisë, etj. të cilat reflektohen në krijimin e politikave ekonomike. Niveli i lartë i informalitetit në Kosovë është një sfidë e rëndësishme e mjedisit të të bërit biznes. Gjatë vitit 2021, ATK ka intensifikuar përpjekjet për formalizimin, duke regjistruar 2,756 punëtorë të paregjistruar më parë deri në tetor 2021, dhe po vazhdon një fushatë të synuar për të nxitur punonjësit që të kërkojnë zyrtarizimin²⁹. Sfidat si reformat rregullatore dhe administrative, barra administrative për bizneset dhe qytetarët, mungesa e mekanizmit dhe adresimit të duhur të kontesteve ekonomike, mungesa e koordinimit dhe trajnimit të duhur në fushën e inspektimeve dhe gjendja jo e mirë e rregullatorit tatimor në Kosovë, vazhdojnë të ndikojnë negativisht në ambientin e biznesit duke krijuar pasiguri juridike dhe konkurrencë jo lojale në treg. Masat e ndërmarra për pengimin e përhapjes së pandemisë COVID -19 gjatë vitit 2020 ndikuan në rënien e ekonomike të Kosovës prej 5.3 %.

Situata ekonomike u përmirësua përgjatë vitit 2021 pas lehtësimit të masave antiCOVID dhe masave të ndërmarra nga qeveria për mbështetjen e bizneseve (subvencione direkte për punonjësit pa punë, për formalizimin e punëdhënësve, mbështetje për likuiditet dhe qira) dhe familje (pagesa shtesë për pensionet bazë dhe asistencë sociale, dhe mbështetje shtesë për grupet e cenueshme). BPV-ja reale vlerësohet të jetë rritur me 9.7% në vitin 2021, të dhëna të detajuara dhe informacione mbi kontribuesit në këtë rritje jepen në seksionin Kuadri Makroekonomik i këtij ERP, si dhe në tabelat shoqëruese. Megjithatë sfidat e përmendura më lartë si dhe vazhdimi i luftimit të pandemisë COVID -19 janë një burim i pasigurisë në të ardhmen.

Ndonëse ekonomia joformale është duke u luftuar në vazhdimësi dhe është një prej prioriteteve të qeverisë, vazhdimi i kësaj dukurie vjen si pasojë e vetëdijes së ulët mbi efektet negative të saj, mos koordinimit dhe mos bashkëpunimit ndërinstytucional të Inspektoratit të Punës dhe trupave tjerë inspektuese që si pasojë ka eficientësi të ulët në luftimin e ekonomisë joformale.

²⁹ <https://www.atk-ks.org/komunikate-per-media-88-raste-denoncimi-per-punedhenesit-nga-punetoret/>

Problem tjetër kyç mbeten barra administrative dhe vështirësitë në zbatimin e plotë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Numri i vogël i shërbimeve one-stop-shop, koha dhe kostoja e lartë e shërbimeve për biznese, kërkesat e shumta për biznese që ndikojnë në menaxhimin e tyre, dekurajojnë bizneset për operim dhe investim në Kosovë. Në ndjekje të frymës së Synimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), kjo fushe është në përputhje me Synimin 16 të SDG (Promovimi i shoqërive të drejta, paqësore dhe gjithëpërfshirëse) përmes promovimit të shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimit të qasjes në drejtësi për të gjithë, dhe ndërtimit të institucioneve efektive, të përgjegjshme në të gjitha nivelet.

Pengesat strukturore: Pengesat dhe sfidat kryesore në këtë fushë janë konkurrenca jo e drejtë si pasojë e ekonomisë joformale, mungesa e koordinimit, planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve të bashkërenduara të organeve të inspektimit, barra administrative, mos zbatimi i plotë i Ligjit për Shoqëritë Tregtare si dhe mungesa e adaptimit të praktikave më të reja evropiane, bashkërendimi i ulët dhe i dobët ndërinstitucional dhe bashkërendimi i institucioneve publike me ato private në mbledhjen dhe ndarjen e informatave financiare. Këto pengesa strukturore ndikojnë në pasigurinë juridike, dekurajim për investim dhe operim në treg, në realizimin e të drejtave ekonomike, në buxhetin e shtetit dhe në rritjen e konkurrueshmërisë së drejtë në Kosovë.

Masa e Reformës #9: Përmirësimi i mjedisit biznesor nëpërmjet zvogëlimit të barrës administrative, reformës së inspektimeve

Përshkrimi i masës: Në vazhdimësi të përmirësimit të ambientit të biznesit Qeveria synon ndërmarrjen e disa aktiviteteve që do të kenë ndikim në rritjen e transparencës dhe cilësisë së shërbimeve për bizneset dhe qytetarët si dhe në ngritjen e efektivitetit të administratës. Reforma e inspektimeve ka për qëllim realizimin e dy objektivave kryesore: përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional sa i përket inspektimeve të aktiviteteve të bizneseve dhe digjitalizimin e procesit të inspektimeve. Kjo masë komunikon me treguesit 2.4.3 Qeverisje efiçente dhe treguesin 2.8.1 Përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes të Programit të Qeverisë së Kosovës 2021 – 2025.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Përditësimi i Programit për Zvogëlimin e Barrës Administrative; (ZKM)
2. Përditësimi i metodologjive për zhvillimin e politikave: manualit për koncept dokumente, manualit për MKS dhe manualit për memorandumet shpjeguese; (ZKM)
3. Analiza e bazës ligjore të rreth 300 akteve nënligjore të miratuara nga Qeveria (vazhdim i analizave të 1762 akteve nënligjore të miratuara nga ministritë e kryera në vitin 2021) dhe shfuqizimi përkatës dhe krijimi i bazës ligjore të akteve nënligjore si rezultat i të dy raundeve; (ZKM)
4. Zhvillimi i trajnimit modular mbi mjetet dhe qasjet e përdorura për zvogëlimin e barrës administrative dhe ngritja e kapaciteteve për zvogëlimin e barrës administrative; (ZKM)
5. Harmonizimi dhe miratimi i 50 ligjeve me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative; (MPB)
6. Analiza për thjeshtimin, bashkimin apo shfuqizimin e lejeve dhe licencave për të gjitha ministritë e linjës dhe rregullatorëve; (ZKM)
7. Vlerësimi për digjitalizimin e të gjitha lejeve dhe licencave; (ZKM)

8. Amandamentimi i legjislacionit horizontal duke lejuar dhe rregulluar reformën e inspektimeve (ZKM);
9. Ngritje e kapaciteteve njerëzore, që nënkupton trajnimin e inspektorëve dhe zyrtarëve tjerë relevant duke i përgatitë për zbatimin e plot të konceptit të ri të inspektimeve (Zyra Qendrore e Inspektimeve);
10. Zhvillimi i platformës digjitale për inspektime (MINT).
11. Riorganizimi i njësive inspektuese, përfshirë ndërlihdjen e data bazave (MINT).
12. Miratimi i Ligjit për Shoqëritë Tregtare.(MINT)
13. Rritja e numrit të inspektoreve të tregut dhe trajnimi(MINT)

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Ngritja e kapaciteteve për Zvogëlimin e Barrës Administrative; (ZKM)
2. Rritja e numrit të inspektoreve të tregut të punës dhe trajnimi(MINT)

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Rritja e numrit të inspektoreve të tregut të punës dhe trajnimi (MINT)
2. Ngritja e kapaciteteve për zvogëlimin e barrës administrative; (ZKM)

Treguesit e rezultateve:

Treguesi	Viti bazë 2021	Objektivi 2023	Objektivi 2024
Zvogëlimi i lejeve dhe licencave	Viti bazë 2014 480 licenca dhe leje	Të paktën 20% e licencave dhe lejeve të thjeshtuara, bashkuara dhe /ose shfuqizuara	Të paktën 3% e licencave dhe lejeve të thjeshtuara, bashkuara dhe /ose shfuqizuara kundrejt bazës së vitit 2014
Shfuqizimi i akteve nënligjore, të cilat nuk kanë bazë ligjore	1762 akte nënligjore (baza e vitit 2020) Të paktën 5% e akteve nënligjore pa bazë ligjore janë shfuqizuar përkundrejt bazës së vitit 2020	Të paktën 15% e akteve nënligjore pa bazë ligjore janë shfuqizuar përkundrejt bazës së vitit 2020	Të paktën 3% e akteve nënligjore pa bazë ligjore janë shfuqizuar përkundrejt bazës së vitit 2020
Zvogëlimi i trupave inspektuese	2021 36	2023 36	2024 18

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Përmirësimi i cilësisë së bërjes së politikave dhe hartimit të legjislacionit, krijimi i një sistemi të unifikuar i cili siguron koordinim ndërinstytucional të qëndrueshëm nga ana e autoriteteve inspektuese si dhe funksionalizimi i një adrese të vetme, efektive dhe të specializuar në zgjidhjen e kontesteve afariste do të ndikojë dukshëm në largimin e pengesave te panevojshme në kuadër të procesit për zvogëlimin e barrës administrative (ZBA), në rritjen e efikasitetit, transparencën dhe llogaridhënien e trupave inspektuese si dhe në ngritjen e sigurisë juridike për bizneset. Prandaj, duke hequr procedurat dhe kërkesat e panevojshme, duke thjeshtuar dhe digjitalizuar procedurat e nevojshme, duke zvogëluar barrën mbikëqyrëse për bizneset, si dhe duke ngritur sigurinë juridike përmes zgjidhjes efikase të kontesteve komerciale do të ketë ndikim direkt në përmirësimin e ambientit

të bërit biznes, përmirësimin e konkurueshmerisë, rritjen e investimeve të huaja dhe nga diaspora si dhe në uljen e riskut për zgjerim të bizneseve ekzistuese.

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Kostoja totale e kësaj mase do të jetë 4,537,330 € për tre vitet e ardhshme (2022-2024). Për sa i përket reduktimit të barrës administrative, për vitin 2022-2024, programi IPA III dhe GIZ do të ndajnë 380,000 € për zhvillimin e kapaciteteve për reduktimin e barrës administrative, thjeshtimin e licencave dhe lejeve për organet rregullatore dhe shfuqizimin e akteve nënligjore pa bazë ligjore. Ndërsa sa i përket reformës së inspektimit, kostoja totale për vitet 2022-2024 është 2,032,000€, nga Buxheti i Kosovës janë planifikuar të ndahen 432,000€ për punësimin dhe trajnimin e inspektorëve të rinj, ndërsa 1,600,000.00€ kredi nga Banka Botërore për zhvillimin e platformën e inspektimit, lidhjen e bazës së të dhënave dhe pajisjen e inspektorëve me pajisje elektronike.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Zvogëlimi i barrës administrative për bizneset dhe administratën, si dhe hartimi i politikave dhe ligjeve më të mira, do të ketë efekt pozitiv në rritjen dhe zhvillimin e bizneseve si dhe përmirësimin e shërbimeve për bizneset dhe qytetarët që si pasojë kanë rritjen e punësimit dhe reduktimin e varfërisë. Reforma e Inspektimeve do të përmirëson efektivitetin administrativ sa i përket inspektimeve dhe zvogëlon barrierën e kontrollit që ushtrohet ndaj bizneseve që do të ndikon në zvogëlimin e ekonomisë joformale si dhe në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët. Zvogëlimi i ekonomisë joformale nënkupton rritjen e buxhetit, dhe me rritjen e buxhetit mund të ndikojmë në ngritjen e mirëqenies për shtresat më të varfër të popullsisë. Në anën tjetër, me përmirësimin e ambientit të biznesit do të rritet edhe interesimi për investime nga jashtë. Investimet e reja dinamizojnë tregun e punës dhe stimulojnë ngritjen e shkallës së pjesëmarrjes së grave në tregun e punës.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Masa nuk pritet të ketë ndikim në mjedis

Rreziqet potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Mungesa e kapaciteteve institucionale për zbatimin e plotë të reformës së inspektimeve.	I lartë	Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve profesionale përmes asistencës teknike.

Masa e Reformës #10: Reduktimi i ekonomisë joformale

Përshkrimi i masës: Përmes kësaj mase parashihet përmirësimi i cilësisë së qeverisjes në ekonomi si dhe rritja e burimeve financiare për shërbimet publike si rezultat i të hyrave shtesë tatimore. Kjo masë është në përputhshmëri me Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023, Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit (SKZH) si dhe është jetësim i angazhimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në dialogun me Bashkimin Evropian (BE) gjatë vitit 2018.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Zbatimi i qasjes së re të rrezikut nga ATK bazuar në hartimin dhe zbatimin e projekteve të përmbushjes, për të synuar trajtimin e sektorëve me shkallë të lart të rrezikshmërisë, si: sektori i ndërtimit, akomodimit, punësimit joformal, tregtisë përkatësisht kontrollit të stoqeve (ATK);
2. Përcaktimi i masave korrigjuese për projektet e përmbushjes përmes vlerësimit ex post të zbatimit të këtyre projekteve; (ATK)

3. Rritja e numrit të inspektimeve dhe stafit të angazhuar në operacionet e përbashkëta mes ATK-së dhe DK-së, nën udhëheqjen e grupit të përbashkët të krijuar nga ana e të dyja Institucioneve me qëllim trajtimin e bizneseve të cilat karakterizohen me shkallë të lartë të rrezikshmërisë në shmangien e detyrimeve tatimore dhe atyre doganore; (ATK & Dogana)
4. Shqyrtimi i sigurimit të qasjes direkte të NJIF-K në data bazën e ATK-së. Autoritetet duhet të shqyrtojnë qasjen indirekte të NjIF-it në data bazën e ATK-së në kuadër të analizës së inteligjencës financiare për të siguruar me afat disponueshmërinë e informacionit në përpjesëtim me rreziqet dhe prioritetet e autoriteteve kompetente.
5. Rritja e nivelit të mbikëqyrjes dhe numrit të inspektimeve në terren, sidomos në lidhje me sektorin e BPCJF-ve, për të siguruar, ndër të tjera, që informacioni i pronësisë përfituese po mblidhet dhe mirëmbahet
6. Miratimi i Ligjit për Regjistrin e Pronareve Përfitues; (MINT)

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Hartimi i Strategjisë së re Kombëtare për luftimin e ekonomisë joformale, bazuar në vlerësimet sektoriale të rrezikut dhe vlerësimet lidhur me hendekun tatimor në përgjithësi. (Sekretariati i SLEJ)
2. Krijimi i një ekipe të veçantë apo njësi organizative në NJIF-K për zhvillimin e analizave strategjike.

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Përmirësimi i koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe ndalimin e punës së padeklaruar.
2. Përforsimi i kapaciteteve hetimore dhe të inteligjencës (NjIF)
3. Rritja e kapaciteteve administrative të NjIF-K që përfshinë sigurimin e burimeve të mjaftueshme të personelit për NJIF-K për të kontrolluar pajtueshmërinë e institucioneve financiare dhe BPCJF-ve me kërkesat e PPP/LFT-së
4. Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të IT-së
5. Ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit të NJIF-K
6. Kryerja e Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar

Treguesit e rezultateve:

Treguesi	Viti bazë 2021	Objektivi 2022	Objektivi 2024
Rritja e të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak	19%	26%	33%

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Reduktimi i ekonomisë joformale do të përmirësojë mjedisin e të bërit biznes në përgjithësi, konkurrencën lojale dhe për rrjedhojë do të mundësojë rritjen e atyre sektorëve ku Kosova ka avantazhe më konkurrues. Konkurrenca nga sektori joformal, është pengesa kryesore e tatimpagueseve të rregullt. Kjo masë do të adresonte këtë çështje, përmes rritjes së transaksioneve të tatueshme, si rezultat i zbatimit të një mekanizmi më të efektshëm të kontrollit dhe një analize më të mirë të rrezikut si dhe zvogëlimin e punësimit joformal. Situata e krijuar nga pandemia COVID-19 në Kosovë, ka ndikuar edhe tek një pjesë e tatimpaguesve që të fshehin qarkullimin e tyre duke gjetur arsyetim shtesë tek rënia ekonomike dhe rënia e fuqisë blerëse si rezultat i pandemisë, kjo situatë mundë të ndikojë

negativisht në rritjen e vazhdueshme të një konkurrence jo lojale, andaj veprimet e propozuara në këtë masë do adresonin këto çështje përmes rritjes së vazhdueshme të bashkëpunimit ndërinstytucional në funksion të shkëmbimit të informatave duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut.

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Për vitin 2022 kostoja vlerësohet të jete 194,100 Euro, kjo vlerë do të financohet nga Buxheti i Kosovës. Ndërsa në vitin 2023 kostoja vlerësohet të jete nga 36,000 Euro. Në vitin 2024 kostoja vlerësohet të jetë 60,000 Euro.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Reduktimi i ekonomisë joformale do ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e punësimit formal. Ndikimi kryesor në punësim do të ishte përmirësimi i niveleve zyrtare të punësimit në sektorët me nivelin më të lartë të informalitetit, kjo do ndikonte edhe në rritjen e të drejtave të punëtorëve në punë dhe qasjen më të lehtë në financa, e veçanërisht në reduktimin e varfërisë që ndikon në pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore. Po ashtu do të ndikojë në zhvillimin ekonomik, rritjen e buxhetit, e cila do mundë të përkthehej dhe me ngritjen e mirëqenies edhe për shtetasit më të varfëra të popullsisë. Reduktimi i ekonomisë joformale do ndikojë ndjeshëm edhe në rritjen e të hyrave buxhetore përmes së cilave financohen shërbimet publike duke ngritur kështu mirëqenien e qytetarëve të vendit.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Nuk ka ndikim relevant në mjedis.

Rreziqet potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Ngecja e bashkëpunimit ndërinstytucional	I mesëm	Intensifikimi apo rritja e shkëmbimit të të dhënave ndërmjet Institucioneve të ndryshme si atyre të nivelit qendror po ashtu edhe atyre lokale me qëllim luftimin e ekonomisë joformale.
Mungesa e konsistencës së Institucioneve Ligj zbatuese në bashkëveprimin ndër-institucional.	I Lartë	Rritja e numrit të memorandumeve të bashkëpunimit në mes Institucioneve duke mundësuar ndërlidhjen e sistemeve ku informacioni do shkëmbehej në forme elektronike

5.2.5. Hulumtim, Zhvillimi dhe Inovacion

Gjendja aktuale: Hulumtimin, Zhvillimit dhe Inovacionit (HZHI) në Kosovë ende mbetet në nivel të ulët. Ndonëse, sipas Ligjit për veprimtari kërkimore shkencore, Kosova duhet të ndajë 0,7% të buxhetit total ose 17,5 milion €, edhe pse ka pasur rritje të buxhetit, ende mbetet në nivel të ulët të financimit me një alokim prej 2,5 milion €, që do të thotë 0,1% e buxhetit total të shtetit.. Republika e Kosovës është vend partner ndërkombëtar i bashkëpunimit në programin Horizon 2020 dhe deri më tani ka arritur të përfitoj 20 projekte të financuara nga ky program (nga 103 aplikime, prej të cilave 95 projekt propozime i kanë plotësuar kriteret dhe 20 nga to janë financiar). Mbështetur në performacën e mirë të treguar në programin Horizon 2020, Qeveria e Kosovës ka realizuar marrëveshjen me BE-në për avancimin e statusit të Kosovës në programin Horizon Europe dhe planifikon edhe anëtarësimin në European Scoreboard. Anëtarësimi në këto mekanizma do të kontribuojë në përmirësimin e sistemit, identifikimin e prioriteteve dhe rregullimin e ekosistemit të inovacionit në vend. Qeveria e Kosovës në vitin 2021 ka lansuar grant skemën për përkrahje të ideve dhe projekteve inovative të bizneseve fillestare Start-Up në vlerë prej 500,000 € dhe për bizneset që do të krijohen (Start-Up me Spin-off në vlerë 650,000). Si rrjedhojë e situatës me pandeminë COVID-19 qeveria ka përkrahur 6 shkolla të mesme për furnizim me pajisje të TIK-ut, nëpër komuna. Gjithashtu bizneset e TIK-ut do të prezantohen me shërbimet e tyre në EXPO2020 në Dubai. Është funksionalizuar

Këshillit Kombëtar i Shkencës i cili do të ndihmojë të ketë qasje gjithëpërfshirëse institucionale dhe koordinim më të mirë të politikave për hulumtim dhe inovacion. Ekziston nevoja për krijim e Fondit Kombëtar të Shkencës si dhe zhvillimin e mekanizmave të implementimit. Si parakusht për të themeluar këtë fond nevojitet infrastruktura ligjore e cila do të definojë qartë synimet kryesore për orientimin e bizneseve drejt aplikimit të ideve dhe projekteve inovative, me qëllim të ngritjes së potencialit për eksport, konkurrueshmërisë, krijimin e vendeve të reja të punës, përmirësimin e cilësisë së produkteve apo shërbimeve, ngritjen e kapaciteteve humane, me përparësi të rinjtë, gratë dhe personat e marxhinalizuar për tregun e punës. Me finalizimin e këtij dokumenti do të rregullohen burimet e financimit për bizneset dhe akademinë për inovacione, funksionet e qendrave të Inovacionit, kllasterëve dhe hapësirave të tjera të përbashkëta për zhvillimin e ideve inovative, të cilat do të sigurojnë shërbime për trajnime dhe konsulencë me qëllim që idetë kreative të inovatorëve, të shndërrohen në projekte dhe biznese të qëndrueshme. Kemi filluar të ndërtojmë Kosovo Research Information System si platformë e mbledhjes, depozitimit të të dhënave dhe rregullimit proceseve përkatëse në fushën e kërkimeve shkencore dhe inovacionit. Është miratuar plotësim ndryshimi i udhëzimit administrativ për Subvencione dhe Transfere. Dispozitat e këtij UA janë të adresuara qartë për përkrahjen direkte financiare për bizneset, studentët dhe personat e tjerë fizik të cilët aplikojnë ide dhe projekte inovative.

Pengesat Strukturore: Fusha e inovacionit në Kosovë është ende e fragmentarizuar dhe kompetencat duhet adresuar qartë. Bashkëpunimi ndërinstitucional duhet avancuar me qëllim të qëndrueshmërisë së ekosistemit të inovacionit dhe rritjen e investimeve për stimulimin e bizneseve dhe akademisë. Ky bashkëpunim ka pasur ngecje edhe për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid19. Korniza ligjore për inovacion duhet të plotësohet me dispozita dhe instrumente shtesë me qëllim të ngritjes së kapaciteteve me theks të veçantë përfshirjen më të lartë të grave, të rinjve, personave me nevoja të veçanta në edukim shtesë. Pengesë serioze për ndërmarrësit, të rinjtë dhe stafin akademik të Kosovës janë mundësitë e limituara për qasje në fonde ndërkombëtare, ngritje të kapaciteteve humane dhe eksport.

Masa e Reformës #11: Përmirësimi i mjedisit për hulumtim, inovacion dhe ndërmarrësi

Përshkrimi i masës: Masa është vazhdimësi nga cikli i PRE të vitit të kaluar dhe synon të përmirësojë mjedisin për hulumtim, zhvillim dhe inovacion me ndikim në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit duke u mbështetur në rishikimin e politikave ekzistuese. Objektivat dhe politikat publike kryesore për periudhën që trajton PRE për hulumtim dhe inovacion do të jenë në favor të zhvillimit të sektorëve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në Ekonomin tranzicionale të Gjellbër. Masa është në përputhje me Programin e Qeverisë 2021-2025, Planin Operacional Strategjik të Qeverisë dhe politikat e institucioneve përgjegjëse për fushën e inovacionit. Gjithashtu kjo masë ndërlidhet edhe me Objektivat e Zhvillim të Qëndrueshëm, gjegjësisht objektiven 9 që ka të bëjë me Industrinë, Inovacioni dhe Infrastrukturën, përmes treguesve në lidhje me investimet në kërkime, prodhim dhe punësim pika (9.5 dhe 9b).

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Miratimi i Ligjit për Inovacion dhe Ndërmarrësi; (MINT)
2. Funksionalizimi i Këshillit Kombëtar për Inovacion - koalicionit dixhital; (MINT)
3. Funksionalizimi i Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe hartimi i Programit Kombëtar të Shkencës; (MASHTI)
4. Hartim i UA mbi format e transferit të njohurive dhe Teknologjisë; (MINT)

5. Hartimi dhe miratimi i koncept dokumentit për hartëzimin e sistemeve të hulumtimit, shkencës dhe inovacionit; (MASHTI)
6. Lansimi i grant skemave për përkrahje direkte të bizneseve dhe personave fizik për projekte inovative; (MINT)
7. Përkrahja me voucher për projekte shkencore dhe publikime në revistat të indeksuara;
8. Investimet në qendrat e inovacionit dhe laboratorë në shkolla të mesme, fakultete dhe shkolla profesionale. (MASHTI)

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Hartimi i projektligjit për Fondin e inovacionit; (MINT)
2. Krijimi i bazës së të dhënave për potencialin e Inovacionit në nivel vendi; (MINT)
3. Investimet në qendrat e inovacionit dhe laboratorë në shkolla të mesme, fakultete dhe shkolla profesionale; (MASHTI)
4. Lansimi i grant skemave për përkrahje direkte të bizneseve dhe personave fizik për projekte inovative; (MINT)
5. Përkrahja me voucher për projekte shkencore dhe publikime në revistat të indeksuara; (MASHTI)

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Anëtarësimi në European Innovation Scoreboard; (MASHTI)
2. Lansimi i grant skemave për përkrahje direkte të bizneseve dhe personave fizik për projekte inovative, (MINT);
3. Përkrahja me voucher për projekte shkencore dhe publikime në revistat të indeksuara; (MASHTI)

Treguesit e rezultateve:

Treguesi	Viti bazë 2020	Objektivi 2023	Objektivi 2024
Përkrahja e bizneseve inovative	10%	20%	30%
Investimet në pajisje të teknologjisë dhe laboratorëve	N/A	20%	N/A
Përkrahja në projekte shkencore	11	15	18

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Me plotësimin e kornizës ligjore dhe krijimin e mekanizmave të nevojshëm për përmirësimin e mjedisit për HZHI, do të rritet përkrahja për biznese, shkencë dhe Inovacion, që do të jetë një nxitës kryesor i rritjes së performancës së ndërmarrjeve tona, dhe njëherit edhe konkurrueshmërisë. Fokus i veçantë do të kushtohet ekonomisë tranzicionale të gjelbër dhe përdorimin e teknologjive të avancuara.

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Vlera totale për zbatimin e kësaj mase për tri vite parashihet të jetë 9,210,000 €, të gjitha të financuara përmes Buxhetit të Kosovës. Për vitin 2022 nga Buxheti i Kosovës parashihet që kostoja për zbatimin e aktiviteteve të kësaj mase të jetë 2,580,000 €, nga të cilat 30.000 € do të jenë nga kategoria mallra dhe shërbime, 2,350,000 € nga “Subvencione dhe Transfere” dhe 200,000 € shpenzime kapitale. Në vitin 2023, kostoja parashihet të jetë 3,230,000 €, nga të cilat €, nga të cilat 30.000 € do të jenë nga kategoria mallra dhe shërbime, 3,000,000 € nga “Subvencione dhe Transfere”

dhe 200,000 € shpenzime kapitale kurse për vitin 2024 shuma totale është 3,400,000 € të cilat janë nga kategoria “Subvencione dhe Transfere”.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Do të investohet në trajnime dhe konsulenca, për ndërmarrësit e rinjë, me qëllim që idetë e tyre inovative dhe kreativiteti i tyre të shendohet nga ideja e projekti në biznese të qëndrueshëm. Nëpërmjet të këtyre trajnimeve të rinjve e grave do t’iu krijohen lehtësira për qasje në investime ndërkombëtare. Vlerësimi i sistemit të hulumtimit dhe inovacionit do të mundësoj politika të bazuara në të dhëna e që do të kontribuojnë në mirëqenien qytetare.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Projektet inovative të cilat do të subvencionohen nga qeveria, për biznese, hulumtime shkencore apo trajnime të ndërmarrëseve, do të fokusohen në përkrahjen e aktiviteteve që kanë ndjeshmëri të lartë ndaj problemeve mjedisore (biznesi i gjelbër), për ruajtjen e peizazheve natyrore (turizmi i gjelbër), produktet e përfituara nga procesi i riciklimit, dixhitalizimi i shërbimeve dhe proceseve apo transformimi dixhital, (industria e gjelbër) sipas marrëveshjes së Agjendës së Gjelbër për vendet e BP.

Rreziqet potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Nevojat për ri-destinimin e buxhetit për inovacion për qëllime të pakove emergjente për ringjallje ekonomike	I mesëm	Koordinimi me Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve për ri-destinimin e buxhetit për inovacion.
Mos funksionalizimi i Këshillit Kombëtar të Shkencës	I ulët	Propozimi për aprovim në kuvend i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës
Mungesa e të dhënave statistikore për indikatorët të nevojshëm për European Innovation Scoreboard.	I mesëm	Bashkëpunimi me Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe institucionet relevante për sigurimin e të dhënave të nevojshme.

5.2.6. Reformat për integrim ekonomik

Gjendja aktuale: Kosova ka ndërmarrë hapa thelbësorë në liberalizimin e tregtisë së jashtme dhe është arritur progres i rëndësishëm në përafrimin e politikave tregtare me rregullat ndërkombëtare të tregtisë. Megjithatë, përkundër të gjitha përpjekjeve të ndërmarra ende nuk ka arritur të sigurojë një qëndrueshmëri pasi që Kosova vazhdon të ballafaqohet me një deficit të lart tregtar të mallrave. Ekonomia e Kosovë u karakterizua me një goditje signifkante në vitin 2020 si pasojë e pandemisë me Covid-19 dhe masat që u ndërmoren për ruajtjen e shëndetit të publikut, kryesisht në kontekst të kufizimit të lëvizjes dhe distancimit fizik, u reflektuan në rënie të përgjithshme të aktivitetit ekonomik. Rritja e eksportit të mallrave, si dhe rënia e konsiderueshme e importit si pasojë e rënies së aktivitetit ekonomik. Deficiti tregtar në terma realë është ngushtuar me rreth 0.5% krahasuar me periudhën janar-shtator të një viti më parë, pasi rritja e ndjeshme e importit të mallrave dhe shërbimeve ka kompensuar pothuajse plotësisht rritjen e eksporteve, veçanërisht ato të shërbimeve (tabela e plotë me zbërthimet janë të disponueshme sipas seksionit 2.2 të Kornizës Makroekonomike në PRE, si dhe në tabelat e aneksit shoqërues). Në nivelin rajonal, Kosova është pjesëmarrëse në reformat e lehtësimit të tregtisë përmes mekanizmave të CEFTA si dhe planit për tregun e përbashkët rajonal i cili është reflektuar përmes aktiviteteve në masën 13.

Pengesat strukturore: Kosova varet nga një numër shumë i ngushtë partnerësh, rrjedhimisht ka kapacitete të kufizuara të ofertës që të mund të plotësojë kërkesat e shumë vendeve. Kështu diversifikimi gjeografik dhe diversifikimi i gamës së produkteve është shumë i ulët dhe si i tillë i ndjeshëm ndaj goditjeve të mundshme të kërkesës që mund të ndodhin në grupin e ngushtë të

tregjeve të eksportit. Sidoqoftë, pengesat në arritjen e cilësisë dhe zbatimit të standardeve tregtare ndërkombëtare, mbeten sfiduese në veçanti pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ku prodhuesit Kosovar po përballen me tregun ‘agresiv evropian’, përfshirë edhe vështirësitë në përmbushjen e kërkesave Sanitare dhe Fitosanitare (SFS) dhe Barrierat Teknike në Tregti (BTT). Për më tepër, integrimi i kufizuar në zinxhirin e vlerave regjionale dhe globale, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet furnizuesve vendor dhe regional/ndërkombëtar pamundëson krijimin e lidhjeve tregtare midis kompanive ndërkombëtare. Një integrim eventual i furnizuesve Kosovar të inputeve në zinxhirin global të vlerës të furnizimit do të krijonte efekte të përhapjes në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Si përfundim, barrierat jo-tarifore tregtare të shpeshta të vendosura nga rajoni ndaj bizneseve vendore mbeten edhe një arsye për një bilanc negative tregtare.

Masa e reformës #12: Përmirësimi i tregtisë ndërkufitare përmes lehtësimit të tregtisë

Përshkrimi i masës: Kjo masë pritet të reduktojë koston e transaksioneve ndërkufitare dhe kohën, për të përmirësuar kushtet e hyrjes në treg për eksportet e Kosovës në tregjet e zgjedhura (targetuara). Gjithashtu, kjo masë pritet të sigurojë një mjedis miqësor juridik për aktivitetet tregtare në Kosovë. Kosova tashmë ka marrë obligime në nivel rajonal dhe global, që derivojnë nga CEFTA, MSA, Marrëveshja për Tregti të Lirë me Turqinë dhe Mbretërinë e Bashkuar dhe Organizatës Botërore të Doganës (OBD). Lehtësimi i tregtisë përkatësisht adresimi dhe reduktimi i barrierave trajtohet edhe përmes Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, Programit të Qeverisë dhe Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Kjo masë përsëritet nga PRE e vitit të kaluar për shkak se disa nga aktivitetet kërkojnë periudhë më të gjatë se 1 vit për t’u realizuar. Gjithashtu, disa nga aktivitetet nuk kanë arritur të realizohen për shkak të ndryshimeve të shpeshta politike dhe situatës me pandeminë COVID-19. Kjo masë ka ndërlidhje me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane pika 2: Transformimi i ekonomisë së BE-së për një të ardhme të qëndrueshme; nën-pika 2.1.3. Mobilizimi i industrisë për një ekonomi të pastër dhe cirkulare. Gjithashtu ekziston një ndërlidhje me OZHQ, që ka për qëllim forcimin e mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimi të partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm.

Për më tepër, ekziston një lidhje me dokumentin mbi Tregun e Përbashkët Rajonal i cili rrjedh nga pika 1 e Samitit të Sofjes: Zona e Tregtisë Rajonale - Masat e ndërlidhura tregtare; nën-pikat: 1.1 Ruajtja e Korridoreve/Korsive të Gjelbra dhe harmonizimi i kontroleve në PKK/PPK (5. Vendosja e lidhjes së plotë ndërmjet SEED+ dhe sistemit elektronik të menaxhimit të radhës (e-QMS) nëse vihet në funksion, për të maksimizuar përfitimet e të dy sistemeve për operatorët ekonomikë), 1.2. Eliminimi i pengesave jotarifore (PJT) (1.Miratimi i një mekanizmi efikas dhe efektiv për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve), dhe 1.5.Ulja e kostove tregtare dhe rritja e transparencës.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Hartimi i dokumentit për Politikave Tregtare (MINT).
2. Plotësim/ndryshimi i Kodit Doganor dhe i Akcizave (KDA) dhe UA për zbatim të KDA, (MFPT- Dogana e Kosovës).
3. Miratimi i Ligjit të ri për Tregti të Brendshme (MINT).
4. Fillimi i procesit të negocimit për marrëveshje me vendet e EFTA-së (MINT).
5. Miratimi i Rregullores për themelimin e Qendrës Informative për Lehtësira Tregtare nga Qeveria (MINT-Dogana e Kosovës).
6. Studimi i fizibilitetit për platformën e projektit NCTS (New Computerized Transit System) (Dogana-MF).

7. Finalizimi i negociatave me vendet e CEFTA-s për Protokollin Shtesë 7 për zgjidhjen mosmarrëveshjeve tregtare;
8. Dërgimi i aplikacionit në Organizatën Botërore të Tregtisë me qëllim të anëtarësimit në këtë mekanizëm;
9. Hartimi i legjislacionit sekondar për Ligjin për Tregti të Jashtme; (MINT)
10. Ratifikimi dhe zbatimi i marrëveshjes me vendet e EFTAs. (MINT)

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Krijimi dhe funksionalizimi i platformës së shkëmbimit të informatave në nivel rajonal përmes SEED+ (Dogana);
2. Ratifikimi i Protokollit Shtesë 7 të CEFTAs për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Tregtare.

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Fillimi i procesit të negociatave për anëtarësim në OBT (MINT dhe institucionet relevante);

Treguesit e rezultateve:

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Tregtisë

Indikatorët		Baza 2021	Treguesi 2023	Synimi 2024
Koha e zhdoganimit në orë, Njësia / Orë	Import	130 min	110 min	100 min
	Eksport	75 min	65 min	55 min
Rritja e përqindjes së deklarimeve elektronike doganore (paperless concept)		70%	80%	90%

lehtësimit të tregtisë mund të ulë kostot tregtare me një mesatare prej 14.3%. Analizat tregojnë se në shumë vende, në nivelin makro reduktimi i kohës për tregti vetëm për një ditë mund të rrit aktivitetin tregtar në më shumë se 5%. Reformat në lehtësimin e tregtisë në Kosovë pritet që të reduktojnë kohën e zhdoganimit në eksport dhe import respektivisht nga 130 minuta sa është aktualisht për import të reduktohet në 100 minuta deri në vitin 2023 ndërsa për eksport nga 75 minuta sa është aktualisht të reduktohet në 55 minuta.

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Shuma totale e buxhetit të planifikuar për këto aktivitete për tri vite është 113,000.00 €. Për vitin 2022 shuma prej 38,000.00 € do të financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe 10,000.00 € nga fondacionet e IPA-s. Për vitin 2023 janë paraparë të financohen 41,000 € nga buxheti qendror që hyjnë në kategorinë mallra dhe shërbime dhe për vitin 2024 shuma e financuar nga buxheti qendror është 24,000 € të cilat gjithashtu hyjnë në kategorinë mallra dhe shërbime.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Në bazë të raportit të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe Bankës Botërore “Trade and Poverty Reduction” të vitit 2018, theksohet se hapja e tregtisë ka ndikime të qarta dhe pozitive në uljen e varfërisë. Sipas hulumtimeve nga Qendra e Tregtisë Ndërkombëtare (ITC), bizneset në pronësi të grave që eksportojnë, punësojnë mesatarisht 42 persona, krahasuar me një mesatare prej vetëm 8 personave të punësuar nga bizneset të cilat nuk janë në pronësi të grave dhe të cilat biznese nuk eksportojnë. Tregtia është gjithashtu e lidhur me pjesëmarrjen më të lartë të grave në punë me formalitet më të madh dhe paga më të larta. Eksportuesit në vendet në zhvillim punësojnë më shumë gra sesa jo eksportuese dhe gratë përbëjnë deri në 90 % të fuqisë punëtore në zonat e përpunimit të eksportit. Prandaj implementimi i këtyre

aktiviteteve synon që në një afat të mesëm të sjell një ndikim pozitive në rritjen e mirëqenies sociale në Kosovë.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Sipas OECD-së, rritja ekonomike që vjen nga zgjerimi i tregtisë mund të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis duke rritur ndotjen ose duke degraduar burimet natyrore. Sidoqoftë, rritja e tregtisë nga ana tjetër, duke mbështetur rritjen ekonomike, zhvillimin dhe mirëqenien sociale, mund të kontribuojë në një kapacitet më të madh për të menaxhuar mjedisin në mënyrë më efektive. Më e rëndësishmja, tregjet e hapura mund të përmirësojnë qasjen në teknologjitë e reja që i bëjnë proceset e prodhimit vendor më efikas duke zvogëluar përdorimin e inputeve siç janë energjia, uji dhe substancat e tjera të dëmshme për mjedisin. Në mënyrë të ngjashme, liberalizimi i tregtisë dhe investimeve mund t'u japë firmave stimuj për të miratuar standarde më të rrepta mjedisore. Ndërsa një vend bëhet më i integruar brenda ekonomisë botërore, sektori i tij i eksportit bëhet më i ekspozuar ndaj kërkesave mjedisore të imponuara nga importuesit kryesorë. Ndryshimet e nevojshme për të përmbushur këto kërkesa, nga ana tjetër, rrjedhin prapa përgjatë zinxhirit të furnizimit, duke stimuluar përdorimin e proceseve dhe teknologjive më të pastra të prodhimit.

Rreziqet potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Vonesat në miratimin e legjislacionit	I mesëm	Rritja e bashkëpunimit koordinues me trupat relevant duke respektuar hierarkinë.
Pengesat politike në lidhje me përfaqësimet rajonale dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare	I mesëm	Ndërtimi i platformave lobuese për anëtarësim në mekanizmat ndërkombëtar dhe adresimi i pengesave të akterët relevant vendor dhe ndërkombëtar.

Masa e reformës #13: Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës së cilësisë dhe fuqizimi i rolit të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut

Përshkrimi i masës: Masa synon përafrimin e mëtutjeshëm dhe implementimin e legjislacionit sektorial të BE-së me qëllim të rritjes së mbikëqyrjes së tregut, përmbushjen e detyrimeve nga prodhuesit e produkteve industriale jo ushqimore, ngritjes së mëtutjeshme të shërbimeve të ofruara në tregun vendor nga trupat e vlerësimit të konformitetit si dhe integrimin në tregun e BE-së dhe vendeve tjera; eliminimin e barrierave teknike në tregti dhe mbikëqyrjen efektive të tregut nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut. Kjo masë ndërlidhet me PKZMSA, Programin e Qeverisë si dhe indirekt me SKZH-në të pjesa e standardizimit gjithashtu ka ndërlidhje me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane pika 2: Transformimi i ekonomisë së BE-së për një të ardhme të qëndrueshme; nën-pika 2.1.3. Industria mobilizuese për një ekonomi të pastër dhe cirkulare (Industritë me intensitet të lartë të energjisë, të tilla si çeliku, kimikatet dhe çimentoja, janë të domosdoshme për ekonominë e Evropës, pasi ato ofrojnë disa zinxhirë kryesorë të vlerës).

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Hartimi i Planit të Veprimit për transpozimin e Rregullores së BE-së 2019/1020 për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Përputhshmërinë e produkteve dhe Rregullores 2019/515 Njohjen Reciproke të Mallrave (DIC-IT);
2. Implementimi i Programit për Eliminimin e Barrierave në Tregti 2021-2025 (*Traktati për funksionimin e Bashkimit Evropian* 34-36 TFEU), për pjesën e fushës së pa harmonizuar të legjislacionit (dispozitave kombëtare) teknik dhe jo teknik (DIC);

3. Krijimi i skemës së akreditimit të trupave certifikues (EN ISO/IEC 17065) duke përfshirë edhe kërkesat e rregullave teknike; (DAK/DIC - MINT);
4. Akreditimi i tre laboratorëve testues/kalibruar të AMK-së (Laboratori i vëllimit dhe rrjedhjes, Laboratori i masës dhe Laboratori i presionit) - (AMK/ MINT);
5. Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve (transpozimi i Direktivës 2001/95/EC), si dhe miratimi i 85 standardeve të harmonizuara të BE-në, sipas kërkesave të Ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve; (AKS- MINT);
6. Hartimi i tre Udhëzimeve Administrative për produktet e ndërtimit si: tubat e plastikes, tuba betoni, mure betoni (DIC);
7. Hartimi i koncept dokumentit për mbikëqyrjen e tregut dhe pajtueshmërinë e produkteve, si dhe për njohjen reciproke të mallrave që tregtohen në BE; (DIC-IT);
8. Themelimi i laboratorit të gjatësisë, dhe përgatitja për akreditim të Laboratorëve kalibruar të forcës, termometrisë; (AMK).

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Hartimit i tre (3) Udhëzimeve Administrative sipas kërkesave të Ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve (DIC);
2. Hartimi i tre (3) Udhëzimeve Administrative për 3 grupe të produkteve të ndërtimit. (DIC);
3. Hartimi i Ligjit për mbikëqyrjen e tregut (ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit pjesa e mbikëqyrjes së tregut);
4. Përgatitja analizës për bashkimin e "Single Liaison Office" dhe "Product Contact Point" si një Pikë Kombëtare dhe zhvillimi i softuerit (IT-DIC);
5. Avancimi (update dhe upgrade) i sistemit SMIS i cili do ju mundësojë bizneseve qasje funksionale dhe blerje online të standardeve.(SMIS- sistemi informativ i menaxhimit të standardeve);
6. Akreditimi i Laboratorëve kalibruar të forcës, termometrisë dhe përgatitja për akreditim të laboratorëve të madhësive elektrike dhe laboratorëve të metrologjisë ligjore.

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Hartimi i akteve nënligjore që dalin nga ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr.06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit pjesa e mbikëqyrjes së tregut (DIC);
2. Miratimi dhe publikimi i 100 standardeve sipas kërkesave të rregullores (MINT) nr. 01/2017 për pajtueshmërinë elektromagnetike;
3. Miratimi dhe publikimi i 500 standardeve sipas kërkesave të rregullores teknike (MINT) nr. 06/2018 për pajisjet elektrike të dizajnuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit.
4. Hartimi dhe miratimi i rregullores për pajisjet me gaz në përdorim.

Treguesit e rezultateve:³⁰

³⁰Të dhënat zyrtare nga Departamenti i Tregtisë (MINT) për bilancin tregtar (importet dhe eksportet).

Treguesi	Baza 2020	Treguesi i 2023	Synimi 2024
Eksporti i produkteve industriale	396.884,042.99	485.469,208.15	520.427,912.20
Importi i produkteve industriale	2.531,343,595.88	2.100,377,693.37	2.010,388,405.02
Bilanci tregtar	2.134,459,552.89	1.614,908,485.22	1.489,960,492.82

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Aktivitetet e lartpërmendura do të mundësojnë fuqizimin e një sistemi rregullator të qëndrueshëm, i cili i mbështetë prodhuesit vendor që duke përmirësuar sigurinë dhe cilësinë që të jenë konkurrues me produktet të cilat kanë shenjë CE, vendosje në treg e produkteve të certifikuara të nivelit të njëjtë me produktet e vendeve të Bashkimit Evropian. Ky sistem do të siguron ngritje të aftësive konkurruese të bizneseve duke iu mundësuar qasjen e tyre në tregjet ndërkombëtare dhe duke ulur deficitin tregtar. Bizneset më konkurruese mundësojnë një mjedis më të mirë për rritjen e punësimit dhe kështu japin bazë për një rritje të qëndrueshme..

Vlerësimi i kostos së aktiviteve dhe burimet e financimit: Kostoja totale për zbatimin e masës për tri vitet e ardhshme (2022-2024) është 111,000 Euro përkatësisht 39,000 Euro për vitin 2022, 48,000 Euro për vitin 2023 dhe 24,000 Euro për vitin 2024. Nga këto fonde 101,400 Euro sigurohen nga buxheti qendror, dhe 9,600 Projekti Lux-DEV.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit rregullator për produktet industriale pritet të ketë edhe ndikim më të gjerë në shoqëri përmes nxitjes së investimeve në sektorin privat, hapjen e vendeve të reja të punës si dhe nxitjen e bizneseve që të zbatojnë standardet për të arritur sigurinë dhe cilësinë e produkteve industriale (jo ushqimore) dhe shërbimeve të palët e interesit. Gjithashtu masa pritet të ketë ndikim edhe më të madh në shoqëri duke nxitur investimet e sektorit privat, hapjen e vendeve të reja të punës si dhe inkurajimin e bizneseve për të zbatuar standardet të arrijë sigurinë dhe cilësinë e produkteve industriale dhe shërbimeve tepër palët e interesit.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Nuk pritet ketë efekte negative në mjedis.

Rreziqet potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Vonesat në miratimin e legjisllacionit si dhe mungesa e kapaciteteve teknike profesionale	I ulët	Rritja e kapaciteteve njerëzore
Vonesat në akreditimin dhe emërimin e TVK-ve sipas Ligjit të Produkteve të Ndërtimit.	I ulët	Trajnime specifike për stafin e TVK-ve.

5.2.7. Reforma e Tregut të Energjisë

Gjendja aktuale: Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë bazohet kryesisht në thëngjill (94.5% e totalit të prodhimit vendor) përdherisa pjesa tjetër e furnizimit prej 5.5% bazohet në BRE që përbëhet nga hidrocentrale, centrale me erë, dhe panele fotovoltaike. Prodhimi i gjithmbarshëm i energjisë elektrike në Kosovë në vitin 2020 ishte 6,301 GWh. Prodhuesi më i madh është KEK, i cili në bazë të Marrëveshjes për Furnizim me Shumicë, është i detyruar të ofrojë sasinë e nevojshme të energjisë me prioritet tek furnizuesi KESCO për të furnizuar konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal. Po ashtu një pjesë të gjenerimit e ofron për

OST dhe OSSH për mbulimin e humbjeve, KEK i ofron në tregun e lirë dhe konkurrues bazuar në Procedurën për Tregtimin e Energjisë Elektrike.

Konsumi bruto i energjisë elektrike për vitin 2020 ka qenë 6,167 GWh. Në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike janë dërguar 5,549 GWh energji elektrike, 396 GWh janë dërguar drejtpërdrejtë te konsumatorët industrial (Feronikeli, Sharr Cemi dhe Trepça), kurse nga pjesa e mbetur 114 GWh janë dedikuar për shpenzime interne të KEK dhe 107 GWh kanë qenë humbje në transmetim.

Gjenerimi vendor nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar ngarkesën maksimale në sistemin elektroenergjetik të Kosovës, andaj një pjesë e kërkesës nacionale për energji elektrike bazohet në import. Importi i energjisë elektrike në 2020 ka qenë 812 GWh ose 13.61 % e totalit të kërkesës, kurse eksporti i energjisë elektrike ka qenë 1,254 GWh. Kërkesa për ngrohje mbulohet me vetëm 3 deri në 5% nga ngrohja qendrore, ndërsa pjesa tjetër është e mbuluar kryesisht nga biomasa.

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë ka filluar liberalizimin gradual në vitin 2017 me nxjerrjen e udhëzuesit për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë nga ZRRE, bazuar në autoritetin e dhënë nga Ligji për Rregullatorin e Energjisë, Ligji për Energji, dhe Ligji për Energjinë Elektrike. Tregu i energjisë elektrike me shumicë ballafaqohet me mungesën e tregut një-ditë-para, mungesën e furnizuesve të mjaftueshëm aktivë ku vetëm KESCO nga gjithsej 8 furnizuesit e licencuar është aktiv,. Sipas kërkesave ligjore, çmimet e prodhimit për Gjeneratorin publik (KEK SH.A) janë të derregulluara nga muaji prill i vitit 2017, por kjo energji do të ofrohet në tregun e energjisë me shumicë, me prioritet për Furnizuesin me Shërbim Universal.

Sa i përket pjesës së energjisë së prodhuar nga BRE, Kompanitë prodhuese të energjisë elektrike të cilat kanë investuar nëpërmjet skemës mbështetëse FiT e kanë të garantuar shitjen e energjisë elektrike të prodhuar prej tyre për një periudhë 10-12 vjeçare me çmime fikse të rregulluara. Për qëllime të sigurisë së furnizimit dhe mbrojtjes së konsumatorëve me të drejtën e shërbimit universal, konform rrethanave të tregut, ZRRE aprovon tarifa të rregulluara për konsumatorët që furnizohen në kuadër të shërbimit universal.

Konsumatorët e mëdhenj të kyçur në tensionin 220 KV dhe 110 KV e blejnë energjinë elektrike në kushte të tregut, kurse konsumatorët tjerë furnizohen me energji elektrike nën kushte të shërbimit universal me tarifa të rregulluara.. Konsumatorët prodhues të energjisë elektrike kanë kufizime sa i përket kapacitetit vet prodhues dhe nivelit të tensionit ku mund të kyçen. Konsumatorët e cenuar aktualisht mbështeten nga një skemë e pagesës direkte për mbulimin e një pjese të kostos së energjisë. Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Furnizuesi me Shërbim Universal dhe Furnizuesit komercialë vazhdojnë të mos kenë qasje në disa komuna në veri të Kosovës. Tregu i energjisë me pakicë vazhdon të ballafaqohet me sfidën e ndër-subvencionimit të konsumatorëve familjarë nga ata jo-familjarë; ku për ta adresuar këtë çështje, ZRRE përmes azhurnimeve vjetore të tarifave të energjisë elektrike sigurohet që në rastet kur ka hapësirë për ulje të tarifave, ulja t'u dedikohet tërësisht konsumatorëve jo-familjarë (komercialë dhe industrialë). Është shënuar progres në fushën e integritimit në tregun rajonal, ku Bursa Shqiptare e Energjisë (ALPEX) do të ketë degën e saj edhe në Kosovë. Bursa do t'i operojë tregjet afatshkurtra të energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë.

Për t'i ofruar mundësi më të mëdha konsumatorit për të krahasuar ofertat, sa i përket tregut me pakicë, ZRRE do të ofrojë sistem të krahasimit të çmimeve i cili do jetë i qasshëm për të gjithë konsumatorët, në formë elektronike. Ky sistem i krahasimit të çmimeve do t'u mundësojë

konsumatorëve që në çdo kohë të krahasojnë ofertat e furnizuesve bazuar në parametrat e tyre të konsumit.

Pengesat strukturore: në sektorin e energjisë janë: mungesa e investimeve për rritjen e fleksibilitetit të Sistemit; diversiteti i ulët i burimeve të energjisë; humbjet teknike dhe komerciale në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike; përdorimi joeficient i energjisë, veçanërisht në sektorin rezidencial; tranzicioni nga skemat mbështetëse në skemat konkurruese për BRE-të; implementimi i plotë të udhëzuesit për liberalizimin e tregut; mosreflektimi i kostos në çmimet e energjisë elektrike; konkurrenca e kufizuar në tregun me shumicë dhe pakicë; bashkëpunimi i limituar ndër-kufitar dhe me vendet e rajonit.

5.2.8. Reformat në tregjet e transportit

Gjendja aktuale: Pozita gjeografike e Kosovës thekson rendësin e të pasurit një rrjet të mire dhe moderne të transportit. Kosova ka investuar shume në korridoret rrugore që kanë përmirësuar lidhjet tregtare me vendet fqinjë dhe ka siguruar qasje në rrugët detare përmes Shqipërisë, Malit të Zi. Kosova është pjesë e Traktatit të Komuniteti të Transportit dhe merr obligime të dala nga ky Traktat. Rrugët e Kosovës kanë lidhje me korridoret nga lindja me Ballkanin perëndimor që është pjesë e rrjetit të transportit PAN Evropian.

Transporti rrugor Kosova ka rrjet ekzistues rrugor prej 2000 km rrugë nacionale dhe rajonale, gjatë periudhës dhjetëvjeçare në rrjetin rrugor të Kosovës janë përfunduar edhe 150 kilometra Autostradë, drejtimet rrugore R7 Prishtinë – Vërmicë dhe R6 Prishtinë- Hani i Elezit, 90 kilometra rrugë Nacionale me 4 korsi, janë ndërtuar dhe rehabilituar mbi 90% të rrjetit të brendshëm rrugor si dhe janë ndërtuar dhe rehabilituar 1500 km rrugë lokale.

Gjithashtu është duke u ndërtuar Autostrada Prishtinë-Gjilan me gjatësi prej 23 km dhe është në proces ndërtimi i segmentit të autostradës Besi-Merdare që lidhet me korridorin 10 të rrjetit PAN evropian. Transporti rrugor i udhëtareve dhe mallrave si dhe mallrave të rrezikshëm rregullohen me Ligje të cilët pjesërisht janë në harmoni me akuis dhe ka marrëveshje bilaterale apo Protokolle teknik me shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor. Mbetet sfidë marrëveshjet bilaterale me Serbin, Bosnje dhe Hercegovinën, kurse jemi në proces të marrëveshjeve bilaterale me Maqedoninë Veriore dhe Malin e Zi.

Transporti hekurudhor, në Kosovës shtrihet në gjithë territorin e Kosovës me një gjatësi prej 335 km linje hekurudhore të hapur, 105 km në stacione dhe 103 km linje industriale.

Transporti hekurudhor i udhëtareve dhe mallrave rregullohet me ligj, ky ligj bën rregullimin dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore dhe kushteve të qasjes në tregun vendor dhe ndërkombëtar të operatoreve rezident dhe jo rezident të transportit hekurudhor të udhëtareve dhe mallrave. Në këtë kuadër duhet përmendur faktin se në sektorin e hekurudhave është duke u rehabilituar linja e 10 hekurudhore e cila është pjesë e rrjetit gjithëpërfshirës të SEETO që lidh Kosovën me Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe Linja hekurudhore 7 (Fushë Kosovë - Prishtinë - Podujevë) e cila lidh Kosovën me Serbinë. Rehabilitimi i këtyre linjave është ndare në 3 faza (faza e parë: F. Kosovë-Hani i Elezit, përmes kredisë dhe mbështetjes së institucioneve ndërkombëtare WBIF, WBIRD), faza e dytë, F.Kosovë-Mitrovicë ku është bërë publikimi i njoftimit për fituesin e kontratës dhe faza e tretë, F.Kosovë – Podujeve e cila është në fazën e studimit të fizibilitetit. Situata e pandemisë COVID-19 ka pasur ndikim në realizimin e projekteve hekurudhore, por edhe në rënien e transportit të udhëtarëve dhe mallrave gjë që për pasojë ka rënien e të hyrave të planifikuara për operatorët e transportit hekurudhor (TRAINKOS dhe RAILTRANS), por edhe të menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, INFRAKOS. Gjithashtu numri i pasagjerëve që kanë shfrytëzuar hekurudhat si mjet udhëtimi është zvogëluar për 76.85 % në tremujorin e dytë 2020, krahasuar me TM2 të

vitit 2019. Zvogëlimi i shfrytëzimit të rrjetit hekurudhor ka ardhur si rezultat i Vendimit të Qeverisë me masat e ndërmarra në luftimin e COVID-19. Transporti i mallrave me rrjetin hekurudhor në TM2 2020 krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2019 ka shënuar ulje për 5.70 %. **Transporti ajror:** Kosova ka Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari", i cili është gjithashtu pjesë e rrjetit gjithëpërfshirës të SEETO. Transporti ajror zhvillohet në bazë të legjislacionit në fuqi. Zhvillimi i transportit ajror bazohet në marrëveshjen për përdorimin e hapësirës së përbashkët evropiane. Në kuadër të Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" është implementuar zgjatja e pistës për 500 metra, e cila do të ndikoj në aspektin e sigurisë dhe në aspektin e konkureshmerisë me shtetet e rajonit, gjithashtu është ngritur sistemi instrumental i ndriçimit, i cili parashihet të eliminoj mjegullën në ANP. Si rezultat i masat parandaluese në luftimin e pandemisë COVID-19 ka ulje prej 96% në qarkullim. Si pasojë, niveli i përgjithshëm i rënies së aktiviteteve shërbyese pritet të ketë ndikim të rëndësishëm në rënien e përgjithshme të BPV. Në bazë të analizave dhe vlerësimeve në periudhën Janar-Shtator të vitit 2020, kishte 726,467 udhëtar, ndërsa në periudhën Janar-Shtator të vitit 2021 ka pasur 1,623,183 udhëtar, që do të thotë ketë vite ka udhëtar 123% me shume se në vitin paraprak.

Pengesat strukturore: në sektorin e transportit janë: Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare të transportit në përgjithësi; Kushtet e sigurisë rrugore për të reduktuar aksidentet me fatalitet dhe lëndime të rënda; Ndotja e ajrit nga Transporti; Digjitalizimi i sektorit të transporti rrugor dhe hekurudhor; Mirëmbajtja e rrjetit rrugor dhe hekurudhor dhe Kontrolli i hapësirës së ulët dhe të lartë ajrore të Republikës së Kosovës.

Masa e reformës #14: Zhvillimi dhe modernizimi i mëtejshëm i Transportit

Përshkrimi i masës: Zhvillimi dhe modernizimi i mëtejshëm i Transportit është masë që prezantohet për herë të parë në PRE dhe si objektivi kryesor ka krijimin e sistemit modern dhe të integruar të shërbimeve të transportit, i cili do të kontribuoj zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, sigurisë rrugore dhe do të jetë miqësor ndaj mjedisit. Kjo masë ka për qëllim rishikimin e legjislacionit duke harmonizuar atë me legjislacionin e BE-së ku përmes kësaj synon edhe vendosjen e sistemeve inteligjente në transport dhe përgatitjen për anëtarësim në organizata ndërkombëtare të Transportit rrugor, hekurudhorë dhe ajrorë. Kjo masë ndërlidhet me programin e qeverisë 2021-2025, Strategjinë e transportit sektoriale dhe multimodal, Plani Strategjik Operacional (PSO), PKZMSA, objektivi 11 të OZHQ-ës, gjegjësisht pika 11.2 që ka të bëjë me përmirësimin e transportit dhe sigurinë rrugore.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Hartimi i Strategjisë për zhvillimin e transportit 2022-2030;(MMPHI)
2. Plotësim ndryshimi i Ligjit për themelimin e Agjencisë për Sigurisë në Trafikun Rrugor. (MMPHI)
3. Plotësim ndryshimi i ligji për hekurudha; (MMPHI)
4. Digjitalizimi i Bazës së shënimeve të aksidenteve rrugore; (MMPHI)
5. Hartimi i Udhëzimit Administrativ mbi kornizën për instalimin e sistemeve inteligjente të transportit (SIT) dhe sistemit inteligjent të transportit (ITS); (MMPHI)
6. Dizajni Preliminarë i Projektit teknik për linjën 7 hekurudhore Fushë Kosovë - Podujevë (Kufiri me Serbinë); (MMPHI)
7. Hartimi i U/A për Licencimin e Makinistëve dhe për Stabilimentet dhe Pajisjet e Automjetit motorik me gaz; (MMPHI)

8. Koncept Dokumenti për Patentë Shofer; (MMPHI)
9. Hartimi i U/A për Menaxhimin e Sigurisë së Infrastrukturës rrugore; (MMPHI)
10. Krijimi i qendrave mobile për kontrollim të automjeteve në rrugë; (MMPHI)
11. Ngritja e kapaciteteve profesionale në fushën e inspektimit të sigurisë rrugore; (MMPHI)
12. Aplikimi i kontrollit të emetimit të gazrave të liruar nga automjetet; (MMPHI)
13. Funksionalizimi i strukturave për sigurinë e trafikut rrugor; (MMPHI)
14. Identifikimi i akseve rrugore me rrezikshmëri të lartë; (MMPHI)
15. Zhvillimi i aplikacionit për e-testim në patentë shofer; (MMPHI)
16. Aplikimi për anëtarësim të Kosovës në organizata ndërkombëtare të Transportit rrugor hekurudhor dhe ajror; (MMPHI)
17. Normalizimi i hapësirës së ulët, hapja e Rrugëve ajrore me Shqipërinë dhe Malin e zi. (MMPHI)
18. Studimi i fizibilitetit për linjën hekurudhore Kosovë – Shqipëri; (MMPHI)

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Hartimi i Ligjit për Patentë Shofer; (MMPHI)
2. Krijimi i Agjencisë për Siguri në Rrugë; (MMPHI)
3. Finalizimin i bazës Ligjore për menaxhimin e Sigurisë së Infrastrukturës Rrugore; (MMPHI)
4. Ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e sigurisë rrugore; (MMPHI)
5. Identifikimin e Akseve rrugore me rrezikshmëri të lartë; (MMPHI)
6. Studimi i fizibilitetit VNM dhe shoqëror si dhe Dizajni Preliminare për linjën hekurudhore (Prishtinë-Aeroporti i Prishtinës); (MMPHI)
7. Normalizimi i kontrollit të hapësirës së ulët dhe të lartë ajrore të Republikës së Kosovës; (MMPHI)

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024

1. Digjitalizimi i Infrastrukturës rrugore; (MMPHI)
2. Digjitalizimi i bazës së shënimeve të aksidenteve rrugore; (MMPHI)

Treguesit e rezultateve:

Treguesi	Viti bazë 2019	Objektivi 2023	Objektivi 2024
Zvogëlimi i aksidenteve rrugore me fatalitet për 100,000 banor	6.5 persona	4 persona	3 persona
Digjitalizimi i sistemeve të transportit	0%	20%	40%

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Zbatimi i kësaj mase do të kontribuojë në zvogëlimin e aksidenteve fatale deri në 50 % dhe atyre me lëndime të rënda deri në 25 %. Orientimi drejt digjitalizimit të sistemit të bazës së shënimeve na mundëson të kemi një pasqyrë të qartë dhe të saktë sa i përket aksidenteve me fatalitet dhe me lëndime të rënda. Me zhvillimin e mëtejme të transportit dhe digjitalizimin do të arrihet zvogëlimi i kohës, kostos financiare, gjithashtu qarkullimi i lire i udhëtarëve dhe mallrave do të realizohet me efikasitet me të lartë.

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Kostoja totale e pritur për zbatimin e aktiviteteve pritet të jetë 520,000 €. Në bazë vjetore për vitin 2022, 160,000 €, për vitin 2023, 170,000 € dhe për vitin 2024, 190,000 €. Nga buxheti i qeverisë së Kosovës për këto tri vite do të jetë 440,000 € kurse nga donatorët 100,000 €. Në funksion të përmbushjes së këtyre aktiviteteve do të hartohen politika dhe do të bëhet harmonizimi i legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Miratimi i dokumenteve strategjike, legjislacionit si dhe zbatimi i projekteve të planifikuara të masës, sigurojnë bazë dhe mundësi për krijimin e vendeve të reja të punës. Grupe të marginalizuara të sektorit joformal do të tërhiqen në ekonomi formale. Rrjedhimisht, kjo masë ndikon në përmirësimin e kualitetit të jetës dhe mirëqenie ekonomike e sociale. Komponenta e barazisë ligjore trajtohet në dokumentet strategjike dhe ligjore.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Zbatimi i legjislacionit, planeve të veprimit për zbatimin e dokumenteve strategjike si dhe projekteve lidhur me digjitalizimin e sistemit, mundësojnë zvogëlimin e ndotjes së mjedis.

Rreziqet Potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Vonesa në implementim nga situata e krijuar me Covid-19	Ulët	
Themelimi i Agjencisë për Siguri Rrugore	Ulët	

5.2.9. Bujqësia, Industria dhe Shërbimet

Gjendja aktuale: Sektori i bujqësisë kontribuon me 7.5% në PBB-në e Kosovës ndërsa punëson rreth 23%³¹ të gjithsej numrit të të punësuarve në Kosovë. Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore është 420,209 ha, ku pjesëmarrje më të madhe kanë drithërat (30%), kulturat foragjere (9%), perimet (3.3%), pemët (2.4%), vreshtat (0.8%) ndërsa pjesën tjetër prej 51.7% e përbëjnë livadhet, kullosat dhe toka e përbashkët.

Te sektori i blegtorisë, gjedhet kanë pjesëmarrje më të madhe prej 48%, pasuar nga delet me 39%, derrat me 8% dhitë me 5% dhe një thundrakët 0.3%. Në kuadër të këtij sektori, rendësi të veçantë kanë edhe shpezët ku numri i tyre është 2,7 milion ndërsa koshere bletësh janë 262,541. Lidhur me zgjerimin dhe rehabilitimit e sistemit të ujitjes, momentalisht llogariten rreth 20,000 ha të tokës bujqësore të cilat janë nën ujitje, apo rreth 5% të sipërfaqes totale të shfrytëzuar për bujqësi. Pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm është 16.4%, përderisa pjesëmarrja e importit është 23.2%. Kosova në vitin 2020 ka importuar produkte bujqësore në vlerë prej 765.4 mil €, ndërsa vlera e eksportit ishte 78.1 mil €, duke rezultuar me deficit në bilancin tregtar në vlerë prej 687.3 mil €. Përmirësim në gjendjen e bilancit tregtar të produkteve bujqësore është 1%, duke marrë parasysh se rritja në vlerën e eksportit ka qenë më e lartë se sa rritja e vlerës së importit.

Qeveria ka vazhduar të mbështetet sektorin e bujqësisë përmes programeve mbështetëse si pagesat direkte dhe grante investive. Në kuadër të pagesave direkte janë mbështetur 3 sektorë (hortikultura, drithërat dhe blegtoria) me gjithsejtë 27 nën-sektor. Sipas të dhënave të vitin 2020 janë mbështetë gjithsej përmes pagesave direkte, 33,644 përfitues (5% gra) në vlerë rreth 36 mil €, kurse përmes grantve janë autorizuar projekte në vlerë rreth 6 mil €. Qeveria i ka dyfishuar vlerën e pagesave direkte për të ndihmuar fermerët si pasojë e COVID 19, deri tani

³¹ Punësim sezonal, dhe gjatë vjeljeve.

janë realizuar rreth 30 mil € në mbështetje nga Programi i Rimëkëmbje Ekonomike për gjithsej 32,315 përfitues. Situata me Covid-19 ka vazhduar të ketë ndikim në sektorin e bujqësisë ku si pasojë e mbylljes së tregjeve lokale dhe qendrore, sektorë të ndryshëm varësisht kulturave janë prekur në mënyra të ndryshme. Zinxhiri i furnizimit është vërejtur që ka pasur shkëputje për arsye të rrethanave të krijuara, sidomos mbyllja e sektorit të gastronomisë ka ndikuar në uljen e shitjes e prodhimeve bujqësore.

Sektori i Industrisë - është i dominuar nga mikro ndërmarrje me 85% dhe NMVM-të me nivele të ulëta integrimi në zinxhirët e vlerave globale, si dhe pjesëmarrje të ulët të inovacionit dhe të tërheqjes së IHD-ve. Sipas hulumtimeve dhe analizave, bashkëpunimi midis kompanive dhe institucioneve arsimore dhe kërkimore është i dobët dhe niveli përgjithësisht i ulët i aftësive në fuqinë punëtore, numri i vogël i bizneseve të udhëhequra nga gratë dhe të rinjtë dhe mungesa e rrjetëzimit. Sektori i Industrisë Përpunuese (Sektori C) në Kosovë, në vitin 2020 ka marr pjesë me 14% në BPV e që krahasuar me vitin 2019, ku BPV ishte 11.67%, është shënuar një rritje më e madhe se sa në dy vitet paraprake (në vitin 2017 ishte 10.9% dhe në vitin 2018 ishte 11.3%). Në punësimin e përgjithshëm, në vitin 2020, ky sektor, ka marre pjesë me 11,8% dhe në qarkullim ka shënuar rritje për 8.36%.

Pjesëmarrja e Sektorit C, në eksportin e përgjithshëm është rreth 84%, kurse në importin e përgjithshëm pjesëmarrja e industrisë përpunuese është 93%, në vitin 2020. Sektorët me pjesëmarrje më të lartë në eksport janë: metalet me 26.01%, plastika dhe goma me 14.63%, mobilet me 8.42%, përpunimi i produkteve ushqimore me 8.38%, prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike me 7.96%, prodhimi i pijeve me 7.45% dhe sektori i prodhimeve të produkteve kimike me 4.93%. Si pasojë e pandemisë, Investimet e Huaja Direkte në Kosovë në vitin 2020, në sektorin e “Prodhimtarisë” kanë shënuar vlerë negative (5,5) milion euro.

Në vitin 2020, me qëllim të tejkalimit më të lehtë të situatës ekonomike, si pasojë e COVID-19, për të ndihmuar direkt sektorin privat është zbatuar plani operacional i Pakos Fiskale Emergjente. Përmes kësaj pakoje me 50% të pagesës së qirasë u është ndihmuar 10.369 bizneseve dhe 178.935 punëtorë, prej të cilëve me nga 170€ janë ndihmuar 148,188 punëtorë aktivë, me nga 130 euro janë ndihmuar 15.822 punëtorë (14.988 punëtorë të rinj dhe 834 punëtorë jo aktiv) si dhe me nga 100 € janë ndihmuar 14.925 punëtorë të rrezikuar.

Turizmi si nën-sektor i industrisë ka qenë në rritje para fillimit të pandemisë Covid-19 duke dhënë sinjal që ky sektor ka mjaft potencial për zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të reja të punës, fuqizimin e gruas dhe të rinjve në përgjithësi. Që nga fillimi i viti 2020 turizmi ka përjetuar një sfidë duke u bërë njëri nga sektorët më të prekur nga pandemia. Sipas ASK-së, për qarkullimin turistik në pikë kalimet kufitare ardhjet e vizitorëve të huaj janë zvogëluar për rreth 35.4% për vitin 2020 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 ose shprehur në shifra nga 4,962,335 turistë sa kanë qenë në vitin 2019, në 3,203,594 në vitin 2020. Kurse sipas numrit të netëve të qëndrimit të vizitorëve vendor dhe të huaj nga 490,402 sa ishin gjatë vitit 2019 ka pasuar rënie në 266,491 gjatë vitit 2020 ose rreth 46%. Mirëpo, nëse bëjmë një krahasim të gjashtë mujorit të parë 2020 dhe 2021 për net qëndrimet e realizuara në Kosovë vërehet se kemi një rritje të numrit të net qëndrimeve për rreth 100% në vitin 2021 (të dhënat e publikuara nga ASK, raporti TM1 dhe TM2 2021). Tejkalimi i kësaj gjendje dhe pasojave të saja do të jetë njëri nga preokupimet kryesore në fushën e turizmit në të ardhmen e afërt, për arsye se sektori i turizmit përfshinë në vete shumë sektorë tjerë.

Sektori i shërbimeve: Shërbimet janë sektori më i madh i ekonomisë, duke zënë rreth 72.7% të PBB-së në vitin 2020. Për më tepër, në vitin 2020, sektori i shërbimeve përbën rreth 79.1% të punësimit në Kosovë, dhe 81.7% e bizneseve të reja të hapura në vitin 2020 ishin në shërbime. Tregtia në Shërbime për vitin 2020 është karakterizuar me të hyra nga eksporti në vlerë prej €994.4 milion. Sektorët të cilat kanë pasur performancë më të mirë janë: udhëtimi

me €628 milion, shërbimet e informimit dhe komunikimit (TIK) me €71.7 milion, shërbimet profesionale/biznesore me €139.6 milion, shërbimet e ndërtimitarisë me €12 milion, dhe shërbimet personale, kulturore dhe rekreative me €3.2 milion. Eksportet totale të shërbimeve janë rritur nga 1,358 miliardë € në 2017 në 1,675 miliardë € në 2019, vit në të cilin suficiti tregtar i shërbimeve arriti në 932.3 milion €.

Tab.1 Statistikat vjetore të tregtisë në shërbime (2018 – 2020)

Vitet (milion euro)	2018	2019	2020
Eksporti i shërbimeve	1,561.6	1,675.1	994.9
Importi i shërbimeve	705.8	749.1	603.3

Burimi: BQK, 2021

Gjatë vitit 2020, COVID-19 pati një ndikim negativ në eksportin e shërbimeve, i cili ra me 994 milionë euro. Eksportet kryesore të shërbimeve të Kosovës janë në udhëtime, shërbime të tjera biznesi, TIK dhe ndërtim. Vlen të theksohet se në kohën e COVID-19, dy sektorë janë rritur: eksporti i TIK dhe Shërbimeve të tjera të Biznesit me 22.4 milionë euro krahasuar me vitin 2019. Shërbimet e tjera të biznesit përfshijnë shërbime të ndryshme biznesi si: shërbime kërkimore dhe zhvillimi, shërbime profesionale dhe menaxhuese, shërbime konsulence, shërbime teknike, tregtare dhe shërbime të tjera të biznesit, mbetje trajtim dhe ndotje, shërbime bujqësore dhe minerare, lizingu operativ, shërbime të lidhura me tregtinë. Ky sektor është ndër sektorët më produktivë në tregtinë e shërbimeve, prandaj është vendimtar fokusimi dhe rritja e mëtejshme e performancës së këtij sektori. Pavarësisht bilancit të përgjithshëm pozitiv të sektorit të shërbimeve, ky sektor ende nuk po ecën me potencialin e tij. Faktorë të tjerë thelbësorë që mund të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve dhe tregtisë së shërbimeve janë që kompanitë e këtij sektori të kenë akses më të mirë në financa dhe të fokusohen në promovimin e eksportit të shërbimeve.

Pengesat strukturore: madhësia e vogël mesatare e fermës 90% kanë sipërfaqe më të vogël se 5 ha, prodhimtaria e ulët dhe kostoja e lartë e prodhimit, fragmentimi i tokës, diversifikimi i ulët i prodhimit, infrastruktura e dobët e ujitjes, teknologjia e vjetërsuar, kapacitetet e kufizuara të ruajtjes, lidhjet e dobëta apo jofunksionale në mes të prodhuesit primar e përpunuesve ndërmjet prodhuesve e tregut, si dhe mungesa e një sistemi të digjitalizuar.

Te sektori i Industrisë pengesë për zhvillimin mbetet shkalla relativisht e lartë e ekonomisë joformale, mungesa e qasjes në financa, zbatimi jo i mjaftueshëm i standardeve në produkte, numër i vogël i bizneseve të udhëhequra nga gratë dhe të rinjtë, mospërputhje të përgatitjes profesionale dhe tregut të punës, qasja në informata dhe mungesa e rrjetëzimit. Te sektori i turizmit pengesat kryesore mbetet mungesa e investimeve në infrastrukturën turistike, korniza ligjore joadekuate dhe koordinimi i pamjaftueshëm institucional, destinacioneve turistike, si dhe për produktet dhe shërbimet në dispozicion.

Te sektori i shërbimeve, Kosova po zgjeron kryesisht aktivitetet e saj të shërbimeve të patregueshme me produktivitet të ulët, dhe ka një artikulum të pamjaftueshëm ndërmjet aktiviteteve të shërbimeve dhe sektorëve të prodhimit të materialeve. Gjithashtu mungesa e kornizës adekuate ligjore që nxit zhvillimin e teknologjisë së lartë dhe shërbimeve me vlerë të lartë të shtuar, Mungesa e një kuadri ligjor që mund të rregullonte dixhitalizimin e sektorëve të shërbimeve dhe akses në financa dhe koordinim të duhur institucional ndërmjet subjekteve të ndryshme që drejtojnë aktivitetet e shërbimeve.

Masa e reformës #15: Ndryshimet strukturore në sektorin e bujqësisë

Përshkrimi i masës: Masa është vazhdimësi e PRE 2021-2023 dhe synon dizajnimin e politikave duke i përafuar me Politikën e Përbashkëta Bujqësore, digjitalizimin e sistemeve, rritjen e prodhimit vendor dhe rritjen e fuqisë punëtore në gjithë zinxhirin prodhues, përpunues dhe shërbyes. Gjithashtu masa synon zgjerimin dhe rehabilitimin e sistemit të ujitjes, rregullimin e tokës bujqësore përmes hartimit të politikave të reja të cilat do të ndikojnë në zgjidhjen e problemit për tokën bujqësore. Masa gjithashtu do të ndikojë në zhvillim të sektorit në përmirësim të kushteve dhe në ofrimin e shërbimeve më të mira. Kjo masë është në përputhshmëri me Programin e Qeverisë 2021-2025, Planin Kombëtar për rimëkëmbje ekonomike, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve KASH 2022-2024 dhe Politikën e Përbashkëta Bujqësore të BE-së brenda Marrëveshjes së Gjellbër. Masa është në përputhje edhe me qëllimet e OZHQ si dhe Planin Ekonomik të Investimeve për Ballkanin Perëndimor i cili ka potencialin për të mobilizuar ndihmë të mëtejshme për transformimin e qëndrueshëm të sistemit agro-ushqimor dhe zhvillimin rural të Kosovës.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Hartimi i bazës ligjore për Zhvillimin e Fondit për Sigurime Bujqësore; (MBPZHR);
2. Rritja e sipërfaqeve me kultura bujqësore me fokus në produkte me vlerë të shtuar; (MBPZHR);
3. Hartimi i Koncept Dokumentit për Organizmin e Tregut të Përbashkët –CMO; (MBPZHR);
4. Hartimi i planit kombëtar për Inventarizimin e Tokave Bujqësore të Republikës së Kosovës; (MBPZHR);
5. Studimi i fizibilitetit i projekteve të ujitjes bazuar në Master Planit për ujitjen e tokave bujqësore; (MBPZHR);
6. Zhvillimi i sistemit për menaxhimin e granteve dhe subvencioneve (Zhvillimi i softuerit) (MBPZHR, AZHB);

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Studimi i fizibilitetit i projekteve të ujitjes bazuar në Master Planit për ujitjen e tokave bujqësore; (MBPZHR)
2. Funkcionalizimi i Fondit për Sigurime Bujqësore; (MBPZHR)
3. Organizmi i Tregut të Përbashkët (CMO) për produktet bujqësore; (MBPZHR)
4. Rritja e sipërfaqeve me kultura bujqësore me fokus në produkte me vlerë të shtuar; (MBPZHR)
5. Unifikimi i numrit identifikues të fermës (NIF) me gjitha institucionet tjera si ASK, AUV; (MBPZHR).

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Rritja e sipërfaqeve me kultura bujqësore me fokus në produkte me vlerë të shtuar; (MBPZHR);
2. Futja në funksion e paketës së akreditimit të AZHB-së.

Treguesit e rezultateve:

Treguesi	Baza 2020	Synimi 2022	Synimi 2024
Pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore (1-24) në eksportin e përgjithshëm (1-98)	16.4%	20%	23%
Pjesëmarrja e importit të produkteve bujqësore(1-24) në importin e përgjithshëm (1-98)	23.2%	18.9%	16.8%
Rritja e sipërfaqeve me kultura bujqësore	22%	23%	26%

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Zbatimi i aktiviteteve të kësaj mase do të kontribuojë në rritjen e prodhimit në sektorin e bujqësisë, me fokus të veçantë në produktet bujqësore të tregut me vlerë të shtuar, gjithashtu do të ketë ndikim në përmirësimin e zinxhirit të vlerës në gjithë ciklin, pasi që situata e krijuar me COVID 19 ka krijuar zbrazëtira në ciklin e zinxhirit të furnizimit pasi që ka pasur mbyllje të tregjeve lokal. Masat për mbështetje të sektorit të bujqësisë, do të kenë ndikim pozitiv gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, duke pasur parasysh investimet e konsiderueshme që po ndodhin në këtë sektor dhe ky efekt do të jetë i dukshëm përmes zëvendësimit të importit të produkteve bujqësore dhe rritjes së eksporteve. Hartimi i ligjeve gjegjësisht programit legjislativ do të shërbej në përmirësim të politikave dhe përmirësim të sektorit i cili dukshëm do të ketë ndikim edhe në të ardhme në përmirësim të konkurrencës.

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Kosto e përgjithshme për zbatim të kësaj mase gjatë viteve 2022-2024 vlerësohet të jetë 220,947,57 €. Nga kjo vlerë 79,152,145 € vlerësohet kosto për vitin 2022, 71,325,764 € për vitin 2023 dhe 70,469,668 € për vitin 2024. Pjesa më e madhe e kësaj kosto pritet të financohet nga buxheti i Kosovës, përkatësisht nga skema e Subvencioneve dhe Transfereve nga MBZHR me vlerat përkatëse, 72,331,446 €(2022), 64,319,166 €(2023) dhe 66,319,166 €(2024) të cilat ofrohen si grante dhe subvencione për fermerët për zhvillimin e sektorit të bujqësisë, si dhe për mbulimin dëmeve natyrore në bujqësi. Pjesa tjetër e aktiviteteve do të mbulohet nga Projekti i Bankës Botërore, me vlerë prej 2,431,697 € për vitin 2022. Për investime kapitale 2,747,500 € për vitin 2022 dhe 2,822,500 € për vitin 2023.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Përmes kësaj mase ndikohet pozitivisht në stimulimin e popullatës në aktivitet bujqësore si dhe punimin dhe kultivimin e tokës bujqësore, futja e kulturave të veçanta në prodhim të cilat mund të kenë prioritet dhe aftësi konkurruese. Aktualisht, bujqësia përbënë 7.7 % të BPV-së, ndërsa punëson rreth 23% të gjithsej numrit të të punësuarve në Kosovë. Përmes këtyre masave synohet të respektohet barazia gjinore ku nuk mungojnë edhe përparësitë në vlerësim gjatë aplikimit dhe po ashtu gjenerimi i vendeve të punës është një ndër prioritetet kryesore është që përmes të hyrave të gjeneruara nga aktivitetet bujqësore të zbutet varfëria në vend dhe gjithashtu të përmirësohet mirëqenia. Zhvillimi i sektorit të bujqësisë ndikon drejtpërdrejt edhe në angazhimin ekonomik të grave dhe për rrjedhojë në fuqizimin e tyre ekonomik.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Mbështetja përmes kësaj mase do të reflektohet edhe në investimet strukturore por gjithashtu edhe në një mjedis më të qëndrueshëm. Përmes rritjes së sipërfaqeve bujqësore dhe përmirësimit të sistemit të ujitjes do të përfitoj edhe mjedisi.

Rreziqet Potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Vonesa në zbatim	I mesëm	Nënshkrimi me kohë i programeve dhe publikimi i thirrjeve për aplikim me kohë si dhe aprovimi i Ligjeve të cilët do të rregullojnë shumë çështje me rëndësi për sektorin;

Zgjatja e pandemisë në nivel global.	I lartë	Zbatimi i pakove të mbështetura nga Qeveria dhe stimulimi i sektorit përmes mbështetjes nga donacione të ndryshme. Përfarim i politikave në stimulim të situatës;
--------------------------------------	---------	---

Masa e reformës #16: Rritja e konkurrueshmërisë në industrinë prodhuese

Përshkrimi i masës: Masa është vazhdimësi e masës së PRE 21-23 dhe ka për qëllim krijimin e një politike më të koordinuar për zhvillimin e industrisë në tërë zingjirin e furnizimit, në asistimin e industrisë përpunuese, rritjen e konkurrueshmërisë dhe ndërkombëtarizimin e NVM-ve. Masa do të përkrah NVM-të që të mund të rriten dhe të kalojnë në aktivitete me vlerë të shtuar dhe të prodhojnë mallra të tregtueshme për eksport, ofron lehtësim në qasje në financa për NVM-të, përkrahje në përmirësimin e standardeve të cilësisë dhe rritjen e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Një numër i aktiviteteve të planifikuara në vitin 2021, nuk janë realizuar për shkak të gjendjes me pandeminë dhe do të përsëriten në vitin 2022.

Seksioni i Konkluzioneve të Përbashkëta të këtij Programi ofron detaje të masave të marra gjatë gjysmës së dytë të 2021 për të adresuar konkurrencën duke mbështetur prodhuesit vendas, eksportuesit dhe bizneset në pronësi të grave, ndikimi i të cilave do të jetë më i dukshëm në vitin 2022.

Masa ndërlidhet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, PKZMSA-së - Kapitulli 20, Programin e Qeverisë 2021-2025, Pakoja e Ringjalljes Ekonomike për zhvillimin ekonomik dhe punësimin, si pasojë e pandemisë – COVID 19, si dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve KASH 2022-2024. Përmes mbështetjes për industrinë dhe aktivitetet e prodhimit, masa është në përputhje me OZHQ 8 (Punë e mirë dhe rritje ekonomike) dhe OZHQ 9 (Industria, Inovacioni dhe Infrastruktura). Ndërsa me zonën e Industrisë së Qëndrueshme të Marrëveshjes së Gjelbër, masa është pjesërisht në përputhje, me synime për modernizimin e teknologjisë së prodhimit për të zvogëluar ndotjen, si dhe krijimin e zonave ekonomike. Po ashtu është edhe në pajtim me OZHQ 5, për barazinë gjinore: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave, përmes fuqizimit të tyre në ndërmarrësi.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Zhvillimin Industrial (Politika Industriale); (MINT/DI)
2. Hartimi i studimit të zingjirit të vlerës për sektorin e industrisë kimike; (MINT/DI)
3. Përkrahja financiare e se paku 100 bizneseve, me qëllim të rritjes së prodhimit, cilësisë së produkteve, eksportit, konkurrueshmërisë dhe qasjes në tregjet ndërkombëtare, si dhe promovimi eksportit kosovar dhe turizmit; (MINT)
4. Ristrukturimi i funksioneve të KIESA-s; (MINT)
5. Rritja e kapaciteteve të hapësirës së inkubacionit; (MINT)
6. Finalizimi i ndërtimit të infastrukturës fizike të katër zonave ekonomike (Suharekë, Viti, Vushtri dhe Lipjan); (MINT)
7. Studimi i fizibilitetit për ndikimin e Zonave Ekonomik; (MINT)
8. Hartimi i Ligjit për Zonat Ekonomike; (MINT/DI)
9. Hartimi i Programit të kujdesit pasues për investimet; (MINT)
10. Hartimi i Politike Kombëtare për Investime (përfshirë investimet e huaja direkte, investimet strategjike); (MINT)

11. Rishikimi dhe aprovimi i ligjit për investimet e huaja. (MINT)

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Hartimi i studimit të zingjirit të vlerës për industrinë e përpunimit të ushqimit dhe krijimi i data-bazës për sektorin; (MINT/DI)
2. Përkrahja financiare e se paku 100 bizneseve, me qëllim të rritjes së prodhimit, cilësisë së produkteve, eksportit, konkurrueshmërisë dhe qasjes në tregjet ndërkombëtare, si dhe promovimi eksportit kosovar dhe turizmit; (MINT)
3. Rritja e kapaciteteve të hapësirës së inkubacionit; (MINT)
4. Ndërtimi i zonave të reja industriale, përfshirë qendrat e transferit të teknologjisë apo parqet teknologjike; (MINT)
5. Fuqizimi i ekipeve promovuese në ambasadat e Kosovës, dërgimi i atasheve ekonomik; (MINT/MPJ)
6. Krijimi dhe fuqizimi i rrjeteve të afarizmit me investitor potencial përmes diasporës; (MINT)

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Përkrahja financiare e se paku 100 bizneseve, me qëllim të rritjes së prodhimit, cilësisë së produkteve, eksportit, konkurrueshmërisë dhe qasjes në tregjet ndërkombëtare, si dhe promovimi eksportit kosovar dhe turizmit; (MINT)
2. Rritja e kapaciteteve të hapësirës së inkubacionit; (MINT)
3. Ndërtimi i zonave të reja industriale, përfshirë qendrat e transferit të teknologjisë apo parqet teknologjike; (MINT)
4. Fuqizimi i ekipeve promovues në ambasadat e Kosovës, dërgimi i atasheve ekonomik; (MINT)
5. Krijimi dhe fuqizimi i rrjeteve të afarizmit me investitor potencial përmes diasporës. (MINT)

Treguesit e rezultateve:

Treguesi	Baza 2020	Treguesi 2022	Synimi 2024
BVSH (MVD) e Industrisë Përpunuese për koke banori (Euro)	502.8	583.2	676.5
Pjesëmarrja e Kompanive eksportuese të Industrisë Përpunuese në Sektorin C (%)	16,81%	18%	21%
Pjesëmarrja e grave në punësim në kuadër të sektorit C (%)	7.6 %	9.1 %	10.5 %

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Hartimi politikave për sektorët industrial do të ndikojnë në krijimin e mundësive të reja për zhvillimin e mëtejshëm të NVM-ve, qasjen në tregje të reja, si dhe rrjetëzimin e ndërmarrjeve në sektorët me potencial zhvillimi përmes zingjirit të vlerës.. Zbatimi i masave të politikës industriale do të mundësojë prodhimin e produkteve me vlerë të shtuar dhe rritjen e konkurrueshmërisë të ndërmarrjeve, si rezultat i investimit në teknologji moderne, digjitalizim, certifikim dhe këshillime, investimet në zonat ekonomike si dhe

bashkëpunimit të kompanive vendore me partnerë të rajonit dhe të BE-së. Pjesëmarrja e ndërmarrjeve në panairë ndërkombëtare do t'iu ofron mundësinë që të jenë pjesë e tregut global si dhe rritjen e potencialeve për eksport. Rishikimi dhe aprovimi i ligjit për investime, hartimi i një politike kombëtare për investime dhe hartimi i programit të kujdesit pasues për investimet, do të ndikoj në rritjen e nivelit të bashkëpunimit me kompanitë e huaja dhe rritjen e investimeve të huaja.

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Kostoja totale e llogaritur për zbatimin e kësaj mase (2022-2024) pritet të jetë rreth 7,063,902 Euro, shumë e cila është ndarë nga buxheti i Kosovës. Në vitin 2022 janë planifikuar 2,374,634 Euro, në vitin 2023, 2,344,634 Euro, dhe në vitin 2024, 2,344,634 Euro.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Priten efekte pozitive në rritjen e punësimit në sektorët industrial të synuar. Si rezultat i zbatimit të kësaj mase presim që të krijohen mundësi punësimi për rreth 2000 persona në vit si dhe që të zhvillohen sektorët prodhues industrial në Kosovë dhe njëherit do të fuqizohen gratë ndërmarrëse.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Kjo masë do të ketë ndikim në mjedis, pasi që gjatë ndërtimit do të degradohet zona ku realizohen punimet e infrastrukturës. Por, me ndërtimin e Zonave Ekonomike, ndikimi në mjedis do të jetë i kontrolluar dhe do të ketë koncentrim të bizneseve me qasje në infrastrukturë, energji elektrike si dhe infrastrukturë nëntokësore, si dhe do të ruhen tokat bujqësore nga degradimi i tyre. Po ashtu, përkrahja e NVM-ve për investime në teknologjinë moderne, do të ketë ndikim pozitiv në mjedis, në uljen e emetimit të gazrave serrë, si dhe kursimin e energjisë.

Rreziqet potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Mungesë e produkteve me standarde për depërtim në tregjet ndërkombëtare	I mesëm	Mbështetje e ofruar për certifikimin e produkteve dhe këshillime për rritjen e eksportit
Zgjatja e pandemisë në nivel global	I lartë	Zbatimi i Planit kombëtar për rimëkëmbje ekonomike vazhdon edhe në vitet tjera; Adaptimi i politikave në varësi të rrethanave si pasojë e pandemisë.

Masa e reformës #17: Ngritja e Konkureshmërisë në Sektorin e Turizmit dhe Hotelërisë

Përshkrimi i masës: Masa është vazhdimësi nga PRE 21-23 dhe do të ndikon në rritjen e vlerës ekonomike të turizmit dhe rritjen e punësimit. Aktivitetet që do të ndërmerren në këtë masë, janë përmirësimi i infrastrukturës ligjore sipas praktikave evropiane, dhe zhvillimi dhe promovimi i produkteve do të ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen e ofertës turistike. Gjatë vitit 2020 shumë aktivitete të planifikuara nuk kanë mundur të realizohen për shkak të pandemisë por edhe ndryshimeve politike, prandaj disa prej tyre janë bartur nga vitit 2020 në vitin 2021. Masa ndërlidhet me Programi i Qeverisë 2021-2025, ndërlidhet me objektivin 5, 8, 9 dhe objektivi 12 SDG , si dhe në aspektin e promovimit të trashëgimisë kulturore ndërlidhet me Strategjinë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027 pastaj Pakoja e ringjalljes ekonomike 2021, KASH 2022-2024.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Miratimi i strategjisë për sektorin e turizmit dhe Plani të veprimit; (MINT)
2. Hartimi i Udhëzimeve administrative që dalin nga Ligji i ri i Turizmit (UA-për Regjistrin e Turizmit dhe UA për Udhërrëfyesit turistik) (MINT)
3. Zhvillimi dhe promovimi i brendit për turizmin e Kosovës (MINT)
4. Përkrahja e turizmit në zonat rurale përmes subvencioneve dhe transfere (MINT, MBPZHR)

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Krijimi i regjistrin të turizmit(MINT)
2. Licencimi i udhërrëfyesve turistik (MINT)
3. Analiza dhe hulumtimi i tregjeve turistike për qasjen dhe promovimin e ofertës turistike të Kosovës në tregjet ndërkombëtare (MINT)
4. Identifikimi i shtëpive tradicionale dhe kullave që të shërbejnë si struktura akomoduese (MKRS)

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Përcaktimi i zonave me përparësi zhvillimin e turizmit (MINT)
2. Zhvillimi i së paku 5 produkteve të reja turistike në bashkëpunim me komunat (zgjerimi i Via Ferrata në Rugovë, zhvillimi i shtegut të çiklizmit në Pejë-Radavc, zgjerimi i shtegut Via Dinarica në Deçan, Junik dhe Pejë) (Komunat, MINT)
3. Mbështetje financiare për ridestinimin e shtëpive tradicionale dhe kullave në objekte akomodimi (MKRS Komunat).

Treguesit e rezultateve:

Treguesi	Viti bazë 2020	Synimi 2022	Synimi 2024
Numri i ardhjeve të vizitorëve të huaj ³²	3,203,954	5,000,000	5,700,000
Nr. net qëndrimi të vizitoreve vendor dhe të jashtëm	266,491	530,000	650,000
BPV (Bruto produkti vendor sipas aktivitetit ekonomik: Hotele dhe restorante)	1.6%	2 %	2.5 %

Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri: Ligji i ri për turizëm rregullon infrastrukturën ligjore në operimin e udhërrëfyesve turistik (guidave), agjencive turistike, akumulimi i taksës së akomodimit si dhe përcaktimi i zonave me përparësi zhvillimin e turizmit, brendimin shtetëror të turizmit. E gjithë kjo do të ndikon në uljen e informalitetit në sektorin e turizmit dhe promovimin e vlerave konkurruese në sektorin e turizmit. Zhvillimi i turizmit do të zgjerohet në zonat rurale dhe malore ku synohet rritja e punësimit në këto zona, rritja e bizneseve familjare ku gratë do të kenë mundësi të lehta të punësimit. Rritja e produkteve të reja turistike do të ndikon në zgjerimin e ofertës turistike të Kosovës e cila ndikon direkt në rritjen e konsumit të shërbimeve turistike dhe si rezultat nxit punësimin dhe rritjen e mirëqenies.

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Sipas vlerësimeve preliminare, implementimi i aktiviteteve të listuara në këtë propozim për periudhën 2022-2024 do të jetë në

³² Burimi i informacionit: ASK/Policia Kufitare, Qarkullimi turistik në pikë kalimet kufitare.

vlerën prej 1,887,000 por mund të ndryshoj. Këto mjete janë mjete të buxhetit të Kosovës. Një vlerë e buxhetit do të jetë nga MKRS në mbështetje të zhvillimit të turizmit përmes trashëgimisë kulturore (deri tani janë të konfirmuara 200,000.00), dhe nga MBPZHR si dhe një pjesë e mjeteve do të jetë nga komunat (610,000) për zhvillimin e produkteve turistike.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Zhvillimi i turizmit do të zgjerohet në zonat rurale dhe malore ku synohet rritja e punësimit në këto zona, rritja e bizneseve familjare ku grat do të kenë mundësi të lehta të punësimit. Skema e granteve gjithashtu do të synojë rritjen e cilësisë dhe sasisë së produktit dhe rritjen e aftësive të biznesit të komunitetit. Zgjerimi i ofertës turistike, duke ofruar shërbime cilësore dhe të standardizuara si dhe promovimi i Kosovës në tregjet ndërkombëtare, do të sjell edhe prurje të reja të turistëve ndërkombëtar dhe kjo do të rezultojë në veçanti në rritjen e numrit të turistëve ndërkombëtar në Kosovë, ku pritet që deri në fund të vitit 2024 të kemi rreth 43% rritje. Kjo pritet të ndikon drejtpërdrejt pjesëmarrjen e turizmit në BPV e cila pritet të rritet deri në 2.5%.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Zhvillimi i turizmit e sidomos në zonat e mbrojtura mund të çojë në rritjen e ndotjes, më shumë mbeturina, në prekjën e specieve që janë në zhdukje etj. Këto afekte mjedisore mund që gradualisht të ndikojnë edhe në dëmtimin e burimeve turistike prej të cilave varet turizmi. Prandaj kjo masë kërkon një bashkëveprim më të madh ndërinstitucional (ndërministror dhe me komunat), në mënyrë që të zhvillohet një turizëm i qëndrueshëm.

Rreziqet potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Bashkëpunimi jo i mjaftueshëm me komunat dhe institucionet tjera relevante	I mesëm	Planifikohet të intensifikohen takimet me komunat me potencial me të lartë për turizëm

Masa e reformës #18: Rritja e konkureshmërisë në sektorin e tregtisë së shërbimeve

Përshkrimi i masës: Kjo masë synon të përmirësojë eficiencën dhe konkureshmërinë e aktiviteteve të shërbimeve të tregtueshme dhe të promovojë zhvillimin e tyre në nivel të sektorëve që lidhen me tregtinë e shërbimeve. Zhvillimi i mëtejshëm i aktiviteteve të shërbimit do të jetë thelbësor në uljen e deficitit tregtar dhe përmirësimin e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve pas ndikimit të COVID-19. Kjo masë synon gjithashtu rritjen e produktivitetit dhe konkureshmërisë së përgjithshme të ekonomisë së Kosovës dhe rritjen e eksporteve të shërbimeve. Kosova ka marrë disa obligime në nivel rajonal dhe global, veçanërisht duke gjeneruar nga CEFTA dhe MSA. Zhvillimi i shërbimeve moderne dhe eficiente është parashikuar në Programin e Qeverisë 2021-2025 dhe në Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Ky aktivitet është i lidhur me disa dokumente strategjike, siç është Marrëveshja e Gjelbër pika 2: Transformimi i ekonomisë së BE-së për një të ardhme të qëndrueshme; nënpika 2.1.3 mobilizimi i industrisë për një ekonomi të pastër dhe qarkore. OZHQ, Objektivi 17, forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimi i partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm. Gjithashtu, një dokument për Tregun e Përbashkët Rajonal, i cili rrjedh nga Samiti i Sofjes, thekson miratimin e një pakete për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve, ndër të tjera, dhe mundëson ofrimin e shërbimeve pa themelime dhe autorizime të detyrueshme, në përputhje me Kapitullin 3 të rregullores së BE-së, mundëson lëvizshmërinë e studentëve, studiuesve dhe profesorëve dhe krijon një treg rajonal të tregtisë elektronike duke miratuar rregulla thelbësore të harmonizuara dhe parime të tregut të brendshëm, duke lehtësuar zhdoganimin e parcelave dhe duke hequr gjeo-blokimin.

a. Aktivitetet e planifikuara për vitin 2022:

1. Themelimi i Pikës së Vetme të Kontaktit (PVK) përmes portalit e-Kosova dhe funksionalizimi i tij (MINT).
2. Identifikimi i sektorëve të mëtejshëm të shërbimeve që bien nën direktivën e shërbimeve 123/2006/KE për t'u integruar në përdorimin në PVK (MINT dhe institucionet përkatëse).
3. Forcimi i komunikimit me bizneset, shoqërinë, shoqatat profesionale dhe komunat për dixhitalizimin e procedurave administrative që lidhen me sektorin e shërbimeve duke hartuar një dokument komunikimi dhe duke organizuar të paktën një event (MINT dhe institucionet përkatëse).
4. Diagnostikimi i sektorëve potencialë të tregtisë së shërbimeve dhe vlerësimi i avantazhit konkurrues të tregtisë së shërbimeve (MINT).
5. Vazhdimi i negociatave për njohje reciproke ndërmjet vendeve të CEFTA-s për profesionet e përzgjedhura (mjekë të përgjithshëm, stomatologë dhe arkitektë) (MINT).
6. Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Tregti Elektronike (MINT dhe institucionet përkatëse).

b. Aktivitetet e planifikuara për vitin 2023:

1. Dixhitalizimi i të paktën dy sektorëve të tjerë dhe integrimi i tyre në KPS përmes portalit e-Kosova (MINT).
2. Analiza e të paktën dy sektorëve për diagnostikimin e sektorëve potencialë të tregtisë së shërbimeve dhe vlerësimin e avantazhit konkurrues në tregtimin e shërbimeve (MINT).
3. Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit vendas me BE-në në fushën e shërbimeve (MINT).
4. Identifikimi i barrierave në tregtinë e shërbimeve dhe hartimi i një plani veprimi për heqjen e këtyre barrierave sipas AP6 (MINT).

c. Aktivitetet e planifikuara për vitin 2024:

1. Adresimi i agjendës së integruar dhe llogaritja e masës së masave kufizuese që ndikojnë në tregtinë e shërbimeve (MINT).
2. Liberalizimi i mëtejshëm i tregtisë së shërbimeve ndërmjet vendeve anëtare të CEFTA-s (MINT dhe institucionet përkatëse).
3. Liberalizimi i shërbimeve me partnerët tregtarë (Mbretëria e Bashkuar, Turqi) (MINT).

Treguesit e rezultateve:

Treguesit	Baza 2019	Treguesit 2023	Synimi 2024
Kontributi i shërbimeve profesionale dhe TIK në PBB (%)	4.05%	4.2%	Rritja në 7.5%
Vlera e eksporteve në shërbime	€1.6 bilion	€ 994 milion	Rritja në €1.9 bilion

Ndikimi i pritshëm në konkurueshmërisë: Zbatimi i aktiviteteve të planifikuara do të kontribuojë në rritjen e eksporteve të shërbimeve dhe orientimin e politikave të favorshme në shërbime. Për më tepër, politikat e zhvillimit në fushën e shërbimeve profesionale do të ndikojnë pozitivisht në konkurueshmërinë e sektorit në përgjithësi dhe në tregtinë e shërbimeve profesionale, kryesisht përmes mundësive të reja të krijimit të vendeve të punës dhe rritjes së IHD-ve në shërbime me produktivitet të lartë dhe lehtësimit të qasjes në financa për bizneset.

Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe burimet e financimit: Shuma totale e buxhetit të planifikuar për këto aktivitete për tre vjet është 260,000.00 €, ndarë sipas viteve: 111,500.00 € për vitin 2022, 114,500.00 € për vitin 2023 dhe 34,000,00 € për vitin 2024. do të financohet nga buxheti i Kosovës dhe 200,000.00 € nga fondacionet IPA.

Ndikimet e pritshme në rezultatet sociale, si punësimi, ulja e varfërisë, barazia gjinore: Zhvillimi i aktiviteteve shërbyese do të orientohet drejt punësimit të të rinjve me fokus tek femrat. Meqenëse shumë aktivitete shërbimi varen nga punësimi i grave, si arsimit, shëndetësia dhe shërbimet e tjera të biznesit, zhvillimi i mëtejshëm i shërbimeve do të rrisë nivelin e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore. Në vitin 2020, 79.1% e të punësuarve në Kosovë ishin të punësuar në sektorin e shërbimeve dhe krahasuar me vitet paraprake në vitin 2019, nuk ka ndryshim të trendit të punësimit në këtë sektor. Më tej, pas ndikimit të situatës pandemike me COVID-19 dhe krahasimit të statistikave të pesë viteve të fundit, nuk ka punësim të luhatshëm në sektorin e shërbimeve.

Ndikimi i pritshëm mjedisor: Kjo masë nuk pritet të ketë ndikim mjedisor.

Rreziqet e mundshme:

Rreziqet	Probabiliteti	Veprimet lehtësuese të planifikuara
Koordinimi i institucioneve publike qendrore dhe në nivel lokal në ndërhyrjen për përshtatjen e shërbimeve	E ulët	Identifikimi i sektorëve të veçantë që plotësojnë kriteret për t'u dixhitalizuar. Analizë e vlerësimit të kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturës së TI-së në institucionet e nivelit qendror për ngritjen e KPS-ve.
Vonesat në miratimin e legjislacionit	E ulët	Rritja e bashkëpunimit të koordinuar me organet përkatëse duke iu përmbajtur hierarkisë dhe përfshirja e ndryshimeve të propozuara në legjislacionin që bien nën Direktivën e Shërbimeve.
Kohëzgjatja e pandemisë Covid-19	E lartë	Masat e qeverisë kundër pandemisë Covid-19.

5.2.10. Edukimi dhe aftësitë

Gjendja aktuale: Viti shkollor 2020/21 u karakterizua me çrregullime të shumta të shkaktuara nga situata e pandemisë, të cilat penguan seriozisht zhvillimin e procesit mësimor dhe rezultuan me humbje mësimore të konsiderueshme për të gjithë nxënësit dhe studentët, sidomos për ata nga grupet e marginalizuara. Kemi bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2021/22, duke rishikuar udhëzuesit për zhvillimin e mësimin në kushte të pandemisë dhe duke ofruar zgjidhje të reja për mësimin në distance.

Sa i përket të dhënave në arsim, shkalla bruto e regjistrimit për 2020/21 të fëmijëve në edukimin parafillor (5 vjeç) është 88.1% (meshkuj 89.9%, femra 86.4%), ndërsa vetëm në nivelin parashkollor (mosha 3-5) është 36.4% e cila është e ulët dhe larg përmbushjes së objektivave të BE-së. Kjo dobëson rezultatet arsimore, por gjithashtu pengon pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore, duke pasur parasysh rolin e tyre mbizotërues sociokulturor si kujdestare. Në arsimin fillor është 101.2% (meshkuj 101.3%, femra 101.1%), ndërsa në arsimin e mesëm të

ulët në vitin shkollor 2020/2021 ishte 90.9% (meshkuj 90.7%, femra 91.2%). Në arsimin e lartë kemi rënie – nga 82.5% më 2019-2020 në 81.1% (meshkuj 80.0%, femra 82.2%) në vitin 2020-2021. Numri i përgjithshëm i studentëve në arsimin universitar ishte 95 335, prej tyre në universitetet publike ishin 54 753 studentë, ose shprehur në përqindje, 57.4%, ndërsa në kolegjet private ishin 40 582 studentë, ose 42.6%. Përqindja e moshës 25-64 e arritshmërisë në arsim ishte 81.1 në vitin 2019, ndërsa 76.7 % në vitin 2020.

Shpenzimet publike në arsim, si % e BPV në vitin 2020 janë 4.4%, ndërsa si % e buxhetit qeveritar janë 12.8%³³. Paga mesatare bruto (mujore) e mësimitdhënësve përgjatë të gjitha niveleve para-universitare është afërsisht 80% e pagës mesatare në Kosovë dhe 77% e pagës mesatare vetëm të sektorit publik. Numri i nxënësve për mësimitdhënës në vitin shkollor 2021/22 është 13.4; kurse raporti nxënës-mësimitdhënës dallon sipas nivelit të shkollimit. Në nivelin parafillor/çerdhe për çdo 10.1 fëmijë të regjistruar ka një mësimitdhënës; në nivelin e arsimit parafillor, për çdo mësimitdhënës janë mbi 17.6 fëmijë; nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, për çdo mësimitdhënës janë afërsisht 13.5 nxënës; në arsimin e mesëm të lartë është një mësimitdhënës për çdo 12.9 nxënës. Në nivelin e arsimit fillor e të mesëm të ulët, madhësia mesatare e klasës është 17.7 nxënës për paralele, ndërkaq për arsimin e nivelit të mesëm të lartë, ky raport është 21.4. Në arsimin profesional, rreth gjysma e nxënësve të arsimit të mesëm të lartë zgjedhin një nga 117 profilet e ofruara në kuadër të 68 shkollave profesionale dhe Qendrave të Kompetencës. Nevojitet që politikat sektoriale të fokusohen në përputhshmërinë e sistemit arsimor në mënyrë që ky sistem të reagojë më mirë ndaj tregut të punës. Shkalla e braktisjes në arsimin e obliguar për vitin shkollor 2020/2021 ishte 0.05% (109 nxënës; më 2018/2019 kjo ishte 0.05% - 122 nxënës) dhe vijuesit e arsimit të të rriturve në vitin shkollor 2020-2021 ishte 2,3 ndërsa statistikat për “Early leavers from education and training” për moshën 18-24) ishte 7.8 % në vitin 2020 (më 2019 ishte 8.2 % sipas AFP).

Në TM1 2021, shkalla e papunësisë tek personat pa arsim ishte 55.4% (meshkujt 61.2%, femrat 33.0%); 35.0% të papunë në mesin e atyre me arsim fillor (meshkuj 34.7; femra 35.9%), 26.5% të papunë në arsimin e mesëm profesional (meshkuj 25%, femra 33.2%); shkollë e mesme-gjimnaz 27.5% (meshkuj 24.4%, femra 35.3%) dhe 19.2% te ata me arsim të lartë (meshkuj 15.8%, femra 23.7%).

Në vitin 2014 AKA ishte bërë anëtare e ENQA, ndërsa në vitin 2019 është rishqyrtuar statusi saj. Tani më AKA ka ndërmarrë veprimet konkrete për plotësimin e të gjitha kriterëve për kthim në ENQA.

Pengesat strukturore: Në fushën e arsimit dhe shkathtësisë pengesat lidhen me përfshirjen e ulët të fëmijëve në arsimin parashkollor dhe përfshirjen e nxënësve tek grupet e marginalizuara; përputhjen e shkathtësive me kërkesat e tregut. Menaxhimi i AAP-së i cili është i ndarë në mes të dy institucioneve (MASHTI-i dhe nga MFPT) që shpie në përdorimin joefikas të fondeve. Roli i paqarte i AAPARR-ja e cila aktualisht menaxhon vetëm 6 prej 68 shkollave profesionale është edhe një pengese tjetër. Arsimi i të rriturve ofrohet vetëm nga institucionet private dhe organizatat jo-qeveritare. Mungon bashkëpunimi i strukturave me tregun e punës, zhvillimi i mekanizmave për ngritjen e cilësisë, profilizimin e institucioneve të arsimit të lartë, numrin e madh të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre akademike; ndërlihdja e arsimit të lartë me tregun e punës; statistikat e pamjaftueshme për tregun e punës, kapacitetet pamjaftueshme në AKA; monitorimi i institucioneve të arsimit të lartë; nevojat për digjitalizimin e proceseve të akreditimit dhe monitorimit; mungesa e monitorimit dhe “Follow up Procedures” për institucionet e arsimit të lartë.

³³ This section was drafted around mid-2021, so the data may have been subject to change by end-2021

Masa e reformës #19: Reforma në arsimin parauniversitar dhe rritja e përfshirjes në edukimin e hershëm.

Përshkrimi i masës: Masa synon të rris vijueshmërinë e fëmijëve në edukimin në fëmijërinë e hershme (EFH) duke përfshirë zbatimin e qasjes gjithëpërfshirëse dhe ngritjen e cilësisë, ngritjen e cilësisë në arsimin parauniversitar, në nivelin e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë menaxhimin efektiv të sistemit të arsimit në këtë nivel, bazuar në mekanizma funksionalë për sigurimin e cilësisë dhe transparencës, që do të ndikojnë në mësimnxënie dhe mësimdhënie efektive si dhe në ngritjen e rezultateve të nxënësve. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet: rritjes dhe adaptimit e hapësirave të Institucioneve Parashkollorë (IP) publike Përmirësimin e legjislacionit dhe zhvillimin e kurrikulës bërthamë Përditësim e platformës “Edukimi në Distancë – ku pritet të përfitojnë të gjithë fëmijët e moshës 0-6 vjeç e në veçanti fëmijët që nuk mund të jenë pjesë e institucioneve parashkollore si dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit menaxherial dhe edukativ, Gjithashtu synohet të përmirësimi i legjislacionit për tekste dhe materiale shkollore, procedurave të përzgjedhjes së personelit edukativo-arsimor të arsimit para-universitar; zhvillimit profesional të mësimdhënësve duke krijuar mekanizma në qëndrueshmërinë dhe ngritjen profesionale të shkathtësive digjitale të MASHTI, DKA dhe shkollat dhe ngritjen e kapaciteteve të inspektoratit të arsimit. Kjo masa është vazhdimësi e ciklit të mëhershëm të (PRE), dhe është në përputhje me Programin e Qeverisë 2021-2025, Planin Strategjik dhe Operacional të Qeverisë dhe politikat e MASHTI, është pjesë e SKZH, ndërsa me SDG është e ndërlidhur me objektivin 4 treguesit 4.1. dhe 4.2, 4.a dhe 4 b).

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Hartimi i analizës së situatës për adaptimin e hapësirave ekzistuese të shkollave në kopshte; (MASHTI).
2. Ndërtimi i 12 institucioneve të reja parashkollore dhe adaptimi i 2 shkollave në kopshte (MASHTI)
3. Hartimi i të gjitha akteve nënligjore që dalin nga Ligji për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme; (MASHTI)
4. Hartimi dhe miratimi i kurrikulës bërthamë për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme; (MASHT);
5. Miratimi i ligjit për tekste dhe materiale shkollore; (MASHTI/Kuvendi)
6. Punësimi i 20 inspektoreve të rinj; (MASHTI)
7. Hartimi dhe miratimi i UA për Procedurat e përzgjedhjes së personelit edukativo-arsimor të arsimit para-universitar; (MASHTI)
8. Rishikimi, harmonizim, finalizimi dhe miratim i legjislacionit për ZHPM; (MASHTI)
9. Trajnimi i 3500 mësimdhënësve sipas programeve prioritare; (MASHTI)

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023

1. Ndërtimi i 10 institucioneve parashkollore të reja dhe adaptimi i 5 shkollave në kopshte; (MASHTI)
2. Aftësimi i trajnerëve për pilotimin e kurrikulës së re; (MASHTI)
3. Trajnimi i deri 100 edukatorëve në fazën e pilotimit për zbatimin e kurrikulës bërthamë; (MASHTI)

4. Trajnimi, mentorimi dhe monitorimi i 500 edukatoreve për zbatimin e kurrikulës bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme; (MASHTI)
5. Bartja e përgjegjësisë financiare të platformës “Edukimi në Distançë – Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme” dhe menaxhimi nga stafi i MASHTIT; (MASHTI)
6. Punësimi i 20 inspektoreve të rinj; (MASHTI)
7. Trajnimi i 5000 mësimdhënësve sipas programeve prioritare; (MASHTI)

c. Aktivitetet e planifikuara për 2024:

1. Ndërtimi i 2 institucioneve të reja parashkollore dhe adaptimi i 5 shkollave në kopshte; (MASHTI)
2. Trajnimi, mentorimi dhe monitorimi i 1000 edukatoreve për implementimin e kurrikulës bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme; (MASHTI)
3. Menaxhimi i Platformës “Edukimi në Distançë – Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme; (MASHTI)
4. Punësimi i 20 inspektoreve të rinj; (MASHTI)
5. Trajnimi i 5000 mësimdhënësve sipas programeve prioritare; (MASHTI)

Treguesit e rezultateve:	Viti bazë 2021	Objektivi 2023	Objektivi 2024
Numri i IP të ndërtuara/adoptuara	44	78	85
Pjesëmarrja në arsimin e hershëm (Numri i fëmijëve të moshës 0 deri në 6 vjeç)	31 179	35 630	35 870
<i>Numri i inspektoreve të rinj të arsimit</i>	30	64	74

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Kjo masë ndikon në përmirësimin dhe rritjen e përfshirjes në edukimin e hershëm, pasi që si synim ka rritjen e mundësisë së qasjes përmes rritjes së numrit të institucioneve, dhe përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të platformës online që mundëson qasje nga distanca (gjë që deri me tani ka arritur në mbi 6 milion hyrje në platformë). Gjithashtu zhvillimi i dokumenteve politike sikurse ligji mbi EFH dhe kurríkula bërthamë, do të kontribuojnë kundrejt cilësisë së edukimit të ofruar gjë që do të shërbejë më pozitivisht në zhvillimin afatshkurtër dhe afatgjatë të fëmijës dhe shoqërisë. Zhvillimi profesional të mësimdhënësve, punësimin e zyrtarëve dhe inspektorëve të rinj, miratimin e ligjit për tekste dhe materiale shkollore, miratimin dhe zbatimin i akteve nënligjore për procedura e përzgjedhjes dhe punësimit së menaxhmentit dhe stafit do të ndikojnë gjithashtu në konkurrueshmëri.

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet të financimit: Kosto e përgjithshme për zbatim të kësaj mase vlerësohet të jetë rreth 20,899,131 € për vitet 2022-2024 nga kategoria e pagave, mallrave dhe shërbimeve dhe shpenzimet kapitale. Nga kjo vlerë, për vitin 2022, kostoja e përgjithshme do të jetë 17,050,377 €, nga të cilat 12,050,377 € nga buxheti i Kosovës dhe 5,000,000 € nga fondet e BE (IPA). Për vitin 2023 kostoja e zbatimit është në vlerë prej 1,799,377 € nga buxheti i Kosovës. Për vitin 2024 kosto e zbatimit është 2,049,377€ nga buxheti i Kosovës.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale, të tilla si punësimi, reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Masa ndihmon në rritjen e punësimit dhe krijimit të mundësive të barabarta për punësim, përmes krijimit të hapësirave shtesë dhe përmes formave alternative të shërbimeve në edukimin e hershëm, avancimin e mësimdhënësve dhe stafit të institucioneve arsimore,

ndërsa në periudhën afatgjatë ulë varfërinë. Me rritjen e qasjes së familjeve në Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, ngritët edhe barazia gjinore pasi që ju mundëson familjeve që të punojnë përderisa kujdesi i fëmijëve të tyre është shërbim që ofrohet në komunitetin e tyre.

Ndikimi i pritur në mjedis: Ndikimi në mjedis pritet të ndodhë në varësi të ndërtimit/adoptimit të Institucioneve parashkollore. Ministria parashihet t'i përmbahet të gjitha parametereve për mbrojtjen e mjedisit varësisht nga specifikat e lokacioneve të identifikuara për ndërtim të institucioneve parashkollore dhe komunave përkatëse.

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
Zgjatje e procedurave për ndërtimin /adoptimin e IP për arsye të shpronësimit apo mos gjetjes së lokacionit të duhur nga ana e komunave	mesëm	Analizim i gjendjes nga komunat në koordinim me Sekretarin e Përgjithshëm dhe Kabinetin në MASHTI
Kufizimi i stafit edukativ që punësohen në institucionet e reja edukative	lartë	MASHTI me rishikimin e formulës së financimit planifikon për stafin edukativ të ri
Pamundësia e punësimit të 44 inspektoreve të rinj	mesëm	Koordinim i saktë dhe në kohë

5.2.11. Punësimi dhe tregu i punës

Gjendja aktuale: Pjesëmarrja e fuqisë punëtore në tregun e punës në Kosovë vazhdon të mbetet e ulët. Ndikimi afatshkurtër dhe afatmesëm i COVID-19 ka rritur cenueshmërinë e vendeve të punës dhe rrezikon të thelloj ndarjet socio-ekonomike.

Përmirësimi i aktivitetit ekonomik ka filluar të reflektohet edhe në tregun e punës. Të dhënat e fundit në dispozicion të tregut të punës të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se shkalla e punësimit në tremujorin e parë të vitit 2021 shënoi një përmirësim të lehtë në terma vjetorë, duke arritur në 29.3%. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore u përmirësua me 0.7 p.p., duke arritur në 39.5%. Ndërsa shkalla e papunësisë u rrit me 0.8 p.p. në terma vjetorë duke arritur në 25.8%.

Sektorët me punësimin më të lartë vazhdojnë të jenë: tregtia me një peshë prej 16.8% ndaj punësimit total; prodhimi me 12.4%, arsimit me 11.1% dhe ndërtimtaria me 9.4%. Punësimi i meshkujve ishte më i lartë në sektorët e tregtisë, ndërtimit dhe prodhimit, ndërsa punësimi i femrave ishte më i lartë në sektorët e arsimit, tregtisë dhe shëndetësisë.

Shkalla e papunësisë në TM1 2021 shënoi 25.8%, krahasuar me 25.9% në 2020. Shkalla e papunësisë tek të rinjtë e moshës 15-24 është ulur nga 49.1% në 2020 në 48.6% në 2021. Rreth 45.7% e të rinjve të moshës 15-19 ishin të papunë afatgjatë (më shumë se 12 muaj). Tek të rinjtë shkalla e papunësisë meshkujt është 46.1%, ndërsa tek femrat papunësia është 53.5%. Sipas AFP-së, në TM1 2021 përqindja e të rinjve në kategorinë NEET shënoi 29.8% (krahasuar me 33.6% në 2020)

Është themeluar Grupi Ndërmintor në nivel politik të udhëhequr nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve si përkushtim i Qeverisë për adresimin e procesit për zhvillimin e Skemës së Garancisë për të Rinj, si dhe . Ekipi Teknik Ndërmintor të hartimin e Skemës së Garancisë për të Rinj. .

Mospërputhja e shkathtësive me nevojat e tregut të punës mbetet pengesë kryesore. Nga ana e punëdhënësit, rreth 50% e firmave raportojnë se edukimi i përgjithshëm nuk i përgatit studentët në mënyrë adekuate për vendin e punës - goftë në drejtim të njohurive të përditësuara apo shkathtësive të buta (Banka Botërore, 2019). Një mungesë e aftësive themelore të biznesit është përmendur si pengesë e dukshme për zhvillimin e sektorit privat. Sipas sondazhit STEP,

75% e kompanive kanë hasur në vështirësi në punësimin e menaxherëve, profesionistëve dhe teknikëve.

Sa i përket punës së padeklaruar në Kosovë, mesatarisht konsiderohet se rreth 30% e punëtorëve nuk deklarohen për qëllime tatimore, 22.6% e punësimit të deklaruar është punësim i nën-deklaruar, dhe nga 20% deri në një të tretën e individëve të punësuar janë punëtorë në llogari vetanake. Aktualisht Kosova nuk ka një Regjistër kombëtarë të Punësimit. ATK-ja posedon informacione për persona të punësuar, por nuk ka informacione në lidhje me detajet rreth të punësuarit. Formalizimi i përfituesve të Masave Aktive të Tregut të Punës, sipas legjislacionit në fuqi, nuk është kërkesë e detyrueshme e vendosur ndaj përfituesve të Masave Aktive të Tregut të Punës-MATP. Mbështetja ose subvencionet e drejtpërdrejta për bujqësinë të siguruara nga MBPZHR, nuk janë të kushtëzuara me formalizimin e punëtorëve. Një sistem i integruar i inspektimit të punës do të sigurojë që inspektimi i punës në bujqësi të konsiderohet një sektor me prioritet në të njëjtin nivel me sektorët e tjerë që IP-ja i ka prioritet. Organizimi i fushatave të vetëdijesimit mbetet i ulët në krahasim me prevalencën e punës së padeklaruar. Ndryshe nga të dhënat e publikuara nga Anketa e Fuqisë Punëtore të ASK-së, të dhënat administrative të ATK-së lidhur me punësimin për vitin 2021 (deri në TM3) na japin një pasqyrë më të mirë sa i përket punësimit, pasi që ato janë prekur shumë nga masat e qeverisë. Masat që synojnë të zbusin ndikimin negativ të COVID kërkonin që të gjithë punëtorët të ishin në sektorin formal. Kështu, të dhënat tregojnë një rritje mesatarisht rreth 10.5% të punësimit për periudhën TM1-TM3/2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Informacioni i detajuar mbi treguesit e tregut të punës është i disponueshëm në seksionin 2.2.2. të Kuadrit Makroekonomik.

Të dhënat e Agjencisë së Punësimit flasin për rritje të numrit të punëkërkuarve të regjistruar në Zyrat e Punësimit (ZP), e cila rritje ka ardhur për shkak të masave të pakos emergjente ku njëri prej kritereve për të përfituar nga masat ka qenë regjistrimi si i papunë dhe punëkërkuar në ZP.

Pengesat kryesore strukturore: Mospërputhja e shkathtësive me nevojat e tregut të punës është pengesa kryesore, punësimi joformal për shkak se ajo zvogëlon produktivitetin nga mungesa e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve, humbjen e të ardhurave buxhetore dhe forcimin e përparësive të kompanive që operojnë në sektorin joformal, shërbimet publike të punësimit, buxheti i pamjaftueshme në zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të punësimit dhe aftësimin profesional në tregun e punës. Lidhja e kufizuar e punëkërkuarve me sektorin privat ngritë papunësinë afatgjatë, brishtësia e institucioneve siç është Inspektorati i Punës, nuk sanksionon mjaftueshëm sektorin joformal, duke ushqyer punësimin joformal pa mbrojtje sociale të duhur dhe duke zvogëluar bazën tatimore.

5.2.12. Mbrojtja dhe përfshirja sociale

Gjendja aktuale: Kosova ka bërë progres në tranzicionin në një sistem të bazuar në treg dhe ka mbajtur një rritje ekonomike relativisht të qëndrueshme. Megjithatë, historikisht rritja ekonomike e Kosovës nuk ka qenë e mjaftueshme për të reduktuar varfërinë dhe në mënyrë të konsiderueshme për të reduktuar varfërinë dhe zvogëluar ndjeshëm normat e larta të papunësisë si dhe për të krijuar vende pune formale, veçanërisht për gratë, të rinjtë, si dhe komunitetin romë, ashkali dhe egjiptian. Shkalla e varfërisë vazhdon të jetë e lartë, rreth 21 % të popullsisë që llogaritet të jetojë në varfëri në vitin 2019.³⁴ Varfëria në zonat rurale është e lartë, ndërsa mbi 40 % e popullsisë rurale është e papunë. Në vitin 2017, niveli i varfërisë në mesin e ekonomive familjare me tre ose më shumë fëmijë ishte 2.5 herë më shumë se niveli i varfërisë tek familjet pa fëmijë. Indeksi i Kapitalit Njerëzor (HCI) tregon se një fëmijë i lindur sot në

³⁴ Bazuar në kufirin e varfërisë prej 5.5 dollarësh amerikanë për person në ditë (me PPP-në e vitit 2011).

Kosovë do të jetë 56 % produktiv kur të rritet krahasuar me të njëjtin fëmijë nëse do të gëzonte arsim të plotë dhe shëndet të mirë.

Pandemia COVID-19 në vazhdim e sipër përbën sfidë serioze sociale dhe ekonomike për vendin, duke përkeqësuar rezultatet e varfërisë. Qeveria e Kosovës e ka trajtuar këtë përmes Paketës së Rimëkëmbjes Ekonomike në 2020 dhe së fundmi me Paketën e Ringjalljes Ekonomike në 2021. Përveç mbështetjes së drejtpërdrejtë për bizneset që përfshinte rritjen e formalizimit, Paketa e Ringjalljes përmban një gamë të gjerë masash që synojnë ata që kanë më shumë nevojë duke ofruar rritje të pensionet (për skemat e pensioneve të zgjedhura), ndihma sociale, mbështetje për pushimin e lehonisë (për nënat e punësuarra dhe të papuna), ato që humbën anëtarët e familjes nga Covid-19, etj. Një diskutim i detajuar dhe modalitetet e pagesave mund të gjenden në seksionin Konkluzionet e Përbashkëta dhe Kuadri Makroekonomik i këtij.

Nëpërmjet bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet financiare ndërkombëtare dhe partnerët e tjerë të zhvillimit do të nisë reformimin e sistemit të mbrojtjes sociale, duke iniciuar reformimin e Skemës së Ndihmës Sociale, , dhe përmirësimin e synimit të shpenzimeve sociale duke harmonizuar kornizën ligjore, ngritjen e kapaciteteve institucionale, njerëzore dhe teknologjike, ku përmes këtyre veprimeve pritet të ketë ndikim në rritjen e barazisë ndërmjet kategorive të ndryshme të përfituesve në aspektin e përfshirjes sociale si dhe në nivel të përgjithshëm shoqëror. Programi i Qeverisë 2021-2025 synon rritjen e mirëqenies sociale dhe uljen e varfërisë nëpërmjet mbështetjes së grupeve të cenueshme dhe ristrukturimit të skemave sociale dhe pensionale, dizajnimin të skemave të reja sociale dhe pensionale. Është filluar me programin e shtesave për fëmijët, ku fëmijët nën moshën 2 vjeçare do të përfitojnë shtesa mujore në vlerë prej 20 euro në muaj, ndërsa fëmijët prej moshës 2 deri në 16 vjeçare do të përfitojnë shtesa mujore në vlerë prej 10 euro në muaj.

Sfidat ekzistojnë në rritjen e kërkesave dhe numrit të qytetarëve dhe familjeve që kanë nevojë për mbrojtje sociale, shërbime sociale si rezultat i ndikimit të humbjes së të ardhurave dhe vendeve të punës nga pandemia Covid-19. Po ashtu sfida tjetër mbetet financimit i programeve të reja të mbrojtjes sociale, mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemit të mbrojtjes sociale, krijimi i sistemit të sigurimeve sociale, sinkronizimi i politikave të mbështetjes sociale, përmirësimi i kornizës ligjore dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, për ofrimin e shërbimeve sociale sipas nevojave të qytetarëve.

Pengesat strukturore: Disa prej sfidave me të cilat ballafaqohet sistemi pensioneve dhe beneficioneve burojnë nga korniza aktuale legjislative, duke shkaktuar presion fiskal në buxhet dhe pabarazi, në mbrojtjen sociale, për disa prej kategorive të ndryshme të përfitimeve sociale. Mos-harmonizimi i kornizës ligjore për pensione dhe beneficione mundëson përfitime nga me shume se një skeme, duke favorizuar kështu disa grupe të përfituesve dhe krijuar presion fiskal në buxhet, ndërsa një pjesë e kategorive janë të përjashtuara si rezultat i kufizimeve ligjore dhe mungesës së një sistemi të sigurimeve sociale të kompletuar.

Masa e reformës #20: Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe fuqizimi i grupeve të përjashtuara

Përshkrimi i masës: Qëllimi i masës është krijimin e një sistemi të mbrojtjes sociale i cili është i qëndrueshëm dhe stabil, sistem ky që plotëson nevojat e qytetarëve dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Zbatimi i saj efektiv kërkon një qasje më të vendosur dhe vendimmarrje gjithëpërfshirëse. Objektivi i përgjithshëm i masës është avancimi i shërbimeve sociale, rritja e mbulueshmërisë së familjeve që jetojnë në varfëri nga skema e ndihmës sociale, reformimi i sistemit pensional, gjithëpërfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në përfitime dhe shërbime, rritja e cilësisë së shërbimeve sociale dhe familjare, eliminimin e duplikimit të pagesave dhe

përfitimeve dhe avancimi i kontrollit të përfituesve lidhur me aktet tjera ligjore që janë kundërshtim me njëra tjetrën.

Kjo masë synon të sigurojë mirëqenien e popullatës, përmes zgjerimit dhe ngritjes së cilësisë së skemave të mbrojtjes sociale, sigurimeve sociale dhe shërbimeve sociale. Kjo masë ndërlidhet ngushtë me Programin e Qeverisë 2021-2025, Objektivat Operacionale të Planit të Punës së Qeverisë 2021-2025, Programin e Ringjalljes Ekonomike 2021, Strategjinë Sektoriale të ish-MPMS 2018-2022, Strategjinë Nacionale për Aftësi të Kufizuar 2017-2023 dhe PKZMSA.

a. Aktivitetet e planifikuara për 2022:

1. Miratimi i Ligjit të Shërbimeve Sociale Familjare dhe hartimi i kornizës ligjore sekondare për fillimin e zbatimit të ligjit;
2. Hartimi dhe miratimi i Ligjit të SNS dhe i kornizës ligjore sekondare për fillimin e zbatimit të ligjit;
3. Miratimi i Ligjit të Financave Lokale dhe hartimi i Udhëzimit Administrativ për formulën e financimit për shërbime sociale dhe familjare (Grantin e Veçantë për Shërbime Sociale);
4. Hartimi i legjislacionit primar për vlerësimin, njohjen e statusit, përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuar.
5. Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e legjislacionit për vlerësimin, njohjen e statusit, përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuar.
6. Hartimi dhe aprovimi i Udhëzimit Administrativ për lirim nga pagesa e kategorive sociale për sigurime shëndetësore;
7. Ndërtimi i Shtëpive për Mbrojtje të Fëmijëve si dhe zbatimi i programit të shtesave për fëmijë;
8. Mbështetja e sektorit joqeveritar të licencuar (50 OJQ) me grante dhe subvencione për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare;
9. Nënshkrimi i të paktën 1 Marrëveshjeve Bilaterale ose Multilaterale për Sigurimet Sociale;
10. Zhvillimi i programit dhe përgatitja e moduleve për trajnim profesional dhe trajnimi i punëtorëve social (200 punëtor social).

b. Aktivitetet e planifikuara për 2023:

1. Hartimi i standardeve minimale për shërbime sociale dhe familjare
2. Zhvillimi i Sistemit Informativ të SAS-it dhe krijimi i platformës së Sistemi të Integruar Informativ për Mirëqenie Sociale si dhe digjitalizimit të të dhënave për skemat pensionale;
3. Ndërtimi i shtëpive të komunitetit për personat e moshuar, dhe grupet vulnerabël;
4. Mbështetja për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në përputhje me legjislacionin e ardhshëm;

c. Aktivitetet e planifikuara për vitin 2024

1. Ndërtimi i shtëpive të komunitetit për personat e moshuar, dhe grupet vulnerabël;

2. Mbështetja për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në përputhje me legjislacionin e ardhshëm;
3. Licencimi dhe trajnimi i punëtorëve sociale nga sektori publik dhe joqeveritar nga Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare;
4. Zhvillimi i platformës së Regjistrimit Social dhe Digjitalizimi i të dhënave të skemave pensionale;
5. Trajnimi i stafit të Zyrave të Pensioneve, Qendrave për Punë Sociale dhe institucioneve tjera të mbrojtjes sociale.

Treguesit e rezultateve:

Treguesi	Viti bazë 2021	Objektivi 2022	Objektivi 2024
Rritja e shkallës së mbulueshmërisë së familjeve që jetojnë në varfëri nga skemat e ndihmës sociale.	50%	60%	90%
Realizimi i të drejtave në sigurim pensional dhe invalidor për të punësuarit në sektorin privat dhe publik si dhe zbatimi i programit të shtesave për fëmijë.	40%	60%	80%
Rritja e gjithpërfshirjes në përfitime dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.	50%	60%	80%

Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri: Megjithëse masa në thelbin e saj është një masë që mbulon fushën sociale, pensionale, invalidore, përmirësimi i shërbimeve sociale do të ndihmon për të ulur kostot e ushtrimit të këtyre të drejtave për përfituesit. Një nga kushtet për rritjen e konkurrueshmërisë dhe arritjen e rritjes ekonomike është ngritja dhe funksionalizimi i një sistemi që mund të sigurojë të drejtën për mbrojtje sociale të përshtatshme dhe të aksesueshme për qytetarët e saj. Reforma e mbrojtjes sociale, shërbimeve sociale, dhe pensionale do të përmirësojë kohezionin social; gratë dhe të rinjtë do të fuqizohen përmes nismave të sipërmarrjes sociale. Niveli qendror dhe lokal i qeverisjes do të jenë aktorët kyç për ofrimin e shërbimeve sociale dhe mbrojtjes sociale për qytetarët në nevojë.

Vlerësimi i kostos së aktiviteteve dhe burimet e financimit: Kosto e përgjithshme për zbatim të kësaj mase gjatë viteve 2022-2024 vlerësohet të jetë rreth 150,000,000. Nga kjo vlerë €30,000,000 vlerësohet kosto për vitin 2022, nga e cila €28,000,000 pritet të financohet nga Buxheti i Kosovës dhe €2,000,000 nga fondet e donatorëve. Për vitin 2023, kosto vlerësohet të jetë rreth €50,000,000, nga të cilat €47,000,000 pritet të financohen nga Buxheti i Kosovës dhe €3,000,000 nga fondet e donatorëve. Ndërsa kosto e vlerësuar për vitin 2024 është €70,000,000 nga të cilat €68,000,000 pritet të financohen nga Buxheti i Kosovës dhe €2,000,000 nga fondet e donatorëve. Kostoja e kësaj mase ndërlidhet me zbatimin e legjislacionit të ri për shtesat e fëmijëve, skemën e ndihmës sociale dhe legjislacionit tjetër primar dhe sekondar nga fusha e pensioneve, aftësisë së kufizuara, mbrojtjes së fëmijëve dhe shërbimeve sociale dhe familjare.

Ndikimet e pritshme mbi rezultatet sociale dhe reduktimi i varfërisë, barazia gjinore: Mundësia e përdorimit të shërbimeve sociale dhe mbrojtjes sociale për një numër të madh të përfituesve (veçanërisht fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, të moshuarit) si rezultat i përmirësimit të skemës së ndihmës sociale dhe nga ana tjetër ngritja e cilësisë së shërbimeve sociale. Përmirësimet në kuadrin ligjor do të sjellin kushte më të mira të jetesës për kategoritë e ndryshme sociale të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, familjeve të varfër dhe për grupet tjera të komuniteteve pakicë. Aktivitete e planifikuara si pjesë e kësaj mase do të ndikojnë në rritjen e mirëqenies dhe reduktimin e varfërisë.

Ndikimi i pritshëm në mjedis: Mirëqenia sociale është gjithmonë e lidhur pozitivisht me shkallën e preferencës së gjelbër të konsumatorit. Grupe me nivel të ulët socio-ekonomike

krijojnë probleme mjedisore gjatë konsumit të mallrave dhe shërbimeve. Kështu, ulja e varfërisë dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së komuniteteve të caktuara, do të ketë ndikim në përmirësimin e mjedisit ku ata jetojnë.

Rreziqet potenciale:

Rreziku	Probabiliteti	Veprimi lehtësues i planifikuar
1.Rritja e kostos së shportës së ushqimit si rezultat i inflacionit.	I larte	Mbështetja me programe tjera të pakova ushqimore dhe higjienike për kategoritë sociale dhe pensionistët.
2.Rritja e numrit të përfitueseve në SNS si rezultat i humbjeve të vendeve të punës.	I ulët	Përfshirja e përfitueseve të SNS-së në programin e masave aktive tregut punës

5.2.13. Sistemet Shëndetësore

Sektori i shëndetësisë në Kosovë përballlet me sfida të mëdha dhe me financim të pamjaftueshëm. Shpenzimet për kujdesin shëndetësor janë 1,6% e BPV (që nga viti 2019) që është më e ulëta në rajon. Kjo përfaqëson vetëm rreth 40% të kërkesave vjetore për kujdesin shëndetësor publik.. 18% e popullsisë nuk kanë akses në shërbimet shëndetësore pasi jetojnë në varfëri ekstreme dhe mungesa e mjeteve të mjaftueshme të sistemit, ka shkaktuar zhvendosjen e kostos tek xhepi i qytetarit, në radhë të parë për medikamente dhe material shpenzues (barnat jashtë spitalore), si dhe për shërbime shëndetësore, në rastet kur këto shërbime nuk janë ofruar në sektorin publik.. Programi i trajtimit jashtë institucioneve publike shëndetësore ekziston (në vend ose jashtë vendit), por mjetet nuk janë të mjaftueshme për të gjitha nevojat, prandaj një numër i qytetarëve kërkon trajtim jashtë vendit Financimi shëndetësor kryesisht realizohet nga Buxheti i Republike së Kosovës, Të hyrat vetanake në Kujdesin Parësor Shëndetësor përdoren për të financuar pjesërisht realizimin e projekteve kapitale për shëndetësinë komunale, ministria e shëndetësisë ndan buxhet të rregullt për investime kapitale ne KPSH në vlerë deri në 4 milion euro në vit.

Raport i Projektit të planifikimit Master Planit për sektorin e shëndetësisë i vitit 2008 për Qeverinë e Kosovës i Bankës Botërore thekson se 80% të popullatës kanë qasje në ndonjërin prej niveleve të kujdesit parësor brenda 10 minutave dhe 99% të popullatës kanë qasje në nivelin parësor shëndetësor brenda 20 minutave. Qendrat kryesore të mjekësisë familjare janë të qasshme për 94% të popullatës brenda 20 minutave dhe për 98% të popullatës brenda 30 minutave. Kjo na tregon që investimet e infrastrukturës gjatë 10 viteve të fundit nuk kanë qenë të nevojshme në shumicën e rasteve dhe mjete e shpenzuara kanë mundur që të përdoren për diagnostikim dhe shërbime shëndetësore. Kështu në kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH), bazuar ne te dhënat e 2016 të punësuar janë gjithsej 5 358 punëtorë, prej të cilëve mjekë 1087 (20.3%),. Numri i banorëve në një mjek është 1 587 që i afrohet normativit të dhënë për Mjekësi Familjare.

Kujdesi Dytësor Shëndetësor (KDSH), ne vitin 2016 në spitalet e përgjithshme të Kosovës sipas IKSHPK, janë raportuar gjithsej 1952 shtretër. Ku shfrytëzimi i kapacitetit spitalor në nivel Kosove është 55.3%, me variacione prej 118.6% deri në 33.4%. Ndërsa në nivelin e kujdesit Tercior Shëndetësor (KTSH) kemi mungese te mjekëve, ku të punësuar janë gjithsej 3 097 punëtorë, prej tyre 597 mjekë (19.3% nga numri i tërësishëm i të punësuarve), Sistemi bazik i informimit shëndetësor në kujdesin parësor shëndetësor ka filluar dhe është shtrire në 29 komuna dhe në 14 ambulanca specialitike, Paralelisht me këtë zhvillim është arritur edhe shtrirja e harduerit i cili është përfunduar në institucionet e kujdesit parësor shëndetësor, spitalet rajonale dhe QKUK, por për shkak të COVID 19 është ndërprerë shtrirja e saj edhe në

institucionet e tjera të KSHP.. Po ashtu në fillim të vitit 2021 është zhvilluar moduli i imunizimit, vizitave në shtëpi si dhe ka filluar përshtatja e modulit për COVID-19. Ne mënyrë që të adresohen nevojat e grupeve vulnerabile të cilat ballafaqohen me barriera të ndryshme në qasje ndaj shërbimeve, , që njëherë paraqesin pjese kryesisht të madhe të popullatës, planifikojmë zhvillimin e shërbimeve specifike për fëmijë me nevoja të veçanta (autizëm, SindromDown), projekte infrastrukturore për hospice (ofrimi i shërbimeve për pacientët në fazat terminale të jetës), korrigjimi i qasjeve fizike për persona me aftësi të kufizuar në institucionet publike shëndetësore, ndërtimi i kanaleve ‘të ngrohta’/ QKUK si dhe të azilit për tetraplegjikë, adresimi i çështjeve të dhunës gjinore dhe trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe fuqizimin e integritit të shërbimeve shëndetësore në burgje.

Pengesat strukturore: Fonde të pamjaftueshme të financimit në sektorin e shëndetësisë nuk mund të adresohet problemi i qasjes për këto kategori të popullatës, moszbatimi i ligjit për sigurim shëndetësor dhe mos alokimi i drejte i resurseve aktuale do të vazhdojnë me mos përmirësimin e mbrojtjes financiare ku do të thellohen barrierat në qasjen e grupeve vulnerabile, qasje e ulët në shërbime shëndetësore dhe pamundësi e familjeve për të përballuar kostot e këtyre shërbimeve me buxhet familjar.

5.3. Përmbledhje e masave të reformës

A) Reformat që adresojnë tre sfidat kryesore:
Sfida kryesore 1: Nxitja e punësimit të qëndrueshëm nëpërmjet përmirësimit të arsimit cilësor dhe lidhjes me nevojat e tregut të punës
Masa e reformës #1: Përshtatja e Arsimit dhe Aftësisit Profesional me nevojat e tregut të punës
Masa e reformës #2: Ngritja dhe sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë përmes fuqizimit të AKA dhe profilizimit të institucioneve të arsimit të lartë
Masa e reformës #3: Rritja e punësimit, ulja e inaktivitetit, formalizimi, zhvillimi i shkathtësive profesionale, përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve publike të punësimit dhe aftësisit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës me theks të veçante për grupet e cenueshme.
Sfida kryesore 2: Riorganizimi i sektorit shëndetësor me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore adekuate dhe të aksesueshme për të gjithë qytetarët
Masa e reformës #4: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore
Sfida kryesore 3: Krijimi i kushteve për furnizim të qëndrueshëm me energji
Masa e Reformës #5: Zhvillimi i politikave për EE dhe BRE në funksion të tranzicionit të gjelbër
Masa e Reformës #6: Reformimi i tregut të energjisë
B) Reformat që adresojnë sfida të tjera:
1. Menaxhimi i Financave Publike

2. Tranzicioni i gjelbër

Masa e Reformës #7: Zvogëlimi i ndotjes së mjedisit dhe ruajtja e biodiversitetit

3. Transformimi digjital

Masa e reformës #8: Shtrirja e infrastrukturës dhe shërbimeve të TIK-ut për zhvillim socio-ekonomik, shërbime publike të avancuara, si dhe dixhitalizim të sistemit arsimor dhe shëndetësor

4. Mjedisi i biznesit dhe zvogëlimi i ekonomisë informale

Masa e Reformës #9: Përmirësimi i mjedisit biznesor nëpërmjet zvogëlimit të barrës administrative, reformës së inspektimeve

Masa e Reformës #10: Reduktimi i ekonomisë informale

5. Hulumtimi, zhvillimi dhe inovacioni

Masa e Reformës #11: Përmirësimi i mjedisit për hulumtim, inovacion dhe ndërmarrësi

6. Reformat për integrim ekonomik

Masa e reformës #12: Përmirësimi i tregtisë ndërkufitare nëpërmjet lehtësimit të tregtisë

Masa e reformës #13: Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës së cilësisë dhe fuqizimi i rolit të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut

7. Reformat e tregut të Energjisë

8. Reformat e Tregut të transportit

Masa e reformës #14: Zhvillimi dhe Modernizimi i mëtejshëm i Transportit

9. Bujqësia, Industria dhe Shërbimet

Masa e reformës #15: Ndryshimet strukturore në sektorin e bujqësisë

Masa e reformës #16: Rritja e konkurrueshmërisë në industrinë prodhuese

Masa e reformës #17: Ngritja e Konkurrueshmërisë në Sektorin e Turizmit dhe Hotelerisë

Masa e reformës #18: Rritja e konkurrueshmërisë në sektorin e tregtisë së shërbimeve

10. Arsimi dhe shkathtësitë

Masa e reformës #19: Reforma në arsimin parauniversitar dhe rritja e përfshirjës në edukimin e hershëm.

11. Punësimi dhe tregu i punës

12. Mbrojtja dhe përfshirja sociale

Masa e reformës #20: Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe fuqizimi i grupeve të përjashtuara

13. Sistemet shëndetësore

6. KOSTOT DHE FINANCIMI I REFORMAVE STRUKTURE

Reformat e identifikuar përbajnë politika ekzistuese dhe të reja të Qeverisë për të adresuar pengesat kryesore për rritjen ekonomike, konkurrueshmërinë dhe krijimin e vendeve të punës. Kostoja totale e parashikuar e 20 masave prioritare të reformës të paraqitura në Kapitullin 4 të PRE 2022-2024 vlerësohet të jetë **543,442,416 EUR** (përfshirë shpenzimet e drejtpërdrejta të buxhetit, kreditë, fondet IPA dhe të tjerët). Këto reforma pritet të financohen kryesisht përmes buxhetit të Kosovës por edhe përmes financimeve të jashtme nga institucionet financiare, grante dhe asistencë teknike nga partnerët zhvillimorë.

Ndikimi i drejtpërdrejtë i përgjithshëm buxhetor që vjen nga zbatimi i 20 reformave strukturore arrin në **475,990,385 EUR** (nivel qendror dhe lokal) për periudhën 2022- 2024.

Një total prej **37,322,836 EUR** pritet të jetë mbështetje nga donatorët gjatë viteve 2022-2024. Mbështetja është e përqendruar në avancimin e mëtutjeshmëm të reformave të reja. Pjesa tjetër e mbështetjes së donatorëve është përqendruar kryesisht në mbështetjen e nismave të ndryshme legislative në formë të ndihmës teknike. Një shtesë prej **12,610,000 EUR** pritet si mbështetje nga fondet IPA.

Një numër i konsiderueshëm aktiviteteve pritet të financohen përmes kredive. Ndikimi i përgjithshëm i huave për vitet 2022-2024, të cilat tashmë janë aprovuar dhe janë pjesë e Buxhetit të vitit 2022, janë në **17,519,195 EUR**.

Tabela: Implikimet buxhetore të reformave strukturore 2022-2024, sipas burimeve të financimit

a- Kosto totale e 20 masave strukturore					
Viti	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Subvencione dhe Transfere	Shpenzimet Kapitale	Total
2022	3,920,547 €	12,204,309 €	138,426,080 €	27,960,150 €	182,511,086 €
2023	3,033,260 €	11,089,658 €	148,711,295 €	10,964,849 €	173,799,062 €
2024	2,607,176 €	9,901,892 €	167,153,800 €	7,469,400 €	187,132,268 €
Totali	9,560,983 €	33,195,859 €	454,291,175 €	46,394,399 €	543,442,416 €

b- Financimi total i 20 masave strukturore								
Year	Buxheti qendror	Buxheti komunal	Burime të tjera të financimit publik	Fondet IPA	Grante të tjera	Huatë	Për tu përcaktuar	Totali
2022	153,874,726 €	320,000€	0.0 €	7,660,000 €	10,587,460 €	10,068,900 €	0.0 €	182,511,086 €
2023	149,495,421 €	2,220,000 €	0.0 €	2,550,000 €	12,578,346 €	6,955,295 €	0.0 €	173,799,062 €
2024	165,010,238 €	5,070,00 €	0.0 €	2,400,000 €	14,157,030 €	495,000 €	0.0 €	187,132,268 €
Totali	468,380,385 €	7,610,000€	0.0 €	12,610,000 €	37,322,836 €	17,519,195 €	0.0 €	543,442,416 €

7. ÇËSHTJET INSTITUCIONALE DHE PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESIT

Ky kapitull paraqet procesin e përgatitjes dhe miratimin e Programit për Reforma në Ekonomi 2022-2024 si dhe konsultimi hisedarëve të ndryshëm gjatë procesit të përgatitjes së këtij programi si pjesë e dialogut për qeverisje ekonomike ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës.

Sipas Vendimit të Qeverisë, Ministri i Financave është emëruar si Koordinator Nacional për PRE, puna e të cilit mbështetet nga Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit; Departamentit për Politika Ekonomike dhe Publike dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar Financiar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Trasfereve; dhe koordinorët e fushave përkatëse në kuadër të ministrive të linjës: Ministria e Financave, punës dhe Transfereve, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit. Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Drejtësisë, dhe organe dhe të tjera mbështetëse.

Bazuar në udhëzimet e Koordinatorit Nacional, më 23 korrik 2021, ZPS ka ftuar ministrinë dhe institucionet tjera për takimin iniciues, ku është mbajtur takimi i nivelit të lartë për lansimin e Programit të Reformave në Ekonomi 2022-2024.

Sipas kalendarit të punës të prezantuar në takimin lansues, Zyra për Planifikim Strategjik, ka zhvilluar këto aktivitete:

- Përgatitja e propozimeve të para të prioritetëve të reformave strukturore duke u bazuar në kriteret e Udhëzuesit të Komisionit Evropian dhe instruksioneve përkatëse.
- Mbajtja e punëtorive me ML për shqyrtimin e masave të propozuara sa i përket cilësisë së prezantimit të objektivave, aktiviteteve, treguesve, kostos indikative dhe ndikimit të masës.
- Më 25-29 tetor 2021, është finalizuar drafti i parë i kapitullit të reformave strukturore i cili është dërguar KE-së për vlerësim dhe komente.
- Organizimi i punëtorisë me CEF dhe me ML për kostimin e masave të për PRE 2022-2024, mbajtur më 19-20 tetor 2021.
- Më 16-17 nëntor 2021 janë mbajtur takime virtuale me delegacionin e Komisionit Evropian dhe Ministrinë e Linjës mbi vlerësimin e draftit të parë të Reformave Strukturore të Programit të Reformave në Ekonomi 2022-2024. Në kuadër të këtij misioni u mbajtën edhe takime tematike për sfida të caktuara që janë identifikuar nga Vlerësimi i Komisionit Evropian për PRE 2022-2024.
- Si pjesë e procesit të konsultimeve publike për diskutimin e draftit të PRE 2022-2024, drafti është dërguar në konsultim publik në platformën qeveritare nga data 22.12.2021 deri më 17.01.2022

(<http://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41299>).

Adresimi i komenteve është paraqitur në një përmbledhje e rezultateve të konsultimeve publike në Aneksin II të Programit.

SHTOJCA 1: TABELAT E PROGRAMIT PËR REFORMA NË EKONOMI 2022-24

Tabela 1a: Parashikimet makroekonomike

% , përveç nëse është theksuar ndryshe		2020	2020	2021	2022	2023	2024
		Niveli (mld)	Shkalla e ndryshimit				
1. BPV reale me çmime konstante	B1*g	6.680	-5.3	9.7	7.8	7.1	6.8
2. BPV Nominale	B1*g	6.772	-4.0	12.2	10.6	9.3	8.8
Komponentët e BPV-së							
3. Konsumi privat	P3	5.791	2.5	6.3	1.5	6.8	5.7
4. Konsumi publik	P3	0.899	2.1	0.6	4.5	-0.1	0.4
5. Formimi I kapitalit bruto	P51	2.023	-7.6	12.2	21.3	11.1	10.9
6. Ndryshimi në inventar dhe fitimi neto (% e BPV-së)	P52+P53	0.241	3.6	3.3	3.8	3.9	4.0
7. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	P6	1.467	-29.1	72.0	6.6	7.6	7.5
8. Importi i mallrave dhe shërbimeve	P7	3.742	-6.1	27.6	5.0	7.4	6.5
Kontributi në rritjen e BPV-së							
9. Kërkesa finale e brendshme		8.7	-0.1	9.0	8.4	9.2	8.4
10. Ndryshimi në inventar dhe fitimi neto (% e BPV-së)	P52+P53	0.2	-0.1	-0.1	0.4	0.0	0.0
11. Bilanci i jashtëm në mallra dhe shërbime	B11	-2.3	-5.1	0.8	-0.9	-2.1	-1.6

Tabela 1b: Çmimet dhe parashikimet e çmimeve

Ndryshimi në përqindje, mesatarja vjetore	ESA Code	2020	2021	2022	2023	2024
1. Deflatori i BPV-së		1.4	2.4	2.5	2.1	1.9
2. Deflatori i konsumit privat		-0.7	3.1	2.7	2.2	2.0
3. IHÇK		0.2	3.4	2.5	2.2	2.0
4. Ndryshimi në IÇK		0.2	3.4	2.5	2.2	2.0
5. Deflatori i konsumit publik		4.7	2.3	3.9	1.1	1.1
6. Deflatori i investimeve		-0.7	4.8	2.6	1.4	1.3
7. Deflatori i çmimeve të eksportit (mallrave dhe shërbimeve)		0.2	4.6	3.1	2.5	2.3
8. Deflatori i çmimeve të importit (mallrave dhe shërbimeve)		-2.4	6.4	4.0	2.4	2.4

Tabela 1c: Zhvillimet në tregun e punës

	ESA	2020	2020	2021	2022	2023	2024
	Code	Niveli	Niveli/Shkalla e ndryshimit				
1. Popullësia (në mijëra) /1			1,795.7	1,798.2	:	:	:
2. Popullësia (rritja në %)			-0.04	0.1	-100.0	:	:
3. Popullsia në moshën e punës (në mijëra persona)			1,222	1,226	:	:	:
4. Norma e pjesëmarrjes			38.3	39.5	:	:	:
5. Punësimi, në mijëra persona			347	359	:	:	:
6. Punësimi, numri i orëve të punuara /2			36.2	38.3	:	:	:
7. Punësimi (norma e rritjes në %)			-4.4	3.5	:	:	:
8. Punësimi në sektorin publik (në mijëra persona)			86.0	95.5	:	:	:
9. Punësimi në sektorin publik (rritja në %)			-2.0	11.0	:	:	:
10. Norma e papunësisë			25.9	25.8	:	:	:
11. Produktiviteti (në persona)		19.2	-0.9	6.0	:	:	:
12. Produktiviteti, numri i orëve të punuara			5.1	3.8	#DIV/0!	:	:
13. Kompenzimi i punëtorëve	D1	2.1	-2.0	-74.0	:	:	:

Tabela 1d: Bilancet sektoriale

Si përqindje e BPV-së	ESA code	2020	2021	2022	2023	2024
1. Kreditimi/ huazimi neto përballë pjesës tjetër të botës	B.9	-6.8	-4.8	-5.6	-6.6	-7.3
<i>nga te cilat:</i>						
<i>Bilanci i mallrave dhe shërbimeve</i>		-32.2	-30.4	-29.8	-29.9	-29.7
<i>Bilanci i të hyrave dhe transfereve primare</i>		25.1	25.5	24.3	23.4	22.5
<i>Llogaria kapitale</i>		0.3	0.1	-0.1	-0.1	-0.1
2. Kreditimi/ huazimi neto i sektorit privat	B.9/ EDP B.9	0.5	-3.6	-0.9	-2.8	-4.2
3. Kreditimi/ huazimi i Qeverisë së përgjithshme		-7.6	-1.3	-4.6	-3.7	-3.0
4. Gabime statistikore		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0

Table 1e: BPV, investimet dhe bruto vlera e shtuar

		2020	2021	2022	2023	2024
BPV dhe investimet						
Vlera e BPV-së me çmime aktuale	B1g	6.8	7.6	8.4	9.2	10.0
Investimet (si % e BPV-së)		29.7	31.1	35.0	36.1	37.2
Rritja e vlerës së shtuar, përqindja e ndryshimit në çmime konstante						
1. Bujqësia		-5.8	-0.3	11.1	4.2	5.9
2. Industria (përfshijë ndërtimin)		2.5	3.5	10.6	8.0	7.0
3. Ndërtimtaria		-9.0	5.5	3.1	3.7	2.6
	3) DE/ME: Më 20 korrik 2020, Ministria ka krijuar një grup pune nga 18 institucione të ndryshme për të hartuar koncept dokumentin për burimet e ripërtëritshme të energjisë. Ky dokument do të rekomandojë opsionin më të mirë për zbatimin e skemës së re mbështetëse konkurruese si dhe do të analizojë mangësitë e legjislacionit për implementimin efektiv të politikave mbështetëse për BRE-të. Donatorët siç janë USAID dhe BB janë angazhuar përgjatë procesit të hartimit dhe komentimit të dokumentit. Tashmë Koncept Dokumenti për BRE ka kaluar fazën e diskutimit paraprak dhe atij publik dhe është duke u përgatitur raporti pasues për procedim të mëtejme.	

	<p>4) DE/ME: Nuk ka pasur zhvillime si rezultat i zhvillimeve të legjislacionit primar dhe vendosjes së targeteve për vitin 2021-2030.</p> <p>ZRRE: BERZh është angazhuar në këtë proces ndërsa përfitues janë ME dhe ZRRE. Ende nuk ka asnjë rezultat lidhur me këtë.</p>						
	<p>5) ZRRE: Zbatimi në tërësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) HC Brodi 1 me kapacitet instalues prej 2.48 MW, b) HC Restelica 3 me kapacitet prej 2.35 MW, c) HC Albaniki 4 me kapacitet prej 1.119 MW, d) HC VICA me kapacitet prej 4.6 MW, e) HC Dragash me kapacitet prej 3.4 MW, f) HC Shtërpce me kapacitet 4.9 MW, dhe g) HC Sharri 6.45 MW. <p style="text-align: center;">Totali 25.3 MW</p>						
	<p>6) ZRRE: Zbatimi në tërësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Wind Park SELAC 2 me kapacitet 34.47 MW, b) Wind Park SELAC 2 me kapacitet prej 34.47 MW, dhe c) Wind Park SELAC 3 me kapacitet prej 34.47 MW. <p style="text-align: center;">Totali 103.41 MW</p>						
	<p>7) DE/ME: Gaz Master Plani dhe studimi i përbashkët i fizibilitetit për interkoneksionin e gazit natyror Maqedoni Veriore - Kosovë është duke u realizuar sipas kërkesave që adresohen nga konsulenca IPF9, e aprovuar nga WBIF/BERZH. Aktiviteti vazhdon të realizohet konform Termave të Referencës dhe Planit Dinamik të prezantuar nga konsulenca si dhe të aprovuar nga grupet e interesit. Për më shumë, është realizuar një takim konsultativ mes Ministrisë së Ekonomisë (Kabinetit) dhe disa përfaqësuesve të WBIF/asistencës teknike.</p>						
	<p>8) KOSTT: Në muajin maj të vitit 2021, ALPEX (bursa e përbashkët e energjisë elektrike) ka themeluar degën e saj në Republikën e Kosovës dhe është emëruar drejtuesi i degës. Me 21 tetor 2021, në Tiranë u nënshkrua Marrëveshja mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Kosovës dhe Shqipërisë në mes të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRRE) dhe Entit Rregullator të Energjisë (ERE) bashkërisht me Operatorët e Sistemit të Transmetimit të të dyja vendeve KOSTT dhe OST. Përmes marrëveshjes palët nënshkruese e njohin Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike ALPEX si bursën e vetme të energjisë elektrike për tregtim një ditë para (day ahead) dhe gjatë ditës (intra-day) për zonat tregtare të të dyja vendeve. Kjo marrëveshje njëherit është parakusht i marrëveshjeve pasuese që mundësojnë operacionalizimin e bursës së përbashkët të energjisë elektrike - ALPEX. Nënshkrimi i marrëveshjes u realizua në kuadër të takimit të grupit punues ligjor për definimin e aktiviteteve dhe marrëveshjeve që duhet të zbatohen në mënyrë që bursa e përbashkët e energjisë ALPEX të bëhet funksionale në Q4 2022.</p>						
<p>Masa e reformës #3: Ndryshimet strukturore në sektorin e bujqësisë</p>							
<p>Aktivitetet e planifikuara per 2021</p>	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 80%;"></th> <th style="width: 20%; text-align: center; background-color: #00aaff; color: white;">Faza e zbatimit të reformës (1-5)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1) Ofrimi i sigurimeve në bujqësi nëpërmjet zbatimit të Implementimi i Programit për Pagesa Direkte 2020-2021; (MBPZHR)</td> <td style="text-align: center;">4</td> </tr> <tr> <td>2) Hartimi dhe miratimi i Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027; (MBPZHR)</td> <td style="text-align: center;">4</td> </tr> </tbody> </table>		Faza e zbatimit të reformës (1-5)	1) Ofrimi i sigurimeve në bujqësi nëpërmjet zbatimit të Implementimi i Programit për Pagesa Direkte 2020-2021; (MBPZHR)	4	2) Hartimi dhe miratimi i Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027; (MBPZHR)	4
	Faza e zbatimit të reformës (1-5)						
1) Ofrimi i sigurimeve në bujqësi nëpërmjet zbatimit të Implementimi i Programit për Pagesa Direkte 2020-2021; (MBPZHR)	4						
2) Hartimi dhe miratimi i Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2021-2027; (MBPZHR)	4						

	3) Hartimi i bazës ligjore për Zhvillimin e Fondit për Sigurime Bujqësore; (MBPZHR)	4
	4) Miratimi i Master Planit për ujitjen e tokave bujqësore; (MBPZHR)	5
	5) Hartimi i Koncept Dokumentit për Tokën Bujqësore; (MBPZHR)	4
	6) Hartimi i Koncept Dokumentit për rregullimin e Tokës Bujqësore; (MBPZHR)	2
	7) Hartimi i Koncept Dokumentit për Organizimin e Tregut të Përbashkët –CMO; (MBPZHR)	3
	8) Hartimi i planit kombëtar për Inventarizimin e Tokave Bujqësore të Republikës së Kosovës; (MBPZHR)	1
	9) Ngritja dhe konsolidimi i kapaciteteve të Shërbimeve Këshillimore; (MBPZHR)	4
	10) Zhvillimi i sistemit për menaxhimin e granteve dhe subvencioneve (Zhvillimi i softuerit) (MBPZHR, AZHB)	3
	11) Subvencionimi i kredive bujqësore në periudhë prej 1 viti si masë për rimëkëmbje ekonomike nga Covid-19 (MF).	1
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërisht ose mos-zbatim	<p>1) MBPZHR përmes Programit të Pagesave Direkte ka ofruar mbështetje direkte për primin e sigurimit bujqësor indeks për kulturën bujqësore të mjedrës, mollës, kumbullës, rrushit, dredhëzës, specit dhe arrës si dhe primit të sigurimit bujqësor tradicional të kultura mollës – pemishte intensive, specit – kultivimi intensive dhe rrushit të verës.</p> <p>2) Draft Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-28 është në proces të Konsultimit Publik deri me datën 07.12.2021, ndërsa sa i përket Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural është hartuar Drafti i Parë për të gjitha masat.</p> <p>3) Pjesa dërmuese e projektligjeve për zvogëlimin e barrës administrative janë aprovuar në Qeveri me datë 24.11.2021. Pas kësaj do të plotësohen dhe ndryshohen U/A që derivojnë nga këto ligje.</p> <p>4) Aktiviteti i përfunduar Master Plani për ujitjen e tokave bujqësore, është miratuar.</p> <p>5) Është përfunduar Drafti final i Koncept Dokumentit për Tokën Bujqësore, ka kaluar fazën e konsultimit paraprak dhe diskutimit publik, janë shqyrtuar komentet dhe i njëjti pritet të procedohet për opinioin të vlerësimit financiar në MFPT.</p> <p>6) Është hartuar Drafti i parë i Koncept Dokumentit për Rregullimin e Tokës, i njëjti bazuar edhe në edhe afatet kohore të procesit të konsultimeve paraprake dhe diskutimeve publike do të shtyhet për miratim deri në K1 të vitit 2022.</p> <p>7) Është hartuar Drafti i parë i Koncept Dokumentit për Organizimin e Tregut të Përbashkët (CMO), i njëjti bazuar edhe në edhe afatet kohore të procesit të konsultimeve paraprake dhe diskutimeve publike do të shtyhet për miratim deri në K1 të vitit 2022.</p> <p>8) Aktiviteti, i cili sipas Planit Strategjik dhe Operacional parashihet për tu përfunduar në vitin 2022.</p> <p>9) Projekt Ligji për Shërbimet Këshillimore ka kaluar leximin e parë në Kuvend; Ka vazhduar pjesa e trajnimeve në bashkëpunim me Qendrat Informativ Këshilluese Komunale.</p>	

	10) Zhvillimi i sistemit për menaxhimin e granteve dhe subvencioneve, bazuar në PSO është i paraparë të përfundojë në vitin 2022, ndërsa ka përfunduar vlerësimi i ofertave nga komisioni dhe është në proces të publikimit.	
	11) Sa i përket këtij aktiviteti nuk ka pasur zhvillime. Mirëpo, MBPZHR me vendim të ministrit z. Mustafa i ka dyfishuar pagesat për subvencione për vitin 2020, për ti ndihmuar fermerët.	
Masa e reformës #4: Rritja e konkurrueshmërisë në industrinë prodhuese		Faza e zbatimit të reformës (1-5)
Aktivitetet e planifikuara per 2021	1) Hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Zhvillimin Industrial (Politika Industriale);	2
	2) Përfundimi i studimit të zingjirit të vlerës për sektorin e tekstitit (MTI);	5
	3) Përkrahja profesionale për së paku 40 biznese përmes programit të dixhitalizimit/transformimit dixhital të NVM-ve (KIESA);	5
	4) Përkrahja financiare e 25 NVM-ve prodhuese dhe shërbyese, me pajisje dhe makineri për automatizim të proceseve, si dhe teknologji të re (KIESA);	5
	5) Subvencionimi i 30 NVM-ve në certifikimin e produkteve dhe në ofrimin e këshillimeve me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë, eksportit, dhe produktivitetit (KIESA);	4
	6) Ngritja e potencialit për eksport nëpërmjet përkrahjes financiare të 70 kompanive prodhuese me potencial eksportues nga Kosova në 10 Panairë ndërkombëtare, me qëllim të zgjerimit të tregut dhe krijimit të lidhjeve me kompanitë ndërkombëtare (KIESA);	4*
	7) Ndërtimi i infrastrukturës fizike të tri zonave ekonomike, respektivisht të parqeve të biznesit (Suhareke, Viti dhe Lipjan) (KIESA).	4
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërishëm ose mos-zbatim	1) Strategjia për Zhvillimin Industrial është në kuadër të Planit të Dokumenteve Strategjike (PVDS) për periudhën 2020-2022 dhe është planifikuar me u finalizuar ne Qershor, 2022. Është kryer raporti statistikor dhe Raporti analitik i zhvillimit të industrisë përpunuese, gjegjësisht Sektori C (10 – 33), bazuar në NACE REV 2. Grupi punues është themeluar me 16.09.2021 dhe është përpiluar draft plani dinamik i realizimit të strategjisë. Janë identifikuar treguesit matës që do të jenë pjesë e strategjisë, janë konsultuar dokumentet ekzistuese që ndërlidhen me industrinë përpunuese, është përzgjedh përmes shpalljes publike, eksperti ndërkombëtar që do të asiston grupin punues në hartimin e strategjisë. Per shkak te Pandemisë COVID -19, hartimi i Strategjisë është shtyrë për 2022.	
	2) Studimi për Zingjirin e Vlerës është finalizuar. Është mbajtur tryeza me përfaqësuesit e sektorit privat dhe Shoqatës së veshëmbatjes-KAMA. Studimi paraqet pengesat e sektorit privat nga furnizimi deri te plasimi në treg të produktit final, dhe rekomandimet për intervenime nga ana e institucioneve dhe sektorit privat. Studimi është publikuar në Web faqen e MINT: https://mint.rks-gov.net/page.aspx?id=1,79 Buxheti: 4,740.00 Euro.	
	3) Gjate vitit 2021 janë zhvilluar dy fazë për dixhitalizimin e NVM dhe kane përfituar gjithsej 50 biznese, te cilët kanë implementuar apo janë në implementim të projekteve. Buxheti 120,000 euro.	

	4) Është shpallur thirrja, kanë aplikuar mbi 140 biznese dhe aktualisht është shpallur lista preliminare e përfitueseve me 32 biznese. Buxheti 500,000 euro	
	5) Sa i përket skemës së Granteve të përputhshme gjatë vitit 2020 dhe 2021 janë nënshkruar 28 , të realizuara kanë qene 25 biznese. Vlera totale e realizuar është: 546194.87 euro. Gjatë vitit 2021 kemi filluar me thirrjen e re për aplikim të granteve-(kanë aplikuar mbi 500 biznese) procesi është në fazën e vlerësimit të aplikacioneve të pranuar.	
	6) Shkaku i pandemisë dhe mos mbajtjes së aktiviteteve të parapara promovuese ndërkombëtare deri në muajin shtator 2021 nuk janë organizuar 8 aktivitete të parapara. Nga muaji tetor 2021 deri në muajin dhjetor 2021 kemi marr pjesë në aktivitete promovuese në 3 panire ndërkombëtare ku janë paraqitur 25 kompani prodhuese me potencial eksportues. Buxheti 273,289 euro.	
	7) Kanë vazhduar punimet në ndërtimin e këtyre zonave, deri me tani kanë arritur të përfundojnë projektet në Suharekë dhe Lipjan, derisa në Viti është në fazën përfundimtare. Buxheti 600,000 euro.	
Masa e reformës #5: Ngritja e Konkureshmërisë në Sektorin e Turizmit dhe Hotelisë		Faza e zbatimit të reformës (1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2021	1) Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së sektorit të turizmit dhe planit të veprimit (MTI);	3
	2) Miratimi i Projektligjit për Turizmin (MTI);	
	3) Miratimi i UA për Udhërrëfyesit Turistik, UA për regjistrin me të dhënat e Agjencive Turistike, UA ekspertët të pavarur dhe klasifikimin e strukturave akomoduese;	0
	4) Përkrahja financiare e bizneseve në zhvillimin e turizmit rural edhe agro-turizëm (MBPZHR);	0
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërisht ose mos-zbatim	1)Grupi punues për hartimin e strategjisë në sektorin e turizmit gjatë vitit 2021 ka hartuar një draft të strategjisë si dhe draftin e planit të veprimit në bashkëpunim me ministrinë relevante dhe komunat e Kosovës. Shpenzimet e bëra për këtë aktivitet kryesisht janë mbuluar nga donatorët 5,156.00€ kurse nga buxheti i Departamentit të Turizmit 1,000.00€	
	2)Qeveria e Kosovës në mbledhjen e 45 të datës 24.11.2021 ka marrë vendim për aprovimin e Ligjit të Turizmit. Projektligji i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim. Shpenzimet e bëra për këtë aktivitet janë në kuadër të shpenzimeve të përgjithshme administrative dhe kapin shumën prej afërsisht 1,200.00€	
	3)Udhëzimet Administrative do të hartohen pasi të miratohet Ligji i Turizmit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nuk ka kosto sepse nuk janë hartuar udhëzimet pa u miratuar ligji.	
	4)Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë vitit 2021 nuk ka realizuar mbështetjen financiare për zhvillimin e turizmit rural.	
Masa e reformës #6: Rritja e konkurrueshmërisë në sektorin e tregtisë në shërbime		Faza e zbatimit të reformës (1-5)

Aktivitetet e planifikuara per 2021	1) Diagnostifikimi i sektorëve potencial të tregtisë së shërbimeve dhe vlerësimi i përparësisë së konkurrueshmërisë në tregtinë e shërbimeve (MTI);	5
	2) Njohja e ndërsjellë në mes të vendeve anëtare të CEFTAs për profesionet e përzgjedhura (mjekët e përgjithshëm, dentistët, arkitektet dhe inxhinieret);	0
	3) Ratifikimi i Protokollit Shtesë të CEFTA, AP6 për tregti në shërbime (MTI);	2
	4) Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Tregtinë Elektronike (MTI);	3
	5) Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe të infrastrukturës së IT-së në institucionet e nivelit qendror për themelimin e PVK-së.	4
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërishtë ose mos-zbatim	1) Janë përfunduar analizat “Tregtia e Shërbimeve të Kosovës me Vendet Anëtare të BE-së dhe CEFTA-së” dhe “Vlerësimi i Shërbimeve të Auditimit dhe Kontabilitetit në Kosovë”, “Vlerësimi i Shërbimeve Logjistike në Kosovë”. Ka filluar analiza për sektorin e shërbimeve ligjore.	
	2) Procesi i negociatave për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale në mes të vendeve anëtare të CEFTAs është pezulluar, deri në një vendim të ardhshëm nga BE në bashkëpunim me RCC dhe CEFTA.	
	3) Protokollat mbetet për t'u miratuar nga niveli politik; megjithatë, vonesat e deritanishme për mos ratifikimin e protokollit kanë të bëjnë me emërtimin ose jo trajtimin e barabartë të pozitës së Kosovës në kuadër të marrëveshjes CEFTA-s, nga e cila rrjedh ky protokoll dhe është nënshkruar nga UNMIK-u në emër të Kosovës.	
	4) Është formuar Grupi Punues për hartimin e draftit fillestar të Koncept Dokumentit për Tregtinë Elektronike me datë 30 qershor me nr. protokollit 02/3235. Ky grup punues është takuar katër herë ku është diskutuar rreth nevojës për hartimin e koncept dokumentit. Me mbështetje të USAID janë mbajtur takimet në mes të ekspertëve të USAID, DT me përfaqësuesit e institucioneve publike relevante dhe sektorit privat si dhe është përfunduar raporti nga këto takime. Drafti i Konceptit është hartuar mirëpo nuk është miratuar ende për shkak të nevojës për definimin e kompetencave/aktiviteteve me Ministrinë e Ekonomisë. Hartimi i Ligjit për Tregtinë Elektronike varet nga rekomandimi që del nga Koncept Dokumentit për Tregtinë Elektronike.	
	5) Me datë 06 Tetor 2020 është lasuar platforma Pika e Kontaktit për Shërbime (https://cps.rks-gov.net/). Kjo platformë do të përdoret edhe si pikë kontakti për CEFTA. Kjo faqe është populluar me informata. Është në proces të finalizimit të prototipit të Shërbimit të PVK-së "Aplikimi për auditor" në kuadër të platformës e-Kosova. Si dhe është bërë analiza për përfshirjen edhe te sektorit te gjeodezisë ne kuadër te PVK-së.	
Masa e reformës #7: Përmirësimi i mjedisit biznesor nëpërmjet zvogëlimit të barrës administrative dhe reformës së inspektiveve		Faza e zbatimit të reformës (1-5)
Aktivitetet e planifikuara per 2021	1) Përditësimi i Regjistrimit qendror të lejeve dhe licencave në mënyrë që sistemi të jetë i përdorshëm për zyrtarët që kanë qasje në të dhëna dhe trajnimi i 52 zyrtarëve nga ZL dhe institucioneve që lëshojnë leje dhe licenca mbi përdorimin e sistemit të përditësuar (ZKM);	3
	2) Ndryshimi dhe plotësimi i akteve ligjore dhe nënligjore për qëllim të thjeshtëzimit, bashkimit dhe zvogëlimit të lejeve dhe licencave (ZKM);	3
	3) Shfuqizimi i akteve nënligjore që nuk kanë bazë ligjore (gijotina e akteve nënligjore) (ZKM dhe ministritë);	3

	4) Kalkulimi i kursimeve të bizneseve si rezultat i thjeshtëzimit, bashkimit dhe zvogëlimit të lejeve dhe licencave (ZKM);	1
	5) Përditësimi dhe miratimi i manualit të modelit të kostimit standard me udhëzime të reja për matjen e barrës administrative për qytetarët dhe administratën (ZKM);	4
	6) Zhvillimi i kapaciteteve për Modelin e Kostimit Standard (MKS), Trajnimi i parë i Trajnerëve për MKS për stafin e ZKM dhe koordinatorët e ZBA nëpër ministri (një trajnim i organizuar me 20 pjesëmarrës deri në fund të vitit 2021) (ZKM);	1
	7) Miratimi i ligjit për inspektimet i cili do të vendos themelet e një qasje të inspektimit të bazuar në rrezik (MTI);	3
	8) Amandamenti i legjislacionit horizontal duke lejuar dhe rregulluar reformën e inspektimeve (MTI, ZKM);	1
	9) Themelimi i zyrës qendrore të inspektimeve që koordinon inspektimet dhe përshtatja e strukturës relevante organizative (ZKM).	1
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërishtë ose mos-zbatim	<p>1) Regjistri Qendror i Lejeve dhe Licencave është përditësuar dhe avancuar. Aktualisht, ASHI, në bashkëpunim me Divizionin e IT-së në ZKM dhe operatorin ekonomik janë duke bërë hostimin e regjistrimit në ASHI. Posa të bëhet publikimi i webfaqes nga ASHI dhe institucionet të kenë qasje në regjistrim, do të bëhet e mundur edhe mbajtja e trajnimeve për zyrtarët që do t'a përdorin regjistrin.</p> <p>Për përditësimin dhe avancimin e Regjistrimit Qendror të Lejeve dhe Licencave, Zyra e Kryeministrit ka angazhuar operatorin ekonomik Botek. Kontrata e lidhur me OE Botek ka kohëzgjatje prej pesë (5) vitesh dhe vlerë prej 46,020.00 EUR.</p>	
	<p>2) Gjatë vitit 2021, me përkrahjen e IFC – Banka Botërore, janë angazhuar ekspertët për kryerjen e analizës së legjislacionit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (pjesa e infrastrukturës). Analizat janë kryer dhe aktualisht është duke u bërë finalizimi dhe përkthimi i tyre, dhe priten të miratohen në Qeveri deri në fund të muajit dhjetor 2021.</p> <p>Ky aktivitet është financuar nga IFC- Banka Botërore, dhe rrjedhimisht Zyra Ligjore në ZKM nuk ka informacion për koston e këtij aktiviteti.</p>	
	<p>3) Me përkrahjen e GIZ, është kryer analiza e bazës ligjore për 1762 akte nënligjore, nga të cilat 292 akte nënligjore do të shfuqizohen me vendim nga ana e Qeverisë. Në këtë drejtim, analiza është finalizuar, Zyra Ligjore ka përgatitur propozim-vendimin për shfuqizim dhe aktualisht të njëjtat janë duke u përkthyer. Pas përkthimit do të procedohet për miratim në mbledhjen e Qeverisë, dhe pritet miratimi i vendimit gjatë muajit dhjetor 2021.</p> <p>Ky aktivitet është financuar nga GIZ, dhe rrjedhimisht Zyra Ligjore në ZKM nuk ka informacion për koston e këtij aktiviteti.</p>	
	4) Kalkulimi i kursimeve të bizneseve si rezultat i thjeshtimit, bashkimit apo eliminimit të lejeve dhe licencave do të bëhet në tre-mujorin e parë të vitit 2022.	
	5) Në kuadër të realizimit të objektivit për Rregullim më të mirë përmes vlerësimit të ndikimit rregullativ të iniciativave të reja, ZKM me mbështetjen e GIZ, e ka filluar përditësimin e manualëve për modelin e kostimit standard, koncept dokumente, memorandume shpjeguese, si dhe ka hartuar një test filtrues të politikave të forta (ligjeve) dhe atyre të buta (strategji, koncept dokument, program), “Vlerësimi i zbatimit të koncept dokumenteve, memorandumeve shpjeguese dhe modelit të kostimit standard”. Sidoqoftë, ka	

	mbetur ende punë për këtë, pasiqë tashmë janë duke u përgatitur përditësimi i shembujve në manualin për modelit të kostimit standard dhe koncept dokumente, në mënyrë që të gjitha institucionet të përdorin modelin e njëjtë të cilat pritet të finalizohen në fund të këtij viti. Ka filluar faza përgatitore e përgatitjes dhe pritet të finalizohet në periudhën e parë të vitit 2022	
	6) Për shkak se fillimisht duhet të bëhet përditësimi dhe miratimi i manualit të modelit të kostimit standard me udhëzime të reja për matjen e barrës administrative për qytetarët dhe administratën, dhe akoma nuk janë funksionale strukturat përgjegjëse (koordinatorët e ZBA nëpër ministri), ky aktivitet do të zhvillohet në vitin 2022.	
	7) Ligji për inspektimet është miratuar në Qeveri me datën 22.09.2021. Është përcjellë në Kuvend dhe së shpejti pritet të dalë në lexim të parë. Përveq shpenzimeve administrative gjatë vitit 2021 nuk ka pas shpenzime tjera.	
	8) Amandamenti i legjislacionit horizontal parashihet pasi që të miratohet Ligji për Inspektimet.	
	9) Parashihet pasi të miratohet Ligji për Inspektimet.	
Masa e reformës #8: Themelimi dhe funksionalizimi i Gjykatës Komerciale		Faza e zbatimit të reformës (1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2021	1) Hartimi dhe miratimi i Projektligjit për Gjykatën Komerciale (MD);	5
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërisht ose mos-zbatim	1) Projektligji për Gjykatën Komerciale është miratuar nga ana e Qeverisë dhe e Kuvendit në lexim të parë.	
Masa e reformës #9: Ulja e ekonomisë joformale në sektorin e pronave të paluajtshme		Faza e zbatimit të reformës (1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2021	1) Ndryshimi i Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës; (ZKM)	3
	2) Miratimi i projektligjeve për Kadastrën (MMPH), Tokën Ndërtimore (MD) dhe Pronën Publike (MD);	3
	3) Hartimi i rregulloreve për detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretariatit të AKKVP-së dhe Komisionit vendosës për adresimin e kërkesave për formalizim (AKKVP);	1
	4) Funksionalizimi i mandatit të ri të AKKVP-së (ZKM, AKKVP);	1
	5) Trajnimi i komisionerëve të AKKVP-së dhe stafit mbështetës të Sekretariatit të AKKVP-së (AKKVP).	4
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse	1) Projektligji i Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës është miratuar në mbledhjen 36-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr. 02/36, të datës 22.09.2021. Projektligji tani është në Kuvend.	

kemi zbatim të pjesërishëm ose mos-zbatim	<p>2.1) Projektligji për Kadastër është në fazën e përgatitjes. Gjatë kësaj jave do të dërgohet në konsultim paraprak dhe publik.</p> <p>Projektligji për Tokën Ndërtimore është miratuar nga ana e Qeverisë, gjithashtu edhe Projektligji për Pronën Publike është finalizuar dhe pritet të miratohet deri në fund të këtij vit. Nuk ka pas shpenzime shtesë përveç kostos administrative për hartimin e Projektligjeve.</p> <p>3) Parashihet pas miratimit të Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës në Kuvend.</p> <p>4) Parashihet pas miratimit të Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës në Kuvend.</p> <p>5) Gjatë vitit 2021, 120 nënpunës kanë mbajtur trajnime në IKAP. Një trajnim në fushën e IT është mbajtur me një kosto prej 180 EUR.</p>
Masa e reformës #10: Zvogëlimi i Ekonomisë joformale	
Aktivitetet e planifikuara per 2021	Faza e zbatimit të reformës (1-5)
1) Ndryshimi i kornizës së nevojshme ligjore, miratimi dhe nxjerrja e akteve nënligjore për uljen e transaksionit aktual prej 500 në 300 EUR për biznes (Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat);	2
2) Funkcionalizimi i sistemit të ri të TI-së për menaxhimin e rrezikut të përmbushjes i cili do avancojë mundësitë ekzistuese në identifikimin, analizimin trajtimin dhe monitorimin e rreziqeve të përmbushjes; 87	3
3) Zbatimi i qasjes së re të rrezikut nga ATK bazuar në hartimin dhe zbatimin e projekteve të përmbushjes, për të synuar trajtimin e sektorëve me shkallë të lart të rrezikshmërisë, si: sektori i ndërtimit, akomodimit, punësimit joformal, tregtisë përkatësisht kontrollit të stoqeve;	4
4) Intensifikimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve në mes ATK dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) me qëllim identifikimin dhe regjistrimin e punëtorëve të pa regjistruar. Shkëmbimin e informatave mes ATK dhe IP rreth gjobave të shqiptuara për punëtorët e padekluar, trajnimin e një grupi të inspektorëve për adresimin e punës së padekluar, përgatitja dhe zbatimi i Manualit për inspektimet e përbashkëta në luftimin e punës së padekluar;	3
5) Rritja e numrit të inspektimeve dhe stafit të angazhuar në operacionet e përbashkëta mes ATK-së dhe DK-së, nën udhëheqjen e grupit të përbashkët të krijuar nga ana e të dyja Institucioneve me qëllim trajtimin e bizneseve të cilat karakterizohen me shkallë të lartë të rrezikshmërisë në shmangien e detyrimeve tatimore dhe atyre doganore;	4
6) Zhvillimi i sistemit nga ATK për identifikimin e tatimpaguesve për të cilët mbahet Tatimi i mbajtur në burim në qira, interes, të drejta pronësore, persona jo-rezident dhe kategori të veçanta;	5
7) Monitorimi dhe ndërmarrja eventuale e masave nga ATK, tek bizneset të cilat janë përkrahur nga ana e Qeverisë përmes pakove fiskale, me qëllim të sigurimit që të gjitha deklaratimet e këtyre bizneseve janë në harmoni me zbatimin e kritereve të këtyre pakove fiskale, dhe zbatimit të drejtë të legjislacionit tatimor, në veçanti me fokus në listën e punëtorëve dhe kontratat e qirasë;	4

	8) Hartimi dhe miratimi i Ligjit të Ri të Punës nga Kuvendi (Futja e pagesës së detyrueshme elektronike për të gjitha pagat dhe mëditjet e punonjësve në të gjithë sektorët);	3
	9) Ristrukturimi i inspektoratit të punës dhe punësimi i 20 inspektoreve shtesë, si dhe realizimi i aktiviteteve vlerësuese dhe monitoruese që kanë për qëllim rritjen e performancës dhe integritetin e inspektorëve;	3
	10) Përpilimi i të dhënave për ekonominë joformale dhe integrimi/publikimi i tyre në Bruto Produktin Vendor (BPV) nga ana e ASK-së;	5
	11) Publikimi i Analizës “Vlerësimi i praktikave më të mira, të realizueshme për Kosovën në zvogëlimin e punësimit joformal”	4
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërishtë ose mos-zbatim	<p>1) Është bërë një vlerësim lidhur me uljen e pragut për transaksionet në mes bizneseve dhe është propozuar ulja e këtij pragu nga 500€ në 300€ dhe e njëjta është përfshirë në draft Ligjin e ri për Administratën Tatimore dhe Procedurat i cili ende nuk është aprovuar në Kuvend.</p> <p>2) Është duke u punuar në këtë drejtim, përshkrimi i procesve biznesore është aprovuar ndërsa deri në fund të këtij viti Operatori Ekonomik duhet që të sjell produktin lidhur me modulën për menaxhimin e rrezikut të përmbushjes i cili do avancojë mundësitë ekzistuese në identifikimin, analizimin trajtimin dhe monitorimin e rreziqeve të përmbushjes.</p> <p>3) Projektet e përmbushjes janë në zbatim e sipër në bashkëveprim edhe me Institucionet tjera ligjzbatuese.</p> <p>4) Janë intensifikuar komunikimet dhe bashkëpunimi në mes ATK & IP-së, është hartuar një marrëveshje të re e memorandumit në mes të dyja Institucioneve, janë zhvilluar takimet të shumta edhe gjatë vitit 2021, është aprovuar Plani i Veprimit së bashku me IP lidhur me trajtimin e punësimit joformal dhe janë duke u ndërmarr aktivitete edhe në terren për identifikimin dhe regjistrimin e punëtorëve të pa regjistruar.</p> <p>5) Gjatë këtij viti janë ndërmarr aktivitete të përbashkëta në mes ATK dhe DK-së, bazuar në vlerësimet e rrezikut të të dyja institucioneve, ekipet nga të dyja palët takohen në vazhdimësi për koordinim të aktiviteteve, në këtë drejtim kemi edhe punën që është duke u bërë në hartimin e planit të veprimit për muajt dhe vitin e ardhshëm.</p> <p>6) Kjo pjesë tani është zhvilluar në tërësi dhe është në funksion të zbatimit të saj, përmes së cilës tani po bëhet identifikimi i të gjithë tatimpaguesve për të cilët është mbajtur tatimi i mbajtur në burim.</p> <p>7) Është bërë verifikimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i respektimit të masave përmes së cilës bizneset kanë përfituar nga masat subvencionuese të Qeverisë, dhe janë marr veprime në drejtim që disa nga masat e reja subvencionuese ta kenë kushtin që vetëm bizneset të cilat kanë zbatuar masat paraprake të mundë të përfitojnë nga masat e reja.</p> <p>8) Projektligji i Punës, është përcaktuar në Programin Legjislativ të Qeverisë që të procedohet për miratim në fund të muajit dhjetor 2021. Për shkak të nevojës të rregullimit të disa koncepteve të reja nga marrëdhënia e punës si dhe adresimi i dialogut social në nivel tripartite në projektligj, është propozuar që Projektligji i Punës, të bartet në Programin e ri Legjislativ 2022. Masa konsiderohet se është zbatuar pjesërisht duke marrë parasysh se projektligji është i draftuar në pjesën e tij me të madhe.</p> <p>9) Procesi i ristrukturimit të Inspektoratit të Punës ka filluar paraprakisht me implementimin e disa aktiviteteve përgatitore siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Është hartuar dhe validuar “Raporti me rekomandime për përmirësimin e sistemit të inspektimeve të punës, të përgatitur në mbështetje të Organizatës Ndërkombëtare të Punës; - Është duke u hartuar Paketa e trajnimeve për Inspektorët të Punës 2022-2024 në mbështetje të Organizatës Ndërkombëtare të Punës; - Është duke u përgatitur struktura e re organizative e Inspektoratit të Punës në mbështetje të 	

	Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Punësimi i 20 inspektorëve, nuk është realizuar gjatë vitit 2020.	
	<p>10) Me qëllim të vlerësimit të ekonomisë joformale dhe sigurimit të mbulueshmerisë së plotë të llogarive kombëtare në Kosovë, ASK, respektivisht Divizioni i Ekonomisë Informale dhe Llogarive Qeveritare ka kryer aktivitetet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me asistencën e Bankës Botërore (BB), ASK ka realizuar Anketën e ekonomisë joformale në biznese në katër aktivitete ekonomike: H - Transportimi dhe magazinimi NACE 49; F - Ndërtimtaria NACE 41-43; I - Hotelet NACE 55; I - Restorantet NACE 56. - Në bazë të rezultateve të Anketës së ekonomisë joformale, në kuadër të projektit të mbështetur nga Statistikat Suedeze “Mbështetje për Forcimin e Sistemit Statistikor të Kosovës 2019-2023/Support to Strengthening the Statistical System of Kosovo 2019-2023”, ASK ka përpiluar të dhënat për ekonominë joformale për të njëjtat aktivitete ekonomike për periudhën 2008-2020. Të dhënat janë përpiluar në baza vjetore dhe tremujore, me çmime aktuale dhe konstante. - Rezultatet për ekonominë joformale për aktivitetet: transport rrugor, restorante dhe hotele janë integruar në të dhënat e Bruto Produktit Vendor dhe rezultatet janë publikuar për herë të parë në maj 2021. Të dhënat janë publikuar në baza vjetore (2008-2019), me çmime aktuale dhe konstante. - Në kuadër të Projektit IPA2017 “Metodologjia e Llogarive Kombëtare”, ASK në vitin 2021 ka implementuar metodologjinë sipas standardeve ndërkombëtare për komponentët në vijim: <ul style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i ekonomisë joformale bazuar në kontrollet e auditimit fiskal, 2. Vlerësimi i ekonomisë joformale bazuar në Metodën e Inputit të Punës (Labor Input Method), 3. Vlerësimi i trafikimit të drogës në Kosovë. - Në kuadër të Projektit IPA2019, ASK sapo ka filluar me vlerësimin e ekonomisë joformale për llojin N6 - Keqraportimi i personave të vetëpunësuar. <p>Poashtu, në vazhdimësi janë duke u hulumtuar aktivitete tjera ekonomike dhe fenomene të ekonomisë joformale me ndikim në ekonominë e vendit.</p> <p>Të gjitha aktivitetet e mësipërme janë realizuar në harmoni me metodologjitë dhe standardet ndërkombëtare dhe procesi i përpilimit të të dhënave është i dokumentuar.</p>	
	11) Publikimi i Analizës “Vlerësimi i praktikave më të mira, të realizueshme për Kosovën në zvogëlimin e punësimit joformal” do të behet pasi të përfundohet ristrukturimi i Web-faqes se re te Ministrisë se Financave, Punës dhe Transfereve.	
Masa e reformës #11: Përmirësimi i mjedisit për hulumtim, inovacion dhe ndërmarrësi		Faza e zbatimit të reformës (1-5)
Aktivitetet e planifikuara per 2021	1) Funkcionalizimi i Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe rishikimi i Programit Kombëtar të Shkencës (MASH);	4
	2) Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Inovacion dhe Ndërmarrësi (MEA);	4
	3) Ndërtimi i Sistemit të Informacionit Aktual për Hulumtime (CRIS) (MASH);	4
	4) Hartimi dhe miratimi i 4 UA për fushën e Inovacionit Shkencor dhe Transfer të Dijes Regjistrin e institucioneve inovative shkencore; Transferin e teknologjisë dhe dijes, dhe format e transferit të teknologjisë; Inovacioni shkencor dhe bartësit e inovacionit shkencor) (MASH);	4
	5) Inicimi i procedurave për kalimin nga vend partner në vend të asociuar; në programin Kornizë të BE-së Horizon 2020 (MASH);	4
	6) Hartimi dhe miratimi i Udhëzuesit lidhur me qytetet e mençura (Smart Cities) (MEA);	/

	7) Mbështetja direkte financiare për projektet inovative (start up, studentëve në përkrahje të ndjekjes së mësimit dual;) (MEA).	4
	8) Investimet në qendrat e inovacionit në kuadër të Universiteteve Publike apo shkollave të mesme (MEA).	3
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërishëm ose mos-zbatim	1)Këshilli kombëtarë i shkencës është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës gjatë muajit nëntor 2021	
	2)Drafti final i Projektligjit për inovacion dhe ndërmarrësi është përfunduar, pritet të dal në konsultim publik dhe të shkojë në qeveri për miratim në shkurt të vitit 2022.	
	3)MASHTI është duke mbështetur zhvillimin dhe funksionalizimin e Sistemit Informativ për Kërkim në Kosovë (Kosovo Research Informaiton System – KRIS); Ministria e ka themeluar grupin punues për KRIS, i cili tashmë i ka finalizuar termat e Referencës për Platformën KRIS. Në koordinim me partnerët dhe bashkëpunim edhe me projektin HERAS+ (ADA)	
	4) Lidhur me udhëzimin administrativ MASHTI ka punuar ketë Udhëzim administrativ në hartimin e UA-së për Trasferin e teknologjisë dhe Format e transferit të dijes, si dhe ka themeluar grupin punues për UA-në Regjistrin e Institucioneve inovative shkencore.	
	5)MASHTI ka përfunduar negociatat me BE-ne për avancimin e statusit të Kosovës në Programin Kornizë të Be-së për Hulumtim dhe Inovacion Horizon Europe. Marrëveshja është në fazë e nënshkrimit. Më pas pritet Ratifikimi i Ligjit për marrëveshjen i cili ligj është në planin legjislativ për vitin 2021.	
	6) Udhëzuesi për qytetet e mençura është vlerësuar se duhet të sponzorizohet nga ASHI, pas kalimit të Departamentit të Inovacionit në MINT.	
	7) Mbështetja direkte financiare për projektet inovative për bizneset Start-Up të themeluara para 3 viteve dhe bizneset spin off Start-Up është lançuar në fund të shtatorit dhe është në proces të vlerësimit. Vlera e grant skemës 1,150,000EUR.	
	8) Investimet në qendrat e inovacionit në kuadër të Universiteteve Publike, kanë përfunduar. Qendrat janë në fazën e funksionalizimit të plotë.	
Masa e reformës #12: Shtrirja e infrastrukturës përkatëse të rrjeteve dhe shërbimeve të TIK-ut për zhvillim socio-ekonomik		Faza e zbatimit të reformës (1-5)
Aktivitetet e planifikuara per 2021	1) Hartimi dhe miratimi i Strategjisë për axhendën e ardhshme dixhitale të Kosovës (MEA);	4
	2) Përkrahja për shtrirjen e infrastrukturës mobile 5G (MEA);	4
	3) Krijimi i Stacionit Fiks për monitorim të frekuencave dhe i rrjetit kombëtar për hulumtim dhe edukim (NREN) (MEA);	4
	4) Zhvillimi i trajnimeve për 500 të rinj dhe lidhja e tyre me mundësitë e punëve online – të rinjtë online dhe programi i rritjes (Youth Online and Upward Program – YOU) (MEA);	3
	5) Fillimi i dixhitalizimit të bizneseve tradicionale (ne sektorin e turizmit, bujqësisë dhe përpunimit te drurit dhe metalit) përmes përdorimit të TIK (MEA);	1
	6) Zhvillimi në vazhdimësi i Qendrës së ekselencës dixhitale (furnizimin e pajisjeve dhe funksionimin e QED, pilotimi i 5G) (MEA);	5
	7) Krijimi i sistemit të monitorimit për TIK bazuar në sistemin DESI (Digital Economy and Society Index) (MEA).	1

<p>Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërishëm ose mos-zbatim</p>	<p>1)Hartimi dhe miratimi i Strategjisë për axhendën e ardhshme dixhitale të Kosovës;</p> <p>Procesi i hartimit të Axhendës Dixhitale të Kosovës 2030 është në finalizim e sipër. Për të garantuar një cilësi dhe zbatueshmëri sa më të mirë të dokumentit strategjik, në procesin e hartimit të Axhendës Dixhitale të Kosovës 2030 është angazhuar përmes projektit KODE edhe ekspertiza teknike. Fillimisht është bërë rishikimi i zbatimit të Axhendës së kaluar Dixhitale 2013-2021,si dhe janë analizuar/studiuar rastet e pesë shteteve të përzgjedhura si më relevante për tu marr si shembuj dhe krahasuar me Kosovën. Janë mbajtur disa seri të punëtorive dhe shumë takime të ndara me palë të ndryshme të interesit, përmes të cilave janë identifikuar 5 Objektiva Strategjike, 5-7 Objektiva Specifike për secilën Objektivë Strategjike, si dhe janë identifikuar Aktivitetet konkrete për arritjen e këtyre objektivave. Për çdo aktivitet e objektivë janë definuar edhe afatet, treguesit matës, bartësit, etj. Drafti i konsoliduar pothuajse është i përfunduar dhe gjatë dy muajve në vijim të realizohen procedurat e konsultimit paraprak dhe të konsultimit publik siç janë të përcaktuara me Rregulloren për hartimin e dokumenteve strategjike. Planifikohet se Axhenda Dixhitale e Kosovës 2030 do të mund të miratohet nga Qeveria e Kosovës gjatë TM2 2022.</p>
	<p>2)Përkrahja për shtrirjen e infrastrukturës mobile 5G, përmes programit <u>KODE</u> – gjatë vitit 2021 janë publikuar dy Thirrje për Aplikim për shtrirjen e infrastrukturës brezgjere në zonat e pambuluara dhe dy Thirrje për Aplikim për mbështetje në shtrirjen e infrastrukturës mobile 5G, sipas skemës së granteve për Financimin e Infrastrukturës Dixhitale për aplikues të interesuar. Vlera e përkrahjes është 1,003,000 €.</p> <p>Përmes këtyre dy Thirrjeve janë arritur nënshkrimi dhe zbatimi i 8 Marrëveshjeve, të cilat kanë përfshirë mbulimin me infrastrukturë të komunikimeve elektronike brezgjere të 16 fshatrave dhe lidhjen me internet të familjeve në këto zona.</p> <p>Gjithashtu, përmes dy Thirrjeve për Aplikim për mbështetje në shtrirjen e infrastrukturës mobile 5G janë nënshkruar 12 Marrëveshje të cilat përfshijnë lidhjen me infrastrukturë fikse brezgjere të 21 pircjeve të infrastrukturës mobile (5G ready). Pjesa më e madhe e punëve fizike për zbatimin e këtyre marrëveshjeve kanë përfunduar, por për shkak të ndikimeve të përgjithshme të pandemisë Covid-19 dhe vonesat nga prodhuesit e disa pajisjeve të Teknologjike kanë mbetur pa u finalizuar deri në fillim të vitit 2022.</p> <p>DPTTI dhe KODE/PIU planifikojnë që të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2022 me publikimin e Thirrjeve të reja për përkrahjen e shtrirjes së infrastrukturës mobile 5G.</p>
	<p>3)Krijimin e Sistemit Nacional për Monitorim të Spektrit frekuencor (SNMS) – Në kuadër të nën-komponentës së KODE për krijimin e Sistemit Nacional për Monitorim të Spektrit frekuencor (ang. NSMS) më datë 18.12.2020 është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik zbatues për krijimin e SNMS. Sipas Planit Dinamik të zbatimit të projektit afati për përfundimin e projektit është 15 muaj, pra deri në mars 2022. Pjesa më e madhe e projektit është zbatuar (>80%), duke përfshirë tri nga katër stacionet fikse radiomonitorese, TDMS-in, MMS-in dhe pajisjet e Qendrës Komunikuese të SNMS-së. Zbatimi i projektit pritet që të finalizohet deri në Mars 2022. Vlera e përkrahjes është 1,690,905 €.</p>
	<p>4)Zhvillimi i trajnimeve për të rinj dhe lidhja e tyre me mundësitë e punëve online (Youth Online and Upward Program - YOU) – Projekti është komponenta e tretë e Projektit KODE që do të financojë ofrimin e trajnimeve për të rinjtë dhe lidhjen e tyre me mundësitë për punë në fushën e TIK, duke përfshirë edhe punët online.</p> <p>Përshkak të situatës pandemike dhe hezitimit që këto trajnime të mbahen online ka pasur shtyrje të fillimit të këtyre trajnimeve deri tani. Megjithatë, gjatë kësaj kohe janë pajisur me pajisjet e nevojshme për trajnimet dy salla trajnuese, si dhe janë përgatitur Termat e Referencës dhe tani më janë duke u realizuar procedurat për kontraktimin e ofrimit fillimisht të gjashtë moduleve të ndryshme, të cilat përfshijnë trajnimin e rreth 500 të rinjëve për një nga këto module: Paython, Advanced Network Administrator, Mobile Development, Digital Marketing, Full Stack developer, 3D printing technology, apo IT Essentials. Trajnimet pritet të fillojnë në janar 2022 dhe përfshijnë rreth 300 orë mësimi për secilin nga modulet.</p>

	<p>Deri në fund të projektit do të shtohen edhe module të reja sipas nevojës dhe numri i të trajnuarve është planifikuar të arrijë deri në 2,000. Pritet që përmes këtij trajnimi përfituesit gjithashtu do të rrisin kapacitetet punëkërkuese në tregun lokal të TIK-ut. Vlera 81,780 €</p>														
	<p>5)Projekti “Përkrahja e BE-së për dixhitalizimin e bizneseve përmes TIK” është projekt i financuar nga IPA 2019.. Produkti kryesor i këtij projekti do të jetë krijimi i Sistemit të Identifikimit Elektronik (ID System). Ai synon rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit të sektorit privat nëpërmjet përdorimit të TIK-ut, krijimin e ekosistemit të duhur dhe më të sigurt për e-biznesin dhe tregtinë elektronike duke mundësuar përmirësimin e shërbimeve elektronike për qytetarët dhe biznesin. Zbatimi i projektit menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropin në Kosovë, ndërsa përfitues është Ministria e Ekonomisë. Projekti është në fazën finale të përgatitjes së Termeve të Referencës për zbatimin e projektit.</p>														
	<p>6)Zhvillimi në vazhdimësi i Qendrës së ekselencës dixhitale (furnizimin e pajisjeve dhe funksionimin e QED, pilotimi i 5G);</p> <p>Projekti për krijimin e Qendrës për Ekselencë Dixhitale në Parkun për Inovacion dhe Trajnime në Prizren është në zbatuar. Në këtë fazë projekti ka përfshirë furnizimin, instalimin dhe trajnimin me/për printerë dhe skaner 3D të avancuar dhe softuer (4 x 3D Printerë dhe 1 x 3D Skaner dhe 2 x softuerëve përkatës. Printimi 3D është një nga përparimet më të rëndësishme teknologjike në prodhimin e aditivëve e cila është implementuar dhe njohur si pjesë e industrisë moderne pasi ka shumë avantazhe në krahasim me qasjen konvencionale, nga të cilat disa nga faktorët më të rëndësishëm janë koha, thjeshtësia, besueshmëria e saktësia, etj.</p> <p>Tani, me qëllim të shfrytëzimit të mundësive të krijuara, janë iniciuar procedurat për ofrimin e trajnimeve për “Teknologjitë e printimit 3D” fillimisht për një grup prej 30 të rinjëve të interesuar për këtë fushë të re të zhvillimit teknologjik.</p> <p>Sa i përket Pilotimit 5G – janë në finalizim e sipër Termat e Referencës për iniciimin e projektit për realizimin e Rrjetit mobil 5G në Parkun për Inovacion dhe Trajnime në Prizren. Gjatë TM1 2022 planifikohet të iniciohen procedurat e prokurimit. Vlera 1,169,970 €</p>														
	<p>7)Krijimi i sistemit të monitorimit për TIK bazuar në sistemin DESI (Digital Economy and Society Index).</p> <p>Ky aktivitet nuk ka mundur të realizohet ende.</p>														
<p>Masa e reformës #13: Lehtësimi i tregtisë përmes uljes së kostos së transaksioneve tregtare Faza e zbatimit të reformës (1-5)</p>															
<p>Aktivitetet e planifikuara per 2021</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="310 1373 1192 1430">1) Finalizimi i dokumentit të ri për Politika Tregtare (MINT);</td> <td data-bbox="1192 1373 1453 1430" style="text-align: center;">2</td> </tr> <tr> <td data-bbox="310 1430 1192 1518">2) Plotësim/ndryshimi i Kodit Doganor dhe i Akcizave (KDA) dhe UA për zbatim të KDA, (MF- Dogana) ;</td> <td data-bbox="1192 1430 1453 1518" style="text-align: center;">4</td> </tr> <tr> <td data-bbox="310 1518 1192 1606">3) Miratimi i Ligjit të ri për Tregti të Brendshme dhe Ligjit për Tregti të Jashtme (MINT);</td> <td data-bbox="1192 1518 1453 1606" style="text-align: center;">4</td> </tr> <tr> <td data-bbox="310 1606 1192 1663">4) Fillimi i procesit të negociimit për marrëveshje me vendet e EFTA-së (MINT)</td> <td data-bbox="1192 1606 1453 1663" style="text-align: center;">2</td> </tr> <tr> <td data-bbox="310 1663 1192 1751">5) Miratimi i Rregullores për themelimin e Qendrës Informative për Lehtësira Tregtare nga Qeveria (MTI-Dogana);</td> <td data-bbox="1192 1663 1453 1751" style="text-align: center;">2</td> </tr> <tr> <td data-bbox="310 1751 1192 1839">6) Studimi i fizibilitetit për platformën e projektit NCTS (New Computerized Transit System) (Dogana-MF);</td> <td data-bbox="1192 1751 1453 1839" style="text-align: center;">2</td> </tr> <tr> <td data-bbox="310 1839 1192 1890">7) Ratifikimi i Protokollit Shtesë 5 të CEFTAs për Lehtësimin e Tregtisë;</td> <td data-bbox="1192 1839 1453 1890" style="text-align: center;">2</td> </tr> </table>	1) Finalizimi i dokumentit të ri për Politika Tregtare (MINT);	2	2) Plotësim/ndryshimi i Kodit Doganor dhe i Akcizave (KDA) dhe UA për zbatim të KDA, (MF- Dogana) ;	4	3) Miratimi i Ligjit të ri për Tregti të Brendshme dhe Ligjit për Tregti të Jashtme (MINT);	4	4) Fillimi i procesit të negociimit për marrëveshje me vendet e EFTA-së (MINT)	2	5) Miratimi i Rregullores për themelimin e Qendrës Informative për Lehtësira Tregtare nga Qeveria (MTI-Dogana);	2	6) Studimi i fizibilitetit për platformën e projektit NCTS (New Computerized Transit System) (Dogana-MF);	2	7) Ratifikimi i Protokollit Shtesë 5 të CEFTAs për Lehtësimin e Tregtisë;	2
1) Finalizimi i dokumentit të ri për Politika Tregtare (MINT);	2														
2) Plotësim/ndryshimi i Kodit Doganor dhe i Akcizave (KDA) dhe UA për zbatim të KDA, (MF- Dogana) ;	4														
3) Miratimi i Ligjit të ri për Tregti të Brendshme dhe Ligjit për Tregti të Jashtme (MINT);	4														
4) Fillimi i procesit të negociimit për marrëveshje me vendet e EFTA-së (MINT)	2														
5) Miratimi i Rregullores për themelimin e Qendrës Informative për Lehtësira Tregtare nga Qeveria (MTI-Dogana);	2														
6) Studimi i fizibilitetit për platformën e projektit NCTS (New Computerized Transit System) (Dogana-MF);	2														
7) Ratifikimi i Protokollit Shtesë 5 të CEFTAs për Lehtësimin e Tregtisë;	2														

	8) Finalizimi i negociatave me vendet e CEFTAs për Protokollin Shtesë 7 për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Tregtare;	4
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërishtë ose mos-zbatim	1) Finalizimi i dokumentit të ri për Politika Tregtare- Finalizimi i dokumentit të ri për Politika Tregtare do të filloj në vitin 2022.	
	2) Plotësim/ndryshimi i Kodit Doganor dhe i Akcizave (KDA) dhe UA për zbatim të KDA- Drafti është përfunduar dhe është në kuadër të programit legjislativ të këtij viti.	
	3) Miratimi i Ligjit të ri për Tregti të Brendshme dhe Ligjit për Tregti të Jashtme- Miratimi i Ligjit të ri për Tregti të Brendshme dhe Ligjit për Tregti të Jashtme- Ligjit për Tregti të Jashtme ka kaluar leximin e parë në Parlament dhe ka vazhduar në procedura të mëtutjeshme dhe pritet të kalojë edhe leximin e dytë deri në fund të vitit 2021. Ligji i ri për Tregti të Brendshme amandamentimi i këtij ligji do të bëhet në vitin 2022.	
	4) Fillimi i procesit të negociimit për marrëveshje me vendet e EFTA-së- Fillimi i procesit të negociimit për marrëveshje me vendet e EFTA-së do të fillojë në vitin 2022	
	5) Miratimi i Rregullores për themelimin e Qendrës Informativ për Lehtësira Tregtare nga Qeveria (MTI-Dogana)- Pasi që kjo rregullore rrjedh nga AP5, ende nuk ka hyrë në program legjislativ.	
	6) Studimi i fizibilitetit për platformën e projektit NCTS (New Computerized Transit System) (Dogana-MF);- nuk është nënshkruar marrëveshja, çështja ka mbetur tek Ministria e Financave	
	7) Ratifikimi i Protokollit Shtesë 5 të CEFTAs për Lehtësimin e Tregtisë- Protokollit Shtesë 5 të CEFTA-së për Lehtësimin e Tregtisë nuk është ratifikuar për arsye të mos trajtimit të përfaqësimit në CEFTA. AP5 mbetet për t'u miratuar nga niveli politik; megjithatë, vonesat e deritanishme për mos ratifikimin e protokollit kanë të bëjnë me emërtimin ose jo trajtimin e barabartë të pozitës së Kosovës në kuadër të marrëveshjes CEFTA, nga e cila rrjedh ky protokoll dhe është nënshkruar nga UNMIK-u në emër të Kosovës.	
	8) Finalizimi i negociatave me vendet e CEFTAs për Protokollin Shtesë 7 për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Tregtare- Negociatat për Protokollin Shtesë 7 për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Tregtare në kuadër të CEFTA-së janë në përfundim. Kosova ka ofruar komentet profesionale për miratimin dhe zbatimin të tij në mënyrë të barabartë.	
Masa e reformës #14: Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës së cilësisë dhe fuqizimi i rolit të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut me fokus produktet e ndërtimit		Faza e zbatimit të reformës (1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2021	1) Përmbyllja e fazës së tretë e asistencës teknike për dy (2) prodhuesit e produkteve ndërtimore si në vijim, betoni i gatshëm, produkte për shtrim nga betoni: bllaqe, pllaka dhe bordura;	5
	2) Hartimi i planit të veprimit për transpozimin e Rregullores së BE-së 2019/1020 për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Përputhshmërinë e produkteve dhe Rregullores 2019/515 Njohjen Reciproke të Mallrave (DIC-IT);	2
	3) Miratimi i planit kombëtar për plotësimin e obligimeve nga nenet 34-36 TFEU (Traktati për funksionimin e Bashkimit Evropian), për pjesën e fushës së pa harmonizuar të legjislationit (dispozitave kombëtare) teknik dhe jo teknik (DIC);	5
	4) Aprovimi i koncept dokumentit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve (DIC);	5

	5) Krijimi i skemës së akreditimit të trupave certifikues (EN ISO/IEC 17065) duke përfshirë edhe kërkesat e rregullave teknike; (DAK/DIC - MTI);	2
	6) Akreditimi i tre laboratorëve testues/kalibruës të AMK-së (Laboratori i vëllimit dhe rrjedhjes, Laboratori i masës dhe Laboratori i forcës dhe presionit)- (AMK/MTI);	3
	7) Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve (transpozimi i Direktivës 2001/95/EC).	3
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërisht ose mos-zbatim	<p>1) Është përmblyllë asistencë teknike tek dy (2) prodhuesit e produkteve ndërtimore, është ngritë Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë (QMS) dhe Kontrolli i Prodhimit në Fabrike (FPC) me çka konfirmohet se këta prodhues i kanë përmbushë të gjitha kërkesat teknike ligjore dhe kërkesat e standardeve në përputhje me Ligjin 06/L-033 për Produkte e Ndërtimit, Udhëzim Administrativ (MTI) Nr. 07/2020 për përcaktimin e kushteve për vendosjen e betonit të gatshëm në treg dhe Udhëzim Administrativ (MTI) Nr. 06/2020 për caktimin e kushteve për vendosjen e produkteve për shtrim nga betoni në treg. Në kuadër të këtij aktiviteti është përmblyllë misioni i fundit i asistencës teknike nga projekti “Lëvizja e lirë e mallrave” tek prodhuesit e betonit dhe elementeve të betonit, “Titan Beton” dhe “Shalaj” prej datës 07 deri 18.06.2021.</p> <p>Me dt.18.06.2021 është mbajtur punëtori me prodhuesit e produkteve të ndërtimit në të cilën janë paraqitë eksperiencat e dy prodhuesve të cilët kanë përfituar asistencën teknike nga Projekti FMG.</p> <p>Gjithashtu gjatë këtij misioni janë përgatitë tre akte nënligjore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzim Administrativ (MINT) Nr.05/2021 për vendosjen në treg të pllakave terace , - Udhëzim Administrativ (MINT) Nr. 04/2021 për vendosjen në treg të detyrave dhe dritareve, dhe - Draft-Udhëzim Administrativ (MINT) Nr. xx/2021 për vendosjen në treg të produkteve për izolim termik. <p>Vlera 13,000.00 Euro.</p>	
	<p>2) Është përgatitë drafti i parë i Planit të Veprimit për transpozimin e Rregullores së BE-së 2019/1020 për Mbikëqyrjen e Tregut dhe Përputhshmërinë e produkteve dhe Rregullores 2019/515 Njohjen Reciproke të Mallrave, aktivitet ky i cili është duke u mbështetur nga Projekti i Lux-Dev. Gjithashtu në kuadër të këtij aktiviteti është mbajtur Punëtori dy ditore me Grupin punues ndërministror (Vendimi (QRK) Nr.21/16, dt.22.06.2021) për koordinimin e punës së të gjitha ministrive kompetente në lidhje me legjislacionin teknik i cili është përgjegjës për zbatimin e detyrave që dalin nga lëvizja e lirë e mallrave në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Kosovës.</p> <p>Vlera 4,900.00 Euro.</p>	
	<p>3) Me Vendimin e Qeverisë të Nr.22/16, dt.22.06.2021 është miratuar Programi për Eliminimin e Barrierave Teknike në Tregti 2021-2025 (nenet 34-36 TFEU Traktati për funksionimin e Bashkimit Evropian).</p> <p>Vlera 7,000.00 Euro.</p>	
	<p>4) Me Vendimin e Qeverisë të Nr.21/34, dt.08.09.2021 është miratuar Koncepti Dokumenti për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve.</p> <p>Vlera 5,000.00 Euro.</p>	
	<p>5) Është realizuar trajnimi i stafit të DAK-së në standardin ISO/IEC 17065, akreditimi për qëllime të notifikimit të trupave certifikues për materiale të ndërtimit. Ky trajni është realizuar në mbështetje të projektit PTB (29.09.2021).</p>	

	<p><i>Koment: Këtë skemë të akreditimit DAK nuk ka arritur që ta ngris për arsye se nuk është paraqitur asnjë aplikim për akreditim të trupave certifikes.</i></p>												
	<p>6) Akreditimi i tre laboratorëve testues/kalibrues të AMK-së (Laboratori i vëllimit dhe rrjedhjes, Laboratori i masës dhe Laboratori i forcës dhe presionit) është në fazën e vlerësimit nga Organi Akreditues i Turqisë (TURKAK). Deri në fund të muajit dhjetor 2021, do të kryhet faza finale e vlerësimit dhe raportimi lidhur me akreditimin e laboratorëve të lartcekur. Nga Projekti “FMG II” është kryer pagesa me vlerë prej 9,400.00 euro për TURKAK, për vlerësimin e tre laboratorëve për akreditim.</p>												
	<p>7) Është përgatitë drafti i projekt-Ligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve i cili transponzon Direktivën Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve 2001/95/KE dhe Direktivën mbi produktet mashtruese 87/357 /EEC. Në bashkëpunim me projektin “Lëvizja e lirë e mallrave” është mbajtur punëtori (dt.09.07.2021) me ekspertin e projektit FMG i cili ka qene i angazhuar në përgatitjen e draft - Ligjit Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të MINT, MSH, AUV. <i>Koment: Për shkak volumit të ligjeve të cilat janë në procedurë të hartimit gjatë vitit 2021, MINT ka vendos që projektligji për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve të jete pjesë e planit legjislativ të Qeverisë në vitin 2022 (K1-K2).</i></p> <p>Vlera 5,000.00 Euro.</p>												
<p>Masa e reformës #15: Rritja e gjithëpërfshirjes dhe cilësisë së edukimit në fëmijërinë e hershme</p>													
<p>Aktivitetet e planifikuara per 2021</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="310 894 1192 947"></th> <th data-bbox="1192 894 1453 947">Faza e zbatimit të reformës (1-5)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="310 947 1192 1035">1) Miratimi i Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, (MASHTI);</td> <td data-bbox="1192 947 1453 1035">3</td> </tr> <tr> <td data-bbox="310 1035 1192 1123">2) Finalizimi i draftit dhe miratimi i kurrikulës bërthamë, e cila përmban 5 fusha, për edukimin në fëmijërinë e hershme, (MASHTI);</td> <td data-bbox="1192 1035 1453 1123">2</td> </tr> <tr> <td data-bbox="310 1123 1192 1211">3) Hartimi dhe miratimi i 5 udhëzuesve praktikë për pilotimin e kurrikulës bërthamë, (MASHTI);</td> <td data-bbox="1192 1123 1453 1211">2</td> </tr> <tr> <td data-bbox="310 1211 1192 1299">4) Trajnimi i deri 100 edukatorëve në fazën e pilotimit për zbatimin e kurrikulës bërthamë, (MASHTI);</td> <td data-bbox="1192 1211 1453 1299">2</td> </tr> <tr> <td data-bbox="310 1299 1192 1304">5) Përfundimi i ndërtimit të 6 objekteve të reja të institucioneve parashkollore si dhe fillimi i ndërtimit të një objekti të ri (MASHTI);</td> <td data-bbox="1192 1299 1453 1304">5</td> </tr> </tbody> </table>		Faza e zbatimit të reformës (1-5)	1) Miratimi i Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, (MASHTI);	3	2) Finalizimi i draftit dhe miratimi i kurrikulës bërthamë, e cila përmban 5 fusha, për edukimin në fëmijërinë e hershme, (MASHTI);	2	3) Hartimi dhe miratimi i 5 udhëzuesve praktikë për pilotimin e kurrikulës bërthamë, (MASHTI);	2	4) Trajnimi i deri 100 edukatorëve në fazën e pilotimit për zbatimin e kurrikulës bërthamë, (MASHTI);	2	5) Përfundimi i ndërtimit të 6 objekteve të reja të institucioneve parashkollore si dhe fillimi i ndërtimit të një objekti të ri (MASHTI);	5
	Faza e zbatimit të reformës (1-5)												
1) Miratimi i Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, (MASHTI);	3												
2) Finalizimi i draftit dhe miratimi i kurrikulës bërthamë, e cila përmban 5 fusha, për edukimin në fëmijërinë e hershme, (MASHTI);	2												
3) Hartimi dhe miratimi i 5 udhëzuesve praktikë për pilotimin e kurrikulës bërthamë, (MASHTI);	2												
4) Trajnimi i deri 100 edukatorëve në fazën e pilotimit për zbatimin e kurrikulës bërthamë, (MASHTI);	2												
5) Përfundimi i ndërtimit të 6 objekteve të reja të institucioneve parashkollore si dhe fillimi i ndërtimit të një objekti të ri (MASHTI);	5												
<p>Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërisht ose mos-zbatim</p>	<p>1.Projektligji për Fëmijërinë e Hershme është hartuar si draft i parë. Projektligji është në diskutim me kabinetin e ministres për të vazhduar pastaj me diskutim paraprak publik dhe diskutim publik. Miratimi i projektligjit për edukimin në fëmijërinë e hershme, pritet të miratohet në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2022.</p> <p>2)Kurrikula bërthamë do të fillojë së shpejti të hartohet. Pritet të formohet grupi punues ne fillim e vitit 2022</p> <p>3)Ky proces është i ndërlidhur me kurrikulën bërthamë.</p> <p>4)Ky proces është i ndërlidhur me kurrikulën bërthamë.</p> <p>5)Me investime nga komuna e Rahovecit janë ndërtuar 3 çerdhe -janë kryer ndërtimet.</p> <p>Me investime nga MAP pritet që deri në fund të vitit 2021 të përfundoj ndërtimi i 1 çerdhe në komunën e Prizrenit.</p> <p>Sipas marrëveshjes së MASHTI dhe komunave Viti dhe Gjilan kanë përfunduar rifunksionalizimi i 2 shkollave në çerdhe për fëmijë, në komunat e Vitisë dhe Gjilanit.</p>												

	Sipas marrëveshjes së MASHTI me komunën e Istogut ka filluar ndërtimi i 1 çerdhe në këtë komunë.	
Masa e reformës #16: Zbatimi i kornizës së re kurrikulare në sistemin e arsimit dhe aftësisë profesionale		Faza e zbatimit të reformës (1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2021	1) Miratimi i Kornizës së Kurrikulës për sistemin e AAP, rishikimi i kurrikulave dhe përpilimi i udhëzuesve për zbatim të kurrikulës bërthamë (MASHTI);	4
	2) Rishikimi i formulës së financimit për AAP duke përcaktuar kriteret e financimit të cilat bëhen përmes grantit specifik për arsim (MASHTI); 105	4
	3) Hartimi dhe miratimi i udhëzimit administrativ për vlerësimin e studentëve të AAP-së, përmes inkuadrimin të përfaqësuesve të punëdhënësve (MASHTI);	5
	4) Pilotimi i platformës dixhitale në fushën e TIK (MASHTI/MTI/ATK);	5
	5) Funkcionalizimi i sistemit për bashkëpunim me biznesin edhe për 10 shkolla të AAP (MASH).	3
	6) Lidhja me programin Master një vjeçar për mësuesit në shërbim të ofruar nga Fakulteti i Edukimit me fakultetet e synuara (p.sh. Mekatronika dhe Bujqësia) për të siguruar vendosjen praktike të mësuesve të AAP-së (MASH);	3
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërisht ose mos-zbatim	1) Janë zhvilluar/rishikuar 85 kurrikula bërthamë për klasën e 10, 11, dhe 12. Po ashtu është hartuar edhe udhëzuesi për implementim të kurrikulave dhe është prezantuar dhe shpërndarë të të gjitha IAAP. Për 14 kurrikulat bërthamë të aprovuara janë hartuar edhe pakot mësimore (standardi i profesionit, materialet mësimore dhe kurrikula) dhe janë mbajtur edhe trajnimet për 108 mësuesit të shkollave të cilat kanë filluar implementimin.	
	2) Është hartuar formula e financimit dhe mundësit e financimit në AAP dhe është prezantuar të të gjithë akteret relevant përfshirë 64 shkolla profesionale. Po ashtu është përfunduar platforma dixhitale “Planifiko VET” në të cilën tani kanë qasje të gjitha shkollat profesionale.	
	3) Është përfshirë në UA për Mësimin në Vendin e Punës.	
	4) Është përfunduar platforma dixhitale në fushën e TIK-ut në bashkëpunim me Oden Ekonomike.	
	5) Sistemi i ri për bashkëpunimin me biznesin është duke u zbatuar në 12 shkolla profesionale ku janë krijuar 62 organe industriale me 120 biznese të përfaqësuara.	
	6) Në fazën e inicimit të aktiviteteve me MASHTI dhe Fakultetin e Edukimit (UP). Është realizuar analiza e kualifikimit të mësuesve të AAP-së.	
Masa e reformës #17: Ngritja dhe sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë përmes fuqizimit të AKA dhe profilizimit të institucioneve të arsimit të lartë		Faza e zbatimit të reformës (1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2021	1) Miratimi i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (MASHTI);	4
	2) Miratimi i Projektligjit për Arsimin e Lartë (MASHTI);	2
	3) Plotësimi i personelit dhe fuqizimi i kapaciteteve të AKA-së përmes rekrutimit të 20 zyrtarëve të rinj (AKA/MASHTI);	2
	4) Themelimi i “Qendrës së kompetencës për lidhje me industrinë” në 2 fakultete të Universitetit të Prishtinës (MASH);	3

	5) Themelimi i Zyrove Kërkimore dhe planeve kërkimore në Universitetet Publike dhe mbështetja e aksesit në platformat anti-plagjiaturë dhe bibliotekave elektronike.	3
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërisht ose mos-zbatim	1)Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim tani më ka përfunduar të gjitha procedurat dhe është përcjellë në Qeverinë e Kosovës për miratim.	
	2)Është plotësuar/ndryshuar grupi punues i Projektligjit për Arsimin e Lartë me përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë dhe të shoqërisë civile. Janë duke u mbajtur takimet me grupin punues. Planifikohet që ky projektligj të miratohet gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2022.	
	3)Zyrtarët do të rekrutohen gjatë vitit 2022-2023. Ende nuk është miratuar nga MAP fillimi i procedurave.	
	4)Memorandumi i Mirëkuptimit i nënshkruar nga tre bashkëthemeluesit (UP, Qyteti i Prishtinës dhe OEK). Janë zhvilluar dokumentet për funksionalizim të qendrës (Akti themelimit, Statuti, Plani biznesit) dhe është nënshkruar Akti i Themelimit nga dy partner dhe është në pritje të nënshkrimit nga ana e UP-së.	
	5)Në kuadër të projektit Erasmus + “Ngritja e Kulturës Kërkimore në Arsimin e Lartë në Kosovë (ResearchCult)” të gjitha universitetet publike në Kosovë kanë themeluar Zyrat Kërkimore (për hulumtim) dhe koordinatorët përgjegjës si dhe planet kërkimore. Në sistemin antiplagjiaturë (sistemi anglez Plagiarismcheck.org) të gjitha universitetet publike në Kosovë kanë akses në librarinë elektronike EBSCO akses për tri vite (2021-2024).	
Masa e reformës #18: Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve publike të punësimit dhe aftësimin profesional, rritja e punësimit të të papunëve afatgjatë, të rinjve, grave dhe grupeve tjera të cenueshme.		Faza e zbatimit të reformës (1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2021	1) Hartimi dhe miratimi i ciklit të ri të Politikës së Punësimit 2021 – 2024 (MPMS);	3
	2) Hartimi dhe miratimi i Projektligjit të ri të Punës (MPMS);	3
	3) Zgjerimi i shërbimeve të punësimit dhe aftësimin profesional me shërbime të reja (orientimi në karrierë, njohja e mësimin paraprak dhe hapja e një profili të ri në QAP në bazë të kërkesave të tregut të punës) për klientët e Zyrove të Punësimit dhe Qendrat e Aftësimin Profesional (APRK/MPMS);	5
	4) Zbatimi i MATP-ve nga pakoja emergjente për periudhën pas Covid 19 për të paktën 3,000 të papunë afatgjatë, me fokus tek grupet e cenueshme si të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara (APRK/MPMS);	5
	5) Rishikimi dhe zhvillimi i 5 Kurrikulave, paketave mësimore duke u bazuar në standardet e profesionit, botimi i teksteve për 5 Kualifikime dhe validimi i 5 profileve të aftësimin profesional (APRK/MPMS);	3
	6) Zhvillimi i një (1) studimi gjurmues të përfituesve të shërbimeve të punësimit (APRK/MPMS);	3
	7) Mbështetja e së paku 5 projekteve rinore në fushën e TIK dhe trajnimi i së paku 100 të rinjve në këtë fushë (MKRS);	5
	8) Realizimi i studimit të fizibilitetit për Skemën Kreditore të të Rinjve (Youth Guarantee Scheme).	5

<p>Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërisht ose mos-zbatim</p>	<p>1) Politika e Punësimit 2021 – 2021 është e përcaktuar të hartohet në Planin e Punës të Ministrisë. Për shkak të sqarimit, definimit, se a do të jetë politikë sektoriale e punësimit vetëm për Agjencinë e Punësimit, apo politikë ndër sektoriale, si aktivitet është bartur për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022. Pavarësisht kësaj ne kemi punuar në draftin e politikës së punësimit, tek pjesa e trendëve të përgjithshme duke i përditësuar të dhënat e nevojshme, ndërsa ka mbetur të definohet se a do të jetë politikë sektoriale apo ndër sektoriale për ta përmbyllur si aktivitet.</p>
	<p>2) Projektligji i Punës, është përcaktuar në Programin Legjislativ të Qeverisë që të procedohet për miratim në fund të muajit dhjetor 2021. Për shkak të nevojës të rregullimit të disa koncepteve të reja nga marrëdhënia e punës si dhe adresimi i dialogut social në nivel tripartite në projektligji, është propozuar që Projektligji i Punës, të bartet në Programin e ri Legjislativ 2022. Masa konsiderohet se është zbatuar pjesërisht duke marrë parasysh se projektligji është i draftuar në pjesën e tij më të madhe.</p>
	<p>3) Shërbimet Publike të Punësimit kanë filluar në ofrimin e shërbimeve të Orientimit në Karrierë në Zyrat e Punësimit. Janë trajnuar stafi i Zyrave të Punësimit dhe procesi është duke vazhduar. Sa i përket zgjerimit të shërbimeve të Aftësimit Profesional me mbështetje të DVV-Internacional është bërë hapja e profilin të Instalimeve Elektrike në QAP-Mitrovicë, ku nga donatori është bërë edhe furnizimi i punëtorisë me pajisje, vegla dhe materiale të këtij profili dhe pagesa e pagës së trajnerit për një vit, po ashtu me mbështetje të projektit GIZ është bërë blerja dhe furnizimi me pajisje moderne për profilin e Rrobaqepësisë në Mitrovicë dhe Prizren, gjithashtu është bërë edhe shtypja e librave për nevojat e profesionit Metal Punues, që veç është akredituar në nivelin e IV sipas AKK. Këtë vit kemi filluar edhe një shërbim të ri në Qendrat e Aftësimit Profesional Gjilan dhe Mitrovicë Njohja e Mësimit Paraprak, ku dhe jemi akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve në profilin e Saldimit.</p>
	<p>4) Sa i përket zbatimit të MATP-ve gjate këtij viti janë përfshirë 3267 persona, ku prej tyre gra janë 2048, te rinjë 1035, persona me aftësi të Kufizuara 13 persona. Ndërsa në Aftësim Profesional janë përfshirë 2761 persona, ku prej tyre gra janë 798, te rinjë 1058, ndërsa persona me aftësi 5</p>
	<p>5) Sa i përket rishikimit dhe zhvillimit të kurrikulave të reja në kuadër të QAP-ve me mbështetjen e donatorit GIZ është rishikuar dhe hartuar kurrikula për Metal Punues në nivelin e IV sipas AKK. Po ashtu me mbështetjen e projektit të EYE ka filluar zhvillimi i kurrikulave, Murator, Zdrukthëtar, Instalues Elektrik dhe Nëpunës i Kontabiliteti. Ky aktivitet ka filluar në shtator 2021 dhe do përfundojë në mars 2022, (sqarim : ky aktivitet mbështetet ekskluzivisht nga donatori dhe duke i parë rrethanat e krijuar nga pandemia ky aktivitet ka filluar pak me vonës)</p>
	<p>6) Është duke u bërë studimi gjurmues për shërbimet e punësimit që është duke u mbështetur nga projekti GIZ dhe ka për qëllim matjen e efektivitetit të shërbimeve të punësimit me theks të veçante të masave aktive të tregut të punës. Studimi tjetër gjurmues është duke u zhvilluar për shërbimet e aftësimit profesional, ku mbështetet nga projekti Lux-Development. Ky gjurmim mbështet arsimin dhe aftësimin profesional për të rritur në Kosovë, ku përfitues direkt është MASHTI, janë të përfshira të gjitha institucionet e AAP, ku përfitues është edhe Agjencia e Punësimit. Implementimi do të bëhet nga Edgurd, ndërkaq punën teknike /profesionale do të bëjë Global CT. Aktivitetet do të jenë ndaras, që i bie për pjesën e QAP do të jemi përgjegjës APRK.</p>
	<p>7) Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit në kuadër të objektivës “Ofrimi i shkathësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës”, këtë vit ka përkrahur së paku 8 Projekte në fushën e TIK, ku përmes këtyre projekteve do të përfitojnë trajnimi në fushën e TIK së paku 150 të rinjve në këtë fushë.</p>
	<p>8) Konform rekomandimeve të KE lidhur me shikimin e mundësive për të zbatuar Youth Guarantee Scheme, Qeveria e Kosovës ka adoptuar përpjekjet e para dhe përgatitja e studimit të fizibilitetit për zbatimin e Youth Guarantee scheme ishte bërë pjesë e planifikimeve vjetore, dhe obligim për Ministrinë e Linjës. Përgatitja e studimit të fizibilitetit mbi mundësinë e implementimit për zbatimin e Youth Guarantee scheme ishte pjesë e Plani të Punës së Qeverisë 2020. Në ndërkohë nga RCC ishte informuar se RCC planifikonte të ndihmonte vendet e rajonit në përpilimin e studimeve të fizibilitetit mbi mundësinë e implementimit të Youth guarantee scheme, iniciativë e cila ishte mirëpritur. RCC me kete rast kishte kontraktuar University College Wisdom për të bërë Studimin. Një studim i tillë është përfunduar i cili pritet të publikohet së shpejti. Qeveria e Republikës së</p>

	Kosovës ka treguar interesim dhe përkushtim në këtë drejtim, dhe punësimi i të rinjve si prioritet, duke përfshirë hapat për iniciimin e implementimit të Youth Guarantee scheme, do të jenë edhe pjesë e Programit të ri të Qeverisë si dhe Planeve vjetore të Qeverisë. Ndërkaq gjatë kësaj kohe sa jemi duke raportuar ka filluar procesi për hartimin e draft Planit të Implementimit për Youth Guarantee, (ekipi teknik, caktimi i koordinatorit për YG);	
Masa e reformës #19: Përmirësimi i shërbimeve sociale, shëndetësore dhe fuqizimi i grupeve të përjashtuara		Faza e zbatimit të reformës (1-5)
Aktivitetet e planifikuara për 2021	1) Hartimi dhe miratimi i Ligjit të Shërbimeve Sociale Familjare dhe Ligjit të Skemës së Ndihmës Sociale dhe akteve nënligjore (MPMS);	4
	2) Miratimi i Ligjit të Financave Lokale dhe hartimi i Udhëzimit Administrativ për formulën e financimit për shërbime sociale dhe familjare (Grantin e veçantë për shërbime sociale) (MPMS);	2
	3) Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve si dhe për trajtimin e aftësisë së kufizuar (MPMS); 117	1
	4) Mbështetja e sektorit joqeveritar të licencuar (50 OJQ) dhe ndërmarrjeve sociale të regjistruara (30 ndërmarrje), me grante dhe subvencione për ofrimin e shërbimeve sociale dhe punësimin e grupeve të cenueshme (MPMS);	4
	5) Nënshkrimi i (3) Marrëveshjeve Bilaterale dhe Multilaterale për Sigurimet Sociale me vende të BE (MPMS);	2
	6) Pilotimi i Testit të Varfërisë, për kategoritë sociale, bazuar në Manualin Operativ (MPMS);	5
	7) Rritja e kapaciteteve infrastrukturore dhe profesionale në fushën e parandalimit, testimit, trajtimit dhe inspektimit për të luftuar Covid 19 (MSH);	5
	8) Plotësim ndryshimi i Ligjit për Sigurim Shëndetësor, hartimi i legjislacionit dytësor për përcaktimin e kriterëve për lirim nga pagesa e kontributit (MSH).	2
Përshkrimi i zbatimit dhe shpjegimi nëse kemi zbatim të pjesërisht ose mos-zbatim	1) Është finalizuar Projektligji për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe është dorëzuar tek Departamenti Ligjor për hapat tjerë të përgatitjes së Deklaratave, Memorandumit Shpjegues dhe Vlerësimit të Ndikimit Buxhetor, , ndërsa është krijuar Grupi Punues për hartimin e Projekt Ligjit per Skemën e Ndihmës Sociale, ku draft I-rë pritet të finalizohet deri në fund të këtij viti. Janë hartuar pesë(5) Udhëzime Administrative nga fusha e Shërbimeve Sociale dhe gjatë(6) Udhëzime Administrative janë hartuar dhe pritet të procedohen në konsultime paraprake gjatë muajit dhjetor/2021 Kostoja e këtij aktiviteti ka qenë rreth 100,000.00 euro, e cila është mbuluar nga bashkëpunimi me donatorët	
	2) Është hartuar Ligji i ri për Financat e Pushtetit Lokal, në kuadër të cilit është paraparë krijimi i Grantit Specifik për Shërbime Sociale. Projektligji ka kaluar fazën e konsultimeve publike, është pjesë e Planit Legjislativ për vitin 2021. Kostoja e këtij aktiviteti ka qenë rreth 10,000.00 euro, e cila është mbuluar nga bashkëpunimi me donatorët	
	3) Ligjit Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti është shtyre për vitin e ardhshëm, ndërsa Projektligji për vlerësimin, njohjen e statusit, përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, është në fazën e finalizimit nga Grupi Punues.	

	<p>Kostoja e këtij aktiviteti ka qenë rreth 10,000.00 euro</p>
	<p>4) Mbështetja e sektorit joqeveritar të licencuar në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për vitin 2021, ka qenë për (39) OJQ të licencuara.</p> <p>Kostoja e aktivitetit ku janë ndarë mjetet buxhetore ka qenë 900,000.00 euro, e cila është mbuluar nga Buxheti i Kosovës</p>
	<p>5)Në vitin 2021 është arritur një Marrëveshje Bashkëpunimi në fushën e Sigurimeve Shoqërore në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Po ashtu një Marrëveshje Bashkëpunimi në mes Republikës se Kosovës dhe Republikës se Shqipërisë është arritur edhe për fushën e mbrojtjes së fëmijëve.</p> <p>Nuk ka ndonjë identifikim të kostos për këtë aktivitet</p>
	<p>6)Është finalizuar Manuali Operativ për lirim nga pagesa e sigurimeve sociale për kategoritë sociale dhe softueri, i cili është pilotuar në dhe testuar nga gjithë Qendrat për Punë Sociale.</p> <p>Kostoja e këtij aktiviteti ka qenë rreth 50,000 euro, e cila është mbuluar nga Granti Zviceran pjesë e Kredisë me Banke Botërore</p>
	<p>7) Sa i përket aktivitetit të planifikuar në vitin 2021 për Rritja e kapaciteteve infrastrukturore dhe profesionale në fushën e parandalimit, testimin, trajtimin dhe inspektimin për të luftuar Covid 19 mund të konsiderohet se është zbatuar në tërësi pasi që janë rekrutuar 1450 profesionist shëndetësor që janë angazhuar për një periudhë 6 mujore. Për këtë aktivitet janë ndarë nga Qeveria 4.5 milion euro si mjete të kredisë së Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës CEB.</p>
	<p>8) Sa i përket ligjit për sigurim shëndetësor në vitin 2021 është hartuar drafti i projektligjit por që me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë projektligji për sigurim shëndetësor, projektligji për shëndetësi janë tërhequr nga programi legjislativ pasi që si pasojë e angazhimit me menaxhim të pandemisë COVID 19 nuk kanë mundur të finalizohen në 2021. Këto projektligje do të barten në programin legjislativ 2022. Ky aktivitet nuk ka pasur kosto financiare.</p>

SHTOJCA 2: LIDHJET MES FUSHAVE TË REFORMËS DHE DOKUMENTEVE TË POLITIKËS PËRKATËSE

Masat e reformës PRE 2022-2024	Sfidat kryesore strukturore (Vlerësimi i Komisionit për PRE 2021-2023)	Udhëzimet e politikave të PRE 2021	Paketa e Zgjerimit 2021	Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm 2020-2030	Axhenda e Gjellbër dhe Marrëveshja e Gjellbër Evropiane për Ballkanin Perëndimor	Axhenda Dixhitale Evropiane / Axhenda Dixhitale e Ballkanit Perëndimor	Projektet IPA III që mbështesin këtë reformë
Masa e reformës #1: Përshtatja e Arsimit dhe Aftësisit Profesional me nevojat e tregut të punës	Sfida kryesore #1: Përmirësimi i cilësisë dhe rëndësisë së sistemit arsimor për të rritur punësimin dhe zbutur mospërputhjet e aftësive.	Konkluzioni i përbashkët 6b: Zhvilloni një sistem për monitorimin dhe parashikimin e nevojave për aftësitë në tregun e punës për të lehtësuar harmonizimin e sistemeve të arsimit dhe aftësisit si dhe ofrimin e rikualifikimit dhe ngritjes së aftësive me nevojat e tregut të punës.	Kjo masë reformuese adreson rekomandimet për miratimin e ligjit dhe harmonizimin e mëtejshëm të politikës së AAP-së me nevojat e tregut të punës.	OZHQ - lidhet me objektivin 4 Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxëniet gjatë gjithë jetës për të gjithë. Treguesit 4.3, 4.4, 4.5, 4.6 dhe 4b.		<i>Objektivi i BE-së për vitin 2030:</i> “Një kontinent me njohuri teknologjike ku të gjithë janë të fuqizuar në mënyrë dixhitale” <i>AD e BB-së:</i> 6.4.5. Korniza Evropiane e Kompetencës Dixhitale për Qytetarët dhe mbështetja nga Fondacioni Evropian i Trajnimit	
Masa e reformës #2: Rritja dhe sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë përmes fuqizimit të AKA-së dhe profilizimit të institucioneve të arsimit të lartës	Sfida kryesore #1: Përmirësimi i cilësisë dhe rëndësisë së sistemit arsimor për të rritur punësimin dhe zbutur mospërputhjet e aftësive.	Konkluzioni i përbashkët 6a: Të zbatohen tërësisht mekanizmat ekzistues të sigurimit të cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit nëpërmjet rritjes së inspektimeve të shkollave dhe efektivitetit të koordinatorëve të cilësisë, si dhe monitorimit të programeve të studimit nga	Projektligji për AKA adreson të gjitha rekomandimet e AESC (ENQA), të kërkuara nga AESC	OZHQ - lidhet me objektivin 4 Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxëniet gjatë gjithë jetës për të gjithë. Treguesit 4.3, 4.4, 4.5 dhe 4b		<i>AD e BB-së:</i> 6.4.4. HEInnovate <i>Kompasi dixhital 2030: Mënyra evropiane për Dekadën Dixhitale:</i> 3.1 Një popullatë e aftë dixhitale dhe profesionistë shumë të aftë dixhitalë	

		Agjencia e Akreditimit..					
Masa e reformës #3: Rritja e punësimit, ulja e pasivitetit, formalizimi, zhvillimi i aftësive profesionale, përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve publike të punësimit dhe aftësimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës me theks të veçantë për grupet e cenusshme.	Sfida kryesore #1: Përmirësimi i cilësisë dhe rëndësisë së sistemit arsimor për të rritur punësimin dhe zbutur mospërputhjet e aftësive..	Konkluzioni i përbashkët 6 (a dhe b) – të përmendur më lartë. Përveç, c: Krijoni një task forcë ndërministrorë që përfshin ministrinë përkatëse, agjencitë e tyre dhe palët e interesuara për të zhvilluar një Plan Zbatimi të Garancisë Rinore.	Kjo masë e reformës adreson rekomandimet për zgjerimin e masave aktive të tregut të punës për punësimin afatgjatë të të rinjve, grave, personave me aftësi të kufizuara.	OZHQ - lidhet me objektivin 8 Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirë dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë dhe produktiv dhe punës së denjë për të gjithë. Treguesit 8.2, 8.3, 8.5, 8.6, dhe 8b.		<i>Objektivi i BE-së për vitin 2030:</i> “Një kontinent me njohuri teknologjike ku të gjithë janë të fuqizuar në mënyrë dixhitale”; <i>Objektivi i BE-së për vitin 2030:</i> “Kontinenti me një përqindje të lartë të bizneseve të dixhitalizuara” <i>AD e BB-së:</i> 6.4. Aftësitë Dixhitale	IPA 2022 BE 4 Zhvillimi gjithëpërfshirës socio-ekonomik: 7,100,000.00 Euro
Masa e reformës #4: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore			Masa e propozuar është një nga prioritetet më të rëndësishme në sistemin shëndetësor, ndryshimi i Ligjit për sigurime shëndetësore dhe adreson rekomandimet nga Raporti për vendin.	OZHQ - lidhet me objektivin 3 Siguroni jetë të shëndetshme dhe promovoni mirëqenien për të gjithë në të gjitha moshat. Treguesit 3.8, 3.c dhe 3.b		<i>Objektivi i BE-së për vitin 2030:</i> “Shërbime publike të modernizuara që i përgjigjen nevojave të shoqërisë” <i>Kompasi dixhital 2030: Mënyra evropiane për Dekadën Dixhitale:</i> 3.4 Dixhitalizimi i shërbimeve publike <i>AD e BB-së:</i> 6.3. e-shëndetësia	
Masa e reformës #5: Zhvillimi i politikave të EE dhe BRE-ve në funksion të tranzicionit të gjelbër	Sfida kryesore #3: Përdorimi i potencialit të energjisë së rinovueshme dhe kursimit të energjisë dhe hapja e plotë e tregut të energjisë	Konkluzioni i përbashkët 4: Miratimi i një strategjie koherente afatgjate të energjisë dhe klimës për uljen e emetimeve të karbonit, duke përfshirë planet për	Ka të bëjë me Raportin për Kosovën 2021 - pika - 5.3.2. Energjia. Respektivisht, zbatoni projektet e energjisë eficientë në komuna dhe paraqitni stimuj për	OZHQ - lidhet me objektivin 7 Sigurimi i qasjes në energji të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë. Treguesit 7.2	Lidhet me shtyllën I - Klima, energjia, mobiliteti. 2.1.1. Rritja e ambicieve klimatike të BE-së për 2030 dhe 2050. 2.1.4. Ndërtimi dhe rinovimi në mënyrë efikase të energjisë dhe burimeve.	<i>Kompasi dixhital 2030: Mënyra evropiane për Dekadën Dixhitale:</i> 3.4 Dixhitalizimi i shërbimeve publike	Ndërtimi i një centrali fotovoltaike diellor - 15 milionë euro, 2022

		<p>heqjen graduale të subvencioneve të qymyrit dhe lëndëve djegëse fosile, sipas zotimit të Deklaratës së Sofjes. Në përputhje me zotimet e Axhendës së Gjelbër për Ballkanin</p> <p>Perëndimor: rritja e stimujve të energjisë efçiente për sektorin privat dhe familjet dhe përmirësimi i skemave mbështetëse për projektet e energjisë së rinovueshme me prezantimin e ankandeve/ofertave konkurruese;</p>	<p>energjinë efçiente në sektorët rezidencialë dhe privatë. Si dhe përmirësoni skemat mbështetëse për projektet e energjisë së rinovueshme duke futur ofertën konkurruese për mbështetjen për burimet e rinovueshme.</p>				
<p>Masa e reformës #6: Reformimi i tregut të energjisë</p>	<p>Sfida kryesore #3: Përdorimi i potencialit të energjisë së rinovueshme dhe kursimit të energjisë dhe hapja e plotë e tregut të energjisë</p>		<p>Ka të bëjë me Raportin për Kosovën 2021 - pika - 5.3.2. Energjia. Për sa i përket tregut të brendshëm të energjisë, mbetet i nevojshëm zbatimi i hapjes së tregut me pakicë, si dhe rregullimi gradual i tarifave të energjisë, duke reflektuar rritjen e pritshme të kostove dhe masat zbutëse për konsumatorët e cenueshëm.</p>	<p>OZHQ - lidhet me objektivin 7 Sigurimi i qasjes në energji të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë. Treguesit 7.1, 7.2, 7.3, 7.a, 7.b.</p>	<p>Lidhet me shtyllën I - Klima, energjia, mobiliteti.</p> <p>2.1.2. Furnizimi me energji të pastër, të përballueshme dhe të sigurt.</p>		<p>Energjia efçiente në sektorin publik - 3 milionë euro, 2022</p>
<p>Masa e reformës #7: Ulja e ndotjes së mjedisit dhe ruajtja e biodiversitetit</p>			<p>Lidhet me Raportin për Kosovën për vitin 2021 - pika 5.3.4. Mjedişi dhe ndryshimet</p>	<p>OZHQ - lidhet me objektivin 13 Merrni masa urgjente për të luftuar ndryshimin klimatik dhe ndikimet e tij [b].</p>	<p>Lidhet me shtyllën III – pa ndotje dhe shtyllën V – Biodiversiteti.</p>	<p><i>Kompasi dixhital 2030: Mënyra evropiane për Dekadën Dixhitale:</i> 3.3 Transformimi dixhital i bizneseve</p>	<p>IPA 2021</p> <p>1. Ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të zeza</p>

			<p>klimatike. Respektivisht, Raporti për Kosovën thekson se nevojitet zotim politik për të adresuar degradimin e mjedisit dhe sfidat e ndryshimeve klimatike.</p>	<p>Treguesit 13.2, 13.3, 13.a 15.a.</p>	<p>2.1.7. Ruajtja dhe restaurimi i ekosistemeve dhe biodiversitetit. 2.1.8. Një ambicie zero ndotje për një mjedis jo toksik. 2.2.1. Ndjekja e financave dhe investimeve të gjelbra dhe sigurimi i një tranzicioni të drejtë. 2.2.3. Mobilizimi i kërkimeve dhe nxitja e inovacionit. 2.2.4. Aktivizimi i arsimit dhe aftësisimit.</p>		<p>në Kosovën B (12 mil Euro) 2. Mbështetja e BE-së për ajrin e pastër (Plani për uljen e dioksidit të squfurit (SO₂)) (2 mil Euro) 3. Mbështetja për Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (2 milionë euro)</p> <p>IPA 2022 1. Avancimi i Ekonomisë Qarkore dhe Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave në Kosovë (ACCENT) (kostoja totale 11.4 milionë euro, granti IPA 9.9 milionë euro) Rrjeti i kanalizimit dhe ujërave të shiut në Prishtinë (kostoja totale 43.4 milion Euro, granti i IPA-s 20 milion Euro).</p>
<p>Masa e reformës #8: Zgjerimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të TIK-ut për zhvillimin socio-ekonomik, shërbimet publike të avancuara, si dhe</p>			<p>Lidhet me Raportin për Kosovën 2021 - pika -5.2.1. Shoqëria e informacionit dhe media. Respektivisht, Raportin për Kosovën thekson se Kosova duhet të sigurojë që tregjet të</p>			<p>Të gjitha objektivat e BE-së: Objektivi i BE-së për vitin 2030: “Infrastruktura dixhitale e besueshme dhe e sigurtë e nivelit të lartë”;</p>	<p>Mbështetja e BE-së për konkurrencën e sektorit të TIK-ut të Kosovës IPA 2019</p>

dixhitalizimin e sistemit arsimor			jenë vërtetë konkurruese, duke përfshirë portabilitetin e numrave, pa të cilën burimet e numërimit nuk mund të përdoren në mënyrë efektive.			<p>Objektivi i BE-së për vitin 2030: “Një kontinent me njohuri teknologjike ku të gjithë janë të fuqizuar në mënyrë dixhitale”;</p> <p>Objektivi i BE-së për vitin 2030: “Kontinenti me një përqindje të lartë të bizneseve të dixhitalizuara”;</p> <p>Objektivi i BE-së për vitin 2030: “Shërbime publike të modernizuara që i përgjigjen nevojave të shoqërisë”</p> <p><i>AD e BB-së:</i> 5.1. Lidhja dixhitale brezgjere</p> <p>5.2. Aspektet e uljes së kostos brezgjere</p> <p>6.1. e-Qeverisja</p> <p>6.4. Aftësitë Dixhitale</p> <p>7.1. Besimi</p> <p>7.2. Siguria kibernetike</p> <p>7.3. Dixhitalizimi i industrive dhe qendrave të inovacionit dixhital</p> <p>8.2. Kërkime në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK-u)</p>	
Masa e reformës #9: Përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes duke ulur barrën administrative,			Kjo masë adreson rekomandimet e Raportit për Vendin 2021 dhe konkluzionet e Nënkomitetit në	OZHQ - lidhet me objektivin 8, treguesit 8.2, 8.3, 8.10, 8.a. Lidhet me objektivin 16 - Promovimi i shoqërive paqësore dhe		<p><i>Kompasi dixhital 2030: Mënyra evropiane për Dekadën Dixhitale:</i> 3.4 Dixhitalizimi i shërbimeve publike</p>	Programi për Uljen e Barrës Administrative - IPA 2021, 4.5 mil euro

reforma e inspektimit			lidhje me ndryshimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe një nga prioritetet kryesore të sektorit, zhvillimin e reformës së inspektimit..	gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.			
Masa e Reformës #10: Reduktimi i ekonomisë informale	Sfida kryesore #2: Formalizimi i ekonomisë dhe konkurrueshmëria e ulët e sektorit privat.	Konkluzioni i përbashkët 5: Përditësoni planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare 2019–2023 për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Informale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimin Financiar, dhe siguron zbatimin e tij. Zbatimi i masave nxitëse me synimin për të formalizuar punësimin dhe bizneset informale dhe adresimin e evazionit fiskal në sektorët e identifikuar me rrezik të lartë në përputhje me strategjinë dhe planin e veprimit. Me qëllim parandalimin e evazionit të tatimit mbi të ardhurat në pronë, të përmirësohet transparenca duke	Kjo masë e reformës adreson rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së qeverisjes në ekonomi dhe rritjen e burimeve financiare për shërbimet publike duke rritur të ardhurat tatimore dhe zbatimin e strategjisë për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë informale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimin financiar.				

		publikuar të gjitha çmimet e shitjes së pronave të paluajtshme					
Masa e Reformës #11: Përmirësimi i mjedisit për kërkime, inovacion dhe ndërmarrësi			Kjo masë synon të plotësojë sistemin e AAP-së me kualifikime formale dhe kualifikime të të nxëniet gjatë gjithë jetës, duke përfshirë njohjen e mësimit paraprak (RPL) bazuar në kërkesat e tregut të punës.	OZHQ - lidhet me objektivin 8 Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimi i plotë dhe produktiv dhe puna e denjë për të gjithë. Treguesit 8.2, 8.3; objektivi 9, treguesit 9.5 dhe 9.b.		<p><i>Objektivi i BE-së për vitin 2030: “Kontinenti me një përqindje të lartë të bizneseve të dixhitalizuara”</i></p> <p><i>Kompasi dixhital 2030: Mënyra evropiane për Dekadën Dixhitale: Transformimi dixhital i bizneseve</i></p> <p><i>AD e BB-së:</i> 6.5. Inovacioni dhe ekosistemet e start-up-ve – Evropa e Start-up-ve 7.3. Dixhitalizimi i industrive dhe qendrave të inovacionit dixhital 8.2. Kërkime në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK-u)</p>	
Masa e Reformës #12: Përmirësimi i tregtisë ndërkufitare nëpërmjet lehtësimit të tregtisë			Kjo masë adreson rekomandimet për zvogëlimin e deficitit tregtar afatgjatë të Kosovës duke zgjeruar tregtinë në shërbime, duke ratifikuar dhe zbatuar Protokollin Shtesë 5, 6 dhe 7 të CEFTA-s dhe zbatimin e zotimeve sipas Planit të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal 2021-2024.	OZHQ - lidhet me objektivin 8 Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimi i plotë dhe produktiv dhe puna e denjë për të gjithë. Treguesit 8.a; Objektivi 17 forcon mjetet e zbatimit dhe revitalizon Partneritetin Global për Zhvillim të Qëndrueshëm	Pika 2 e Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane: Transformimi i ekonomisë së BE-së për të ardhmen e qëndrueshme; nën-pika 2.1.3. Mobilizimi i industrisë për një ekonomi të pastër dhe qarkore (Teknologjitë dixhitale janë një mundësues kritik për arritjen e qëllimeve të qëndrueshmërisë së marrëveshjes së gjellbër në shumë sektorë të ndryshëm	<p><i>AD e BB-së:</i> 6.1. e-Qeverisja 7.1. Besimi</p>	

<p>Masa e reformës #13: Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës cilësore dhe fuqizimi i rolit të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut</p>			<p>Kjo masë e reformës reflekton rekomandimet për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së në fushën e infrastrukturës së cilësisë dhe rritjen e kapaciteteve zbatuese në veçanti të organeve të vlerësimit të konformitetit dhe mbikëqyrjes së tregut.</p>	<p>OZHQ - lidhet me objektivin 9 për ndërtimin e infrastrukturës reziliente, promovimin e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitjen e inovacionit. Treguesit 9.1, 9a.</p>	<p>Pika 2 e Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane: Transformimi i ekonomisë së BE-së për të ardhmen e qëndrueshme; nën-pika 2.1.3. Mobilizimi i industrisë për një ekonomi të pastër dhe qarkore (Industritë me intensitet energjie, si çeliku, kimikatet dhe çimentoja, janë të domosdoshme për ekonominë e Evropës, pasi ato furnizojnë disa zinxhirë të vlerave kryesore).</p>		<p>IPA 2021 BE për Tregtinë dhe Tregun e Brendshëm</p> <p>5,500,000.00</p>
<p>Masa e reformës #14: Zhvillimi dhe modernizimi i mëtejshëm i Transportit</p>			<p>Lidhet me Raportin për Kosovën 2021 - pika -5.3.1. Politika e transportit. Respektivisht, Raporti për Kosovën ku thekson se Kosova duhet të përmbushë rekomandimet e CONNECTA-s për mirëmbajtjen e hekurudhave dhe rrugëve, inspektimet e sigurisë rrugore, sistemet inteligjente të transportit dhe vendosjen e një sistemi të të dhënave të aksidenteve ende nuk janë zbatuar.</p>	<p>OZHQ - lidhet me objektivin 11 Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta dhe reziliente dhe të qëndrueshme. Treguesit 11.2.</p>		<p>Objektivi i BE-së për vitin 2030: “Infrastruktura dixhitale e besueshme dhe e sigurtë e nivelit të lartë”;</p>	
<p>Masa e reformës #15: Ndryshime strukturore në sektorin e bujqësisë</p>			<p>Lidhet me Raportin për Kosovën 2021 – pika 5.4.1. Bujqësia, Raporti për Kosovën thekson se Kosova duhet të bëjë një vlerësim cilësor të</p>	<p>OZHQ - lidhet me objektivin 2 Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i ushqyerjes, si dhe nxitja e bujqësisë së</p>	<p>Lidhet me shtyllën IV - Bujqësia e qëndrueshme dhe prodhimi i ushqimit. 2.1.6. Nga 'ferma në tryezë': projektimi i një sistemi të drejtë, të shëndetshëm</p>		

			efektivitetit të pagesave direkte dhe programeve të zhvillimit rural. Kosova është në proces të krijimit të një sistemi të integruar informativ bujqësor duke rritur dhe përmirësuar ndërlidhjen e elementeve ekzistuese, të cilat përfshijnë sistemin e administrimit dhe kontrollit (IACS), sistemin informativ të tregut bujqësor (AMIS) dhe rrjetin e të dhënave të kontabilitetit në ferma (FADN).	qëndrueshme. Treguesit 2.3, 2.4, 2.5, 2.a, 2.b, 2.c.	ushqimor dhe miqësor ndaj mjedisit.		
Masa e reformës # 16: Rritja e konkurrencës në industrinë e prodhimit			Kjo masë adreson rekomandimet për miratimin e një Strategjie për të mbështetur mjedisin e biznesit dhe zhvillimin industrial të Kosovës dhe zhvillimin e përgjithshëm të ndërmarrjeve dhe politikës industriale.	OZHQ - lidhet me objektivin 9 Ndërtimi i infrastrukturës reziliente, promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit. 5 Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.		Objektivi i BE-së për vitin 2030: “Infrastruktura dixhitale e besueshme dhe e sigurtë e nivelit të lartë”;	IPA 2021 BE për Tregtinë dhe Tregun e Brendshëm 5,500,000.00 Euro
Masa e reformës # 17: Rritja e konkurrencës në sektorin e turizmit dhe hotelerisë			Kjo masë reflekton rekomandimet lidhur me detyrimet që dalin nga ligji për turizmin si dhe zhvillimin e përgjithshëm të sektorit të turizmit.	OZHQ - lidhet me objektivin 8 Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimi i plotë dhe produktiv dhe puna e denjë për të gjithë. Treguesit 8.9.			

<p>Masa e reformës # 18: Rritja e konkurrencës në sektorin e tregtisë së shërbimeve</p>			<p>Kjo masë reflekton rekomandimet për heqjen e barrierave të identifikuar për të drejtën e vendosjes/themelimit dhe lirinë për të ofruar shërbime duke zbatuar më tej ligjin për shërbimet.</p>	<p>OZHQ - lidhet me objektivin 8 Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimi i plotë dhe produktiv dhe puna e denjë për të gjithë. Treguesit 8.a. OZHQ, Objektivi 17, forcimi i mjeteve të zbatimit dhe revitalizimi i partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm.</p>	<p>Gjithashtu, dokumenti mbi Tregun e Përbashkët Rajonal, i cili rezultoi nga Samiti i Sofjes, thekson miratimin e një pakete për liberalizimin e tregtisë së shërbimeve, ndër të tjera, dhe mundëson ofrimin e shërbimeve pa themelimin e detyrueshëm dhe autorizimin, në përputhje me Kapitullin 3 të acquis së BE-së, mundëson mobilitetin e studentëve, studiuesve dhe profesorëve dhe krijon një treg rajonal të tregtisë elektronike duke miratuar rregulla thelbësore të harmonizuara dhe parime të tregut të brendshëm, duke lehtësuar zhdoganimin e parcelave dhe duke hequr gjeo-blokimin.</p>		
